

UNITED  
NATIONS  
United Nations  
Interim  
Administration  
Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission  
d'Administration  
Intérimaire des  
Nations Unies au  
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**TRANSKRIPTI**

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS TË  
MBAJTUR MË 19 DHE 20.1.2006 DHE TË VAZHDUAR  
MË 14 DHE 15 SHKURT 2006**

**TRANSKRIPT**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE 19 I 20.01.2006 I NASTAVLJENA  
14 I 15 FEBRUARA 2006 GOD**

*Janar – Januar 2006*



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**RENDI I DITËS**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligji për inspektoratin shëndetësor,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për edukimin parashkollor,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Minierat dhe mineralet,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për metrologjinë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Radio Televizionin e Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës,
8. Raporti i Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për familjen,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmjetësim,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për konfliktet administrative,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit kundër shpifjes dhe fyerjes,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ditën e Dëshmorit,
13. Debat sipas kërkeses së Grupit parlamentar të Partisë reformiste ORA,
14. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e pavarur për ankesa,
15. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Agjencisë për prokurim publik,
16. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Rregullatorit të energjisë,
17. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit,
18. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për buxhet dhe financa lidhur me buxhetin e ART-së për vitin 2006,
19. Përgjigjja e ministres, Melihate Tërmkolli, në kërkesën për interpelancë të Grupit parlamentar të PDK-së,
20. Propozimi i Rendit të ditës për seancën plenare me 9 shkurt 2006,



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**DNEVNI RED**

1. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice;
2. Drugo razmatranje Nacrta zakona o zdravstvenoj inspekciji;
3. Drugo razmatranje Nacrta zakona o predškolskom vaspitanju;
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o rudnicima i mineralima;
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o metrologiji;
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Radioteleviziji Kosova;
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o pravosudnom ispitu;
8. Izveštaj Komisije za sudska pitanja, zakonodavstvo i Ustavni okvir u vezi sa UNMIK- ovim primedbama na Zakon o porodici;
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona o posredovanju;
10. Prvo razmatranje Nacrta zakona o upravnim sporovima;
11. Prvo razmatranje Nacrta zakona protiv kleveta i uvreda;
12. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Danu palog borca;
13. Rasprava po zahtevu parlamentarne Grupe reformisticke partije ORA,
14. Razmatranje Predloga Vlade o imenovanju članova u Nezavisnom bordu za žalbe;
15. Razmatranje Predloga Vlade o imenovanju članova u Bordu Agencije za javnu nabavku;
16. Razmatranje Predloga Vlade o imenovanju članova u Bordu Regulatora energetike;
17. Razmatranje Predloga o imenovanju članova u Savetu Agencije protiv korupcije,
18. Razmatranje Preporuke Komisije za budžet i finansije u vezi sa budžetom RAT-a za 2006. godinu;
19. Odgovor ministarke Melihate Termkolli na zahtev sa interpelacijom Parlamentarne grupe PDK;
20. Predlog dnevnog reda za plenarnu sednicu od 9. februara 2006. godine;



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**A G E N D A**

1. Approval of the meeting minutes of the previous session,
2. Second discussion of the Draft-Law on Health Inspectorate,
3. Second discussion of the Draft-Law on Pre-School Education,
4. Second discussion of the Draft-Law on Mines and Minerals,
5. Second discussion of the Draft-Law on Metrology,
6. Second discussion of the Draft-Law on Radio-Television of Kosovo,
7. Second discussion of the Draft-Law on Bar Examination,
8. Report of the Commission on Judicial, Legislative and Constitutional Framework Affairs on UNMIK objections on the Family Law,
9. First discussion of the Draft-Law on Mediation,
10. First discussion of the Draft-Law on Administrative Conflicts,
11. First discussion of the Draft-Law on Defamation and Insult,
12. First discussion of the Draft-Law on the Heroes Day,
13. Debate at request of the Parliamentary Group ORA,
14. Discussion of the Kosovo Government proposal on appointment of the members of the Independent Board of Complaints,
15. Discussion of the Kosovo Government proposal on appointment of the members of the Public Procurement Agency,
16. Discussion of the Kosovo Government proposal on appointment of the members of the Energy Regulatory Board,
17. Discussion of the Kosovo Government proposal on appointment of the members of the Anti-Corruption Agency,
18. Discussion of the Budget and Finance Committee recommendation on the budget of ART for 2006,
19. The reply of the Minister Melihate Termkolli, at request for interpellation of the Parliamentary Group of PDK,
20. Proposal of the Agenda for the plenary session of 9 February 2006,

Seanca u mbajt në sallën solemne të Kuvendit të Kosovës dhe filloi në orën 10,00.

Seancën e kryesoi akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.  
Bashkëkryesues: Naim Maloku

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëmëngjesi. Mirë se erdhët në seancën plenare. Ju lutem të instalohen kartelat identifikuese për shkak të problemeve që kishim në fillim. Të pranishëm janë 88 deputetë, kështu që mund ta fillojmë punën. Materialet shpresoj se i keni marrë me kohë, si dhe rendin e ditës dhe të gjitha dokumentet për këtë seancë plenare. Për fjalë është paraqitur. Berat Luzha lidhur me bllokadën e rrugës Kaçanik – Hani i Elezit.

Ju lutem mikrofonti Berat Luzhës. Po ashtu edhe kjo është jashtë rendit të ditës ,pastaj edhe ju do ta merrni fjalën.

DEPUTETI BERAT LUZHA:

Z. kryetar, të nderuar deputetë,

Po bëhet gati një javë që pas shembjes së gurëve është mbyllur për kalim porta kryesore e Kosovës, rruga Prishtinë – Hani i Elezit në Grykën e Kaçanikut. Kjo rrugë jo vetëm që e lidh Kosovën me Maqedoninë, siç është thënë, por njëkohësisht është lidhja e vetme e Hanit të Elezit me rrethinën- me disa fshatra të komunës së Kaçanikut, me qendrën komunale dhe me Kosovën.

Popullsia e kësaj ane që ka më se 15.000 banorë, tash është e rrezikuar shumë ,shumë më tepër se nga gurët e shembur. Autoritetet e pilot- njësisë komunale të Hanit të Elezit, të alarmuar kanë pohuar se të sëmurit me dializë nuk mund të shkojnë në spital, se nënat nuk mund të barten për lindje, se të sëmurit kronikë nuk kanë ku ta marrin ndihmën e shpejtë dhe se furnizimi me artikuj ushqimorë po bëhet problem i madh. Deri tash këtë zonë të rrezikuar nuk e ka vizituar asnjë përfaqësues i institucioneve tona, madje çdo bisedë që është kërkuar nga përfaqësuesit e Hanit të Elezit në ministrinë përkatëse nuk është realizuar. Bllokimi i rrugës nuk dihet sa do të zgjatë. Ata që e kanë mbyllur rrugën nuk kanë menduar se në raste të tilla detyrimisht duhet të krijohet rrugë alternative, që në këtë rast ka mundur të bëhet shumë shpejt dhe shumë lehtë, ndoshta për 3 – 4 orë.

Mbyllja e rrugës nëpër Grykën e Kaçanikut tregoi edhe një herë çfarë rëndësie strategjike ka ndërtimi i rrugës Hani i Elezit – Qafë Shqipe, e gjatë vetëm 9 km , që do t'i lidhte dy pikat kufitare. Qe tre vjet komuna e Kaçanikut ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që ta ndërtojë këtë rrugë me prioritet, por kot. Vallë kush do ta merrte përgjegjësinë për vdekjen eventuale të ndonjë të sëmuri për pamundësi dërgimi në spital. Andaj ,propozoj që një grup i deputetëve menjëherë t'i bëjë një vizitë zyrtare pilot- njësisë komunale të Hanit të Elezit, komunës së Kaçanikut dhe rajonit të rrezikuar. Duhet t'i rekomandohet Qeverisë të shkojë në këtë rajon të rrezikuar dhe ta përcjellë gjendjen nga afër, të aftësohet menjëherë një kalim alternativ i pikës së rrezikuar, të aftësohet për kalim emergjent edhe rruga ekzistuese Hani i Elezit – Qafë Shqipe, që është në gjendje

shumë të keqe. Kërkoj nga Kuvendi që për këto propozime të votohet sot dhe ato të miratohen. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Berat ju faleminderit. Unë besoj se në pauzat që do t'i kemi gjatë ditës- kërkesa është e arsyeshme dhe nuk kemi pse të votojmë dhe as të mos e votojmë,- por besoj se do të realizohet, sepse është urgjente.

Për fjalë janë paraqitur z. Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë, pastaj Ferid Agani, Teuta Sahatçia dhe Hydajet Hyseni.

Ju lutem ,kam informatë se përkthimi nuk funksionon. Le ta rregullojë regjia. Urdhëroni z. Xhavit Haliti.

#### DEPUTETI XHAVIT HALITI:

Z. kryetar, të nderuar kolegë.

U paraqita për fjalë, jo sipas rendit të ditës, por për një çështje që është duke na shqetësuar të gjithë kosovarëve , si shqiptarët, ashtu edhe të gjitha nacionalitetet e Kosovës, si në institucione ,sikur edhe qytetarët.Fjala është për siguri.

Ne kemi dëgjuar këtu dy herë përfaqësuesit e UNMIK-ut dhe të Shërbimit Policor të Kosovës lidhur me sigurinë në Kosovë. Konstatimet janë mediatike, herë siguria është më e mirë dhe herë më e keqe, varësisht kush vritet dhe "sa vonon të vritet dikush". Realiteti është se qindra vrasje të bëra natën, ditën, me maska, pa maska, nuk janë zbuluar ende, por rasti i fundit kur forcat e policisë, uniformat e policisë ,vrasin qytetarë, është i pajustificueshëm për këto organe, prandaj kërkoj që institucionet e obliguara për ruajtjen e sigurisë të vijnë dhe të japin llogari në Parlament dhe në të njëjtën kohë kërkoj që Qeveria e Kosovës, përkatësisht kryeministri i saj, të kërkojë shkarkimin hierarkik për përgjegjësitë që i kanë lidhur me dy vrasjet e bëra në Pejë dhe në Vushtrri nga vetë uniformat e policisë. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Xhavit, ju faleminderit. Fjalën e ka Ferid Agani, të përgatitet Teuta.

#### DEPUTETI FERID AGANI:

Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë. Paraqitem në emër të Grupit Parlamentar për Integrim me një propozim për zgjerimin e rendit të ditës të kësaj seance plenare. Çështja qëndron në situatën para takimit të Vjenës të paralajmëruar për 25 janar. Grupi Parlamentar për Integrim konsideron se Grupi Negociator duhet të dalë para këtij kuvendi me një informatë lidhur me momentin e përgatitjeve për këtë takim, madje në kuptim të dokumentit për decentralizim, për të cilin është arritur pëlqimi në grupin politik strategjik në kuptim të përbërjes së Delegacionit të Kosovës për këtë takim, me qëllim që të hapet debati për qëndrimin e Kuvendit të Kosovës lidhur me paralajmërimet në media për pjesëmarrjen e deputetit të Kuvendit të Kosovës dhe të kryetarit të Komitetit për

Interesat e Komuniteteve dhe të Kthimit, Ranxhell Nojkiq, si pjesë e Delegacionit të Serbisë në këtë takim dhe për këto qëndrime të Kuvendit të njoftohet edhe kryenegociatori Ahtisari. Mendoj se debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës do të jetë në konformitet të plotë me atë që kemi premtuar si Kuvend i Kosovës, se do të jemi në vazhde të të gjitha vendimeve të rëndësishme, në procesin e negociatave dhe se do të jemi në shërbim të transparencës së plotë të këtij procesi. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Varet nga seanca, por z. Agani sa për informim, këtu janë tre anëtarë të delegacionit. Në momentin sa më të shpejtë të duhur, pas takimit, ne do ta informojmë dhe besoj se është qëndrim i plotë i Delegacionit të ketë transparencë me Kosovën, në veçanti me Parlamentin. Nuk ka asnjë arsye që Delegacioni të mos raportojë në Kuvend, por nuk e besoj që në këtë moment, për shkak të shumë rrethanave të papërshtatshme mund ta bëjë në këtë seancë. Besoj se kjo do të jetë obligim edhe për Kryesinë dhe për Delegacionin, pra, do të kemi informacion dhe raport. Në qoftë se seanca plenare e vlerëson se duhet të jetë në fund, por pa përgatitje nuk e shoh të arsyeshme, sepse seancat janë publike, besoj se më tepër do ta dëmtonin procesin se që do t'u ndihmonin Parlamentit dhe deputetëve. Me- gjithë- këtë ka kohë dhe deputetët mund të mendojnë çfarë informate duhet t'u sigurojmë, që nuk është e përgatitur.

Fjalën e ka Teuta Sahatçija, të përgatitet Hydajet Hyseni.

#### DEPUTETJA TEUTA SAHATQJA:

Faleminderit z. kryetar. I nderuari kryetar, e nderuara Qeveri dhe të nderuar deputetë. Së pari desha t'ia jepja përkrahjen deputetit të PDK-së Berat Luzhës, që ngriti një çështje jetike, një çështje shumë të rëndësishme për banorët e asaj ane. Në vazhdim desha ta bëja një kritikë për udhëheqjen e seancës, duke pasur parasysh se rendi i ditës është pika e parë që do të duhej të shqyrtohej këtu. Gjithashtu mosfunksionimi i përkthimit simultan është një pikë shumë e dobët që tregon se funksionimi i Kuvendit nuk është ndër pikat më me përparësi. Duhet të kihet parasysh më tepër kush punon, a keni njerëz të aftë që do ta ndihmojnë punën sa më të mirë të deputetëve dhe të seancës. Desha të di a është kjo seancë e radhës apo e jashtëzakonshme, duke pasur parasysh se grupi ynë parlamentar, i mbështetur në 40 nënshkrime të deputetëve, që e paraqesin një të tretën e deputetëve, e ka parashtruar kërkesën për seancë të jashtëzakonshme dhe si e tillë ajo seancë do të duhej të procedohej në Kuvend para se të fillonte procedura e rregullt e Kuvendit.

Më lejoni ta citoj rregullën 23 pika 5 të Rregullores së Kuvendit, ku thuhet: "Kryesia me nismën e vet ose me kërkesën e kryeministrit apo të një a më shumë grupeve parlamentare, që përfaqësojnë jo më pak se një të tretën e deputetëve, përkatësisht të 40 deputetëve në Kuvend, thërret seancën e jashtëzakonshme, në mënyrë që ta trajtojë një çështje të ngutshme dhe në këtë rast shqyrtohen vetëm çështjet që e përbëjnë bazën e kërkesës". Kërkesa e grupit tonë e mbështetur në 40 nënshkrime të deputetëve për seancën e jashtëzakonshme është protokolluar më 7 nëntor 2005 me numër protokolli 02-808. Në shkresë parashtrohet kërkesa për debat lidhur me mënyrën e vendimmarrjes për

ndërtimin e Qendrës Administrativo – Protokollare në Gërmi, si dhe debati lidhur me shpenzimet buxhetore të Kuvendit të Kosovës për periudhën janar – qershor 2005. Kjo kërkesë nuk mund të trajtohet si pikë e rëndomtë e rendit të ditës në seancën e rregullt në bazë të Rregullores së punës, prandaj kërkojmë që kjo rregull e Rregullores, që ky Kuvend e ka miratuar, të respektohet dhe kjo pikë të jetë pika e parë dhe e vetme e jo pika e 13-të e rendit të ditës të seancës së rregullt. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Ju faleminderit. Fjalën e ka z. Hydajet Hyseni, të përgatiten Gjylnaze Syla dhe Naser Osmani, i fundit dhe pastaj do të vendosim.

**DEPUTETI HYDAJET HYSENI:**

Faleminderit z. kryetar. Më lejoni që edhe unë ta mbështes qëndrimin e paraqitur pak më parë nga parafolësja dhe duke e përshëndetur praktikën e re të vendosur tani të përmirësuar të krijimit të agjendës së Kuvendit, jam i detyruar që edhe një herë ta shtroj çështjen e pyetjeve parlamentare. Çështjen që e kam shtruar në mbledhjen e mëparshme të Kuvendit, është shtruar edhe nga deputetët e tjerë në raste të tjera. Megjithatë ishte propozuar dhe ishte konkret, duhet të merret qëndrim që në mbledhjen vijuese të rezervohet një pikë e veçantë për pyetjet e deputetëve. Ne jemi të obliguar ta respektojmë këtë, duke pasur parasysh edhe Rregulloren e Kuvendit sipas së cilës punojmë. Mirëpo kjo nuk po ndodh kështu, i kam shtruar dy pyetje parlamentare, së paku 3 – 4 muaj më parë që kanë të bëjnë me çështjen që edhe atëherë ishte e ngutshme, por tani janë edhe më emergjente. Fjala është për të dëmtuarit nga tërmeti në Gjilan, shumica e të cilëve edhe sot janë pa asnjë përkujdesje dhe merrni me mend çka do të thotë në këto kushte ajo gjendje. Shtrohet pyetja, natyrisht, çka ndodhi me paratë e ndara edhe nga ky Kuvend dhe nga Qeveria? Kjo shumë nuk është e vogël. Çështja e dytë ka të bëjë me të zhvendosurit nga regjioni i Preshevës dhe të tjera. Në pyetje kërkohej përgjigje çka ka bërë Qeveria për këto dy çështje të ndjeshme?. Z. kryetar, më lejoni ta ngre zërin kundër këtij qëndrimi injorues, për të mos thënë më shumë të Qeverisë dhe të ministrave, ndaj pyetjeve të deputetëve. Dëshirojmë që kjo praktikë të ndërpritet. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Z. Hyseni, për informatën tuaj dhe të deputetëve. Kryesia në takimin e fundit ka vendosur ta mbajë një mbledhje të veçantë për programin 3- mujor të ardhshëm. Janë kërkesat e Lidhjes Demokratike të Kosovës, të Partisë Demokratike të Kosovës dhe po hartohet një program pune, në të cilin është në agjendë edhe kjo që thatë, parashtrimi i pyetjeve dhe i përgjigjeve, në praninë e Qeverisë, prandaj ju lus t'ia propozojmë seancës plenare atë program, në mënyrë që të gjitha të përfshihen në të. .

Fjalën e ka Gjylnaze Syla, kurse le të përgatitet Naser Osmani.

**DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA:**



I nderuari z. kryetar, i nderuari z. kryeministër, anëtarë të kabinetit qeveritar, deputetë të nderuar. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i propozon Kuvendit të Kosovës ta fillojë seancën në të ardhmen, me një përmbledhje të ngjarjeve të rëndësishme në Kosovë. Të gjitha çështjet që i shtruan deputetët, si deputeti Berat Luzha, Xhavit Haliti dhe të tjerë, mendoj se kjo do ta ndihmonte shumë funksionimin e punës së Kuvendit, nëse në të ardhmen do ta bënim një përmbledhje ngjarjesh prej një seance në seancën tjetër që do t'i referoheshin Kuvendit, aatyre që janë përgjegjës për ato ngjarje. Çështja që e shtroi z. Xhavit Haliti kishte të bënte me sigurinë dhe do të ndihmonte shumë punën e Kuvendit, por do ta ndihmonte edhe zgjidhjen e problemeve, në qoftë se seancat i fillon me një përmbledhje dhe referim këtyre çështjeve. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Edhe kjo do të jetë pjesë e përgatitjeve. Të lutem Naser ,fjalën e ka Fatmir Sejdiu , anëtar i Kryesisë. Më fal Naser, pastaj do ta kesh fjalën ti.

**DEPUTETI FATMIR SEJDIU:**

Faleminderit z. kryetar. Desha ta shtroja një çështje, jo të inicioj. Mbase arsye ka secili, por në kuptimin e punës si të punojmë. Mendoj se para vetes kemi një rend dite që është miratuar në Kryesinë e Kuvendit dhe natyrisht që në të ardhshmen do t'i përfillim të gjitha procedurat e nevojshme për të përgatitur rendin e ditës sa më mirë. Çështja e dytë, do të them kështu, si pjesë të propozimit, që ato çështje që parashtrohen, le të shtrohen në fazën e mëvonshme , jo në fazën para se të hyjmë në rend dite, sepse praktikisht ne po marrim një kohë që në një formë ose në formën tjetër e dëmton debatin. Në pjesën e fundit të gjitha iniciativat, të gjitha kërkesat që mund të jenë edhe pjesë e kërkesës për debat në të ardhshmen, të shtrohen nga deputetët dhe s'ka asgjë të keqe. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Ju faleminderit. E kisha në mend që në fund ta jepja një sqarim. Fjalën e ka Naser Osmani.

**DEPUTETI NASER OSMANI:**

Faleminderit z. kryetar. Si kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa dua të paraqes para jush një shqetësim për arsye se Kryesia e Kuvendit ka aprovuar për rendin e ditës që të jetë në pikën e 13 një çështje që ka kërkuar Grupi Parlamentar Ora, për të cilën kemi debatuar dhe e kemi shqyrtuar në seancën që u mbajt më 28 shkurt 2005. Fjala është për shqyrtimin e raportit 6 -mujor të buxhetit dhe atëherë kemi pasur rastin që para ministrit çdo deputet t'i paraqiste shqetësimet e veta për çdo pjesë të buxhetit dhe të merrte informacione. Ky rikthim i kësaj çështjeje në debat në Kuvend i ngarkon deputetët, e ngarkon Kuvendin pa nevojë dhe është njollosje e madhe për një parti që thjesht po bën vetëm propagandë prej më të poshtrave dhe më të mundshmet. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Naser, ju faleminderit. Për hir të respektit si anëtar i Kryesisë fjalën e merit Gazmend Muhaxheri, e pastaj një përgjigje timen dhe vazhdojmë.

#### DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI:

Po i përgjigjen parafolësit. Seanca që është mbajtur më 28 shkurt 2005 nuk mund ta përmbante raportin e shpenzimeve të buxhetit. Kërkojmë të debatohet si janë shpenzuar parat e këtij kuvendi prej janarit deri në qershor 2005, d.m.th. nuk mund të diskutohet në shkurt ajo që ne po e kërkojmë tani. Kjo kërkesë jona është mbështetur nga 40 deputetë, por nuk ka të drejtë as Kryesia as kryetari i Kuvendit, as kryetari i ndonjë komisioni, madje as seanca, që ta heqë nga rendi i ditës. Kjo pikë duhet të debatohet dhe do të debatohet sipas Rregullores.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Besoj për hir të dokumentacionit z. anëtar i Kryesisë krejtësisht datat i kanë serbisht, prandaj më vonë do t'i korrigjosh. Ju lutem ne i dëgjuam të gjitha. Kërkoj falje për ata që i lejuam, ndoshta dikush e ndien që edhe janë keqtrajtuar.

Kryesia e Kuvendit pa asnjë qëndrim kundër Parlamentit i ka paraqitur rendin e ditës me sqarimet përkatëse. Mund edhe të mos e mbaj mend mirë seancën, është stenogrami i Kryesisë, është procesverbali i saj dhe është drejtori i procedurave të Departamentit, sepse kryetari nuk e shkruan, as zyra e kryetarit, as Kryesia rendin e ditës, por sipas dokumentacionit valid është bërë ky rend i ditës, prandaj mendoj se do ta procedojmë rendin e ditës dhe kur të vijë në radhë pika përkatëse, që e tha Naseri, do të debatojmë të gjithë. Do t'ju lus për një pauzë, sepse regjia lajmëron se nuk mund të funksionojë as përkthimi, nuk mund të funksionojë as prezenca e deputetëve dhe ju lutem 30 minuta pauzë. Po ju lus sepse kjo është kërkesë e një grupi parlamentar. Kush është për rendin e ditës që e kanë marrë deputetët, ju lutem? Ju faleminderit shumë. Kush është për propozimin e Orës që të ndryshohet rendi i ditës, ju lutem numëroni votat.

Ju lutem nga 99 deputetë të pranishëm në sallë, 35 deputetë kanë votuar kundër rendit të ditës që e keni marrë, përkatësisht për ndryshim, prandaj vazhdojmë me rendin e ditës të miratuar pas gjysmë orë pauze.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

I lus deputetët të ulen në vende dhe ta vazhdojmë punën.

Në sallë janë të pranishëm 88 deputetë, prandaj mund ta vazhdojmë. E kam një lutje për deputetët, sepse po shkatërrohet sistemi elektronik. Ju lutem kartelat jo të rregullta ose kartelat e shqyera- dëmtojnë- randaj duhet të kemi kujdes. Nuk mendoj së dikush këtë e bën me qëllim, por po kemi telashe. Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

## **1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.**

Deputetët e dinë që mund t'i bëjnë me shkrim vërejtjet në procesverbal, Gjithashtu dikujt i duket e nevojshme se edhe gojarisht mund të bëjë vërejtje në procesverbal.

**DEPUTETI FERID AGANI:**

Po e përsëris se për mocionin e Grupit Parlamentar për Integrim, Kuvendi nuk u deklarua me votim. Ju lus të deklarohet me votim. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Keni të drejtë, por seanca plenare u deklarua për rendin e ditës, mirëpo për shkak të rëndësisë që e kemi shtruar dhe respektit për grupin e ri, ne do ta marrim si obligim që edhe gjatë seancës në qoftë se keni argumente të reja që mund t'i japim diçka si përgjigje, nuk do ta eliminojmë si parim, por seanca plenare është deklaruar për rendin e ditës dhe vazhdojmë me këtë rend dite.

Pika e dytë e rendit të ditës.

## **2. Shqyrtimi i dytë e Projektligjit për Inspektoratin Shëndetësor**

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 24 qershor 2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Parlamentit i kanë paraqitur raporte dhe rekomandimet me amendamente.

Prandaj kalojmë në sqarime të përgjithshme. Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si Komision Funkcional dhe Raportues janë radhitur rekomandimeve dhe amendamentet lidhur me tekstin e Projektligjit për Inspektoratin Shëndetësor.

Komisioni për Çështje Gjqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për Inspektoratin Shëndetësor e ka bazën juridike në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për Inspektoratin shëndetësor dhe amendamentet e propozuara nuk përbëjnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe Interesat e Komuniteteve kanë vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për Inspektoratin Shëndetësor dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet dhe rekomandimet e Komisionit Funkcional.

Lus regjinë që të përgatitet për votim.

Amendamenti 1

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.

68 vota janë për.

2 janë kundër,

Konsideroj se ka kaluar amendamenti 1.

Amendamenti 2

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.

74 vota janë për,

3 vota janë kundër

Konsideroj se ka kaluar edhe amendamenti i dytë.

Amendamenti 3

Fjalën e ka ministri i Shëndetësisë z. Sadik

MINISTRI SADIK IDRIZ:

Hvala predsedniçe. Mëslim da će se i komisija složiti da 4 – 5 tačka za svoj rad glavni inspektor rada odgovara „Ministarstvu“, trebalo bi da bude „ministru“ jer Minsitarstvo je širok pojam. Za svoj rad odgovara ministru.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Kryetari i Komisionit të Shëndetësisë a e ka të njëjtin mendim.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU:

Me qenë se në versionin e mëparshëm ka qenë se për punën e tij, inspektori i përgjigjet sekretarit të përhershëm të Ministrisë së Shëndetësisë. Intenca e Komisionit ka qenë t'i përgjigjet ministrit, prandaj e përkrahim mendimin e ministrit dhe i ftoj kolegët deputetë ta përkrahin propozimin e tij.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem regjia a mund të vazhdojmë me votim elektronik apo jo.Regjia, jo.

Atëherë votojmë. Ju lutem, kush është për amendamentin nr. 3. me përmirësimin e ministrit dhe të kryetares së Komisionit. Ju faleminderit shumë. A ka votë kundër, nuk ka. Miratohet amendamenti nr. 3.

Amendamenti 4

Kush është për: ju faleminderit,

A ka votë kundër: nuk ka,

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5.

Kush është për: ju faleminderit,

A ka votë kundër: nuk ka asnjë votë kundër.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6.

Fjalën e kërkon deputeti Ferid Agani

DEPUTETI FERID AGANI:

E kam një plotësim në amendamentin 6 , konkretisht në paragrafin 8.1, në fund definohet se inspektori duhet t'i ketë 5 vjet përvojë në fushën e mjekësisë. Kjo mund të krijojë probleme në procesin e implementimit. Këtu duhet të jetë në fushën përkatëse shëndetësore, sepse përfshihen farmacia dhe stomatologjia ,d.m.th. në vend se: "në fushën e mjekësisë" të jetë: "në fushën përkatëse shëndetësore". Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Kryetarja e Komisionit, deklarohet se është në rregull.

Kush është për amendamentin 6 me përmirësime të propozuara nga Feridi? Ju faleminderit.

A ka votë kundër, nuk ka,  
Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 7.

Kush është për: ju faleminderit.

A ka votë kundër: nuk ka.  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 8

Kush është për: ju faleminderit.

A ka votë kundër: nuk ka.  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 9

Kush është për: ju faleminderit.

A ka votë kundër: nuk ka.  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 10 dhe i fundit.

Kush është për: ju faleminderit.

A ka votë kundër: nuk ka.  
Kalon amendamenti.

Të pranishëm janë 94 deputetë.Tani , ju lutem të votojmë për ligjin në tërësi, me amendamentet e propozuara.

Kush është për? Ju faleminderit.

A ka votë kundër, asnjë votë kundër.

Prandaj ju falënderoj që të gjithë jemi të një mendimi.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

### 3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për edukimin parashkollor

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 3.10.2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raporte dhe rekomandime. Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport si komision funksional dhe raportues janë radhitur rekomandimet dhe amendamentet në tekstin e Projektligjit për edukimin parashkollor. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për edukimin parashkollor ka bazë juridike në Kornizën Kushtetuese. Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për edukimin parashkollor dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për edukimin parashkollor dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet dhe rekomandimet e Komisionit Funksional:

Amendamenti 1

Kush është për: ju faleminderit.

A ka votë kundër: 1 votë.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2

Kush është për: ju faleminderit

A ka votë kundër: nuk ka votë kundër

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3

Kush është për: shumica absolute.

A ka votë kundër:

Mendoj se kjo është plotësisht e arsyeshme

Drejtori është përgjegjës dhe thotë se shumica absolute.

Amendamenti 4.

Kush është për: shumica absolute

Pasi që nuk ka votim elektronik, le të mbetet për dokumentacion.

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5

Kush është për: ju faleminderit

A ka votë kundër: nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6  
Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 7  
Kush është për: ju faleminderit  
A ka votë kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti

Amendamenti 8  
Kush është për: ju faleminderit  
A ka votë kundër: nuk ka,  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 9  
Kush është për: ju faleminderit  
A ka votë kundër: nuk ka  
Kalon Amendamenti.

Amendamenti 10  
Kush është për: ju faleminderit  
A ka votë kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 11 dhe i fundit  
Kush është për: ju faleminderit  
A ka votë kundër: nuk ka votë kundër.

Ishte një përmirësim i një fjale. Kush është për miratimin e Ligjit me përmirësimin e doktoreshës, shumica absolute  
A ka votë kundër: nuk ka  
Ju faleminderit edhe për këtë ligj.

Kalojmë në pikën e 4 të rendit të ditës.

#### **4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale**

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 5.10.2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendi i kanë paraqitur raporte dhe rekomandime. Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues është bërë radhitja e rekomandimeve dhe e amendamenteve në Projektligjin për miniera dhe minerale. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për minierat dhe për mineralet e kanë bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni i Buxhetit ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për minierat dhe mineralet dhe amendamentet e propozuara, nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për minierat dhe për minerale, por edhe amendamentet e propozuara, nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet dhe rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 1, janë dy propozime:

a/ Komisioni FunkSIONAL,

b/ Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese.

Komisionet nuk e konsiderojnë si të nevojshme, prandaj ju lutem të votojmë, së pari për propozimin e Komisionit FunkSIONAL.

Kush është për: shumica absolute.

Kush është kundër:

Vazhdimisht po i shikoj komisionet funksionale. Jam i informuar se vërejtjen që e ka Komisioni është vërejtje fundamentale, por mos pritni që të hyjmë në procedurë të vendosjes, sepse po na qitni jashtë rregullave.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI:

Z. kryetar. Mendoj se nuk ka pasur asnjë arsye që në këtë rast të dilej me dy amendamente, sepse në disa raste Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese, ka sugjeruar në të njëjtin amendament që referenca të jetë e standardizuar. Mund t'ju them se qëndrimi i Komisionit Legjislativ është konform Kornizës Kushtetuese të shpallur me këto dhe me ndonjë rregullore të miratuar së fundi nga Zyra Ligjore e UNMIK-ut. Përfaqësuesit Special ka adoptuar këtë formulim, prandaj ne e kemi konsideruar si çështje parimore, për të cilën Kuvendi është deklaruar dhe kjo duhet të vlejë për të gjitha ligjet. Fjala për një korrigjim të një reference të gabuar dhe të pasaktë. Mendoj se Zyra Ligjore e kryeministrit nuk e bën, duhet ta bëjë administrata jonë dhe kjo duhet të bëhet automatikisht, sepse edhe praktikat parlamentare janë bazë normative për funksionimin e Kuvendit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

E Lus kryetarin e Komisionit FunkSIONAL a e mbështet.

Mendoj se propozimi i z. Hyseni është normë, por megjithëkëtë, për shkak të procedurës kërkoj ndihmën e Komisionit FunkSIONAL.

DEPUTETI FATMIR REXHEPI:

Nëse është kjo që tha z. Hydajet, se është më e drejtë dhe më e mirë, as ne nuk kemi arsye ta vazhdojmë pavarësisht që votuam. Nëse është një normë për të gjitha projektligjet do të ishte mirë. Unë them se tash e kam parë, nuk e kam parë më parë, por në qoftë se vlerësohet që është më mirë, atëherë të pajtohem.



## KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit Fatmir. Kam edhe informacionin juridik- burimor . Edhe keshillin e kam pasur, por nuk dua te propozoj pa e degjuar edhe mendimin tuaj, prandaj ju faleminderit per perkrahje dhe po i kerkoj falje seancës per mirekuptim, por ju lus te mos votojme per anulimet, por per variantin nen (b), kete qe e sqaruam.

Kush eshte qe amendamenti 1 te jetë me variantin nen (b): shumica absolute  
A ka ndonje vote kundër: nuk ka  
Prandaj konsideroj qe njezëri ka kaluar amendamenti 1.

### Amendamenti 2

Kush eshte per, keto jane te Komisionit FunkSIONAL: shumica absolute  
A ka vote kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti.

### Amendamenti 3

Kush eshte per: ju faleminderit  
A ka vote kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti.

### Amendamenti 4

Kush eshte per: ju faleminderit  
A ka vote kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti.

### Amendamenti 5

Kush eshte per: shumica absolute,  
A ka vote kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti

### Amendamenti 6

Kush eshte per: ju faleminderit  
A ka vote kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti.

### Amendamenti 7

Kush eshte per: shumica absolute  
A ka vote kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti.

### Amendamenti 8

Kush eshte per: ju faleminderit

A ka kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 9  
Kush është për: ju faleminderit.  
A ka votë kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 10  
Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 11  
Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti

Amendamenti 12  
Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 13  
Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti

Amendamenti 14  
Kush është për: ju faleminderit  
A ka votë kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti

Amendamenti 15  
Kush është për: shumica absolute  
A ka kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 16  
Kush është për: shumica absolute  
A ka kundër: nuk ka  
Kalon amendamenti

Amendamenti 17  
Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti

Amendamenti 18

Kush është për: shumica absolute

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti

Amendamenti 19

Kush është për: shumica

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti.

Amendamenti 20

Kush është për: Ju faleminderit

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti.

Amendamenti 21

Kush është për: Ju faleminderit

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti.

A bën, drejtor, t'i votojmë në tërësi amendamentet e Komisionit Funkcional, që nuk e kanë asnjë vërejtje dhe pastaj Ligjin me amendamente, sepse po të ishte elektronika, më lehtë, jo për ta shkelur procedurën, por rezultatet po tregojnë që vërtet s'ka as diskutime as mendime kundër.

Përgjegjësi po thotë se ndryshohet Rregullorja.

Vazhdojmë pra.

Amendamenti 22

Kush është për: shumica absolute

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti

Amendamenti 23

Kush është për: shumica absolute

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti

Amendamenti 24

Kush është për: shumica absolute

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti.

Nuk i kuptoj këto rregulla, asnjë diskutim, asnjë votë kundër Komisionit Funkcional, por patjetër po duhet t'ju maltretojmë.

Në qoftë se amendamentet janë të një natyre, këto nuk janë të tilla, prandaj vazhdojmë.

Amendamenti 25

Kush është për: shumica absolute

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti.

Amendamenti 26

Kush është për: shumica

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti

Amendamenti 27

Kush është për: shumica

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti.

Amendamenti 28

Kush është për: shumica absolute

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti

Amendamenti 29

Kush është për: shumica absolute

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti.

Amendamenti 30

Kush është për: shumica absolute

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti.

Amendamenti 31

Kush është për: shumica absolute

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti.

Amendamenti 32

Kush është për: shumica absolute

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti.

Amendamenti 33

Kush është për: shumica absolute

A ka votë kundër: 1 votë kundër.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 34

Kush është për: shumica absolute

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti

Amendamenti 35

Kush është për: ju faleminderit

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti.

Amendamenti 36

Kush është për: shumica

A ka votë kundër: nuk ka .

Kalon amendamenti

Amendamenti 37

Kush është për: shumica

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti

Amendamenti 38

Kush është për: shumica absolute

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti

Amendamenti 39

Kush është për: shumica absolute

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti

Amendamenti 40

Kush është për: shumica absolute

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti

Amendamenti 41

Kush është për: shumica

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti

Amendamenti 42

Kush është për: shumica

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti

Amendamenti 43

Kush është për: shumica absolute

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti

Amendamenti 44

Kush është për: shumica

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti

Amendamenti 45

Kush është për: shumica

A ka votë kundër: nuk ka

Kalon amendamenti

Tash ju ftoj të votojmë për ligjin në tërësi

Kush është për: ju faleminderit

A ka votë kundër: pa asnjë votë kundër.

Konstatoj se e miratuam ligjin.

Kalojmë në pikën e radhës.

## 5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për metrologjinë

A e kërkon dikush fjalën, para se të kalojmë në pikën tjetër?

E kam marrë një shkresë në postën time elektronike prej këtij instituti. Ky ligj po zgjatet një kohë të gjatë. Instituti kërkon shqyrtimin e tretë, që ne nuk e kemi praktikuar deri më tash. Ne, sipas procedurës dhe praktikës, duhet të vazhdojmë.

Fjalën e ka Afrim Arzuallxhi

DEPUTETI AFRIM ARZUALLXHI:

I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra të pranishëm. Ministra të nderuar.

Grupi Parlamentar i PDK-së, pas shqyrtimit të Projektligjit për metrologjinë dhe të amendamenteve të propozuara në këtë projektligj, Komisioni Funkcional erdhi në përfundim se gjatë përpunimit të këtij projektligji nuk janë marrë parasysh diskutimet, qëndrimet, vërejtjet dhe propozimet e parashtruara në leximin e parë nga të gjithë deputetët që morën pjesë në debat. Amendamentet e propozuara edhe më tej e degradojnë Institutin ekzistues të Metrologjisë Legale të Prizrenit, duke e sjellë në nivel të një servisi të thjeshtë, që u kundërshtua edhe nga të gjithë diskutuesit në leximin e parë, prandaj Grupi Parlamentar i PDK-së propozon të hiqet nga rendi i ditës për t'u plotësuar ose të shkojë në leximin e tretë. Të organizohet dëgjimi publik i projektligjit në fjalë, pastaj të merret sërish në shqyrtim në Komisionin Funkcional. Ju faleminderit

## KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Fjalën e ka Fatmir Rexhepi

### DEPUTETI FATMIR REXHEPI:

Kryetar i Komisionit FunkSIONAL.

Faleminderit z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë, të nderuar anëtarë të kabinetit të Qeverisë, ministra...

Është interesant se ky projektligj është vonuar mjaft nga koha kur Komisioni Parlamentar si Komision FunkSIONAL, e ka mbaruar punën e vet. Konsideroj j se e kam për detyrë, më shumë për shkak të zhurmës, marketingut dhe të tjerave, sesa për shkak të argumenteve që i kanë pasur ata që e kanë vonuar rrugëtimin e këtij projektligji deri në shqyrtimin e dytë dhe normalisht se këtu janë deputetët dhe le të urdhërojnë në shqyrtimin e dytë të të gjitha amendamenteve. Nëse e vlerësojnë se ato nuk janë në pajtim dhe që e plotësojnë më mirë këtë projektligj dhe organizimin e këtij instituti, atëherë le të urdhërojnë dhe le të votojnë si duan vetë, por puna e Komisionit ka rezultuar me këto. Nuk është e vërtetë ajo që tha këtu përfaqësuesi i PDK-së se amendamentet e degradojnë këtë projektligj, përkundrazi ato, krahasuar me Projektligjin që është ofruar dhe vetë materia apo kompetencat që i jepen Institutit të Metrologjisë të Prizrenit, dallohen shumë për të mirë. Komisioni ka pasur debat publik dhe e ka marrë edhe stenogramin edhe nga debati publik, kështu që nuk ka nevojë për atë që u tha këtu. Ne e kemi vizituar edhe Institutin e Metrologjisë Legale të Prizrenit, po ashtu edhe udhëheqjen e Prizrenit, deputetët që vijnë këtu dhe me krejt ata që kanë marrë pjesë në këtë punë. Unë nuk i di kërkesat dhe motivet e ndryshme, s'ka mundësi askush t' i punojë as t' i qëndisë brenda një projektligji, aq më pak me amendamente. Nuk e kam atë detyrë dhe as që e marr atë rol, por mund të them se brenda kësaj kohe nuk ka pasur korrektësi të sjelljes as të atyre që vetë i kanë ndërruar qëndrimet e veta. Për hir të deputetëve dhe të opinionit, po jua lexoj - shkurt- letrën.

Qëndrimi i parë që ka ardhur më 3.1.2003 nga Instituti i Metrologjisë Legale të Prizrenit. Këshilli i Institutit të Metrologjisë Legale të Prizrenit

Kërkon të jetë pjesë përbërëse e Ministrisë për Tregti dhe Industri, ku janë kërkesa, qëndrimi dhe vendimi i tyre. Të mos e harrojmë këtë datë, kur njerëzit vetë e thonë, por pastaj e ndryshojnë. Më 6.1.2005, kur po këta i kanë parashtruar kërkesë Qeverisë së Kosovës për vazhdimin e veprimtarisë së Institutit të Metrologjisë Legale të Kosovës me seli në Prizren, në kuadër të institucionit Qeveritar dhe po këta më 31.1.2005, sërish shtruan kërkesë që të bëhet një institut i pavarur krejtësisht dhe të kalojë me një zyrë në kuadër të kryeministrisë. Kjo do të thotë se janë qëndrime që dallohen shumë njëri nga tjetri.

Në kuadër të Projektligjit, siç e dini, këtu fjala është kryesisht për çështje organizative dhe për kompetencat e Institutit. Projektligji ka ofruar, me kërkesën e Institutit, të futet në kuadër të Departamentit, d.m.th. ashtu siç kanë kërkuar ata vetë, kurse tjetra është që ne si komision pas të gjitha vizitave, takimeve dhe debateve që i bëmë, kemi përfunduar si vijon: se megjithatë në kuadër të Ministrisë së Tregtisë të jetë

Departamenti i Metrologjisë ,që i ka dy njësi në kuadër të vet. E ka Departamentin e Metrologjisë Shkencore me seli në Prishtinë dhe Institutin e Metrologjisë Legale të Kosovës, të cilit i kthehet emri me këto amendamente, jo sikur është bërë në Projektligj ,jo sikur që e kanë bërë, por i kthehet emri që ta ruajë atë trashëgimi që e ka pasur Instituti i Metrologjisë Legale të Kosovës me seli në Prizren,sepse pa pëlqimin e këtij instituti nuk mund të hapim as degë të tjera në Kosovë. Pra kjo është përmbyllje e punës që e ka bërë Komisioni dhe mendoj se është shumë mirë , prandaj nuk qëndron asnjë nga konstatimet që u thanë edhe këtu, por edhe më parë. Mendoj se nuk kanë pasur arsye që ne me përkushtim të madh i kemi marrë vërejtjet nga dëgjimi publik, nga vizitat që i kemi pasur dhe nga parlamentarët këtu. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Fatmir,ju faleminderit shumë për sqarimet, por një grup tashmë është deklaruar për diskutim: Teuta në emër të Orës, pastaj Shaban Halimi, Fatmire Mulhaxha , si duket kjo e fundit do të abstenojë.

#### DEPUTETJA TEUTA SAHATQJA:

Faleminderit z. kryetar.

Sa i përket Ligjit të metrologjisë, vërtet në Komision kemi punuar dhe jemi përpjekur mjaft, por në shqyrtimin e parë të Projektligjit për metrologji, shumë deputetë, të të gjitha partive, janë deklaruar me një qëndrim ,se selia ose Departamenti duhet të jenë në Prizren. Në qoftë se te të gjithë deputetët ka ekzistuar një qëndrim, një kërkesë që të jetë në Prizren dhe në qoftë se ne e kemi një mbështetje në Rregulloren për shqyrtimin e tretë, mendoj se është e vlefshme t'ia japim edhe një shans këtij ligji dhe përsëri brenda Rregullores së punës së Kuvendit, pa e cenuar në asnjë moment Rregulloren e punës të Kuvendit ,ta kthejmë edhe një herë në shqyrtim -të tretë- dhe të bisedojmë për këtë ligj. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor Alush Gashi, në emër të LDK-së, urdhëroni.

#### DEPUTETI ALUSH GASHI:

I nderuari z. kryetar. Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar këtë projektligj si në shqyrtimin e parë, është angazhuar mjaft edhe në Kuvend, por edhe në Prizren me strukturat udhëheqëse të atjeshme dhe me qytetarët ,si dhe me punëtorët e Institutit përkatës të Prizrenit.Me këtë rast ,z.kryetar , në emër të Grupit dua ta lavdëroj angazhimin e Institutit të Prizrenit që t'u ndihmojë proceseve që ofrohen për një zgjidhje juridike më të mirë për këtë fazë të zhvillimeve tona. Ne, si grup, jemi të vetëdijshëm se në këtë fazë ka nevojë të jetë ligji më i mirë i mundshëm. Pas debatit në



komisione, grupi ynë parlamentar ka vendosur që në seancën plenare t'i votojë amendamentet. E përshëndesim edhe angazhimin e deputetëve të LDK-së, që eventualisht, për këtë çështje ka pikëpamje të tjera. Këtë e marrim si vendim të tyre individual dhe si pjesë të demokracisë së brendshme, andaj z. kryetar, në emër të Grupit, ju lusim t'i procedoni amendamentet, ashtu siç janë paraqitur. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor ju faleminderit. Është një sqarim që e dha shumë mirë Fatmiri, që Teuta e përzeu. Është tjetër selia e Institutit dhe tjetër Departamenti. Qeveria është në Prishtinë dhe jam fort i bindur, se edhe unë kam qenë adhures i asaj ideje, por vërtet, pas të gjitha këtyre argumenteve që Komisioni Funkcional i ka dhënë, nuk qëndron arsyeja të thuhet tradita e zakonshme që t'i qasemi amendamentimit. Do t'ju lus edhe pse është e drejtë demokratike, pas sqarimeve burimore dhe sqarimeve që po i marr vazhdimisht nga njerëzit që kanë qenë në atë Institut, e kam afër anëtarin e Kryesisë, nuk ka më arsye të shëndosha, profesionale, as procedurale që të mos vazhdojmë. Megjithëkëtë, në qoftë se e shihni të nevojshme që grupet parlamentare të debatojnë, pajtohemi që ato të debatojnë. Ne do të vazhdojmë me rendin e ditës, sepse e kemi miratuar. I di obligimet, por po mundohem në këto faza sa të jetë e mundshme, sepse shumë ligje i miratua njëzëri, s'kemi arsye që për këtë ligj të mos jemi njëzëri.

#### MINISTRI BUJAR DUGOLLI:

Ju faleminderit zoti kryetar. Nganjëherë kur po dëgjoj zëra këtu po më duket interesant, sepse si punëtorët e Institutit, qoftë edhe të ndonjë instituti tjetër, që është në kompetenca dhe nën kontrollin e ministrive përkatëse del dhe cakton qëndrime të veçanta, ose personale dhe dikush nga zyrtarët, nga dikush këtu i Kuvendit ose nga partitë, i merr si të 100%. Duhet ta dini se kjo është një praktikë, siç ndiqet në çdo ministri. Ne nuk e kemi vënë vetë në kompetenca të Ministrisë sonë, por kjo është vënë nga UNMIK-u, ashtu siç janë: Instituti Albanologjik ose Instituti i Historisë- në kuadër të Ministrisë së Arsimit- Instituti i Planifikimit Hapësinor- në kuadër të Ministrisë së Ambientit dhe nuk ka mekanizëm tjetër që ne të mund t'i vëmë në kontroll as t'i ndihmojmë institutet, përveç formës së paraparë në ligj dhe me amendamente të Komisionit. Ne e kemi shqyrtuar dhe kemi marrë pjesë në hartimin e shqyrtimeve të amendamenteve, po ashtu edhe me Komisionin dhe mendoj që Komisioni i ka përfillur edhe kërkesat e deputetëve të rajonit të Prizrenit, që selia e Institutit të mbetet atje, Instituti i Meteorologjisë Legale dhe ne e kemi mbështetur këtë si Ministri dhe deklaroj të mos vonohemi me miratimin e këtij ligji, sepse është shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e punës në këtë sferë dhe se Ministria ka investuar dhe ka punuar që ky ligj të kryhet, prandaj kemi dëshirë që tashmë të ishte nënshkruar nga përfaqësuesi special. Ne e kemi biseduar edhe në Grupin Parlamentar dhe i mbështesim amendamentet e Komisionit, por kërkojmë që ato t'i votojmë njëkohësisht. Edhe Qeveria i mbështet amendamentet e Komisionit. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, ju faleminderit. Edhe një herë, sepse edhe Instituti edhe qytetarët na përcjellin. Me amendamentet e propozuara Instituti nuk humb sipas sqarimeve të sinqerta dhe profesionale, prandaj e fitoj edhe Grupin Parlamentar të PDK-së, sepse tri grupe tashmë u deklaruan për: LDK-ja, AAK-ja dhe Ora, që nuk e dëmtojnë. Parlamenti, si themelues i atij institucioni do ta ketë në mbikëqyrje dhe do të jetë gjithmonë koordinim i mirë me Qeverinë, prandaj t'i kthehemi miratimit të amendamenteve sipas Komisionit Funkcional.

#### Amendamenti 1

Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: 6 vota janë kundër  
Kalon amendamenti

#### Amendamenti 2

Kush është për: Shumica absolute  
A ka votë kundër: 11 vota kundër  
Kalon amendamenti

#### Amendamenti 3 i ka dy propozime

a/ Komisioni Funkcional,  
b/ Grupi i deputetëve

Vërejtje: Nëse miratohen amendamentet 1 dhe 2 të Komisionit Funkcional, amendamenti i Grupit të deputetëve është pa objekt, prandaj votohet vetëm propozimi i Komisionit Funkcional.

Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: 7 vota janë kundër  
Kalon amendamenti.

#### Amendamenti 4

Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: 7 vota janë kundër  
Kalon amendamenti

Amendamenti 5 i ka dy propozime, por do të votojmë vetëm për propozimin e Komisionit Funkcional.

Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: 9 vota janë kundër  
Kalon amendamenti

#### Amendamenti 6

Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: 8 vota janë kundër  
Kalon amendamenti

#### Amendamenti 7

Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: 7 vota kundër  
Kalon amendamenti

Amendamenti 8  
Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: 5 vota janë kundër  
Kalon amendamenti

Amendamenti 9  
Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: 6 vota janë kundër  
Kalon amendamenti

Amendamenti 10  
Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: 6 vota janë kundër  
Kalon amendamenti

Amendamenti 11  
Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: 6 vota janë kundër  
Kalon amendamenti

Amendamenti 12  
Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: 6 vota janë kundër  
Kalon amendamenti

Amendamenti 13  
Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: 5 vota kundër  
Kalon amendamenti

Amendamenti 14  
Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: 6 vota kundër  
Kalon amendamenti

Amendamenti 15  
Kush është për: ju faleminderit, shumica absolute  
A ka votë kundër: 6 vota kundër  
Kalon amendamenti

Amendamenti 16 i ka dy propozime, por do të votohet vetëm propozimi i Komisionit Funkcional nën (a).

Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: 7 vota kundër  
Kalon amendamenti

Amendamenti 17  
Kush është për: Ju faleminderit, shumica absolute  
A ka votë kundër: 5 vota kundër  
Kalon amendamenti.

Deputetë të pranishëm janë 84 . Ju lus të votojmë për Ligjin në tërësi me amendamentet e miratuara.

Kush është për: shumica absolute  
A ka votë kundër: 13 vota kundër.  
Kalon Ligji me amendamentet e miratuara.

Ju faleminderit dhe ju propozoj që deri në orën 14,00 ta shfrytëzojmë pauzën edhe për drekë.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes. Mirëseardhje në vazhdimin e seancës plenare.  
Para se të kalojmë në pikën e radhës, edhe një herë do t'i lutja deputetët që t'i vendosin kartelat identifikuese.

73 deputetë janë të pranishëm, kurse tregohet numër joreal në monitor.  
E kam edhe një lutje, të mos e keqësojmë funksionimin teknik me ndonjë pakujdesi eventuale. Tani veç po funksionon më mirë.

Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Radiotelevizionin e Kosovës.

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 25.07.2005.  
Komisionet parlamentare i kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet, me amendamente.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe Komisionit për shërbime publike, administratë lokale dhe media, si Komision funksional dhe raportues, është bërë radhitja e rekomandimeve dhe amendamenteve në tekstin e Projektligjit për RTK.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për RTK ka bazën juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për RTK dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për RTK dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet dhe rekomandimet e Komisionit funksional:

Amendamenti 1.

Lus regjinë, të bëhet gati për vendimmarrje. Votojmë tani.  
69 vota për; 4 kundër – ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 2.

Lus regjinë të bëhet gati për votim. Votojmë tani.  
78 vota për, 2 kundër – ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 3.

Dy propozime:

- a) Komisioni funksional,
- b) Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim.

A e shohin të arsyeshme të paraqiten për fjalë kryetarët e komisioneve, apo po procedojmë me votime. Nuk paraqitet askush.

Regjia le të bëhet gati. Shkojmë me radhë:

- a) Propozimi i Komisionit funksional.

Votojmë tani.

69 vota janë për; 8 kundër – prandaj konsideroj se u aprovua versioni nën a) i amendamentit 3.

Propozimi nën b) është i paobjekt sepse shumica absolute kanë votuar për Komisionin funksional.

Amendamenti 4.

Dy propozime:

- a) Komisioni funksional,
- b) Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim.

Regjia le të bëhet gati për të votuar. Votojmë tani.

67 vota për; 11 kundër – prandaj konsideroj se propozimi nën a) i Komisionit funksional është miratuar si amendament.

Amendamenti 5, pa përkrahje nga Komisioni funksional.

Regjia, ju lus të përgatiteni. Votojmë tani.

52 vota janë kundër, 18 për – konsideroj se nuk ka kaluar amendamenti 5.

Amendamenti 6 i Komisionit funksional.

Përgatitemi për vendimmarrje. Votojmë tani.

78 vota për, 4 kundër – ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 7 i Komisionit funksional.  
Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.  
74 vota janë për, 3 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 8, Komisioni funksional.  
Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.  
72 vota për, 4 kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 9, dy propozime:  
a) Komisioni funksional;  
b) Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.

(Ndërrhyrje ...)

Po, gjithmonë votohet propozimi i parë. Do të thotë, unë e theksova këtë edhe në fillim.

69 vota janë për, 10 kundër – kalon amendamenti me versionin nën a).

Amendamenti 10, Komisioni funksional.  
Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani.  
75 vota janë për, 4 kundër – ka kaluar amendamenti 10.

Amendamenti 11, komisioni funksional.  
Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.  
73 vota janë për, 4 kundër ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 12. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
68 vota janë për, 4 kundër ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 13. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
71 vota janë për, 4 kundër – ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 14. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
68 vota për, 6 kundër – ka kaluar amendamenti.

15 - Me përkrahje nga Komisioni funksional, Komisioni për buxhet dhe financa.  
Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
74 vota për, 6 kundër - ka kaluar amendamenti.

16. Komisioni funksional.  
Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.  
68 vota për, 4 kundër – ka kaluar amendamenti.

E ka fjalën Nekibe Kelmendi, pastaj profesor Sabriu!

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:

Te amendamenti 17 kemi dy propozime. Kemi pas propozimin e Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim, dhe të Komisionit për buxhet dhe financa. Si Komision funksional e mbështesim variantin b) të Komisionit për buxhet dhe financa.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. Po habitem, qysh s'po të korrigjon profesori. Jo "b-c" por "b-ë" Nekibe, kështu na thotë gjithmonë Sabri Hamiti.

Ju lutemi të përcaktohem, me korrigjimin e kryetares së Komisionit, për variantin nën b). Më parë e kërkon fjalën Hydajet Hyseni, kryetar i Komisionit. Urdhëroni Hydajet.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI:

Faleminderit zoti kryetar. Unë kam vërejtje në mënyrën si po i shqyrtojmë amendamentet e ndryshme. Mendoj se do të ishte mirë që t'u jepet mundësia përkatësve të secilit amendament ose autorëve të secilit amendament që të t'i arsyetojnë ato. Për shembull, ne mund tani të sugjestionohemi nga ajo që u tha dhe të votojmë variantin b) pa e ditur ku është dallimi. Unë personalisht nuk shoh ndonjë dallim me këtë dhe mendoj se nuk ka asnjë arsye që ne të mos e votojmë, për shembull, në këtë rast amendamentin a) dhe do të kërkoja që edhe me amendamentet vijuese ku ka qëndrime të ndryshme t'u ofrohet mundësia përfaqësuesve të tyre që t'i shpjegojnë qëndrimet e tyre dhe dallimet. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Hydajet, të faleminderit. Unë vazhdimisht, para çdo amendamenti, po shikoj a kërkon fjalë komisioni. Unë nuk kam të drejtë ta ftoj patjetër dikë në debat. E ka fjalën Nekibe Kelmendi, përsëri. Urdhëroni Nekibe.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:

Megjithatë, unë vërej dallimin midis fjalës "rajon" dhe fjalës "vendbanim", sepse fjala rajon përfshin një territor më të gjerë, që do të thotë se ekziston rreziku që të përjashtohet nga parapagimi një rajon i tërë, e të ketë frekuenca. Kurse, e kundërta mund të ndodhë që vetëm një vendbanim të mos ketë frekuenca, prandaj duhet vetëm ai vendbanim të lirohet nga parapagimi televiziv. Këtu është ai dallimi, sepse edhe vetë midis rajonit apo regjionit dhe vendbanimit ekziston dallim substancial.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. Sanije Aliaj u paraqit për fjalë.

DEPUTETJA SANIJE ALIAJ:

Ju faleminderit zoti kryetar. Komisioni për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve ka dalë me këtë amendament me një arsyeshmëri të plotë sepse në Kosovë ka konstatuar se ka rajone e jo vendbanime, ku nuk është rjeti, ku nuk përcillet Radiotelevizioni i Kosovës si tërë vendbanimet e Hanit të Elezit ashtu edhe të Dragashit, prandaj jemi përcaktuar për terminin rajon dhe unë si përfaqësuese e këtij Komisioni, për momentin insistoq që të përkrahet propozimi nën a).

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Dëgjuam sqarimet. Objektivisht sqarimi i Nekibes është më adekuat - profesionalisht por ne dëgjuam edhe tjerat, dhe e drejta e deputetëve është të vendosin.

Ju lutem, si parim, duhet të shkojmë një herë për variantin nën a).

Më falni. E ka fjalën zoti Jakup Krasniqi. Urdhëroni.

(Tërhiqet nga diskutimi)

Faleminderit. Do të thotë, të shkojmë për variantin nën a)

Regjia të bëhet gati një herë për propozimin nën a).

Bëhemi gati për të votuar dhe votojmë tani.

45 vota janë kundër, 25 për – dhe kjo do të thotë se nuk është miratuar versioni nën a) dhe ky është interpretimi zyrtar, dhe mbetet varianti i nën b) si amendament i aprovuar.

(Ndërhyrje – reagime)

Atëherë, do ta hedhim në votim. Regjia të përgatitemi për votim.

Kush është për amendamentin 17 – versioni nën b). Votojmë tani.

56 vota janë për, 23 kundër – prandaj amendamenti 17 me nën b) është i aprovuar.

Amendamenti 18, dy propozime:

a) Komisioni funksional;

b) Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim.

Regjia të bëhemi gati për votim dhe votojmë tani.

67 vota janë për, 11 kundër – kalon amendamenti 18 nën a)

Amendamenti 19, pa përkrahje nga Komisioni funksional.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim.

Përgatitemi për votim. E ka fjalën Sadudin Berisha.



DEPUTETI SADUDIN BERISHA:

Këtu nuk ka të bëjë me tekstin e amendamentit por ka të bëjë me mënyrën e përgatitjes së amendamentit.

Amendamenti 19 si dhe të gjitha amendamentet tjera duhet të dihen se të cilit komision i përket. Në këtë rast është i Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe ashtu duhet të figurojë. Dhe, në pjesën e dytë duhet të jetë – pa përkrahjen e Komisionit funksional, sepse mënyra si u votua amendamenti 5, në mënyrën e njëjtë të përgatitur nënkuptohet se është mbështetur amendamenti i komisionit përkatës, që e ka formuluar. Urdhëroni së paku të shikohet. Do të thotë amendamenti 19 – Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve – në pjesën e dytë thuhet: pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Kështu, edhe duhet të jenë rregullat procedurale. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DADI:

Sadudin, faleminderit, je edhe profesionist për këtë. E ka fjalën Nekibe Kelmendi. Nekibe, t'i përkrahim edhe ata që kanë mendime ndryshe, nëse nuk kanë dallime të mëdha.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:

Po, zoti kryetar, do t'i përkrahja sikur të mos ekzistonte menjëherë konstatimi: pa përkrahje nga Komisioni funksional.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DADI:

Sadudin, unë duhet ta respektojë procedurën. Deputetët dëgjuan vërejtjet, prandaj le të shkojë ashtu siç është, domethënë – pa përkrahje nga Komisioni funksional.

Regjia, të përgatitemi për votim dhe votojmë tani.  
50 vota janë kundër, 28 për – prandaj nuk kalon amendamenti 19.

Amendamenti 20, Komisioni funksional.

Ju lus, një sqarim, më tepër për opinionin që na përcjell, sepse të mos mendohet se Komisioni funksional është komision njëpartiak ose njëetnik. Ky është më tepër jo për deputetë, ju lutem. Është transmetimi i drejtpërdrejt, janë dokumente që mbesin, prandaj e ndija të nevojshme ta them këtë.

Regjia, të përgatitemi për votim dhe votojmë tani.  
68 vota për, 9 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 21, Komisioni funksional.  
Përgatitemi për votim, votojmë tani.

Më falni! Urdhëroni profesoreshë. E ka fjalën Sala Ahmetaj. Ia bëni gati mikrofonin Sala Ahmetaj, ju lutem.

DEPUTETJA SALA AHMETAJ:

Së pari për amendamentin 21 kam vërejtje në formulim dhe do të pyesja Komisionin pse nuk mund të jetë anëtar i bordit një njeri që ka qenë i punësuar në institucionet e shërbimit publik të Kosovës. Por, edhe gjuhësisht është formuluar keq. Domethënë, "personi i cili ka qenë i punësuar në institucionet e shërbimeve publike", dhe prapë "nuk mund të jetë anëtar i bordit", e jo "nuk mund të jetë anëtarë të bordit", domethënë kam dy vërejtje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Vërejtje gjuhësore, dhe unë po i pranoj, sepse profesori po ma bën me krye OK a këtë të Komisionit Nekibja a kush që do ta sqarojë. Po, urdhëroni. E ka fjalën profesor Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI:

Unë pajtohem me pikë e me presë, edhe me idenë edhe me vërejtjet që i tha zonja Sala Ahmetaj. S'ka kurrfarë arsye të pengohet një njeri që ka punuar në shërbimet publike – që ka punuar më dikur, jo që puno tash, por formulimi është "që ka punuar" dhe s'ke drejtë t'ia mohosh askujt të drejtën që të marrë një funksion – nëse e meriton. Kaq, faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Nekibe Kelmendi, për sqarime. Urdhëroni Nekibe.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:

Kur Komisioni është përcaktuar për këtë formulim, e pranoj se janë përvjedhur gabime edhe teknike edhe gjuhësore. Gabimi teknik ka të bëjë me "institucione në shërbimin publik", kurse gabimi gjuhësor "të bordit" siç u tha. Mirëpo, ky formulim është bërë pas dëgjimit publik dhe në bazë të vërejtjeve që kemi pas nga personat më kompetent e të cilët i janë referuar dokumentave ndërkombëtare evropiane që e rregullojnë këtë çështje. Dhe sigurisht kanë pasur parasysh konfliktin e interesit, dhe për këtë arsye edhe është përjashtuar ose nuk është lejuar mundësia që këta persona të jenë anëtarë të bordit të RTK.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Dëgjuam sqarimet nga parafolësit. Unë procedoj sipas rregullit për amendamentin 21 siç e ka propozuar Komisioni funksional.

Përgatitemi për votim. Votojmë tani.

56 janë kundër, 25 janë për – do të thotë nuk ka kaluar amendamenti dhe mbetet siç ka qenë në ligj.

Amendamenti 22, pa përkrahje nga Komisioni funksional, i Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim.

Nuk paraqitet askush për sqarim.

Regjia përgatitemi për votim. Votojmë tani.

44 vota janë kundër, 26 për – **nuk kalon** amendamenti.

Amendamenti 23 – Komisioni funksional.

Përgatitemi për votim. Votojmë tani.

68 vota për, 7 kundër – kalon amendamenti.

24 – Komisioni funksional.

Përgatitemi për votim. Votojmë tani.

67 janë për, 4 kundër – kalon amendamenti.

25 – pa përkrahje nga Komisioni funksional. Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim.

Përgatitemi për votim. Votojmë tani.

51 votë kundër, 18 për – **nuk kalon** amendamenti 25.

Amendamenti 26, Komisioni funksional.

Përgatitemi për votim. Votojmë tani.

61 për, 4 kundër – kalon amendamenti.

27 – Komisioni funksional.

Përgatitemi për votim. Votojmë tani.

71 për, 6 kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 28.

Përgatitemi për votim. Votojmë tani.

65 për, 6 kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 29.

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.

62 vota për, 3 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 30, me përkrahje nga Komisioni funksional, i Komisionit për buxhet dhe financa.

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.

68 për, 3 kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 31, Komisioni funksional.

Përgatitemi për votim...

Urdhëroni. E ka fjalën Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI:

Zotni kryetar, se ju drejtova: profesor por s'prishë punë sigurisht.

Unë mendoj se amendamenti 31 është pa objekt, nuk ka vlerë. Komisioni mund ta sqarojë por unë kërkoj që ky të mos votohet sepse në 35a) thuhet "RTK vazhdon të veprë si institucion publik me autorizime të përcaktuara me ligj" domethënë me këtë ligj që po e aprovojmë dhe kjo shtesë është shtesë totalisht jofunksionale. Ky amendament nuk vlen. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë besoj se e përkrah Nekibja, a Nekibe?

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:

Unë do ta përkrahja por s'po dua me krijua diskontinuitet midis atij që është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut dhe këtij që po themelohet sot me këtë ligj. Kjo është esenca.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor, e paskemi pas profesor gabim, sepse dy jurist po më thonë amendamenti është mirë, prandaj ju lutem unë e dëgjova dhe e kisha atë mendim por profesionistët janë këtu....

Regjia, përgatitemi për votim. Votojmë tani.

55 janë për, 21 kundër – kalon amendamenti 31.

32 – me përkrahje nga Komisioni funksional, i Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Përgatitemi për të votuar. Votojmë tani.

74 vota janë për, 3 kundër – ka kaluar amendamenti.

Ky ishte amendamenti i fundit.

Ju ftoj të përgatitemi për ta votuar ligjin, me amendamentet e aprovuara sot.

Regjia, bëhemi gati. Votojmë tani.

73 deputetë kanë votuar për, 4 kundër – prandaj konstatoj se me shumicë absolute e kemi aprovuar ligjin e shqyrtuar.

Pika e radhës është:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës.

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 25. 07. 2005.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raporte dhe rekomandime me amendamente.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për shërbime publike, administratë lokale dhe media – si komision funksional dhe raportues është bërë radhitja e rekomandimeve të amendamenteve në tekstin e Projektligjit për provimin e jurisprudencës.

Komisioni për çështje gjyqësore, dhe të tjerat në vazhdim, ka vlerësuar se Projektligji për provimin e jurisprudencës ka bazën juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për provimin e jurisprudencës dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe financiare.

Ndërsa, Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për provimin e jurisprudencës dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamenti 1. Vlejnë rekomandimet e Komisionit funksional, deri sa nuk theksoj diçka tjetër.

Përgatitemi për votim. Urdhëroni për sqarim. E ka fjalën Nekibja, kryetare e Komisionit funksional.

**DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:**

Ne, në këto amendamente, meqë ky Projektligji është kthyer edhe një herë në ripërpunim dhe rishqyrtim, kemi pas të arsyeshme të punojmë në shqyrtimin e këtij ligji dhe në amendamentimin e të dy komisioneve: Komisionin për legjislacion dhe Komisioni ynë si

komision funksional, kështu që të gjitha amendamentet janë me përkrahjen e dy komisioneve.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Për korrektësi, do të thotë propozues është deputeti Ramadan Kelmendi, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.

70 vota për, 2 kundër – ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 2, dy propozime:

- a) Komisioni funksional dhe komisioni legjislativ;
- b) Deputeti Ramadan Kelmendi.

Ramadan, urdhëroni.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI:

Faleminderit kryetar. Po qe shikohet përmbajtja e dispozitës të amendamentuar, rezulton se është identike dhe vërtetë dy komisionet janë për, dhe është i njëjti tekst.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Po nuk e di, pse atëherë nuk figurojnë ashtu?

(Ndërhyrje – nuk dëgjohej për transkriptim)

Ka dallim, po thotë departamenti....

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI:

Ne jemi marrë vesh që të jetë i njëjti teksti.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirë. Nekibja e tha propozimin. Do të thotë të gjitha amendamentet....

(Ndërhyrje – vërejtje)

A? Vetëm një, thotë Nekibja. Prandaj, ky amendament është i të dy komisioneve. Përgatitemi për ta votuar. Kush është për, e kush kundër?  
58 për, 1 kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 3:

- a) Komisioni funksional, dhe Komisioni legjislativ,
- b) Deputeti Ramadan Kelmendi.

A është njësoj Nekibe? E njëjta, do të thotë.  
Përgatitemi për të votuar. Votojmë tani.  
66 për, 2 kundër – ka kaluar amendamenti.

4 – me përkrahje nga Komisioni funksional dhe Komisioni legjislativ, deputeti Ramadan Kelmendi.

Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
66 për, 4 kundër – ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 5, si i mëparshmi.  
Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.  
62 për, 2 kundër – ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 6, si i mëparshmi.  
Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.  
68 për, 2 kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 7, si i mëparshmi.  
Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.  
67 për, 2 kundër – ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 8.  
Donë sqarim kryetarja e Komisionit, Nekibe Kelmendi. Urdhëroni Nekibe.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:

Te amendamenti 8, duhet të përkrahet propozimi përkatësisht amendamenti i deputetit Ramadan Kelmendi, sepse në ligj është paraparë 6 muaj përvojë pune, domethënë është paraparë me fjalë tjera një stazh i beneficuar për të punësuarit në organet e jurisprudence. Kjo nuk mund të mbështetet që të kenë stazh të beneficuar prandaj, deputeti Ramadan Kelmendi ka propozuar të fshihet kjo pikë e këtij neni dhe ne e përkrahim.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Do të thotë, Ramadan s'ke nevojë të paraqitesh, sepse të përkrahin. Qëndrimet e dy komisioneve e përkrahin qëndrimin dhe në këtë mënyrë....

Përgatitemi për të votuar dhe pas sqarimeve të votojmë dhe vendosim. Votojmë tani.  
62 për, 9 kundër – ka kaluar amendamenti 8.

9 – deputeti Ramadan Kelmendi, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe Komisioni legjislativ.

Dëshiron të marrë fjalën Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMDAN KELMENDI:

Vlerësoj dhe mendoj se edhe ky amendament duhet përkrahur. Mbështetja është shumë e argumentuar, edhe pse nuk është përkrah. Në shumicën e vendeve të botës gradat shkencore mbulojnë provimet formale profesionale në lëmin përkatës prandaj edhe këtu, pasi është në lëmin përkatës, kryesisht me një provim, është e drejtë të përkrahet, është çështje edhe e deputetëve. Unë do të them se duhet përkrahur.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor Hajredin Kuçi.

#### DEPUTETI HAJREDIN KUÇI:

Faleminderit. Mendoj se diskutimi im nuk do të merret subjektiv në këtë rast, por them se duhet përkrahur mendimin apo propozimin e deputetit Ramadan Kelmendi me një modifikim të vogël, që do ta propozoja kështu: provimi i jurisprudencës iu pranohet të gjithë atyre juristëve të diplomuar të cilët kanë arritur gradën shkencore doktor i shkencave nga lëmi i drejtësisë. Pse? E para, e përmendi edhe deputeti Kelmendi, në praktikën e shumë vendeve të botës ndodh një gjë e tillë, shembulli konkret do të jetë ta marrim, që është më së afërmi Maqedonia, dhe mund të pyetni. E dyta, është një parim i njohur juridik që juristët e dinë mirë, kur mundesh me shumë pse nuk mundesh me pak. Dhe, e treta, është një parim që nga koha e romakëve: Që ta vlerësoni ndokënd duhet të jeni minimum i nivelit të tij. Me fjalë të tjera, kush do ta vlerësojë doktorin e shkencave juridike për të dhënë provimin e jurisprudencës.

Unë mendoj se këtu kemi të bëjmë me nja 20 veta në Kosovë, nga se shumica e njerëzve që e kanë fituar titullin doktor shkencë juridike në kohën e ish Jugosllavisë dhe se ka qenë i njohur një provim i tillë. Do të thotë, nuk do të jetë një mëkat nga Kuvendi t'ia njohësh të drejtën një doktori të shkencave të drejtësisë - provimin e jurisprudencës, pra njihni diçka më pak se sa ai e ka në jetë apo në praktikë. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor ju faleminderit. E ka fjalën kryetarja e Komisionit Nekibe Kelmendi. Urdhëroni Nekibe.

#### DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:

Unë mendoj, të kundërtën. Për provimin e jurisprudencës kërkohen të përgatiten jo më pak se 14-15 lëndë që janë dhënë si provime në fakultetin juridik, kurse doktoratura mund të fitohet edhe me një lëmi shumë të ngushtë. Dhe si mund të parashohim ne që një doktor, pa dashur t'i fyej doktorët e shkencave - nëse ka doktoruar shembull vetëm në fushën e rregulloreve të UNMIK-ut dhe ka fituar titullin e doktorit të shkencës e të fitojë të drejtën të merret me avokaturë, për mua është diçka e papranueshme. Domethënë se, për t'u bërë gjyqtar dhe avokat nevojitet një gjerësi më e madhe e dijes juridike sesa specializimet e ngushta në të cilat doktorohet, ose të merret titulli i magistraturës. Në të kundërtën, edhe ne avokatët - do të kërkonim të fitojmë titullin e doktorit të shkencës.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Pak sabër, po për replikë... Unë do të thoja se Nekibe nuk do të duhej të merren shembujt ekzemplarë negativ, sepse pakica nuk duhet ta mbizotërojë shumicën as në demokraci, prandaj shikoni një parim krejt tjetër vlen. Po, por veç unë jam mjaft i vjetër në shkencë. Ata që s'e kanë një gradë, gjithmonë e kontestojnë - si praktikë po ju them, jo si përmbajtje.



(Ndërrhyrje)

Jo, gjithmonë por si praktikë po ju them – po. Ka pas në një kohë të masave të dhunshme në Universitet, kur një numër i asistentëve shumë aktivë dhe shumë të fuqishëm kanë dashur të njëjtën pagë si profesori ordinar ose inordinar, se thotë – unë po ligjëroj ti po ligjëron. Ajo nuk vlen në shkencë dhe profesur, këtu nuk jam kompetent, prandaj urdhëroni profesoreshë e doktoreshë....

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI:

Unë desha vetëm një analogji me lëmin e shëndetësisë dhe këtu patjetër duhet me përkrah Nekibën. Unë vetë jam doktor i shkencës por në shëndetësi e japim provimin shtetëror për me pas licencë për punë. Domethënë është çështje praktike për me punuar në praktikën e përditshme ndërsa gradat e magjistratit, doktorit të shkencës janë grada për me dhënë mësim në Universitet. Kështu është në mjekësi, se di a ndihmon tash në këtë debat. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Po, ka edhe shembuj negativ. Profesor Kuçi edhe një herë.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI:

Faleminderit, edhe një herë. Unë në radhë të parë me doktoreshën tash do t'i them se gjermanët e kanë një fjalë – çdo imitim çalon. Mendoj se edhe në këtë rast çalon krahasimi i shkencave juridike me ato të mjekësisë. Unë dua t'ia përkujtoj zonjës Kelmendi se në Fakultetin Juridik ata që e marrin gradën doktor shkence i kryejnë disa provime në fakultet, i kryejnë disa provime në magistraturë dhe kryejnë disa provime në doktoraturë. Dhe do të ishte joprofionale, po e quaj më së lehti, t'i themi dikujt që është doktor shkence e din më pak se një avokat. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

E ka fjalën Sabri Hamiti, pastaj Ramadan Kelmendi.

(Ndërrhyrje e shkurtër)

DEPUTETI SABRI HAMITI:

Unë mendoj që nuk është rasti t'i tëhollojmë disa probleme të cilat po kalojnë në probleme pak a shumë të preferencave personale. Ne kemi dy propozime. Një e kemi të Ramadan Kelmendit dhe një propozim të zotit Kuçi, i cili – në esencë e përkrah Kelmendin me një restriksion sepse unë sa dëgjova, nëse dëgjova mirë Kuçin, ai e përjashton titullin e magjistratit. Unë megjithatë i jap përkrahje propozimit të Ramadan Kelmendit me të dy titujt – edhe magjistër edhe doktor. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Urdhëroni Ramadan. Ju lutem ia bëni të mundshme diskutimin Ramadan Kelmendi.

#### DEPUTETI RAMADAN KELMENDI:

Unë do të jam i shkurtër. Natyrisht, e tha profesor Hamiti atë që deshi të thotë. Duhet të dimë se krahasimet nuk bëhen në lëmi të ndryshme. Fjala është se a mundet një qytetar i cili ka gradën shkencore magjistër dhe doktor i shkencave juridike ta ushtrojë profesionin e avokatit në lëmin përkatës? Mundet! Sepse, ai është megjithatë jurist që ka kryer katër vjet apo me këtë të sistemit të Bolonjës dhe asgjë aty nuk ka... Unë nuk dua tash të shpjegoj sa provime janë dhënë për këtë e atë. E tha profesor Hamiti dhe jam për atë që të dy titujt të shkojnë. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Nekibe Kelmendi, e fundit. Urdhëroni Nekibe.

#### DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:

Unë megjithatë e kam sqarimin tim, se ky amendament nuk duhet të kalojë për faktin se juristët e diplomuar, edhe kandidatët potencial për titull shkencor, të gjithë së pari e kryejnë fakultetin juridik dhe i japin të gjitha provimet e parapara me program. Kurse, për të fituar titullin e gjyqtarit, prokurorit dhe të avokatit, duhet përsëri të jepen edhe ato 13 – 14 provime dhe të fitohet një përvojë në praktikë. Dhe, nuk shkoj me shembuj individual, por shkoj me realitetin. Mirëpo, Kuvendi është që vendos, dhe le të vendosë dhe e respektojmë atë vendim të Kuvendit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem. Dëgjuam të gjitha sqarimet.

Regjia, përgatitemi për votim të amendamentit 9, sikur që është propozuar. Votojmë tani.

Ju faleminderit shumë. 49 vota janë për, 25 janë kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 10, me përkrahje nga Komisioni funksional dhe Komisioni legjislativ – Ramadan Kelmendi.

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.

70 vota për, 5 kundër – ka kaluar amendamenti.

11 – dy propozime:

a) Komisioni funksional dhe Komisioni legjislativ;

b) Deputeti Ramadan Kelmendi.

Do të thotë, e votojmë të parin një herë. Regjia përgatitemi për votim dhe votojmë tani.

53 vota për, 11 kundër, prandaj është vendosur për versionin nën a) të amendamentit 11.

Amendamenti 12 Komisioni funksional.  
Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.  
73 për, 1 kundër – ka kaluar amendamenti.

13 – me përkrahje nga Komisioni funksional dhe Komisioni legjislativ – Deputeti Ramadan Kelmendi.

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.  
66 për, 9 kundër – ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 14, dy propozime:

- a) Komisioni funksional,
- b) Deputeti Ramadan Kelmendi.

A është një, apo ndahen në dy pjesë? Ndaras.

Përgatitemi sipas procedurës, nën a) e para. Votojmë tani.

51 për, 14 kundër – ka kaluar amendamenti 14 – versioni nën a).

Amendamenti 15, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe Komisioni legjislativ – deputeti Ramadan Kelmendi.

Do të thotë pa përkrahje. Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.  
43 kundër, 29 për – nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 16 – me përkrahje nga Komisioni funksional dhe Komisioni legjislativ – deputeti Ramadan Kelmendi.

Përgatitemi për votim. Urdhëroni, e ka fjalën Ferid Agani.

DEPUTETI FERID AGANI:

Faleminderit zoti kryetar. Mendoj se pas miratimit të amendamentit 14, e kemi një diskrepancë në amendamentin 16 ku thirremi në ministrinë e drejtësisë. Mendoj se edhe këtu duhet të jetë teksti: në ministrinë përkatëse, në pajtim me amendamentin 14.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë mendoj se deputeti ka plotësisht të drejtë, por a ka ndonjë sqarim a vërejtje Komisioni funksional? E ka fjalën Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:

Tani e kemi të formuar Ministrinë e Drejtësisë dhe ajo duhet ta caktojë lartësinë e participimit për dhënien e provimit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Unë mendoj se duhet .... E ka fjalën Hydajet Hyseni, kryetar i Komisionit për legjislacion.

#### DEPUTETI HYDAJET HYSENI:

Faleminderit zoti kryetar. Mendoj se në shqyrtimin dhe vendimin në amendamentin e 14, për shkak edhe të nxitimit nuk u arrit të sqarohet se fjala është për një rrethanë të re. Drafti i ligjit dhe ligji është shkruar në kohën kur Kosova nuk ka pas as juridikisht institucionin e ministrisë së drejtësisë, prandaj edhe formulimi ka qenë për ministrinë përkatëse. S'ka mund të thuhet: për ministrinë e drejtësisë, por në ndërkohë, me rregulloren e shpallur, është themeluar Ministria e Drejtësisë në pikëpamje juridike, prandaj ne kemi sugjeruar që kjo të zëvendësohet me Ministrinë e Drejtësisë sepse është ajo mundësi tani.

Mendoj që, edhe pse Kuvendi i deklarua, po të ishte sqaruar, me siguri që Kuvendi do të përkrahte amendamentin e zotit Kelmendi sepse ai në të vërtetë vetëm e saktëson tash. Tash Ministria përkatëse është Ministria e Drejtësisë. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Hydajet të faleminderit. Pak më parë ishte ministria e formuar, unë po shoh, reagoni me kohë ju kryetarët e komisioneve, ju lutem. Asnjë nxitim nuk është bërë. E ka fjalën Ramadan Kelmendi. Urdhëro Ramadan.

#### DEPUTETI RAMADAN KELMENDI:

Këtu është amendamenti shumë decidiv dhe i qartë. Çdokund në tekst, emri ministria e shërbimeve të përbashkëta zëvendësohet me emrin ministria e drejtësisë dhe asgjë tjetër.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Tash duhet të unifikohet kjo. Ne tash do të votojmë sipas asaj që kemi. Do të thotë amendamenti 16 me përkrahje të dy komisioneve funksionale.

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.  
72 për, 3 kundër – ka kaluar amendamenti.

E dëshiron fjalën edhe një herë zoti Agani.

#### DEPUTETI FERID AGANI:

Unë ju kisha lutur që Kuvendi, për hir të asaj që të kemi një tekst konsistent ligjor t'i hyjë edhe një herë amendamentit 14 dhe të miratohet që në tekst të jetë ministria e drejtësisë gjithkund prezent në tekstin ligjor, sepse tash e kemi ligjin ku vetëm në një nen e kemi të

përmendur ministrinë e drejtësisë, ndërsa në të gjitha nenet e tjera e kemi ministrinë përkatëse.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ferid të faleminderit. E tha Ramadan Kelmendi ne e aprovojmë. Do të thotë gjithkund duhet të korrigjohet ajo – të gjitha komisionet dhe nuk kemi arsye, vetëm nëse dyshojmë në rezultat ose në llogaritje të votave proceduralisht me redaktuarën dhe që i bëhet korrigjimeve edhe gjyqësore, le të futet kjo. Ky ishte amendamenti i fundit, prandaj përgatitemi që ta votojmë ligjin në tërësi me amendamentet e aprovuara dhe me korrigjimin që u bë në nenet e duhura, të mbështeten në ministri përkatëse.

Regjia, përgatitemi për votim. Votojmë tani.

79 janë për, 2 kundër, konstatoj se është aprovuar ligji me të gjitha amendamentet.

Kalojmë në pikën e radhës:

- Raporti i Komisionit për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese lidhur me vërejtjet e UNMIK-ut në ligjin për familjen.

Ligji për familjen numër 2004-32 është miratuar në seancën plenare të mbajtur më 8 shtator 2004. I njëjti i është dërguar për shpallje PSSP me 6 tetor 2004.

PSSP, përmes Zyrës ligjore i është drejtuar Kuvendit me disa vërejtje, duke kërkuar sqarime plotësuese për disa dispozita të këtij ligji.

Shkresa i është shpërndarë të gjithë deputetëve, si dhe Komisionit për çështje gjyqësore dhe legjislacion e kornizë kushtetuese.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, pas shqyrtimit radhazi në disa mbledhje vendosi që Kuvendit t'i paraqes Kuvendit raportin e datës 12 dhjetor 2005 me rekomandimet për amendamentimin e këtij ligji.

Arsyetimin për të mbështetur këto rekomandime, mund t'i paraqesë Nerxhivane Dauti, anëtare e Komisionit në qoftë se dëshiron, kuptohet. Profesoreshë mund ta merrni fjalën.

#### DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI:

Ju faleminderit zoti kryetar. Atë që desha ta theksoj, ju pjesërisht e keni theksuar dhe për hir të nënshkrimit të ligjit të familjes që të bëhet sa më shpejt dhe të hiqet nga përdorimi dhe zbatimi "ligji i familjes i krahinës socialiste autonome të Kosovës" ftoj deputetët që t'i votojnë amendamentet e propozuara dhe të miratuara nga Komisioni funksional dhe ato të cilat i ka refuzuar grupi punues, që është formuar grupi punues nga Komisioni funksional në përbërje prej Gjykatës Supreme, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Zyrës së USAID-it, Zyrës së Kryeministrit dhe Zyrës për barazi gjinore që të miratohen në parim dhe të nënshkruhet ligji. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesoreshë ju faleminderit. Nuk kemi arsye të veprojmë ndryshe.

Amendamenti 1.

Të përgatitet regjia për votim dhe votojmë tani.

Ju lutem. Është një kërkesë, dhe unë dua mendimin e Komisionit funksional. Meqë të gjitha amendamentet janë të Komisionit – a mund t'i votojmë në pako, në tërësi? Çfarë mendimi ka Komisioni, profesoreshë? Edhe një herë Nerxhivani e ka fjalën.

#### DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI:

Kisha fluar deputetët që an-gjeneral të votohen të gjitha amendamentet, sepse janë të një karakteri, të një natyre, janë punuar nga grupi punues, janë shqyrtuar nga ekspertë përkatës dhe do të mund të votoheshin në tërësi.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Regjia të përgatitemi për votim... Urdhëroni, por s'jeni ju ekspertë për këtë...Urdhëroni. E ka fjalën Ferid Agani.

#### DEPUTETI FERID AGANI:

Zoti kryetar, nuk jam ekspert juridik por kam vërejtje në amendamentet që janë propozuar dhe mendoj se praktikisht të gjitha amendamentet që propozohen këtu vijnë nga komisionet funksionale, por ne po shkojmë me ligje tjera – po shkojmë amendament për amendament dhe s'po shoh arsye pse këtu me shkuar në paket. Mirëpo, unë i kam dy vërejtje në amendamentin 8 dhe në amendamentin 37 të këtij Projektligji.

Në amendamentin 8, në rreshtin e dytë – “martesa deklarohet si bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme”. Seksi dhe gjinia, në aspektin socio-psikologjik nuk janë të njëjta. Unë propozoj që pas fjalëve të “sekseve” të shtohen fjalët “dhe gjinive”. Seksi tregon vetëm dallimet fizike të trupit, ndërsa gjinia i referohet edhe dallimeve psikologjike, sociale dhe kulturore midis meshkujve dhe femrave. Mendoj se kjo është një çështje esenciale.

Dhe, në amendamentin 37 e kam vërejtjen time, te fjala “dhe ose” në rreshtin e dytë. Prandaj, në qoftë se në amendamente ngelë fjala “ose” atëherë praktikisht përjashtohet mundësia që në situata ku nevojitet trajtimi i specializuar i fëmijut jashtë Kosovës prioritet në procesin e adoptimit të jetë “qytetar i Kosovës”.

Mendoj se janë dy vërejtje substanciale të cilat kanë implikime konkrete. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Edhe një herë, profesoreshë Dauti. Urdhëroni.

#### DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI:

Ju faleminderit zoti kryetar. Sa i përket vërejtjes së parë, Komisioni apo grupi punues i ekspertëve ka shqyrtuar çështjen dhe ka bërë dallimin ndërmjet sekseve dhe gjinisë, sepse në të drejtën familjare ekziston gjinia e krushqisë dhe gjinia e adoptimit, prandaj për hir që të mos përzihen dhe të bëhen konfuzion Gjykata Supreme dhe ekspertët tjerë kanë kërkuar që të bëhet dallimi i tillë.

Sa i përket vërejtjes së dytë, kemi Konventën ndërkombëtare – Konventën e Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin në fushën e adoptimit ndërshtetëror të 29 majit 1993, e cila është e nënshkruar dhe kësaj konvente ne duhet t'i aderohe mi dhe ta pranojmë. Prandaj, për hir të harmonizimit me standardet ndërkombëtare është bërë amendamenti i propozuar. Këto janë arsyetime. Ne i kemi shqyrtuar këto vërejtje të cilat i ka bërë tani momentalisht deputeti dhe kemi marrë qëndrim sikurse e keni në raport. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Nazim Jashari, Ramadan Kelmendi dhe ta përfundojmë sepse s'po bëjmë debat, je që kërkon seanca e tash bëni debat të këtillë. Urdhëro Nazim.

#### DEPUTETI NAZIM JASHARI:

I nderuar zoti kryetar, të nderuar kolegë deputetë, kam një vërejtje procedurale para se të hyjmë në votim. Unë e di se të gjitha ligjet dhe projektligjet që vijnë në këtë seancë punohen nga grupe të ekspertëve, trajtohen sigurisht nëpër komisione mirëpo praktika jonë e punës nuk lejon që të votohen amendamentet në paket, përveç në rastet kur ka të bëjë një çështje apo një ndryshim ka të bëjë me më shumë nene. Prandaj, ju kisha lutur të mos hyjmë në një punë të parregullt procedurale. Keni konsideratë.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit, E ka fjalën Ramadan Kelmendi, i fundit.

#### DEPUTETI RAMADAN KELMENDI:

Ju faleminderit kryetar. Unë vlerësoj se profesoresha ka plotësisht të drejtë dhe si anëtar i këtij Komisioni kërkoj që ta përkrahni sepse është punuar mjaft dhe kohë e gjatë është duke u pritur për këtë ligj. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Për të vendosë, është e drejtë e deputetëve. Ne thamë po e qesim në votim në tërësi rekomandimin me amendamente të Komisionit. Në qoftë se nuk e fiton kjo votën tonë,

ne shkojmë nen për nen dhe mua nuk më bën pengesë asnjëra. Prandaj e vëmë në votim propozimin e Komisionit. Regjia të bëhet gati dhe votojmë tani.

64 deputetë kanë votuar për, 13 janë kundër – prandaj amendamentet prej 1 deri 49 janë aprovuar.

Një moment tani. Rregjia të bëhet gati, sepse duhet ta votojmë tekstin e miratuar më parë dhe amendamentet në tërësi.

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.

63 vota për, 5 kundër – konstatoj se ligji dhe amendamentet janë miratuar.

Tani vazhdojmë me pikën tjetër të radhës. Është kërkuar pauzë. Unë do t'i dëshiroj një herë mirëseardhje kryeministrit, dhe i kërkoj falje që këtë e bëj me vonesë. Kam sugjerim që, meqë është kryeministri, fjalën le ta merr për ta prezantuar këtë ligj dhe këtë pikë dhe pastaj të shkojmë në pauzë edhe për drekë dhe ju lus për mirëkuptim.

Pika e radhës është:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmjetësimin.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 02.12. 2005 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Vërejtjet parimore do t'i adresohen për shqyrtim Komisionit funksional përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftohet kryeministri, zoti Bajram Kosumi, që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Kryeministër, me kënaqësi, foltorja është e juaja.

**KRYEMINISTRI BAJRAM KOSUMI:**

I nderuar kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj,  
Para jush kemi sjell për miratim Projektligjin për ndërmjetësim, i cili në periudhën e ardhshme do të rregullojë ndërmjetësimin si formë e zgjidhjes së konteksteve me marrëveshje.

Ligji mendohet në të ardhmen të jetë me vlerë të rëndësishme, për vetë faktin se ndihmon në zgjidhjen e konteksteve me marrëveshje dhe liron gjykatat nga një numër çështjesh të cilat do të ishin të përshtatshme të zgjidhen me këtë formë.

Nisur nga arsyeshmëria që ndërmjetësimi ka vlerë të theksuar për të gjithë qytetarët e Kosovës, presim që çdo qytetar i Kosovës ta mirëpret dhe mbështet këtë ligj pas miratimit dhe shpalljes së tij.



Kur e kemi hartuar këtë projektligj, jemi nisur nga gjendjet e mëparshme praktike dhe ligjore që ndërlidhen me këtë fushë. Ndërmjetësimi në Kosovë, si formë e zgjidhjes së kontesteve ka qenë prezente në praktikën zakonore tradicionale por edhe në legjislacionet e mëparshme. Njëkohësisht nevoja e kornizimit me legjislacion përkatës të avancuar, më modern, në përputhje me standardet evropiane - ka qenë shtytje për Qeverinë që t'ia prezantojë Kuvendit të Kosovës një ligj të tillë për miratim.

Ligji në të ardhmen do të vendosë një kornizë adekuate ligjore dhe të vetme për rregullimin dhe funksionimin e ndërmjetësimit si mënyrë alternative e zgjidhjes së kontesteve, dhe me theks të veçantë - rregullon krijimin e këshillit të ndërmjetësimit, të drejtat dhe obligimet dhe aspektet e certifikimit dhe mbikëqyrjes së ndërmjetësimit të institucioneve trajnuese dhe kurseve, si dhe të drejtat dhe detyrat e kualifikuesve për ndërmjetësim.

Nisur nga këto arsye të mëdha, të cilat i përmenda më lartë, i kemi hyrë përgatitjes së këtij Projektligji, i cili sipas vlerësimeve të institucioneve ndërkombëtare, veçanërisht të OSBE paraqet një hap shumë të rëndësishëm të Kosovës në drejtim të garantimit të funksionimit edhe më të mirë të shtetit ligjor.

Përgatitja e këtij Projektligji është bërë nga zyrtarët e Qeverisë së Kosovës, në bashkëpunim të plotë me përfaqësuesit e OSBE dhe me ekspertë tjerë vendor e ndërkombëtar.

Projektligji është aprovuar nga ana e Qeverisë në mbledhjen e mbajtur më 22 nëntor 2005 dhe pas procedurës së përcaktuar po i parashtrohet Kuvendit të Kosovës për miratim.

Sipas vlerësimit të Qeverisë, aprovimi i këtij Projektligji përbën një hap përpara në pranimin e standardeve ndërkombëtare, në veçanti të standardeve që promovojnë përmirësimin e qasjes së përgjithshme në drejtësi, në jetën e përditshme, me anë të krijimit të metodave alternative të zgjidhjes së kontesteve.

Njëkohësisht, aplikimi i këtyre metodave të parashikueshme në mënyrë efektive ndikon pozitivisht në buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe në respektimin e historisë tradicionale të ndërmjetësimit në Kosovë.

Prandaj, të nderuar deputetë, ju propozoj që ta aprovoni këtë Projektligj me qëllim të implementimit të këtyre standardeve përkitazi me maksimalizimin e lirisë së zgjidhjes së kontesteve në njërën anë dhe në anën tjetër të vendosjes së kornizave ligjore të nevojshme në fushën e ndërmjetësimit dhe të ndërmjetësuesve. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Kryeministër, ju faleminderit. Hapim debatin në parim.

E ka fjalën Ramadan Kelmendi, në emër të LDK, dhe le të përgatitet Nerxhivane Dauti, në emër të PDK. Urdhëroni Ramadan.

**DEPUTETI RAMADAN KELMENDI:**

I nderuari kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë dhe të pranishëm tjerë. Ju faleminderit për fjalën e dhënë.

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të LDK të paraqes vlerësimin përkrahës në miratimin në shqyrtim të parë të Propozimligjit për ndërmjetësim. Këtë vlerësim përkrahës e mbështesim në këto fakte:

1. Propozimligji për ndërmjetësim është i punuar mirë në nivelin e kriterëve të duhura, si dhe është në pajtueshmëri me standardet e Unionit Evropian si dhe me kërkesat bashkëkohore të zgjidhjes së kontesteve të ndryshme në proceset paragjyqësore;
2. Në praktikën e përditshme, disa çështje, në fushën e së drejtës civile, penale e tjera nuk zgjidhen dhe mbesin kontestuese dhe të hapura juridikisht, andaj është mëse e nevojshme të kërkohen forma alternative të zgjidhjes dhe pikërisht këtë e arrin ndërmjetësimi qëllimin më të mirë;
3. Grupi Parlamentar i LDK vlerëson se zgjidhjet e propozuara në propozimligj për ndërmjetësim krijojnë mundësi ligjore që përmes alternativës së ndërmjetësimit të zgjidhen shumë konteste të cilat në mënyrë më efikas dhe më me sukses në aspektin kohor dhe financiar dhe në përmirësimin e marrëdhënieve ndërnjerëzore;
4. Në vlerësojmë se ndërmjetësimi efektivin e duhur do ta arrijë me njerëzit profesional dhe autoritativ në mjedise të caktuara si anëtarë të këshillit ndërmjetësues por duke mos kuptuar asnjëherë këtë si këshill të pleqërisë apo të pajtimit nga se propozimligji për ndërmjetësimin parasheh trajnimin, riaftësimin dhe kualifikimin për kryerjen e detyrave të ndërmjetësuesit;
5. Grupi Parlamentar i LDK, ndërmjetësimin në procesin paragjyqësor e koncepton si një veprim të organizuar institucional dhe qëllimor për zgjidhjen me mirëkuptim të konflikteve, mosmarrëveshjeve, dënimet materiale e morale të shkaktuara njëri-tjetrit dhe format tjera të përditshme.
6. Vlerësojmë se Projektligji duhet të përcaktojë mundësitë ligjore që ndërmjetësimi të pranohet edhe në shumë raste kur nuk e propozon gjykata apo prokuroria nga se arritja e vullnetit së zgjidhjes së kontestit është shumë më e lirë dhe më e qëndrueshme në rrethana tona se sa vendimet gjyqësore;
7. Vlerësojmë se këshilli ndërmjetësues duhet të formohet nga Ministria e Drejtësisë në përbërje më të madhe se 6 anëtarë duke përfshirë këtu edhe kryetarin e këshillit dhe pranë çdo gjykate të qarkut dhe në përbërje të tij të ketë edhe një përfaqësues të shoqatës së juristëve profesional të Kosovës me mundësi që kjo të jetë me mundësi afati 1 vit;
8. Grupi parlamentar i LDK vlerëson se detyrat dhe përgjegjësitë e këshillit të ndërmjetësimit duhet të përkufizohen në cilësi dhe sasi, duke u plotësuar dhe riformuluar pasi që këshilli është ndërmjetësues nuk është e arsyeshme që në raste të

konflikteve të zgjidhjet marrëveshje me vota sepse marrëveshja nuk mund të imponohet nga këshilli gjegjësisht do të ishte shumë më mirë që ndërmjetësimi të fillojë edhe zyrtarisht e jo të pritet vetëm kërkesa për ndërmjetësim, si dhe është mëse e arsyeshme që kushtet për ndërmjetësim të përcaktohen me nenin 11 të plotësohen dhe riformulohen;

9. Propozimligji duhet definuar në tërësi institucionin e trajnimit dhe kurseve për ndërmjetësuesit për mos të lënë përzierje të kompetencave në afate dhe në dhënien e licencës së punës e tjera, si dhe faktin se ndërmjetësimi nuk mund të jetë personi që ka konflikte të interesave në çështjet konkrete, si dhe çka do të ndodhë nëse njëra palë në konflikt nuk e pranon ndërmjetësuesin.

Dhe, në fund, Grupi parlamentar i LDK vlerëson se preambula e këtij propozimligji nuk është në pajtueshmëri me vendimin e Kuvendit të Kosovës, si dhe disa dispozita që i referohen departamentit të drejtësisë duhet t'i referohen Ministrisë së Drejtësisë.

Mbështetur në vlerësimet e lartcekura, Grupi Parlamentar i LDK konfirmon përkrahjen procedurale kuvendore të propozimligjit mbi ndërmjetësimin për miratim të mëtutjeshëm. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ramadan, ju faleminderit. E ka fjalën profesoreshë Dauti, le të përgatitet Mazlloom Kumnova.

#### DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI:

Ju faleminderit zoti kryetar. Projektligji për ndërmjetësimin hyn në grupin e ligjeve të rëndësishme në sistemin e drejtësisë. Ligji i propozuar ofron mundësi për të krijuar metoda konkrete alternative të zgjidhjeve të kontesteve si të fushës penale, civile dhe administrative. Nga nenet 27, sa i përmban në tërësi ky ligj, rrjedh se qëllimi i ligjit është jo vetëm rregullimi dhe funksionimi i ndërmjetësimit si mënyrë alternative e zgjidhjes së kontesteve por edhe rregullimi dhe krijimi i këshillit të ndërmjetësimit, kushtet e kërkuara nga ministria e drejtësisë, komisionet e ndërmjetësimit dhe certifikimi i ndërmjetësuesve, duke i dhënë ingerenca ekskluzive ministrisë dhe ministrit të drejtësisë.

Ligji konsideron ndërmjetësimin si veprimtari jashtëgjyqësore, që realizohet nga personi i tillë – ndërmjetësi për zgjidhjen në pajtim të mosmarrëveshjeve ndërmjet subjekteve të së drejtës personave fizik dhe juridik.

Ky ligj e pranon ndërmjetësimin e arritur në bazë të marrëveshjes jozyrtare të subjekteve të së drejtës para fillimit të procedurës në një gjykatë kompetente.

Sipas këtij ligji, të gjitha kompetencat për themelimin e këshillit të ndërmjetësimit i ka ministria e drejtësisë.

Sipas ligjit, këshilli do t'i emërojë komisionet ad-hoc ndërmjetësimi të zgjedhur në mesin e anëtarëve të këshillit.

Marrë në përgjithësi, ligji përmban një teknikë të mirë juridike për rregullimin e materies së ndërmjetësimit për zgjidhjen e kontesteve.

Disa nene të këtij ligji, duhet të riformulohen dhe konkretizohen më hollësisht. Konkretisht nenet 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 24.

Neni 25 i këtij ligji duhet të riformulohet dhe të precizohet. Këtu është fjala për legjislacionin ndihmës, ku theksohet se ministri i drejtësisë do të miratojë akte nënligjore për implementimin e këtij ligji, por nuk precizohet se këto akte nënligjore a duhet të jenë në procedurën e ndërmjetësimit në lëmin penal, civil apo administrativ, e që është e domosdoshme të bëhet.

Në emër timin dhe të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, konsideroj se ligji mund të miratohet në shqyrtim të parë, me vërejtjet dhe sugjerimet përkatëse të cilat do të paraqiten në Komisionin funksional në fazën e amendamentimit. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesoreshë, faleminderit. E ka fjalën MazlloM Kumnova, në emër të AAK, le të bëhet gati Husnija Beshkoviq, në emër të Grupit 6+.

#### DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA:

Zoti kryetar, kryeministër,  
Grupi i AAK e ka pas në dorë këtë Projektligj dhe ka konstatuar parimisht se Projektligji për ndërmjetësim rregullon ndërmjetësimin si formë alternative të zgjidhjes së kontesteve me marrëveshje të vullnetshme të palëve.

Dihet se ndërmjetësimi e ka një traditë, e po ashtu dihet se është edhe një ligji mbi marrëdhënie martesore dhe familjare dhe se kjo formë deri tani është kufizuar vetëm në konteste që lindin nga marrëdhëniet martesore familjare.

Ndoshta ky Projektligj mëton të rregullojë të gjitha kërkesat e dala si nga kontestet civile penale apo administrative me një kornizë të vetme ligjore. Po ashtu ky Projektligj ka për qëllim të rregullojë ndërmjetësimin në përputhshmëri me standardet ndërkombëtarisht të pranuar në përmirësimin e qasjes së përgjithshme në sistemin gjyqësor.

Me qëllim të krijimit të një sistemi më funksional gjyqësor, me anë të ndërmjetësimit si mënyrë alternative të zgjidhjes së konflikteve, palët nuk do të kenë nevojë t'i drejtohen gjykatës për të vendosur në bazë të detyrës zyrtare që ajo ka, por ai kontest mund të zgjidhet me ndërmjetësim natyrisht nëse palët kanë vullnesë për një pajtim.

Është vlerësim i Grupit të AAK se ky Projektligj përbën një hap përpara në pranimin e standardeve ndërkombëtare, që rregullojnë mjetet alternative të zgjidhjes së konflikteve, zbatimi i ndërmjetësimeve redukton numrin e rasteve të dërguara në gjykatë, ekonomikisht është më i favorshëm për palët dhe buxhetin e Kosovës si dhe me anë të ndërmjetësimit palët sigurojnë marrëveshjen pa imponim dhe këtë në një periudhë të shkurtër kohore, duke mos i mënjeluar se ndërmjetësimi garanton edhe ruajtjen e fshehtësisë personale apo afariste.

Si gjithnjë, edhe këtij projektligji i duhet një përkujdesje gjuhësore.

Mbi këto argumente, Grupi ynë ka vlerësuar se duhet dhënë përkrahje në parim këtij Projektligji. Faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Faleminderit. E ka fjalën Husnija Beshković, dhe le të përgatitet Nexhat Rexha.

**DEPUTETI HUSNIJA BEŠKOVIĆ:**

Poštovani predsedavajući, poštovani premijeru, poštovani kolege poslanici, Nacrt zakona o posredovanju je od posebnog značaja zbog činjenice da dosadašnji pravilnici UNMIK-a nisu u celosti regulisali ovu materiju i praktične potrebe za jednim zakonom ovakve prirode su imedijatne. Sve ovo je sa obrazloženjem da jedan veliki broj pitanja iz krivičnih civilnih administrativnih i drugih oblasti mogu da se reše posredovanjem kao alternativnom formom rešavanja pitanja.

Ovaj nacrt zakona ima za cilj da promoviše u skladu sa medjunarodnim prihvaćenim standardima poboljšanje opšteg pristupa pravosudju u svakodnevnom životu, stvaranjem alternativne metode rešavanja sporova.

Ovaj nacrt zakona sa posebnim naglaskom reguliše stvaranje saveta za posredovanje kao i prava i obaveze u aspektima certifikovanja, nadgledanja, posredovanja institucija za obuku i kurseve, kao i prava i dužnosti kvalifikovanih za posredovanje.

I pored uočenih izvesnih nedostataka, jezičkih grešaka poput onih u Poglavlju 2, član 3. tačka 2, Parlamentarna gurma 6+ u načelu prihvata Nacrt zakona o posredovanju a svoj dalji doprinos daćemo kroz amandmane. Hvala vam.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Husnija, të faleminderit. Unë nuk jam "predsedavajući", jam "predsednik". Këtë sa për t'ju relaksuar pak dhe për dokumente. E ka fjalën, edhe Nexhat Rexha. Urdhëroni Nexhat.

**DEPUTETI NEXHAT REXHA:**

I nderuar zoti kryetar, i nderuar zoti kryeministër, ministra dhe kolegë deputetë,

Projektligji për ndërmjetësim ngërthen në vete 27 nene, në të cila janë parashtruar probleme shoqërore që ndodhin apo mund të ndodhin në çdo vend të botës. Përmes këtij ligji, mund të parandalohen shumë dukuri negative në shoqëri. Konsideroj se këtij Projektligji i mungojnë elemente të qartësisimit të punëve dhe sikur çdo gjë iu ka lënë seminareve apo trajnimeve dhe në asnjë rast nuk parashihet përvoja e autoritetit që është domosdoshmëri e anëtarëve të këtij këshilli.

Neni 7, ku bën fjalë për themelimin e komisionit për ndërmjetësim, propozoj t'i shtohet edhe një pjesë me këtë përmbajtje: Këshilli mund të zgjedh një komision vetëm edhe në një rast të veçantë kur shihet se është domosdoshmëri e zgjidhjes së një rasti apo problemi.

Neni 23, i cili përshkruan dënimin e një anëtari të këtij këshilli, mendoj se së pari duhet të bëhet përjashtimi i tij e pastaj mund të vihet dënimi që paraqitet në këtë nen.

Ndërsa, pas këtij neni, mendoj se duhet të formulohet një nen i ri, apo vazhdues i tij, me këtë përmbajtje: Nëse një anëtar i këtij këshilli vepron në ndonjë rast kundër vetë këtij ligji në vend apo jashtë vendit, i merret imuniteti i anëtarit të këtij këshilli dhe pastaj ai mund të përjashtohet.

Propozoj që këshilla për ndërmjetësim të formohen edhe në qendra kryesore rajonale të Kosovës dhe njëherit mendoj se anëtar i këtij këshilli mund të bëhet personi i cili gëzon autoritet edhe në vendin ku jeton dhe vepron.

Duke marrë parasysh përmbajtjen e këtij Projektligji dhe punën e mëtutjeshme që do të bëhet në Komisionin përkatës, e përkrah në parim këtë Projektligj. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Nexhat ju faleminderit. Nekibja është provokuar nga diçka me vonesë, por urdhëro Nekibe për çka është fjala.

**DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:**

Jo, unë desha edhe një kontribut të vogël timin ta jap për fazat e amendamentimit të këtij ligji. Mos të përdoret askund gjykata konkrete, për shembull gjykata e qarkut ose gjykata komunale, sepse pritet së shpejti t'i dorëzohet në procedim këtij Parlamenti ligji për gjykatat, si ligj i cili do të fillojë edhe me reformën e sistemit gjyqësor...

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Deputetët le të kthehen, në seancë është diskutimi i fundit, ju lutem do të vendosim.

**DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:**

...Kështu që nuk dihet se cilat kompetenca të cilave gjykata do t'i mbesin për zgjidhjen e kontesteve të caktuara. Pra, duhet të thuhet vetëm "konteste të caktuara". Kjo ishte ajo imja, pa përmend cila gjykatë.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Nekibe, ju faleminderit. Unë i ftova deputetët, megjithatë 61 janë në sallë dhe kemi kuorum për të vendosur dhe e kemi këtë drejtë, por është mirë që kur po i afrohem vendimmarrjes edhe pse e zgjatëm pa pauzë, por për hir të kryeministrit... Prandaj ftoj deputetët, meqë ishte përkrahja nga grupet parlamentare që në parim të deklarohemi.

Regjia, të bëhemi gati.

#### (Ndërprerje e shkurtër)

I kërkoj falje regjisë. Le të bëhet gati tani për të marrë vendim dhe votojmë tani. Ju faleminderit. 69 janë për, 1 votë kundër – konstatoj se ligji në parim është aprovuar.

Pasi është i aprovuar, duhet t'ju them se komisionet të cilat duhet ta shqyrtojnë janë: Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, si komision funksional dhe referues, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për komunitete.

Tani do të bëjmë pauzë deri në orën 13, 30.

Para se të marrim pauzë, lajmërohet profesor Kuçi për fjalë. Urdhëroni profesor.

#### DEPUTETI HAJREDIN KUÇI:

Faleminderit zoti kryetar. Sikur jemi të njoftuar, mbrëmë ka pasur një tragjedi me ushtarët e KFOR-it që kanë shërbyer në Kosovë – ushtarët sllovak. Mendoj se do të ishte mirë që ky Kuvend, përveç një telegrami ngushëllues, ta bënte edhe një minutë heshtje për ata ushtarë që një kohë të gjatë kanë shërbyer në vendin tonë. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë mendoj se me kënaqësi, Kuvendi pranon këtë propozim, prandaj përveç dërgimit të telegramit ngushëllues, ju ftoj edhe për një minutë heshtje.

(Të gjithë në këmbë - vijon minutë heshtjeje për ushtarët sllovak të KFOR-it)

L A V D I !

(Nga deputetët dhe të pranishmit: L a v d i!)

Tani, mund të bëjmë një pauzë. Pas kësaj pauze, në ora 13,30 vazhdojmë punën ju lutem.

Vazhdimi i seancës pas pauzës të datës 20.1.2006 13,30 minuta

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Të nderuar deputetë, vazhdojmë seancën me pikën e radhës, si vijon:

### **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për konfliktet administrative**

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 13.12.2005. Pra , janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Vërejtjet parimore do t'u dërgohen për shqyrtim Komisionit Funkcional Përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftohet ministrja, Melihate Termkollli ,që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit, të prezantojë projektligjin.

E keni fjalën , ministre.

**MINISTRJA MELIHATE TERMKOLLI:**

Faleminderit z. kryesues. E di që Sala ka vërejtje në këto emërtime: ministër, ministre etj. etj. por s'ka dert ,herëve të tjerë i rregullojmë.

I nderuari z. kryetar, të nderuar deputetë,

Kompletimi i infrastrukturës se nevojshme ligjore të rregullimit të të gjitha sferave të jetës në Kosovë, përbën jo vetëm epiqendrën e angazhimit tonë, por edhe një nga sfidat e rëndësishme për institucionet e Kosovës, për faktin se një mori ligjesh të aplikueshme në Kosovë, nuk u përgjigjen rrethanave dhe kërkesave të reja, si dhe standardeve të legjislacionit evropian. Kjo shtron nevojën imediate të rregullimit të këtyre raportëve shoqërorë me dispozita ligjore.

Promovimi i një shoqërie demokratike në Kosovë përqendrohet në ndërtimin e institucioneve demokratike përfaqësuese e të ekuilibruara, ku respektohet parimi i ndarjes së pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.



Pas miratimit të Projektligjit të procedurave administrative nga Kuvendi i Kosovës Projektligji për konfliktet administrative është një dokument ligjor, që përmbledh rregulla procedurale që synojnë të garantojnë përgjegjshmëri dhe transparencë në marrëdhëniet e autoriteteve të administratës, të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe palëve – përkatësisht qytetarëve në pajtim me standardet më të mira evropiane, që është qëllim edhe i Qeverisë të Kosovës.

Me këtë ligj, rregullohen në tërësi marrëdhëniet në kontestet administrative ndërmjet organeve të administratës, palëve dhe Gjykatës Supreme, përkatësisht gjykatës kompetente.

Ky ligj u ofron palëve më shumë garanci procedurale dhe eliminon edhe ligjet e aplikueshme, që tani në këtë nivel të zhvillimit, janë të pazbatueshme në Kosovë. Ligji për konfliktet administrative përmban rregulla procedurale që garantojnë ligjshmëri, efektivitet, përgjegjshmëri, integritet dhe transparencë në marrëdhëniet e autoriteteve administrative me palët në procedurë.

Pjesa e parë e projektligjit përcakton mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të personave fizikë, të personave juridikë ose palëve të tjera dhe sigurimin e ligjshmërisë së akteve administrative, me të cilat organet e administratës në ushtrimin e autorizimeve të tyre, vendosin për të drejtat dhe detyrimet në çështjet administrative. Ky ligj përcakton kush mund të jetë palë në konfliktin administrativ, duke zgjeruar numrin e subjekteve që mund të jenë palë me të vetmin qëllim të përfshihen të gjithë ata që konsiderojnë se me aktin përfundimtar administrativ u është shkelur ndonjë e drejtë ose ndonjë interes i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj. Në këtë grup mund të hyjnë: personi fizik, personi juridik, grupi i personave; avokati i popullit, shoqatat dhe organizatat e tjera, organi i administratës, prokurori publik dhe personi i autorizuari i administratës ose i autoritetit publik.

Është përcaktuar, po ashtu, që kompetente për zgjidhjen e konfliktit administrativ, sipas këtij ligji, të jetë Gjykata Supreme e Kosovës ose gjykata kompetente e paraparë me ligj të veçantë.

Në projektligj është paraparë mundësia e fillimit të konfliktit administrativ kundër aktit administrativ, ndaj të cilit nuk ka mjete të rregullta juridike në procedurën administrative, si dhe aktet administrative, kundër të cilave nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ, numërimi i shkaqeve për të cilat akti administrativ mund të kontestohet, sqarimi i të drejtave dhe i detyrave të palëve në konfliktin administrativ, mundësia e shtyrjes së ekzekutimit nga organi, akti që ekzekutohet, përkatësisht organi që është kompetent, deri në vendimin përfundimtar gjyqësor.

Projektligji i përcakton kompetencën për vendosje në konfliktin administrativ, përbërjen e kolegjit, rastet kur dhe kush i paraqet mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike. Në projektligj është paraparë procedura në bazë të padisë. Me këto dispozita rregullohet mënyra e fillimit e vazhdimit dhe e përfundimit të konfliktit administrativ, pastaj përcaktohet mënyra e dorëzimit të padisë gjykatës ose organit tjetër, mundësia e fillimit të konfliktit administrativ për shkak të heshtjes së organit administrativ, vlerësimi

formal dhe material i padisë dhe mënyra e vendosjes nga gjykata lidhur me padinë e paraqitur. Është paraparë, po ashtu, mundësia që gjykata vetë ta vërtetojë gjendjen faktike dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar të nxjerrë aktgjykimin, përkatësisht vendimin kur në bazë të provave është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative ose nëse për të njëjtën çështje administrative është anuluar një here akti administrativ ,ndërsa organi administrativ nuk ka vepruar plotësisht sipas aktgjykimit.

Me këto dispozita është paraparë mënyra e paraqitjes së ankesës,të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe të kërkesës për rishikim dhe janë përcaktuar procedura lidhur me këto mjete juridike dhe afatet për paraqitjen e tyre.

Në projektligj është paraparë se nëse ky ligj nuk përmban rregulla përkatëse apo të plota për konfliktin administrativ , do të zbatohen përshtatshëmrisht dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore.

Për zbatimin e këtij ligji nuk do të ketë shpenzime shtesë dhe nuk nevojiten mjete financiare shtesë..

Të nderuar deputetë, ju propozoj ta miratoni këtë projektligj, në mënyrë që çështja e procedurës administrative dhe e konfliktit administrativ të vihet në suaza të parapara të kornizës ligjore . Ju faleminderit.

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Ju faleminderit ministre, ju faleminderit për përmirësimin që ma bëtë,por e kisha të shkruar kështu në material, gjuhëtarët le të merren pak me këtë çështje. Hapim debatin për diskutim në parim.Është paraqitur deputeti Sadudin Berisha, besoj që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së. E keni fjalën.

#### DEPUTETI SADUDIN BERISHA:

Faleminderit, i nderuari kryesues, i nderuari kryeministër, e nderuara monistre, të nderuar kolegë deputetë.

Projektligji për konfliktet administrative, i sponsoruar nga Qeveria, i hartuar nga Ministria e Shërbimeve Publike, është mirë i përgatitur, i arrin objektivat e parashikuar, synon rregullimin ligjor të konflikteve administrative, si objektiv duke siguruar ligjshmërinë dhe mbrojtjen gjyqësore të personave fizikë, juridikë, të personave dhe të subjekteve të tjera në raport me organet administrative ,të organeve të administratës në vendimmarrje për të drejtat e personave fizikë e juridikë, të subjekteve të tjera,nga çështjet e caktuara administrative. Këta objektiva ky projektligj i arrin në masën më të madhe, sepse qartë përcakton procedurat dhe rregullat procedurale për konflikte

administrative, përcakton palët në konflikt, pra kush mund të jetë palë paditëse dhe kush palë e akuzuar, përcakton kompetencat dhe mjetet juridike që mund të ushtrohen, përcakton procedurat në bazë të padisë, procedurat sipas mjeteve juridike- pra të ankesës, procedurat për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimeve të plotfuqishme, mbrojtjen e ligjshmërisë nëpërmjet ushtrimit të kërkesave, mundësinë e rishikimit të vendimeve të formës së prerë e të tjera.

Me gjithë këto vlerësime pozitive, dhënë me të drejtë këtij projektligji, është vlerësuar se disa nene 8, 25 dhe disa të tjera kërkojnë qartësim, riformulim ose edhe ndryshim me amendamentim në procedurat në vijim, qoftë nga Komisioni Funkcional Raportues, nga grupet parlamentare ose nga deputetët në grupe ose individualisht, me qëllimin e fundit që ky ligj të jetë më praktik, më i zbatueshëm dhe më funksional në procedim të mëtejshëm.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, krahas këtyre vërejtjeve, ia jep vizën pozitive për procedim të mëtejshëm dhe kërkon nga deputetët e Kuvendit ta mbështesin në parim. Ju faleminderit.

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Ju faleminderit z. deputet. Ju njoftoj se në debat janë të pranishëm 74 deputetë. Për fjalë është paraqitur, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së deputetja Nerxhivane Dauti.

#### DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI:

I nderuari z. kryesues, të nderuar deputetë,

Është fakt i pakontestueshëm se Projektligji për konfliktet administrative hyn në grupin e ligjeve më të rëndësishme sistemore.

Projektligji për konfliktet administrative rregullon marrëdhëniet ndërmjet organeve të administratës, palëve dhe gjykatës kompetente

Ligji ofron sigurimin e ligjshmërisë dhe mbrojtjen gjyqësore të drejtave të personave fizikë, të personave juridikë dhe të autoritetit publik, kur organet e administratës vendosin për të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve në çështjet administrative. Ligji u ofron palëve më shumë garanci procedurale, garanton ligjshmëri, efektivitet, por edhe transparencë në marrëdhëniet e autoriteteve administrative me palët në procedurë.

Në këtë ligj parashihet mundësia e fillimit të konfliktit administrativ kundër aktit administrativ, kundër të cilit nuk ka mjete të rregullta juridike në procedurën administrative, si dhe ndaj akteve administrative kundër të cilave nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ.

Me dispozita juridike të këtij ligji:

Së pari, përcaktohen mënyra e dorëzimit të padisë gjykatës ose organit tjetër, mundësia e fillimit të konfliktit administrativ për shkak të heshtjes së organit administrativ, vlerësimi formal dhe material i padisë dhe mënyra e vendosjes nga ana e gjykatës lidhur me padinë e paraqitur, ku parashihet edhe shqyrtimi verbal, nëse gjykata konstaton se çështja është e ndërlikuar,

Së dyti, saktësohen detyrimet e organit kompetent që të veprojë ashtu siç është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ, mundësia që gjykata vetë ta vërtetojë gjendjen faktike dhe në bazë të saj të nxjerrë aktgjykimin

Së treti, saktësohet procedura sipas mjeteve juridike: a) ankesë, b) kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm dhe c) kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Në këto raste, sipas ligjit, gjykata do ta hedhë poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se padia është paraqitur pas kalimit të afatit, se akti që kontestohet me padi nuk është akt administrativ, se është fjala për çështjen për të cilën sipas dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ, kurse në anën tjetër ekziston vendimi i formës së prerë, i nxjerrë në konfliktin administrativ për të njëjtën çështje.

Në qoftë se organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nuk nxjerr menjëherë, në afat prej 30 ditësh, aktin e ri administrativ ose, aktin në zbatim të aktgjykimit të nxjerrë në bazë të nenit 39, paragrafi 5, të këtij ligji, Ligji i ofron palës mundësi të kërkojë, me kërkesë të veçantë, nxjerrjen e aktit të tillë.

Ligje të përsosura nuk ka. I tillë është edhe Ligji për konfliktet administrative. Si vërejtje kryesore lidhur me këtë ligj do t'i paraqes:

1. Neni 52, paragrafi 1, duhet të riformulohet teknikisht. Asnjëherë nuk kam hasur në legjislacion radhitje të tillë, siç veprohet me pikat e nenit, me një shkronjë, i, dy, tri dhe me katër i. Kështu veprohet edhe në nenet 2, 6, 26, 35, 49. Propozoj standardizimin juridik komplet të ligjit.

2. Neni 57 përmban dispozita të tjera të procedurës, duhet riformuluar; të konkretizohet më hollësisht, sepse si i tillë është abstrakt dhe vështirëson mundësinë e zbatimit të ligjit në praktikën gjyqësore.

3. Neni 58, paragrafi 3 duhet të fshihet, sepse e njëjta çështje rregullohet me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Neni 61 paragrafi 2 duhet të harmonizohet me rregullat e Ligjit të procedurës kontestimore.

5. Neni 62, që përmban dispozita kalimtare dhe të fundit të riformulohet dhe të konkretizohet në mënyrë analoge ,siç është vepruar edhe me ligjet e tjera të miratuara në këtë Kuvend.

6. Neni 63 në tërësi është i panevojshëm, sepse me vetë faktin e miratimit të këtij ligji ,do të shfuqizohen dispozitat e ligjit të aplikuar që është në kundërshtim me këtë ligj. Duke marrë parasysh vlerën dhe rëndësinë e këtij ligji, në emër timin dhe të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, konsideroj se Ligji mund të miratohet në shqyrtim të parë, me vërejtjet dhe me sugjerimet përkatëse që do të paraqiten në Komisionin Funkcional në fazën e amendamenteve.  
Ju faleminderit.

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Ju faleminderit z. deputete. Fjalën e ka deputeti Ymer Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, le të bëhet gati deputetja Shpresa Murati ,në emër të Grupit Parlamentar 6+. E keni fjalën z. deputet.

#### DEPUTETI YMER HALIMI:

Faleminderit z. kryesues ,i nderuari kryeministër, të nderuar deputetë.

Grupi Parlamentar i AAK-së ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për konfliktet administrative dhe mbështet në parim për procedim në Kuvend. Projektligji për konflikte administrative ka për qëllim sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të personave fizikë, juridikë dhe të palëve të tjera për të gjitha çështjet që procedohen sipas Ligjit për procedurat e përgjithshme administrative.

Miratimi i ligjit ka një rëndësi të veçantë për përmbushjen e kuadrit ligjor të nevojshëm të ne dhe përcakton pasuritë lidhur me mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave dhe për realizimin e një shkalle të caktuar të efektivitetit të parimeve në pajtueshmërinë me natyrën e procedurave të caktuara.

Grupi Parlamentar i AAK-së është i mendimit se ky projektligj është hartuar mirë në aspektin profesional.Me këtë sigurohet se qëllimi i synuar mund të arrihet pikërisht nëse zbatohet ky ligj. Mendojmë se me kohë ky projektligj do të avancohet., por në fazën e tashme ka edhe disa mangësi, andaj po i paraqesim disa sosh konkretisht.

Neni 9 pika 9.2., teksti është mirë të riformulohet ose të shlyhet tërësisht

Neni 15 duhet të harmonizohen pikat 15.2 dhe 15.3 me 15.1 ,sepse në një formë janë në kundërshtim me njëra-tjetrën..

Te neni 59 në vazhdim është gabim numërimi i pikave të nenit, sepse fillon me numërim 58 ,ndërsa duhet të jetë me 59 dhe kështu pika 59.3 e këtij neni ,si e tillë, nuk ndërlidhet fare me këtë nen dhe mbetet pa kuptim.

Besojmë se komisioni do t'i mënjanojë gabimet dhe kështu ligjin do ta dërgojë të plotësuar mirë, në Kuvend për miratim. Ju faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Faleminderit z. deputet, fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar 6+ . deputetja Shpresa Murati. E keni fjalën, le të bëhet gati deputeti Milazim Haliti.

**DEPUTETJA SHPRESA MURATI:**

Hvala!

Poštovani predsedavajući, poštovana Vlado i kolege poslanici. Nacrt zakona upravni sporovima ima poseban značaj i eliminiše zakonsku prazninu koja se odnosi na upravne sporove. Ovaj Nacrt zakona uređuje odnose u upravnim sporovima između upravnih organa, stranaka i Vrhovnog suda, odnosno nadležnog suda. Odredbe ovog Nacrt zakona sažimaju proceduralna pravila kojima teže da osiguraju zakonitost, efikasnost, odgovornost, integritet i jasnoće u odnosima autoriteta uprave sa strankama u proceduri.

U načelu mi nemamo primedbe na samu srž sadržine Nacrta zakona o upravnim sporovima zato što pre svega smatramo da isti u potpunosti ispunjava uslove koji su neophodni za jedan zakon ovakve prirode, a prvo vezano za pravo pokretanja upravnog spora, ko rešava upravne sporove, protiv koga se nemože voditi upravni spor, kada se može pobiti upravni akt, tužilac i tužena stranka i tako dalje. S toga, parlamentarna grupa 6+ u načelu podržava ovaj Nacrt zakona i daće doprinos u toku njegove dalje skupštinske procedure kojom će građani Kosova dobiti još jedan savremeni zakonski dokument sprovedljiv u praksi savremenog Kosova. Hvala!

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Milazim Haliti.

**DEPUTETI MILAZIM HALITI:**

Faleminderit z. kryesues, të nderuar deputetë.

Projektligji për konfliktet administrative, i propozuar nga Ministria e Shërbimeve Publike, ofron një bazë të mirë ligjore dhe rregullon marrëdhëniet në kontestet administrative ndërmjet organeve të administratës , palëve dhe Gjykatës Supreme, përkatësisht gjykatës kompetente të paraparë me ligj të veçantë.

Synimi kryesor i këtij projektligji është rregullimi i marrëdhënieve në kontestet administrative dhe me këtë eliminohet zbrazësia juridike në këtë fushë. Me dispozitat e këtij projektligji parashihet fillimi i procedurës së konfliktit administrativ ndaj aktit, kundër të cilit nuk lejohen mjetet e rregullta juridike në procedurë administrative, por tani me padi duhet të vendosen në procedurë gjyqësore dhe kjo bëhet atëherë kur me aktin administrativ shkelen të drejtat ose interesat e palëve.

Projektligji ka strukturë të mirë ligjore dhe përmbush kriteret e miratimit në parim, më gjithë vërejtjet që i ka është e nevojshme të plotësohen dhe të riformulohen disa nene. Me këtë rast po i përmend disa:

Te neni 8, paragrafi 1, pastaj kemi nenin 21, paragrafi 2, ku thuhet "po qe se paraqitja e saj këtij organi ka qenë pasojë e mosdijes së paraqitësit.

Edhe te neni 25, ku thuhet se kryetari i kolegjit do të ftojë paditësin që brenda afatit të caktuar t'i mënjanojë mangësitë e padisë, por nuk është caktuar cili është ky afat, do të thotë ligji duhet ta parashohë. Mendoj se plotësimi dhe riformulimet e nevojshme do të bëhen nga Komisioni Funkcional. Në parim e mbështes miratimin e këtij projektligji. Ju faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit z. deputet, fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

**DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:**

Faleminderit z. anëtar, kryesues i Kuvendit

Nuk do të diskutojë për këtë ligj, por nuk e pata të qartë se ju e përmendët Komisioni Funkcional, që është komision funksional që ngarkohet me shqyrtimin e mëtutjeshëm të këtij ligji.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Faleminderit. U vjen radha komisioneve funksionale. Me këtë përfundon debati në parim, nuk ka të paraqitur më për debat, prandaj i ftoj deputetët e nderuar të votojmë për miratim në parim të këtij projektligji. Të pranishëm janë 78 deputetë. Regjia I lutem, të përgatitemi për votim.

Votojmë tani.

65 deputetë votojnë për,  
2 janë kundër  
1 abstenon.

Konstatohet se projektligji u miratua në parim në bazë të rregullës 23.6. dhe rregullës 35.2 Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media si Komision Funkcional dhe referues,
2. Komisionin për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,
3. Komisionin për Buxhet dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet në afat, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, duhet ta shqyrtojnë projektligjin .Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën tjetër. Pika 11 e rendit të ditës.

### **Shqyrtimi i parë i Projektligjit kundër shpifjes dhe fyerjes**

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 20.12.2005 dhe janë përmbytur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore t'u dërgohen për shqyrtim Komisionit Funkcional përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftohet kryeministri, z. Bajram Kosumi që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë projektligjin. E keni fjalën z. kryeministër.

### **KRYEMINISTRI BAJRAM KOSUMI:**

I nderuar kryesues i Kuvendit të Kosovës, të nderuar deputetë të Kuvendit zonja dhe zotërinj. Kemi sjellë para jush, për miratim Projektligjin civil kundër shpifjes dhe fyerjes, që do të rregullojë përgjegjësinë civile për shpifje dhe fyerje, duke siguruar të drejtën e lirisë së shprehjes, ashtu si garantohet me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9, të 15. maj 2001 të Kornizës Kushtetuese, si dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut. Qëllimi i këtij projektligji është ristrukturimi i rregullave që kanë të bëjnë me shpifjen dhe fyerjen me qëllim që të mos vihen kufij pa arsye mbi lirinë e shprehjes dhe në veçanti për publikimin dhe diskutimin e çështjeve me interes të rëndësishëm për publikun. Gjithashtu, ky projektligj siguron kompensime efektive dhe të përshtatshme për ata të cilëve u është dëmtuar reputacioni nga publikimi i materialit shpifës, i obligon mjetet e informimit publik të kenë rol të rëndësishëm me procesin demokratik si vëzhgues publik dhe transmetues të informatave për publikun.



Nisur nga këto arsye të mëdha që i përmendëm më lart, e kemi hartuar këtë projektligj që sipas vlerësimeve të institucioneve tona, por edhe të atyre ndërkombëtare, posaçërisht të Këshillit të Evropës, përbën një hap shumë të rëndësishëm që Kosova po ecën përpara në drejtim të garantimit të lirisë së shprehjes në Kosovë.

Këtë projektligj e hartuan zyrtarët e Qeverisë së Kosovës në bashkëpunim të plotë me përfaqësuesit e OSBE-së, të Komisionarit të Përkohshëm për Media dhe me ekspertë të tjerë vendorë e ndërkombëtarë. Është zhvilluar një vizitë zyrtare në Këshillin e Evropës, ku zyrtarët tanë atje kanë inkorporuar standardet e Këshillit të Evropës në përmbajtjen e këtij projektligji.

Projektligji është miratuar nga ana e Qeverisë në mbledhjen e mbajtur më 22.11.2005 dhe sipas procedurës së përcaktuar po i parashtrohet Kuvendit të Kosovës për miratim.

Projektligji është i strukturuar në tetë kapituj:

- Kapitulli I. Dispozitat e përgjithshme, ku trajtohen qëllimi i Ligjit, interpretimi i tij dhe përkufizimet.
- Kapitulli II. Masat për mbrojtjen nga shpifja dhe fyerja, në të cilin rregullohet veprimi kundër shpifjes dhe fyerjes.
- Kapitulli III. Përgjegjësia, me të cilin rregullohen përgjegjësia për shpifje dhe fyerje.
- Kapitulli IV. Rastet e përjashtimit nga përgjegjësia dhe kufijtë e përgjegjësisë. Në këtë kapitull rregullohen rastet e tilla veç e veç si: Prova e së vërtetës, publikimet e arsyeshme, opinionet, imuniteti, imuniteti i kushtëzuar, kufijtë e përgjegjësisë.
- Kapitulli V. Përbën dispozitat me të cilat rregullohen detyrimi për të zbutur dëmin dhe e drejta për reagim.
- Kapitulli VI. Me këtë kapitull rregullohet kompensimi për shpifjen dhe fyerjen dhe urdhëresat gjyqësore.
- Kapitulli VII. Rregullon afatet për paraqitjen e kërkesave për kompensim, mbrojtja e burimeve si dhe, gjykata kompetente për të vendosur në lidhje me shpifjen dhe fyerjen.
- Kapitulli VIII. Dispozitat kalimtare dhe të fundit, përmbajnë dispozitat për rregullimin e rasteve kur procedura të ketë filluar dhe është duke u zhvilluar në bazë të ligjit të vjetër deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, si dhe momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Sipas vlerësimit të Qeverisë së Kosovës, miratimi i këtij projektligji është një hap përpara në pranimin e standardeve ndërkombëtare, në veçanti standardeve të Këshillit të Evropës në fushën e Lirisë së Shprehjes. Prandaj, të nderuar deputetë, ju propozoj dhe ju ftoj ta aprovoni këtë projektligj me qëllim të implementimit të këtyre standardeve përkitazi me maksimalizimin e lirisë së shprehjes- në njërën anë- dhe në anën tjetër vendosjen e

dispozitive për mbrojtjen adekuate ligjore nga shpifja dhe fyerja, që njëkohësisht përbën edhe esencën e këtij projektligji. Ju faleminderit.

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Ju faleminderit z. kryeministër. Hapim debatin për diskutim në parim për fjalë është paraqitur, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Sabri Hamiti.

Zonja. deputete, ia japim fjalën kryetarit të Komisionit, ju nuk jeni paraqitur në fillim, pastaj e keni kyçur. Kur doni ta kërkonit fjalën shtypni pullën që e keni përpara dhe ne atëherë mund ta dimë, se ndryshe, nuk mund t'i përcjellim të gjithë kur e kemi këtu mundësinë sot. Hydajet Hyseni në emër të Komisionit Parlamentar Funkcional. Urdhëroni.

#### DEPUTETI HYDAJET HYSENI:

Faleminderit z kryesues. Më lejoni që në fillim ta sqaroj edhe këtë pa e llogaritur kohën se kërkesën për t'iu drejtuar Kuvendit lidhur me këtë çështje, e kam bërë ditë më parë. Ishte e njoftuar gjithë administrata e Kuvendit. I kam njoftuar edhe drejtuesit e seancës plenare, do të thotë e kam bërë me shkrim si kërkesë për të kërkuar në emër të Komisionit që kjo çështje të hiqet nga rendi i ditës sot, por kërkohet kohë shtesë dhe ndërkohë edhe të plotësohen parakushtet për shqyrtimin meritor të këtij projektligji.

Megjithatë, z. kryesues, është një rend. E kërkova fjalën edhe me dorë edhe me teknikë dhe rregulla e përcakton qartë rendin e diskutimeve dhe kjo nuk është bërë rastësisht, por është bërë pikërisht për atë që të mos hapim çështje që mund të ngatërrohen më vonë.

Z. kryesues, të nderuar deputetë, i nderuari z. kryeministër.

Komisioni për Çështje Legjislative, Kushtetuese, Juridike e ka shqyrtuar, në përputhje me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, Projektligjin civil, kështu është emëruar Projektligj civil kundër shpifjes e fyerjes dhe ka vendosur t'ia propozojë Kuvendit si vijon:

1. Të sigurohet kohë shtesë për shqyrtimin e këtij projektligji,
2. Kuvendi ta heqë nga rendi i ditës i seancës së sotme dhe ta shtyjë për më vonë shqyrtimin e këtij projektligji,

3. Kuvendi të kërkojë nga Qeveria që ndërkohë t'ia bashkëngjet Projektligjit edhe komentet e Këshillit të Evropës që u referohen në shkresën përcjellëse.

Më lejoni, z. kryesues, z. kryeministër, që në vend të arsytimit të këtij propozimi t'i theksoj edhe disa nga arsyet e një qëndrimi të përmendur.

Për arsyet që përmenda, por edhe për shkak të kohës së shkurtër që kishim në dispozicion, Komisioni nuk kishte mundësi ta konstatonte bazueshmërinë ose

jobazueshmërinë juridike kushtetuese të tij harmonizimin ose mosharmonizimin e tij me dispozitat e Kornizës Kushtetuese, të Kodit Penal dhe të akteve të tjera, të standardeve të mirënjohura ndërkombëtare.

Megjithatë në Komision është shprehur brengosje se Projektligji kështu siç është, në zbatim e sipër në praktikë, lë mundësinë e të qenit në kundërshtim me dispozitat përkatëse të Kodit Penal dhe mund ta cenojë dhe ta kufizojë më tej lirinë e shprehjes, si të drejtë themelore njerëzore. Projektligji është motivuar me synimin për ta parandaluar gjuhën e shpifjes dhe të fyerjes, prandaj si të tillë e mbështesim. Duke i dekriminalizuar, siç thuhet edhe shprehimisht, por në pamundësi për t'i shfuqizuar përsëri, po citoj dispozitat përkatëse të Kodit Penal, siç thuhet në shkresën përcjellëse: "Për shkak të pushteteve të rezervuara" synohet që kjo të bëhet duke e relativizuar, duke defunksionalizuar dhe duke u dhënë përparësi dispozitave të Ligjit civil për shpifjen dhe fyerjen gjithnjë, siç theksohet në shkresën përcjellëse: "Në përputhje me praktikën e një pjese -po citoj- dërmuese të vendeve perëndimore. Imponohen me këtë rast pyetje të shumta. Më lejoni ta veçoj ndonjë: "A është e vërtetë se është e pamundshme të bëhen ndryshime në dispozitat e Kodit Penal" edhe kur, siç thuhet, minimalizojnë lirinë e shprehjes, pse na qenka e pamundshme dhe pse do të pamundësonte këtë Zyra Ligjore e UNMIK-ut", siç thuhet në tekst. Si të kuptohen këto, në këtë rast pozicionet krejtësisht të kundërta të Këshillit të Evropës dhe të UNMIK-ut, që janë rekomandimet e vërteta të Këshillit të Evropës dhe që janë vendet që përbëkan pjesën dërmuese të vendeve perëndimore.

Pastaj, nuk është Ligji civil zgjidhja më e mirë në situata të ngjashme, sepse ai mund t'i mbivlerësojë dispozitat e Kodit Penal dhe si do të reflektohet kjo si praktikë dhe si precedent në ligjvënien tonë.

Për më tepër, po të lexohet me vëmendje teksti i Projektligjit, krijohet përshtypja se ai jo vetëm që nuk e zbut dukurinë e shpifjeve dhe të fyerjeve të sanksionuara edhe me dispozitat e Kodit Penal, siç thuhet me burgim dhe me gjobë, por përkundrazi e ashpëron, e përgjithëson dhe e ndërlikon edhe më shumë çështjen edhe vetë nocioni themelor. Më lejoni për ilustrim në Projektligjin Civil, ndryshe nga definimi në Kodin penal, sepse derisa në Kodin Penal shpifja përkufizohet kështu: "Pohimet e pavërteta e që mund t'i dëmtojnë nderin dhe autoritetin e një personi tjetër megjithëse dihet se pohimet e tilla janë të pavërteta. Në Projektligjin civil që të jetë më i zbutur dhe më i civilizuar, shpifja nënkupton publikimin e një deklarate kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër, d.m.th mjafton që një deklaratë ta dëmtojë reputacionin dhe është shpifje, kurse fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës ndaj një personi që është nënçmuese, mjafton, d.m.th që një deklaratë të jetë nënçmuese dhe kjo me ligj vlerësohet si fyerje.

Zonja dhe zotërinj, merrni me mend çka do të thoshte në praktikën tonë, sa do të kishte konteste po t'i legjitimonim nocione të tilla që janë themeli i këtij ligji.

Për më tepër, në shkresën përcjellëse- e përsëris- është theksuar se Projektligji është hartuar në përputhje me rekomandimet e Këshillit të Evropës, ku edhe janë bërë vizita, por Komisioni nuk e ka pasur tekstin e këtyre rekomandimeve, nuk e ka as Kuvendi. Është vështirë të besohet se Këshilli i Evropës bën rekomandime të këtilla, por po të jetë

e vërtetë se rekomandime të këtilla në emër të standardeve evropiane bëhen nga ndonjë trup evropian, vërtet ka arsye për brengosje dhe për t'i rishikuar se sa janë ato rekomandime në përputhje me frymën dhe me standardet e vërteta evropiane. Për këto dhe për arsye të tjera, zonja dhe zotërinj, Komisioni ka propozuar që Kuvendi të gjejë kohë shtesë për shqyrtimin e këtij ligji që të sigurohen të gjitha dokumentacionet e nevojshme dhe të bëhen përpjekje për ta kompletuar shqyrtimin tonë meritor të këtij ligji, gjithsesi të rëndësishëm. Ju faleminderit.

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Ju faleminderit kryetar i Komisionit.

Dëgjuam mendimin dhe qëndrimin e Komisionit parlamentar nga kryetari i Komisionit. Kemi hyrë në debat për diskutim në parim, ftohet deputetja Nekibe Kelmendi që në emër të LDK-së ta marrë fjalën.

#### DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:

I nderuari z. kryesues, i nderuari z. kryeministër dhe zonja ministre, të nderuar deputetë.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së nuk do të flas për rëndësinë e nxjerrjes së një ligji çfarë është ky që sot po e shqyrtojmë për herë të parë, meqë do të përsërisja atë që është thënë me memorandumun shpjegues të Qeverisë përkitazi me rëndësinë e këtij projektligji.

Rëndësia tjetër, që do ta theksoja për këtë projektligj, konsiston në atë se parasheh përgjegjësinë civile për shpifje dhe fyerje, në vend të dy veprave penale nga kapitulli XVIII me titull: Veprat penale kundër nderit dhe autoritetit të sanksionuara me Kodin penal të Kosovës nenet 188 dhe 187, së këndejmi efekti i përgjegjësisë civile për fyerje dhe shpifje është i rëndësishëm së dyfishtë. E para, depenalizon fyerjen dhe shpifjen si një delikt verbal që më nuk gjendet në ligjet penale të shteteve demokratike, kurse nga ana tjetër palës së dëmtuar ky ligj i siguron sadsifaksion moral dhe material. Me depenalizimin e shpifjes dhe të fyerjes mbështetet pacenueshmëria e lirisë së fjalës, e garantuar me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me titull Liria e shprehjes dhe e informimit. Mirëpo në rastet e caktuara kufizimet e lirisë së fjalës janë të nevojshme, siç është rasti i shpifjes dhe i fyerjes, që dëmtojnë reputacionin e individit, prandaj në raste të tilla ligji parasheh, si mekanizëm mbrojtës, të drejtën për ushtrimin e padisë civile për të kërkuar dëmshpërblimin dhe sadsifaksione të tjera për mbrojtjen dhe për reputacionin e individit. Nga kjo del se me këtë projektligj në përgjithësi është bërë një balancim i drejtë i lirisë së fjalës nga neni 10 i Konventës së cituar dhe i mbrojtjes së reputacionit nga shpifja e fyerja. Marrë në tërësi, mund të konstatohet se ky projektligj është i mirë. Mirëpo, nëse analizohen veç e veç nenet ose pjesët e projektligjit, mund t'i bëhet vërejtje pjesës "përkufizime" të rregulluar me nenin 3 të këtij ligji, sepse disa nga përkufizimet bien ndesh me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Edhe neni 4 duhet të plotësohet me përfshirjen e të gjitha mbrojtjeve të mundshme të së vërtetës , të qëllimit të mirë etj. në mënyrë që shpifja dhe fyerja të mos arsyetohen me qëllime efektive të shtrembëruara apo të trilluara me ç'rast liria e fjalës do të keqpërdorej e kjo pamundëson mbrojtjen e reputacionit ose atë ta dëmtojë më shumë edhe pse ky nuk është qëllim i këtij projektligji.

Edhe çështja e procedurës gjyqësore duhet të rregullohet me rregulla konkrete, si dhe të rregullohet sa më mirë edhe çështja e barrës së argumentimit të së vërtetës sipas padisë civile, për të cilën Grupi Parlamentar i LDK-së mendon se kjo barrë duhet të bjerë mbi të mbrojturin, përkatësisht ushtruesin e padisë civile.

Grupi Parlamentar i LDK-së mendon se me këtë ligj do të duhet të përcaktohet edhe lartësia e kompensimit të dëmit për shpifje e fyerje nga minimumi deri në maksimum të jetë lartësi(kuotë) e kompensimit duhet të jetë proporcionale me shkallën e dëmtimit të reputacionit për të mos lënë hapësirë për laramani në rastin e caktimit të lartësisë së dënitimit dhe për të mos lënë hapësirë që dëmshpërblimi të jetë disproporcional .

Neni 20 i këtij ligji duhet të riformulohet, sepse me nenin 20 është paraparë nëse procedura lidhur me lëndën që rregullohet nga ky ligj është filluar dhe nuk është përfunduar me vendim të plotfuqishëm të gjykatës kompetente. Deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdohet në pajtim me ligjin që ishte në fuqi kur ka filluar procedura . Këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me çështje të së drejtës procedurale, por edhe të së drejtës materiale, prandaj ky ligj duhet të përpunohet dhe të harmonizohet më mirë ,sepse në fakt me këtë ligj, si ligj special, po hiqen nga Kodi penal i Kosovës dy vepra penale- shpifja dhe fyerja.Kjo, sigurisht, më vonë do të pasojë ndonjë ndryshim të atij ligji ose të këtyre procedurave përfundimtare. Do të rregullohet edhe kjo çështje. Mendoj se titulli i këtij ligji nuk përkon me qëllimin dhe brendinë e tij, sepse ka për objekt mbrojtjen e reputacionit nga shpifja dhe fyerja, kështu që edhe titulli i Projektligjit duhet të ndryshohet që në lexim të parë, nëse me këtë pajtohet edhe sponsori i Ligjit dhe të miratohet me titullin: "Projektligji për mbrojtjen nga shpifja dhe fyerja", sepse këtë e synon edhe përmbajtja e ligjit. Ka edhe çështje të tjera që duhet të përpunohen dhe të rregullohen edhe pak, sepse edhe ky projektligj, sikur edhe rastet e ligjeve të mëparshme të miratuara nga ky Parlament, ka disa mangësi dhe zbrazësi që është e nevojshme të evitohen edhe në fazat e mëtejshme,pa marrë parasysh këtë që u cek më sipër. Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet në parim këtë projektligj dhe do të japë kontributin e vet në fazat e mëtejshme të shqyrtimit të tij. Ju faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit.

Fjalën e ka deputeti Gani Koci në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kurse le të përgatitet deputetja Zylfije Hundozi

**DEPUTETI GANI KOCI:**

Propozuesi i këtij projektligji, sikur ka harruar se ekziston Kodi Penal dhe tërë materia është e përfshirë në këtë kod penal dhe si i tillë nuk është dashur fare të na verë në këso dilemash dhe të hyjmë në sallë të Kuvendit e të flasim për diçka që krejt është pa materie, por megjithëkëtë më duhet që në emër të Grupit Parlamentar t'i theksoj disa çështje lidhur me nismën e hartimit të një ligji të tillë, siç e quajmë këta ,ligj civil për shpifjet dhe arsyet e tyre pse është nisur kjo. Por, para kësaj, dua të theksoj se integriteti personal dhe fizik, autoriteti, nderi i njeriut dhe jeta personale e familjare, sikur edhe të drejtat e tjera të njeriut, janë të drejtat themelore që duhet të kenë mbrojtje kushtetuese dhe ligjore, pra pjesë përbërëse e të gjitha atyre të drejtave të njeriut është edhe e drejta e secilit për të ndjerë vlerat e veta, përkatësisht për t'i pasur dhe për t'i ruajtur nderin dhe personalitetin e vet, si edhe për ta mbrojtur atë nga të tjerët kur ai kërcënohet.

Nderi dhe autoriteti i njeriut në literaturën e deritashme janë definuar si tërësi e vlerave jo materiale që i ka njeriu si qenie njerëzore dhe si pjesëtar i shoqërisë së caktuar. Këto vlera janë edhe të veçanta edhe të përgjithshme. Si vlerë e përgjithshme është: nderi njerëzor ose dinjiteti njerëzor që i takon dhe që e ka secili njeri që me lindjen e tij si qenie njerëzore. Vlera e përgjithshme ka këtë kuptim dhe është vlerë që secili njeri i takon një kombi dhe një shoqërie të caktuar dhe që është bartës i vlerave të tilla të përgjithshme. Si vlerë e veçantë në këtë kuptim është autoriteti "njeri". Autoriteti është vlerë që fitohet jo me lindjen, por me jetën e tij, me angazhimin e tij në shoqëri, me angazhimin e tij në jetën politike, shoqërore, profesionale, kulturore dhe sportive, por është vlerë personale e njeriut. Është e drejtë e secilit të kërkojë nga të tjerët që të sillen ndaj tij në atë mënyrë që të mos preken dhe të mos cenohen këto vlera dhe të mos dëmtohet në këtë kuptim nderi personal, familjar dhe autoriteti i tij. Nderi dhe autoriteti i njeriut si kategori e vlerave jomateriale, por si vlera shumë të rëndësishme, kërkon mbrojtje ligjore nga çfarëdo cenimi.

Nderi, si kategori morale dhe si vlerë, nuk është konstant, pra është kategori morale që ndryshon, por pavarësisht nga kjo, askush nuk mund të relativizojë mundësinë e shkeljes dhe të cenimit të këtyre vlerave, prandaj edhe veprat e kryera kundër këtyre vlerave, që nga shekulli XIX janë cilësuar si vepra penale dhe në të gjitha legjislacionet penale të shteteve të Evropës dhe më gjerë janë futur si kaptinë dhe lloj i veçantë i veprave penale nën emërtimin: "Veprat penale kundër nderit dhe autoritetit të njeriut". Edhe Kodi penal i Kosovës në kapitullin e 18-të parasheh jo dy lloje të veprave, por tri lloje të veprave të kësaj natyre dhe këto i ndan në: fyerje, shpifje dhe zbulim i rrethanave personale dhe familjare. Nuk di dhe nuk mund ta kuptoj propozuesin e këtij projektligji që për këto vepra duhet të nxirret ligj i veçantë ose, siç thotë ai, ligj civil.

Arsyetimet se janë tendencat evropiane për depenalizimin dhe deinkriminimin e këtyre veprave dhe futjen e tyre si çështje civile nën idenë e zgjerimit të lirisë së shprehjes, nuk janë gjë tjetër pos për t'i relativizuar shpifjen dhe fyerjen si veprime shumë të rënda kundër nderit dhe personalitetit të njeriut. Nuk konsideroj se Kosova duhet të jetë e para me eksperimentimin e këtij lloji, pra depenalizimit të këtyre veprave penale. Është bërë edhe një eksperiment tjetër, është edhe Bosnja Hercegovina që në 2001 nxori një ligj të tillë civil dhe bien praktikat në këtë fushë, te shpifjet. Propozuesi, së paku, është dashur ta

përmendte një shembull të një shteti të vetëm evropian në të cilin është bërë kjo dhe në bazë të cilave trajtime dhe përfundime shkencore u pranua ideja se depenalizimi dhe deinkriminimi i këtyre veprave penale, mos është edhe ky një eksperiment në vazhden e eksperimentimeve të shumta që po bëhen në Kosovë. Vetëm me të drejtën anglosaksone është një dallim në rastet kur këto vepra cilësohen si vepra penale dhe në rastin tjetër si delikte civile dhe këto dy cilësime vijnë si rezultat i mënyrës së kryerjes së këtyre veprave. Në rast se shpifja bëhet me anë të mjeteve të informimit ose të shkrimeve të ndryshme, vepra kualifikohet vepër penale, ndërsa ajo po të kryhet gojarisht kualifikohet si delikt civil. Në këtë rast të mos e përmend edhe profesorin tim të nderuar Ismet Salihun si bashkautor i këtij projektligji dhe profesor i shkencave penale ,se mori pjesë kur u hartua Kodi penal .Edhe pse këto vepra u futën si kapitull i veçantë i veprave penale të këtij kodi, nuk është shumë që është bërë ky kod. Nëse ka pasur tendencë depenalizimi ,nuk është tendencë e para dy ditëve, por mund të jetë tendencë e para 5 – 6 vjetëve, ndërsa për emra të tjerë të ekspertëve ndërkombëtarë mund të them vetëm një gjë, janë po të njëjtit që na i kanë bërë të gjitha ligjet dhe sikur këta na dalin se kanë eksperiencë dhe aftësi edhe për çështje civile, edhe për çështjet penale edhe të së drejtës ekonomike edhe të të gjitha të drejtave të tjera, që nuk do t'i konsideroja se ata janë të gjithëdjshëm, por edhe sikur të jetë kështu ,vetë shpifjen si e definojnë këta, siç e tha edhe z. Hydajet, nënkupton publikimin e një deklarate që dëmton prestigjin e njeriut.Këta ekspertë harrojnë se reputacioni i njeriut dëmtohet në dy mënyra edhe me deklarata të bazuara dhe të argumentuara që nuk ka dëshirë t'i dalin edhe me deklarata të trilluara.Vallë, a mos kemi të bëjmë në të dy rastet me shpifjen, sipas definicionit të propozuar konstatimi është **po**. Pikërisht ky definicion dhe kuptimet e tjera të kësaj natyre në këtë projektligj tregojnë seriozitetin e këtyre ekspertëve të gjithëdjshëm . Në kuptim të këtij kualifikimi dhe cilësimi të këtyre veprave si delikte civile ,propozuesi i arsyeton edhe me tendencën e zgjerimit të lirisë së shprehjes, por definicioni i dhënë më lartë jo që zgjeron lirinë e shprehjes, por ngushton skajshmërisht këtë liri, sepse sipas tij edhe deklarimet e vërteta mund të kualifikohen si shpifje, prandaj sikur këta ta shfletonin fjalorin e gjuhës letrare shqipe ose edhe kapitullin 18 të Kodit Penal të Kosovës, do ta gjenin definicionin e saktë edhe për shpifjen edhe për fyerjen.Më lejoni t'jua përkujtoj definicionin për shpifjen sipas Kodit penal: Shpifja është bartje, nxjerrje ose përhapje e deklaratave të pavërteta( të trilluara), me të cilat dëmtohet autoriteti i njeriut. Ky propozim që ka ardhur këtu, nuk e thotë kështu, prandaj në këtë kuptim, d.m.th .në kuptimin penalo- juridik nocioni i shpifjes përbëhet prej shumë elementeve, por elementi kryesor është ajo se deklarata duhet të jetë e rrejshme, e qëllimshme e trilluar e konstruktuar etj. Ky element që e përbën si vepër qoftë penale ose civile këtë veprim nuk ekziston te nocioni që e jep propozuesi. Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me vlera esenciale,siç janë nderi , autoriteti dhe përgjegjësia për vepra kundër nderit dhe autoritetit të njeriut, në radhë të parë duhet të jetë përgjegjësi penale e jo civile. Sanksioni në radhë të parë është sanksion penal dhe jo material. Përgjegjësia materiale ose dëmtimi material vjen vetëm pas gjykimit penal, prandaj dëmi moral dhe rrezikshmëria shoqërore, e shikuar në këto vepra, nuk janë aq të parëndësishme sa të kualifikohen si delikte civile dhe se propozuesi është dashur ta kishte parasysh faktin se vetëm dëmtimi material nuk sjell drejtësi, në vend, kur është fjala për cenimin e këtyre vlerave.

Përfshirja e këtyre veprave në kapitull të veçantë të Kodit Penal dhe kualifikimi i tyre si vepra penale, nuk e ngushtojnë lirinë e shprehjes, përkundrazi inkriminimi i tyre veprave si vepra të veçanta penale, mbron dhe zgjeron këtë liri, por në radhë të parë mbron vlerat më të rëndësishme të njeriut.

**KRYESUSI NAIM MALOKU:**

Lus regjinë t'i vazhdohet koha. Vazhdoni.

**DEPUTETI GANI KOCI:**

Përpjekja për të depenalizuar dhe për t'i deinkriminuar këto vepra është përpjekje për të zgjeruar mundësinë e shpifjes, të fyerjes dhe gjithçka tjetër që i dëmton nderin personal e familjar dhe autoritetin e njeriut, si vlera madhore individuale. Nëse propozuesi ka pasur këtë qëllim, veprat e emërtuara si shpifje dhe fyerje, qofshin ato të kualifikuara penale ose civile të shlyhen fare nga legjislacioni. As dje, as sot askush nuk e ka respektuar ligjin lidhur me këtë çështje. Po ashtu edhe gjykatat tona, thuajse kanë harruar fare ekzistimin e këtyre veprave penale dhe sanksionimin e tyre me ligj, tash jemi mësuar me mediat, qofshin ato të shkruara ose elektronike, që e tërë politika redaktuese e tyre është e mbështetur në shpifje dhe fyerje, insinuata, denigrime, kundër nderit dhe personalitetit të secilit në Kosovë dhe askush nuk i jep llogari askujt, prandaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, duke pasur parasysh faktin se e tërë materia lidhur me shpifjen dhe me fyerjen është përfshirë në Kodin Penal të Kosovës dhe në këtë mënyrë të drejtë dhe në start mbrohen nderi personal, familjar dhe autoriteti i njeriut dhe se dispozitat lidhur me këtë çështje dhe me këtë kod me asgjë nuk cenojnë lirinë e të shprehurit. Nuk e përkrah këtë projektligj dhe kërkon që fare të mos procedohet për të, sepse është krejt i pamateric.

Ky është qëndrimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit z. deputet.

Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së. Të përgatitet deputeti Nazim Jashari.

**DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI:**

Z. kryesues, kryeministër, deputetë të nderuar.

Në periudhën e pasluftës disa gazeta ditore vendore kanë qenë plotë me akuza dhe shpifje ndaj personaliteteve, sidomos ndaj atyre publike, sipas intensitetit dhe kontinuitetit të tyre dukej se nuk kishte ose së paku nuk funksiononte asnjë ligj që do të ndalte këtë fenomen që shumëkujt i ka shkaktuar shumë vuajtje shpirtërore e ndonjëherë për këtë arsye është dashur ta kërkojnë edhe ndihmën e profesionistit. Grupi Parlamentar



i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e mirëpret diskutimin e sotëm për këtë projektligj edhe pse ky ka të meta të shumta.

Në kapitullin V thuhet: Para se personi i dëmtuar t'i drejtohet Gjykatës Komunale ka të drejtë të reagojë dhe ta demantojë shpifjen në botimet periodike ose në ndonjë medium tjetër, që e relativizon çështjen se demanti kurrë nuk e ka rëndësinë e lajmit të parë. Është mirë e qëlluar për këtë çështje thënia se shpifja e publikuar është sikur kur derdhet jastëku me pupla, kurse demanti kur mbliidhen ato pupla një nga një. Prandaj edhe pse ky projektligj është i hartuar mjaft mirë, duke e relativizuar problemin për të cilin është hartuar, nuk e përmbush qëllimin për të cilin është bërë. Në nenin 14, ku flitet për kompensim për shkak të dëmit nga shpifja, përsëri nuk saktësohet cilat shuma janë paraparë për t'i kompensuar vuajtjet e përrjetuara të personit nga shpifja. Megjithëkëtë Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim miratimin me shpresë se në komisionin përkatës do të plotësohet me amendamente që do ta arsyetojnë përpilimin e këtij projektligji. Faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Faleminderit zonja deputete. Në emër të Grupit Parlamentar ORA deputeti Nazim Jashari, të përgatitet Xhezair Murati në emër të Grupit Parlamentar 6+.

**DEPUTETI NAZIM JASHARI:**

Kolegë të nderuar deputetë.

Më lejoni në fillim ta shpreh edhe unë një rezervë të vogël për këtë projektligj që e kemi sot përpara, po jo si kolegët e mi nga PDK-ja me përmbajtje më shumë, si u prezantua këtu në seancë, me siguri se kryeministri u mundua ta bënte punën sa më mirë.

Po të kishte ardhur zëvendëskryeministri këtu, z. Salihu, me siguri ky projektligj do të ishte shumë më bindës se përvoja që ka bërë ai nëpër gjykata të Kosovës, do t'ju kishte bindur edhe ju se ky ligj është shumë i nevojshëm dhe i domosdoshëm.

Sa i përket materies që e rregullon ky projektligj, mendoj se është një projektligj modern, i nevojshëm, për këtë që po e shohim nga praktika e jetës sonë publike se është shumë i nevojshëm, kurse depenalizimi i shpifjes dhe çështje të tjera të ngjashme me të, me siguri do të kontribuojë që drejtësia jonë pak a shumë të zgjohet nga gjumi që edhe gjykatësit tanë të mos presin angazhimin e prokurorëve për këto çështje, por edhe ata të mund t'u iniciojnë qytetarëve të vet procedura gjyqësore nëpër gjykata lidhur me këto çështje dhe me rregullativën, sepse ta them të drejtën- megjithëse ka shumë zbrazësi dhe duhet paksa të definohet edhe aspekti praktik, se çka nënkupton shpifja edhe pse u tha ose thuhet se nënçmimi paraqet shpifjen. Por si mund të trajtohet kur kryetari i Kuvendit i thotë deputetit se ke dalë në sernishtë a është ky nënçmim apo shpifje, apo çka është ky dhe si do ta trajtojë ky ligj këtë materie, apo kur deputeti i thotë kryetarit: Ke dalë në sernishtë që është e njëjta gjë realisht, por sidoqoftë mendojmë se ligji mund ta

bëjë punën dhe mund ta përmirësojë jetën juridike në Kosovë dhe nevojat e qytetarëve tonë për shërbime të gjykatësve. Ju faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit z. deputet.

Me të vetmen vërejtje që nuk ka nevojë t'i përmendim emrat e atyre që nuk janë këtu, por të përqendrohemi te ligji, për shkak të pamundësisë që emrat që i përmendëm të mos mund të japin replikë.

Në emër të Grupit Parlamentar 6+ deputeti Xhezair Murati. -

**DEPUTETI XHEZAIR MURATI**

Hvala gospodine predsedavajući,

Moj pozdrav Premijeru i našim kolegama, ovaj civilni Nacrt zakona o kleveti i uvredi je novi zakon u pravosuđu Kosova, čime se pokušava realizovanje međunarodnih standarda koji se utvrđuju kako univerzalnom deklaracijom za ljudska prava tako i evropskom konvencijom za zaštitu ljudskih prava i slobode govora. Naravno, on se oslanja i na odredbe Ustavnog okvira privremenih institucija na Kosovu tako da ovaj Nacrt zakona sigurno predstavlja korak dalje ka uključivanju u nova i demokratska rešenja u zakonodavstvu po ugledu na zemlje sa dugim iskustvom u ovaj oblasti, međutim ja ću ovom prilikom reći ono što su i moje kolege rekle da u njegovoj sadržini ima dosta uopštenih odredbi tako da predstoji dobar deo posla kao bi se neke stvari konkretizovale jer se ovim otvara široko polje kleveta, ne samo putem medija već nešto što je u našem mentalitetu će biti jedno pomodarstvo kako da skupljamo perje što je rekla naša kolegenica Hundozi kada ga neko prospe u vidu, kada neko nekoga uvredi i onoga koji demantuje, mislim na tu aluziju. Međutim ovom prilikom ću reći da u radnoj grupi koja je radila na njemu, i pored većeg broja eksperata nije učestvovao nijedan pravni autoritet iz redova ostalih zajednica, pa se ovaj propust u kontinuitetu nastavlja. Mislim da treba da se zapitaju predstavnici ne samo u koaliciji već i u Parlamentu, dokle ćemo usvajati zakone, a da radne grupe ne održavaju jedan konglomerat eksperata kako to odražava i sama Skupština. Mislim da mi imamo pravne eksperte iz redova ostalih zajednica i mi smo više puta dosad dogovorili da treba da ih uključimo, međutim naša ponuda ostaje bez efekata, u tom smislu ja mislim da u daljem procesuiranju da će ove manjkavosti da se otklone i pored našeg dvoumljenja oko toga kako da postupimo mi ćemo ipak dati šansu ovom zakonu da navedene nedostatke koji su pomenuti danas budu otklonjeni. Mi ga u startu i u načelu, s obzirom da je prvo čitanje, u ime parlamentarne grupe 6+ prihvatamo. Hvala.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit.

Fjalën e ka deputeti Fetah Berisha, kurse le të përgatitet deputeti Ramadan Kelmendi. Luten deputetët të kthehen në sallë, për shkak se po i afrohem vendimmarrjes,

**DEPUTETI FETAH BERISHA:**

Z. kryesues, i nderuari kryeministër dhe të nderuar kolegë.

Edhe ky projektligj për fyerje dhe shpifje, për të cilin po debatojmë sot në këtë seancë, vërtet është i një rëndësie të veçantë. Themi kështu nga një anë, sepse stimulon të drejtën dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Konventën Evropiane, kurse në anën tjetër, duke ngritur ose maksimalizuar lirinë e shprehjes, minimizon mbrojtjen ligjore nga shpifja dhe fyerja. Pra minimizon mbrojtjen, d.m.th. nuk dënohet penalisht. Ky projektligj u referohet shpifjes dhe fyerjes që i bëhen një personi nga dikush tjetër me shkrim ose me gojë. I fyeri ka të drejtë pastaj të reagojë, të ngrehë zërin, të ngrehë padi sipas dispozitave ligjore, por civile. Ai pastaj edhe vihet në përdorim: tërheqja, pendimi, mosdija, d.m.th. shpifsi thotë nuk kam ditur se kamë fyer dhe kështu përgjegjësi lirohet nga penalteti, prandaj në 8 kapitujt që e përbëjnë këtë projektligj, dalin në shesh qëllimi mbrojtja nga shpifja dhe nga fyerja, e drejta për kompensim, minimizimi i përgjegjësisë për t'i dhënë më tepër hapësirë lirisë së shprehjes.

Ky projektligj, gjithashtu, ngërthen në vete zhvillimet më të larta ndërkombëtare, në një nivel më të lartë edhe të tolerancës shoqërore, që rekomandojnë eliminimin penal për shpifje dhe fyerje dhe që i rekomandon të rregullohen me dispozitat ligjore civile. Qëllimi i projektligjit është i qartë, të ngritet në një nivel të lartë liria e shprehje, që është në vend, të ngitet toleranca që lidhet me parandalimin e gjuhës së fyerjes dhe të shpifjes. Edhe kjo është me vend. Mirëpo, duke marrë parasysh edhe nivelin e vetëdijes së një shoqërie, sepse zbatimi i këtij ligji në kushtet, ashtu si jeton ajo shoqëri, ndoshta është pak i vështirë për t'u zbatuar. Pra, ky projektligj ma thotë mendja, se minimizon fyerjet edhe shpifjen dhe maksimalizon atë lirinë e shprehjes me shkrim e me gojë. Pos kompensimit për fyerje e shpifje, individit ka të drejtë të kërkojë edhe procedurë gjyqësore, pra tërheqjen e informacionit të fyerjes, por ka të drejtë, pastaj të shprehet edhe premtimi i atij që e ka fyer tjetrin, prandaj urdhërsa gjyqësore aplikohet vetëm për shprehje specifike, që këtu nuk janë të shpjeguara mirë.

Meqë në asnjë nen nuk është paraparë ndëshkimi as për shprehje specifike që dëmtojnë lirinë e shprehjes, mendoj se, pos dëmtimit për përgënjeshtim, për ndaljen e shpifjeve të premtimit se s'do të përsëritet më fyerja etj. Ky projektligj, në ndonjë nen është dashur të kishte edhe udhëzime administrative, në të cilat do të sqaroheshin pak më qartë edhe rregullat që janë paraparë në këtë ligj. Pos sqarimit të disa neneve të përpiluara edhe me udhëzimet administrative që ligji të jetë sa më i qartë, megjithatë edhe unë si të gjithë të tjerët e përkrah idenë që ky ligj të miratohet në parim. Ju faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit z. deputet, është tërhequr nga pjesëmarrja në debat deputeti Ramadan Kelmendi, deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

#### DEPUTETI SABRI HAMITI:

Në shikim të parë dukej se kjo është një materie, për të cilën nuk do të ketë probleme, mirëpo kur e lexova tekstin u përpoqa ta studioja dhe duke ditur situatën sociale dhe komunikimin publik të veçantë në Kosovë, në periudha të ndryshme, kam paraparë së do të ketë diskutime të këtij niveli. Mund t'ju them se personalisht mendoj që kam dëgjuar fjalë shumë interesante që janë thënë këtu, pa marrë parasysh pozicionimin final rreth përkrahjes apo jo të këtij ligji, d.m.th. e kam parë një debat jashtëzakonisht interesant të të gjithë folësve e parafolësve të mi. Kjo tregon se është një materie që në shikim të parë duket e lehtë, por që ka prekur në thellësinë e vet në komunikimin publik. Do të thosha historinë e dhënë, karakterologjinë e këtij mesazhi. Çka dua të them me këtë? Dua të them që kjo nuk do të mund të përmbledhet në një mangësi ta quaj kulturo karakterologjike për ambientin tonë që do të thoshte përafërsisht, fjala është e lirë, shpifja është e dënueshme. Dhe po të studiohet mirë materia, po të shihen kodet tradicionale që kanë të bëjnë me fjalën dhe me të vërtetën, se e edhe ne e kemi një kod të famshëm të Lekë Dukagjinit, që ka referenca të jashtëzakonshme, interesante që do të duheshin të studioheshin përpara se të krijohet një ligj që i kodifikon këto raporte në ambient siç është ky yni. E di që pa një pa dy ata bëhen universal dhe do të më përgjigjeshin se edhe ne jemi, si krejt bota dhe qysh po përmendet Kanuni. Po ju them se vlerat universale janë vlera universale të përgjigjesisë së të folurit publik dhe ai Kanun yni me maturinë e jashtëzakonshme, por edhe me shembuj të veçantë janë këto vlera dhe fundi i fundit të gjitha ligjet, e kam përmendur edhe një herë, po e përmend edhe sot, e kanë bazën universale dhe e kanë një shtresë që është shumë autentike, sepse i përgjigjet një ambienti. Dua të them këtu që liria e të shprehurit po, veç se shpifja e dënueshme, gjithsesi. Problemi është si të maten këto, si të kodifikohen. Ne e kemi një ligj që e kemi në fuqi që e përmenden znj. Nekibe dhe të tjerë që për këto dy fenomene i ka dy nene, nenin 187 dhe 188 dhe në të dy herat shpifja është vepër penale dhe penalizohet me gjobë ose deri 3 muaj burg.

Shtroj pyetjen para këtyre ekspertëve, se nëse ky ligj hyn në fuqi si i tillë a i fshin këto dy nene apo jo? Mendoj se jo, sepse a është ligj sistemor më i madh se ky, i shfuqizon apo jo? Nëse jo, atëherë si funksionon, nëse po atëherë duhet të jemi shumë të kujdesshëm në definimet, sepse u tha edhe më parë, janë dy definime shumë të pakujdesshme për këto dy elemente të sjelljes që në bazë të formulimeve që i kanë, e bëjnë fyerje çdo gjë. Absolutisht çdo deklaratë mund të konsiderohet fyerje, pra të kemi kujdes, sepse njeriut të vogël i them se t'i je shtatgjatë, sepse ai mund të fyhet nga ironia, se di që nuk është shtatgjatë dhe thotë: më tha se je i vogël, - janë situata njerëzore që nëse nuk definohen mund të arsyeohen në njëqindmijë mënyra, kurse ligji nuk duhet të japë kuptime të dyta si në literaturë që është konotacioni, duhet të jetë preciz. Prandaj po them duhet të definohet ndryshe fyerja, sepse fyerja është deklaratë e një të pavërtete rreth dikujt. Shpifja, është shumë e thjeshtë: t'i i thuash diçka dikujt që nuk është e vërtetë dhe atë ia thua publikisht. Kur i thua të tretit e sidomos kur bëhet publike, këtu i afrohem problemit të madh, problemit të fyerjes që artikullohet dhe shumëzohet

publikisht. Këtu u fol me ironi edhe me emra e pa emra. Po ju them në qoftë me këtë ligj kaq të butë,ose me ligje të tjera, po të vepronte ligji, gjysma e gazetave tona do të falimentonin, sepse ato edhe ashtu me tirazhe nuk janë duke u mbajtur, por me donacione.

Po të veprojë ky ligj kaq liberal që është total, po ju them së ato për nja një javë do të falimentojnë të gjitha. Pse, sepse nëse fyerja del në faqen e parë me germa me 20 ciceru.Kush punon e di çka është kjo në shtypshkronjë dhe detyrohet ta shkruajë demantin për rrena dhe nëse fyerjen e vet të nesërmen me të njëjtat shkronja ,në të njëjtën faqe,në të njëjtin kënd, do të kujtohet mirë çka do të shpjerë, por nuk do të ndalet as sot as nesër, se nëse e shkruan titullin e tillë si shpifje, ndërsa kërkesën e të dëmtuarit e boton me petit, kush prapë kush merret me shtyp, e di që janë shkronjat më të vogla dhe e qet diku në një kënd tjetër.

Pse po flas kështu? Po flas kështu, sepse pas analizës së këtij projektligji unë e kam gjetur që ky ua ka lënë mundësitë këtyre njerëzve që në atë formë të vepronë, sepse nuk garanton që kundër shpifjes të jepet përgjigjja në të njëjtën masë, të njëjtin vend, në televizion në të njëjtin emision pak a shumë, në të njëjtën kohë, në të njëjtën minutash, por thotë nëse është e mundshme . S'ka nëse është e mundshme, se ai gjithë e bën të pamundshme.

Dhe e dyta, nëse ekziston mundësia herën tjetër dhe fundi i gjithë kësaj është neni 18, "mbrojtja e burimeve". Duhet të shkruhet qartë mbrojtja e burimeve të shpifjes, se kemi të bëjmë me shpifjen. Thotë në tri aline, ky nen thotë se nuk është i detyruar ai shpifësi të tregojë qoftë në gjyq burimet e shpifjes, por pse të mos jetë i detyruar nëse vërtetohet që ajo shpifje: Po ti a po e ruan atë burimin e shpifjeve a ajo? Është sikur kriminelit t'i i thuhet do të të përkëdhelim, se tjetër herë nuk e bën të zezën.

Edhe kjo që po them, tjetër herë se bën të keqen, është një relativizim total me disa nene në të cilat thuhet, duhet të merret parasysh zbutja ,sepse njeri duhet ta dëshmojë a ka pasur qëllim të të fyej a jo?. Ato janë kategori që nuk maten ligjërisht, si matet ligjërisht: a e ka pasur me qëllim a jo. Natyrisht njeri kur rrezikohet me qëllim e ka , por thotë s' e kam pasur, e bën sherrin e thotë jo s' e pata me qëllim. Ta theva kryet pa qëllim e tash shërohu. Unë për ta shkurtuar po them edhe një herë. Kam marrë fjalën ,sepse më është dukur se ka nevojë të flitet. Edhe kolegët e mi e kanë parë që është ligj që shtron probleme të mëdha civile penale te ne,prandaj edhe një herë po përsëris se më ka pëlqyer përgjithësisht diskutimi, pasi Neki bja në emër të grupit tha se e përkrah ligjin, mirëpo edhe unë kërkoj që ata që do ta përpunojnë më tutje, të kenë çka të bëjnë dhe saktësimi, bile në katër pesë pikat,që thashë, është i domosdoshëm ,madje vullnetarisht kur të më thërrasin do të përpiqem t'i ndihmoj atij që ka nevojë. Faleminderit z. deputet.

KRYESUESI, NAIM MALOKU:

Faleminderit z. deputetë. Për fjalë është paraqitur deputeti Xhavit Haliti

DEPUTETI, XHAVIT HALITI:

Z. kryesues,të nderuar kolegë

Mendoj që shefi i komisionit përkatës e ka dhënë fjalën në emër të komisionit. Mora vesh që e ka bërë kërkesën me vonesë për ta tërhequr ligjin. Besoj që deputetët do të duhej të vendosnin për tërheqjen e ligjit ,do të thotë për kthimin e ti. Edhe nga diskutuesit e mëparshëm konstatohet që nuk është një ligj i duhur, një ligj që vërtet i mbron interesat e të fyerve,të të goditurve në shpifje të ndryshme. Duhet të ndalem te disa çështje me të cilat jam ballafaquar edhe unë në Kosovën tonë të lirë dhe demokratike.

Unë e kam gjetur veten nëpër faqe gazetash bulevardeske, me fyerje me shpifje, natyrash të ndryshme.Më dilte njëfarë gazetari po i përmendi me emër besoj që nuk ka replikë për këtë, një Kastrati, kurrë nuk kisha ndier për këtë, ai dinte më mirë për mua sesa unë për vete. Tani thashë ta marr një avokat dhe të merrem vesh me gjyqin, nuk kishte mundësi të merresha vesh me të, e mora avokat shokun e sponsorit të shpifjeve. Edhe ai kishte bërë padinë në gjyq shumë mirë dhe e rregulluam punën shumë bukur, që për nja dy ditë ta bënim sipas ligjit, lënda u vonua këtu,prandaj edhe u tërhoq padia.

Rasti tjetër i njëjti avokat e kishte bërë padinë shumë mirë me mend se unë nuk di ta bëja ashtu as nuk kisha ditur, padia ishte bërë një ditë para se të botohej gazeta me datë dhe ai thoshte shumë mirë, këtu është bërë që thoshte: gjyqi me avokatin dhe me ata sponsorit që kanë para të shpifin. të bashkëpunojë. Një rast tjetër, një gazetë po ajo e ka dënuar një gazetar këtu dhe përmbarimi nuk vepron,sepse avokat i atij tash, meqenëse është dënuar për shkallën e lartë ,është marrë një personalitet publik dhe deputet, normalisht se përmbarimi Gjykata e Lartë e Kosovës dihet se si ka funksionuar deri sot dhe çfarë vendimesh ka nxjerrë, do të thotë që për- mbarimi nuk do të veprojë, sepse e ka një mbështetje shumë të fuqishme.

Mendoj se në këtë aspekt ky ligj ka zbrazësi, meqenëse qëndrimi i komisionit përkatës është për t' u tërhequr, diskutuesit ishin pothuaj se marrin vesh në këtë punë dhe kanë përjetuar që e kanë gjetur veten në faqet e para me shkronja më të mëdha, se gjysma e faqes dhe demantimin e kanë gjetur në faqen e tretë, në një qosh që nuk e lexon askush, me shkronja që duhet të përdoren jo syze, po asi bilur që përdornin dikur, e dinë çka është kjo punë. Prandaj, duke u dhënë mbështetje të fuqishme edhe vërejtjeve z. Sabri Hamiti, mendoj që ne të mos e miratojmë këtë ligj , ta kthejmë prapa në Qeveri në përpilim. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU:**

Debati është kryer, pra nuk ka të paraqitur. Fjalën e ka kryeministri i Kosovës Bajram Kosumi

**KRYEMINISTRI BAJRAM KOSUMI:**

Jam i vetëdijshëm se me këtë projektligj nuk zgjidhen problemet e fyerjeve dhe të shpifjeve në gazetë. Sigurisht secili prej jush e ka ndierë në lëkurën e vet dhe ju besoj,

mirëpo qëllimi është që esenca e projektligjit të depenalizohet dhe të hiqen nga kodi penal: fyerja dhe shpifja. Kjo është esenca që do të thotë të krijohet një hapësirë edhe më e madhe për fjalën e lirë. Edhe pse gjykatat te ne nuk kanë vepruar kundër shpifjes dhe fyerjes ashtu siç e tha edhe deputeti, besoj plotësisht, mirëpo fakti se fyerja dhe shpifja janë vepra penale të kodifikuara në Kodin Penal, ndikon drejtpërsëdrejti në perceptimin e atyre që flasin e të atyre që shkruajnë, më këtë ngarkohet ai që shkruan dhe që flet, prandaj frikësohet. Gjykatat mund të mos veprojnë, mirëpo kjo ndikon si frikë te të gjithë ata që flasin dhe të ata që shkruajnë. Qëllimi i këtij ligji është ta zbusin dhe ta heqin atë frikë, që njerëzit të flasin dhe të shkruajnë lirisht, por në të njëjtën kohë të jenë të kujdesshëm që të mos shpifin dhe të mos fyejnë. Mund të pajtohemi se nuk janë të definuara saktë fjalët këtu, por komisionet janë për atë punë të punojnë, t'i definojnë saktë çka është shpifja, çka është fyerja dhe mënyra si veprohet ndaj tyre. Përndryshe ky është një nga kriteret që kërkohet për të gjitha shtetet që hyjnë në rrugën e integritimit evropian. Vlen për të gjitha shtetet dhe mund ta tërheqim sot projektligjin, por pas një viti përsëri do të kërkohet në mënyrë decisive të plotësohet. Ky kusht nuk është vetëm në Bosnje, fjala është për gjitha shtetet që shkojnë në integritet evropian, është kriter që kërkohet të bëhet edhe kjo.

Prandaj do t'ju kisha ftuar që komisionit t'i ofrohen, do të kërkojë nga Zyra Ligjore t'i ofrohen të gjitha dokumentet që përmendi kryetari i Komisionit, të gjitha rekomandimet e nevojshme që Komisioni t'i ketë parasysh të gjitha dhe lus që Komisioni të punojë në definimin dhe të saktësohen definicionet që janë dhënë për shpifje dhe fyerje dhe për çështje të tjera që e sheh të nevojshme t'i bëjë. Po ashtu mendoj se edhe emri i Projektligjit që e propozoi deputetja Kelmendi mund të ndërrohet dhe të jetë: Projektligji për mbrojtjen nga fyerja dhe nga shpifja, është nga këndet pozitive dhe me këto ju propozoj ta miratoni dhe të vazhdojë puna. Ju faleminderit

**KRYESUESI, NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit kryeministër, i dëgjuam fjalët, janë paraqitur dy deputetë për diskutim: Gani Koci ka pasur kohë edhe shtesë për replikë. Nuk ka arsye, fjalën e ka Hydajet Hyseni.

**DEPUTETI, HYDAJET HYSENI:**

Z. kryesues, meqë e kam fjalën, megjithatë po mendoj se fjala për propozim do të bëni mirë që t'ua jepni fjalën deputetëve të propozojnë, por mendoj që është praktikë e përgjithshme parlamentare që para votimit të mund të bëhen propozime të tjera, sepse janë më shumë procedurale. Edhe këtu dua të kufizohem. E kuptoj qëllimin e mirë të atyre që e kanë bërë ligjin edhe prezantimit të kryeministrit, megjithëse nuk u sqarua sa duhet, si mund të arrihen efekte më të mëdha, duke e ndërlikuar çështjen në shikim të parë, duke e zbutur, por duke e përgjysmuar deri në absurd dhe duke krijuar situatë kontradiktore në ligjvënienë, prandaj e theksova këtë veçanërisht.

Zonja e zotërinj, nëse ne kemi probleme me Kodin Penal, t'i hyjnë punës së dispozitave të kodit penal, përndryshe, nuk shoh asnjë seriozitet në atë që huajt, - t'ia hedhim ne tash UNMIK-ut, se ata po na pengojnë dhe ne e bëjmë një ligj tjetër. Çka po bëjmë ne me të? Nuk po kanë efekt dispozitat e Kodit Penal dhe na presim se do të kenë efekt dispozitat e një ligji civil, në të cilin kërkohet falje dhe gjepura të tilla.

Prandaj edhe si komision ne kemi qenë njëzëri, keni kërkuar jo që të refuzohet, të kundërshtohet, por keni kërkuar kohë shtesë dhe keni pritur që duke dëgjuar argumentet tona, vetë përfaqësuesit e Qeverisë z. kryeministër do ta tërheqin ligjin për kohësisht, do t'i bëjnë këto plotësime, për të cilat u morëm vesh dhe po të na sillen brenda afatit më të shpejtë të mundshëm, nuk do të humbim asgjë, por do ta shfrytëzonim rastin për të parandaluar konfliktin me Kodin Penal dhe Ligjin, por edhe krijimin e precedentit shumë të rrezikshëm, pastaj në gjendjen tonë dhe në të ardhmen edhe ashtu kemi një aramasis.... në funksionimin e ligjvënies sonë, miratojmë ligje specifike pa ligje bazike, pastaj eja e shiko harmonizimin ndërmjet ligjeve e Kornizës Kushtetuese etj. Për ta parandalohet këtë është mirë të praktikohet kjo që ligji të tërhiqet për t'u plotësuar dhe për të na u siguruar të gjitha ato që i kërkuam dhe që ta shqyrtojmë në rastin e parë. Është një kërkesë e gjithë komisionit dhe se këtu të gjithë jemi unikë. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit z.deputet.I fundit z.Gani Koci

**DEPUTETI, GANI KOCI:**

Çuditë prej atyre që vërtet gjatë gjithë jetës janë marrë me çështje juridik,por ende duhet t'u shpjegojnë ata ndoshta që kanë qenë studentë, ose nxënës të tyre. E di se edhe shkenca zhvillohet dhe përparon dhe diçka çka ka qenë dje nuk është sot, por dua të shtoj vetëm një pyetje për propozuesin, që në letrën përcjellëse në shpjegime thotë: Kjo fushë është e rregulluar edhe me Kodin Penal ,dispozitat e të cilit nuk kemi autoritet t'i shfuqizojmë. Prandaj, do të veprojmë paralelisht edhe Kodi Penal edhe ky ligj civil, që e quajmë. Atëherë vërtet,do të kemi një xhungël dispozitash dhe ajo që kërkohet të mbrohet, qoftë me dispozitë penale qoftë me civile nuk do të mbrohet as me njërin as me tjetrën. Ky ishte qëllimi i propozuesit.

Ne kërkojmë që vërtet nëse kjo çështje nuk duhet të jenë kategorikë se a depenalizohet ose jo, nëse duhet diçka e tillë t'i shtrohet një debati të mirëfilltë me gjithë ata që merren me këto problematika dhe them me ekspertë të fushave penale të asaj civile, sidomos edhe me ekspertë të çështjeve të të drejtave të njeriut dhe pastaj të vijë një ligj çfarë duhet të jetë që t'i mbrojë, nuk ma merr mendja që nderi dhe autoriteti i njeriut, janë vetëm çështje personale, janë edhe interes publik, janë edhe interes shoqëror, sepse asnjë shoqëri nuk ka dëshirë të jetë shoqëri e shtisëve dhe e shpifjeve, prandaj ky është qëllimi në fund të fundit.

Ajo që thuhet ngushtim i lirisë edhe Ligji penal edhe sanksioni penal, dënimin me burg e ka vetëm si dënim alternativ, që nuk është zbatuar ndoshta asnjëherë dhe askund, përndryshe sponsorit e shpifjes do të mendonin kur dëshironin të merren me shpifje, kur ka edhe dënim penal prej tre muajve, sepse një ditë burg është shumë për ata që e kanë



provuar dhe të tjerët që kanë para shumë, lehtë do të ndikonin që fundi i fundit për jetë prishin autoritetin e njeriut. Kush e ka ndjekur intervistën, atë debatin publik me Edi Ramën, ka qenë një shpifje ndaj tij, që është vrasje e përjetshme, sepse njeriu vritet me plumb vdes e shkon e nuk ngjallet, por ta vrasësh të gjallin, ai përjetë do ta bartë atë vrasje pas vetes. Shpifja dhe fyerja janë vrasje për së gjalli për njeriun dhe ky është ai interesi publik, ai interesi që duhet të mbrohet.

KRYESUESI, NAIM MALOKU:

Ju faleminderit z. deputetë, tash paraqiten edhe dy deputetë të tjerë. Ne nuk mund ta përfundojmë debatin. Keni pasur kohë mjaft. Fjalën ua kam dhënë të gjithëve që janë paraqitur me kohë. Ju lus për nga një minutë. Deputeti Fatmir Sejdiu.

DEPUTETI FATMIR SEJDIU:

Së pari të kuptohemi qartazi, se ky ligj as nuk është ligj për ta sanksionuar fjalën e lirë as ligj për të stimuluar shpifjen. U dhanë vërejtje të shumta që besoj se në shqyrtimin e dytë janë shumë të nevojshme, që duhet të analizohen, të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me ligjet bazike. Ky është thelbi ku lihet hapësirë e bollshme. Dihet afati sa mund të bëjnë punë komisionet, duke pasur parasysh të gjitha proceset e nevojshme të tjera. Dhe e dyta, po të kisha kërkuar nga kolegët që absolutisht, kur është fjala për shpifjet, për joshpifjet dhe për paragjykimet dhe për gjykimet, ne nuk i kemi ato arsye të flasim, se fundi i fundit do ta argumentojmë procesimin.

KRYESUESI, NAIM MALOKU:

Ju faleminderit, urdhëro. Deputeti Fatmir Rexhepi

DEPUTETI, FATMIR REXHEPI:

Mua më intereson ta di, komisioni që e ngrit tash këtë çështje të tërheqjes të Projektligjit a ka shtruar këtë kërkesë para Qeverisë edhe para Kryesisë së Kuvendit me kohë. Në qoftë se e ka bërë me kohë, nuk kemi pasur nevojë të vinim në këtë pozitë, çfarë jemi tash, por nëse nuk e ka bërë me kohë atëherë nuk është mirë të shkelen procedurat si mbrojtës që duhet t'i zbatojë procedurat. Dje ishte komisioni që miratoi një ligj, ishte ofruar këtu, por kur doli Grupi Parlamentar me të gjitha parimet e tjera në kundërshtim me këtë, sot po luhet një lojë tjetër. E kam fjalën për procedurat dhe për rregullat të cilave duhet t'u përmbahemi me të gjitha projektligjet njësoj. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU:

Ju faleminderit z. deputetë, ju ftoj- deputetë të nderuar, që të votojmë për Projektligjin. Votojmë tani:

Për.....51;

Kundër... 8  
Abstenojnë 4.

Konsideroj se Projektligji është miratuar në parim.

Në bazë të Rregullores 23.6 dhe rregullës 35.2, Kuvendi i ngarkon këto komisione:

1. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese si Komision Funkcional dhe Referues;
2. Komisioni për Buxhet dhe
3. Komisioni për Komunitete.

Ju faleminderit, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës

**Pika e 12.**

### **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ditën e dëshmorit,**

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 20.12.2005 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe për miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore do t'ua drejtojmë për shqyrtim Komisionit Funkcional përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore. Ftohet kryeministri Bajram Kosumi që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ,ta prezantojë Projektligjin.

**KRYMINISTRI BAJRAM KOSUMI:**

I nderuari z, kryetar, të nderuar deputetë , zonja dhe zotërinj;  
Para jush Qeveria ka prurë për miratim Projektligjin për ditën e dëshmorit .

Projektligji për ditën e dëshmorit, që po e paraqesim këtu, shënon hapin më të rëndësishëm në unifikimin e një date të vetme në gjithë territorin e Kosovës, me të cilën do të shënohej dita e dëshmorëve. Kjo ditë që simbolizon ditën kur komandanti legjendar i UÇK-së Adem Jashari dhe familja e tij u sakrifkuan për ideale më të larta të lirisë , tregon gjithë rrugën e mundimshme të popullit tonë për një jetë më të mirë për paqe dhe për bërjen e shtetit të pavarur të Kosovës.

Dita e dëshmorit- gjashtë marsi- ka për qëllim nderimin e të gjithë atyre që kanë dhënë jetën për lirinë e Kosovës, për drejtësi shoqërore dhe për të mirën e popullit të Kosovës, por kjo datë shënon edhe ditën e bashkimit tonë që t'i kujtojmë ata. Kjo datë shënon dhe do të mbajë të pashlyeshme kujtesën për ata që shkruan faqe të re të historisë së Kosovës. Deri më tani ka pasur data të ndryshme për qytete të ndryshme të Kosovës, me të cilat janë përkujtuar dëshmorët e Kosovës, por me Projektligjin e ri që sot e kemi në shqyrtim, duam t'i bashkojmë në një datë të gjitha këto data dhe të gjithë bashkërisht t'i përkujtojmë dëshmorët e Kosovës. Dita e dëshmorit do të festohet në tërë territorin e Kosovës dhe do të jetë ditë pushimi për të gjithë qytetarët e Kosovës. Në këtë ditë do të organizohen homazhe në varrezat e dëshmorëve dhe manifestime të ndryshme kulturore

dhe sportive e tjera. Projektligji ,si i tillë, paraqet bazën juridike me të cilën mbështeten korniza e rregullimit dhe mënyra e organizimit të kësaj dite shumë të rëndësishme për Kosovën dhe për nderimin e atyre që dhanë më të shtrenjtën e tyre për lirinë që po e gëzojmë sot.Përkundër natyrës specifike që rregullon, ky ligj i është nënshtruar standardizimit dhe harmonizimit me legjislacionin e BE-së, si dhe u është përshatur nevojave të Kosovës për organizimin e kësaj dite të shënuar për Kosovën në nderim dhe përjetësim të dëshmorëve. Të nderuar deputetë, ju ftoj ta votoni në parim Projektligjin për Ditën e dëshmorit. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit z. kryeministër, nuk shoh askënd që në emër të Komisionit Parlamentar është paraqitur , në emër të Grupit Parlamentar të LDK- deputeti Fatmir Sejdiu është paraqitur si anëtar i Kryesisë.

**DEPUTETI, FATMIR SEJDIU:**

Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar deputetë,  
E dëgjuam me vëmendje ekspozenë e kryeministrit lidhur me Ditën e dëshmorit dhe po ashtu kemi parasysh arsyen dhe motivet e shtruara në memorandumimin përcjellës për këtë projektligj.

Duke ndier thellë dhimbje të përhershme për dëshmorët e rënë për lirinë e Kosovës, mendojmë së Qeveria ka bërë mirë me këtë hap që të normohet edhe kjo fushë e rëndësishme e jetës sonë, po e quaj edhe politike në këtë rast, por në aspektin juridik, duke pasur parasysh që ky ligj duhet ta rregullojë një materie që deri në fazën e deritanishme thjesht ta quajmë si të parregulluar. Është përmbajtja e ligjit natyrisht mjaft e shkurtër,por kjo s'e dëmton qëllimin themelor. Mendoj se në Komisionin përkatës në fazën e mëtejshme do të vihen edhe elementet e nevojshme që mund ta përcjellin këtë ligj ,duke u mbështetur në standardet ndërkombëtare me të cilat rregullohet kjo materie dhe një çështje që mund të jetë pjesë e dilemës,por edhe që mund të jetë edhe materie e këtij ligji ,por nuk është materie as e Projektligjit për të drejtat e pjesëtarëve të luftës së UÇK-së, familjeve të dëshmorëve dhe viktimave civile të luftës, mbase mund të jetë e rregulluar krahas me çështjen e normimit , po ashtu të saktë se cili është dëshmor i luftës dhe kush e shpalli dëshmor të luftës , cilat janë kriteret e shpalljes së dëshmorëve të luftës, apo të dëshmorëve për lirinë e Kosovës. Mendoj se këto elemente që deputetët do t'i kenë parasysh në fazën e mëtejshme, LDK- ja përkatësisht Grupi i saj Parlamentar, e mbështet . Ju faleminderit.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit z. deputetë, besoj që në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së deputeti Xhevat Bislimi le të përgatitet në emër të AAK-së Gjylnaze Sylja.

**DEPUTETI, XHEVAT BISLIMI:**

Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar kolegë dhe kolegë deputetë.

Ky projektligj dhe kjo datë janë një çështje mjaft e ndjeshme për të gjithë shqiptarët, veçmas për ata të Kosovës. Ne mendojmë së Epopeja e Jasharëve, epopeja e familjes që bëri kthesë historike në Kosovë, nuk mund të përkufizohet, nuk mund të mbyllet në një datë të vetme, siç është 6 marsi Dita e Dëshmorit, ditët e familjes Jashari dhe ditët e UÇK-së, që tashmë janë pagëzuar Epopeja e UÇK-së dhe shënohen tash 6 vjet, janë manifestim tashmë tradicional dhe mendoj se nuk duhet të preket, nuk duhet të ngushtohet në një ditë të vetme, që quhet dita e dëshmorëve, por duhet të mbetet si Epopeja e UÇK-së dhe se 6 marsi, ashtu si ka qenë edhe deri më tash, si ditë kur bëhen homazhe të varrezat e Jasharajve në Prekaz dhe të varrezat e dëshmorëve anë e mbanë Kosovës. Prandaj kjo mund të saktësohet në ligj si Epopeja e UÇK-së. Familja Jashari, komandanti legjendar i UÇK-së -Adem Jashari- janë sublimim i gjitha përpjekjeve, i gjithë heroizmit shqiptar, prandaj si e tillë nuk mund t'i ndryshohet karakteri kësaj ngjarjeje madhore kombëtare, nuk mund të ndryshohet dhe të bëhet dita e dëshmorëve. Kjo duhet të mbetet Epope e UÇK-së dhe si ditë kur i gjithë kombi shqiptar përulet me respekt para Jasharajve të mëdhenj, para komandantit legjendar dhe para gjithë dëshmorëve të kombit jo të Kosovës, siç përpiqet dikush t'i quajë se dëshmorë krahinash nuk ka.

Ne insistojmë dhe kërkojmë që kjo çështje të mendohet më mirë, të bisedohet shtruar e qetë, se edhe ashtu është një çështje mjaft emocionale me grupet parlamentare, me shoqata, me qytetarë, me familje të dëshmorëve dhe të rregullohet kështu si është, sepse tashmë është e rregulluar si Epope e UÇK-së dhe e shënon Kosova, e shënon mbarë kombi -vijne nga të gjitha viset shqiptare atë ditë në Prekaz, prandaj nuk duhet t'ia ndryshojmë karakterin kësaj ngjarjeje madhore të kombit, jo vetëm të Kosovës. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit, fjalën e ka Gjylnaze Syla. Të përgatitet për fjalë, nuk po e shoh në sallë,

**DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA:**

I nderuari z. kryesues, i nderuari z. kryeministër, të nderuar deputetë.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, me kujdes të veçantë e ka shqyrtuar këtë ligj. Projektligji për ditën e dëshmorëve është i një rëndësie të veçantë dhe ne e përgëzojmë hartuesin përcjelljen e këtij projektligji dhe për gjetjen e bazës juridike që të caktohet një datë e vetme - 6 marsi - Ditë e Dëshmorëve lidhet drejtpërsëdrejti me të gjitha sakrificat, përpjekjet dhe luftën tonë për liri dhe për pavarësi. Është ditë kur mund ta rikujtojmë gjithë sakrificën e atyre që ranë për lirinë që e gëzojmë, por është ditë që na i rikujton të gjitha detyrimet dhe përgjegjësinë që kemi për lirinë dhe për progresin që e kemi arritur, duke marrë parasysh se kjo është vetëm një kontribut shumë i vogël në krahasim me detyrimet e shumta që kemi ndaj dëshmorëve dhe familjeve të tyre, Grupi Parlamentar i AAK-së e mbështet dhe i fton deputetët të votojnë. Gjithashtu

ky ligj dhe dita e caktuar, 6 Marsi, na bën me dije të shënohet dinjitetshëm dhe të shprehim respekt të thellë për të gjithë ata që ranë, por edhe të njëjtën kohë të ndihemi krenarë. Ju faleminderit

**KRYESUESI, NAIM MALOKU:**

Në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, deputetja Fatmire Mulhaxha -Kollçaku

**DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA KOLLÇAKU:**

Është e qartë se nevojitet të bëhet unifikimi i një date të vetme si ditë e dëshmorëve në tërë territorin e Kosovës. Mirëpo me të vërtetë kemi pritur sidomos ne që jemi mbështetur në Grupin e Punës, në të cilin ka marrë pjesë, në të cilin ceket se kanë marrë pjesë edhe shoqatat e dala nga lufta, por edhe thuhet se kanë marrë pjesë kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës, kryetari i Shoqatës së Familjes së Dëshmorëve, Shoqata e Invalidëve, d.m.th. përfaqësues kemi pritur që me të vërtetë të jetë një datë që është në pajtueshmëri me të gjithë, sepse ne do ta caktojmë një ditë të dëshmorëve për një pjesë të Kosovës dhe një ditë tjetër, prandaj, besoj që nuk di sa është e mundshme që komisioni funksional ta bëjë këtë. Kësaj është dashur t'i paraprinte data për të cilën do ta jepnin pëlqimin të gjitha grupet, sot këtu të unifikohet një qëndrim dhe të shkohet dhe të caktohet një datë që vërtet do të ishte datë për ta shënuar me dinjitet të plotë, ditë e të gjithë dëshmorëve të Kosovës.

Nuk jam e sigurt se do të jemi komision funksional, nuk di a do t'i përket Komisionit për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale të jetë, apo Komisioni për Legjislacion, kështu që kur shtrohet çështja, kur po pritet në lexim të parë të deklarohen komisionet, ju e dini që sipas rregullores deri më tani komisionet në lexim të parë nuk deklarohen kryesisht, sepse nuk e shqyrtojnë para leximit të parë, dhe se zakonisht mendimet jepen në lexim të dytë. Prandaj, mirë është të parashikohet kjo me rregullore, sepse ne si komision paraprakisht e kemi Ligjin për ushqimin, p.sh. e kemi marrë një vendim që paraprakisht para leximit të parë, është e vlefshme që Komisioni të ketë mundësi, gjithnjë para leximit të parë, të debatojë për një projektligj. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit në emër të Grupit Parlamentar 6+ deputeti Mahir Yagcilar, të përgatitet deputeti Gjergj Dedaj

**DEPUTETI MAHIR YAĞCILAR:**

Sayın başkan vekili, sayın başbakan, değerli milletvekilleri  
Kahramanlar Gününe ait Yasanın, hem parlamento hem Kosova için, yani Kosova için canlarını feda eden savaşçılar ile insanların anısına, hem de bugün Kosovada yaşayan insanlar için özel önmi bulunmaktadır. Bu Yasa, Kahramanlar gününün kurumsal olarak

kutlanmasini ve Kosova için yapılan fedakarlıkların gururla anılmasını sağlayacaktır. Buna inanarak 6+ Parlamento Grubu adına, bu Yasayı prensipte kabul ediyoruz ve düşüncemize göre bu Yasa, milletvekilleri tarafından sunulacak önerilerle en iyi bir şekli alacaktır.

İlginize teşekkür ederim

KRYESUESI, NAIM MALOKU:

Ju faleminderit, fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar për Integrim Gjergj Dedaj

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ:

Z. kryesues, i nderuari kryeministër, deputetë të nderuar.

Në janar të vitit të kaluar e kemi diskutuar një projektligj, pastaj është miratuar me të drejtat për pjesëtarët e luftës së UÇK-së, të familjeve të dëshmorëve, të martirëve, madje kemi thënë edhe të viktimave civile. Atëherë pata shprehur rezervat e mia se cilat janë viktimat civile, sepse po që se të njëjtën ditë nga i njëjti okupator dhe ushtri e polici, janë vrarë njerëzit e dikush të jetë dëshmor, dikush martir e dikush viktimë civile, nuk ma ka pasë marrë mendja as atëherë as tash se kjo është një trajtim i drejtë, sepse viktimat civile janë ata që vdesin në fatkeqësi elementare, vërshime, zjarre ose aksidente të aeroplanëve, ku ta di unë, për ata që vriten në mbrojtje të vendit të vet, siç ka ndodhur në konfliktin e fundit në Kosovë. Tash shtrohen dilemat: kush dhe si e merr statusin e dëshmorit dhe kush e jep atë status që ka shumë familje e individë që e meritojnë një status të tillë. Por, kush mbetet atëherë martir, cila kategori mbetet vetëm viktimë civile. Që të mos ketë mosmarrëveshje gjatë procesit shpeshherë, ndoshta me indinjatë për një trajtim jokorrekt ndaj të gjithë atyre që kanë sakrifikuar jetën për lirinë e Kosovës, në parim Grupi Parlamentar për Integrim e mbështet atë që një ditë ta kemi të unifikuar që t'i nderojmë ata që na bënë të mundshme të jemi sot në Parlamentin e Kosovës, të punojmë për të ardhmen e vendit tonë dhe ndoshta nuk do të ishte një ditë tjetër më e pranueshme se pikërisht 6 Marsi, pa dashur të anashkalohet e drejta që shprehi deputeti Bislimi. Nuk di që në atë kohë pati ditë më të shënuar se dita e 6 Marsit, që lidhet me sakrificën mbinjerëzore dhe heroike të familjes Jashari. Kujtoj se është mirë të hiqet çdo procedim tjetër. d.m.th. termi viktimat civile për thjeshtësim, për të mos i vënë njerëzit e familjet para gjërave shpeshherë të pakëndshme, për të cilat do të flisja ndonjëherë tjetër. Për të mos marrë kohë shumë është mirë që 6 marsi të jetë Dita e lirisë, për të mos cekur se u kujtuan vetëm dëshmorët, por u harruan martirët, u harruan të sakrifikuarit. Vetëm durim ju lutem, d.m.th. është mirë të dëgjohet edhe mendimi tjetër dhe do të mësoheni t'i dëgjojmë edhe të tjerët, d.m.th. dita e lirisë së Kosovës, të jetë pikërisht 6 marsi. Ju faleminderit

KRYESUESI, NAIM MALOKU:

Fjalën e ka Hydajet Hyseni, le të përgatitet Kamber Kamberi

DEPUTETI, HYDAJET HYSENI:

Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar kolegë deputetë, i nderuar kryeministër. Nuk ka si të mos përshëndetet një nismë e tillë, dëshmorët meritojnë shumë më tepër seç kemi bërë dhe seç po bëjmë. Meriton shumë më tepër familja Jasharaj nga Prekazi se sa kemi bërë e që po bëjmë. Prandaj, duke e përshëndetur nismën, duhet edhe t'i kuptojmë shqetësimet që po shtrihen a thua zgjidhjet gjithmonë janë adekuate me përmasa, me rëndësinë, me kontekstin e tjera.

Së pari më lejoni t'i them disa vërejtje ose reflektime të kësaj natyre. Dokumenti na ka ardhur pa aparaturën e nevojshme, pa shkresën përcjellëse, besoj që ajo ndoshta do ta lehtësonte edhe debatin tonë, kurse për më tepër në dispozitën e fundit që duket formalitet ose cikërrimë, ky ligj hyn në fuqi, thuhet, pas miratimit nga Kuvendi dhe pas shpalljes nga Përfaqësuesi Special. Kjo mund të jetë një ditë, një vit, mund të jetë shumë vjet, më vonë, për mendimin tim ka edhe arsye për qasjen në aspekte që janë më serioze se kjo, megjithëse edhe ajo është me bisht prapa. Vini re ju lutem, në preambulën e ligjit, po lidhem edhe me atë që e tha deputeti Deda. Në shqip fjalia e fundit është: Caktimi i një date unike është për ditën e Dëshmorit, në anglisht është:..... kurse në gjuhën serbe është: dan palih boraca etj. Ju e dini se në praktikën tonë versioni në anglisht, kur ka mospërputhje, është versioni që merret parasysh. Shtrohen dy çështje, një që këtu është ditë e përkujtimit të dëshmorëve, është edhe më e relativizuar në anglisht do të thotë versioni mbizotërues dhe është dita e martirëve. Në tekst nuk ka përkufizim ç'është dëshmori, kurse në të vërtetë ka një nen që ka përkufizime ,por nuk e ka çuditërisht përkufizimin e dëshmorit. Fjala dëshmor ka shpjegime të ndryshme, por martir, në enciklopedi e fjalorë që i kam konsultuar, gjithmonë është njeriu që ka vuajtur shumë ose ka sakrifikuar për një qëllim ,për një ideal e tjera.

Prandaj ndoshta janë edhe ato nuanca dhe keqkuptime te ne për do farë klasifikimesh. Ju e dini a u përshtaten një dimension dhe një petk i tillë atyre që duam t'i rregullojmë me këtë ligj. Tash shtrohet pyetja çka duam të rregullojmë me këtë ligj, a duam ta caktojmë ditën e dëshmorëve që nuk e kemi të rregulluar më së miri, apo duam t'i dalim borxhit asaj që përfaqëson Prekazi- familjes Jashari, të Adem Jashari e të tjerëve. Nuk është mirë të përzihen këto dy çështje.

Prandaj, mendoj se duhet të kemi parasysh nëse duam të jemi në nivelin e kërkesave, të jemi edhe inventivë. Dikur, nuk ka pasur ditë dëshmorësh, ka pasur ditë të mëdha historike, por është krijuar nevoja dhe u gjetën realitete të reja që sollën cilësi të reja në realitetin tonë, prandaj duhet të merren seriozisht propozimet që jeta i ka nxjerrë, si p.sh. Epopeja e UÇK-së, ditë e lirisë, ditë e heroizmit etj.

Kjo vetëm ua jep dimensionin e vërtetë realitetit të ri në Kosovë dhe historisë më të re të saj, madje më tepër mendoj se duhet të reflektojmë edhe në një aspekt tjetër, 6 marsi dhe ditët e tjera lidhur me të, janë identifikuar me Epopenë e Jasharajve të Prekazit, njëfarë mënyre jo vetëm gjithë Kosova, por edhe gjithë hapësira shqiptare dhe shumë dashamirës, atdhetarë, paqedashës, liridashës nga vendet e ndryshme ,atë ditë në një mënyrë e identifikojnë me atë epope. Le të mendojmë nëse ne e kthejmë atë tani në një ditë të dëshmorëve të përgjithësuar, mos po e shkapërderdhim pikërisht atë, që ka qenë shumë unike, shumë specifike. Mos po e konsiderojnë si ditë që secili duhet të shkojë dhe

t'i nderojë dëshmorët e vet. Ne edhe ashtu kemi prirje feudalizmi, parcializmi, partikularizmi e partizmi etj. dhe mos po e fusim edhe këtë linjë në këtë ditë. Së paku kjo ka qenë e pakontestueshme. Për më tepër ta kemi parasysh edhe një dimension tjetër.

Dëshmorët janë brezash të ndryshëm, të periudhave të ndryshme historike. Njerëzit që janë mësuar t'i nderojnë dëshmorët një ditë nuk do të jetë edhe e lehtë të themi se prej sot nuk do ta nderoni këtë ditë, por do të nderoni një ditë tjetër. Tash p.sh. po e bëjmë pikërisht në janar, kurse gjithë Kosova ka pasur aktivitet gjithnjë , andej për tre dëshmorët e janarit, ose për dëshmorët e Luftës së Dytë Botërore etj. Për mendimin tim ia vlen që për këto çështje të mendohet më mirë, të pasurohet nderimi për dëshmorët dhe për atë që përfaqësojnë ata, po të parandalohet mundësia e telasheve ta them me një fjalë më të butë, më të thjeshtë ndërlikimesh, komplikimesh, lojërash etj. Së paku në këtë çështje është mirë të mos preket.

Për mendimin tim kësaj do t'i ndihmonte procesi i konsultimit paraprak, para se të merrete formën e ligjit. Zakonisht edhe ndiqet kjo praktikë. Edhe idenë, edhe propozimin për çështje të tilla ,për ide të tilla ,e japin ata që janë më afër asaj që janë sakrifikuar më shumë. Zakonisht këtë e bëjnë shoqatat e veteranëve etj. Mendoj se kjo duhet të merret parasysh dhe ta plotësojë nismën tonë ,që uroj të përfundojë me sukses dhe të jetë në nivelin e dinjitetit që meritojnë dëshmorët dhe ata që përfaqësojnë . Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU:

Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Kamber Kamberi. Të përgatitet Nazim Jashari.

DEPUTETI, KAMBER KAMBERI:

Më sa shoh nga parashkresa e këtij projektligji, duket se lista ka qenë e përpiluar nga 16 anëtarë ,nga përfaqësues edhe të shoqatave të veteranëve të luftës, të familjarëve, të dëshmorëve etj. Por në përpilimin përfundimtar marrin pjesë 5 anëtarë.Ma merr mendja se ky është një hendikep, por megjithëkëtë gjatë përpunimit të këtij projektligji ka vërejtje, sepse ky projektligj, kaq i shkurtër, e definon jo qartë dhe jo në mënyrë reprezentuese gjithë atë çka duhet të ketë për nderimin e dëshmorëve.

Sa i përket datës së 6 marsit kujtoj se asnjë cenim nuk i bëhet familjes së Jasharajve, por mendoj se begatohet, se edhe ata që janë vrarë para se të ndodhë kjo epope e familjes Jashari. Ky flijim më sublim pasi bartet në këtë datë ,d.m.th., sipas mendimit tim nuk i bëhet asnjë cenim, madje do të ishte bëhej një begati e kësaj familje.

Në nenin 2 kujtoj por nuk e di kush e përmendi, nuk i përfshin vetëm lufta e fundit dëshmorët e luftës së UÇK-së, por duhet të jetë një ligj pak më i përgjegjshëm që të përfshihet ndoshta edhe periudha e para luftës së vitit 98 – përkatësisht 99.

Neni 2 mendoj se nuk është i definuar aq qartë. E kam një përpilim edhe për nenin 2 edhe për nenin 4, pikat 2. Ligji ka për qëllim ta caktojë një datë unike për tërë territorin e Kosovës, në shenjë nderimi për të gjithë dëshmorët në vazhdimësi, për sakrificën dhe



për kontributin e dhënë për lirinë e Kosovës, për lartësimin e idealit të luftës për liri, demokraci e progres njerëzor.

Nenet 21 dhe 4.1, ma merr mendja duhet të mbeten kështu, të mos ndryshohet asgjë, por në pikën 2 kjo datë është caktuar në shenjë nderimi të aktit më sublim të rënies heroike të familjes Jashari, jo vetëm të familjes Jashari, sepse për fat të mirë kanë shpëtuar edhe të tjerë që jetojnë edhe sot. Pra, pas rënies heroike të familjes Jashari, të komandantit, jo krijuesit dhe strategut të Luftës Çlirimtare në Kosovë, Adem Jashari.

Gjithashtu e kam edhe një vërejtje për shpenzimet, ku përfshihen 40 mijë euro, që nuk ceket në çfarë niveli bëhet. Ju faleminderit

KRYESUESI, NAIM MALOKU:

Ju faleminderit, deputeti Nazim Jashari e ka fjalën. Të përgatitet Sadudin Berisha.

DEPUTETI NAZIM JASHARI:

I nderuari z. kryesues, i nderuari z. kryeministër, të nderuar kolegë deputetë. Ky projektligj që e kemi përpara, është një projektligj me tri katër fletë dhe po të shikohet vëllimi i tij do të konsiderohej se nuk është projektligj i rëndësishëm, mirëpo dua t'jua tërheq vërejtjen se e kemi një projektligj para vetes, që është shumë i rëndësishëm për ne. Mënyra si procedohet sot në Kuvend lidhur me këtë çështje, tash po e ngrit në çështje, këtë projektligj po e bëj pjesë të një çështjeje më të madhe. Kjo është mënyrë se nuk do të duhej të ndodhte kështu. Para se të gjendeshim në këtë situatë, z. kryeministër do të ishte dashur në këtë Kuvend ta iniciohte një debat të hapur lidhur me këtë problematikë. Ky debat do të zgjaste një ditë, dy apo tri ditë, apo dy tri herë, ai debat do të duhej të rrumbullakohej me një rezolutë, që do t'i paraprinte këtij ligji, në të cilin të gjitha forcat politike në Kosovë do të mund të dakordoheshin për një datë të vetme të dëshmorëve të Kosovës. Në qoftë se do të bëhej kështu, sigurisht se edhe këto kundërshtime të këtij projektligji nuk do të ekzistonin fare, por do të kishin bërë në një mënyrë solemne shpalljen e kësaj date.

Pra, mënyra e punës është një mënyrë e papranueshme. Në qoftë se Qeveria, që e ka paraparë një komision për ta hartuar Projektligjin. Në këtë komision është paraparë të marrin pjesë 16 veta, vendorë dhe ndërkombëtarë, por në qoftë prej tyre 16 kanë marrë pjesë në hartimin e ligjit vetëm 5 sish, sipas logjikës elementare demokratike, do të duhej të ishin 9, z. kryeministër, që të krijohet kuorumi ( shumica) elementar, ta quajmë ashtu edhe pse nuk ka rregullore për atë punë, po do të duhej së paku 9 të ishin që në një mënyrë ta plotësojnë edhe aspektin formal, mirëpo pa një vendim politik mendoj se ky projektligj nuk mund të jetësohet. Ne mund ta caktojmë një datë, se shumicën e votave i kemi si Qeveri dhe të pretendoni se e keni bërë ligjin, por ai ligj duhet të zbatohet, kurse për t'u zbatuar ky ligj duhet ta keni përkrahjen e të gjithëve dhe të mos e mendoni se duke u fshehur pas familjes Jashari, mund të na impononi një datë që ju dëshironi ta bëni. Familja Jashari i ka meritat e veta të padiskutueshme, por megjithëkëtë debati në këtë Kuvend, në të cilin duhet të ishin 120 përfaqësues të popullit, do të duhej të prodhonte

një datë konvencionale që lidhet edhe me datat e rrënjëve shqiptare. Jo me patetikë, jo me ide shqiptaro madhe. Këtë po e them sipas praktikës themelore, se në luftën e Kosovës kanë rënë në të gjitha kohërat shqiptarë edhe nga trojet e tjera, siç ka ndodhur edhe në luftërat e vendeve të tjera, ranë shqiptarë edhe nga Kosova. Përkitazi me këtë, vetëm për hir të unitetit sa më madh, që do të duhej të ishte themelor që të krijohej një konsensus mase edhe më i gjerë se brenda kosovar. Kjo mënyrë si po procedohet mendoj se është krejtësisht e gabueshme, prandaj do thërrisja që ky projektligj të tërhiqet dhe ta vazhdonim punën pikërisht si propozova pa pretendime. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU:

Deputeti Sadudin Berisha e ka fjalën.

DEPUTETI, SADUDIN BERISHA:

Në parim mbështes Projektligjin si të domosdoshëm, pritet nga kryetari i Komisionit për Legjislacion që deputetët e pranishëm t'i njoftojë për qëndrimin që merret në mbledhjen e fundit të Komisionit për Legjislacion, që debatoi edhe për këtë projektligj. Komisioni ka vlerësuar se ka baza juridiko- kushtetuese dhe nevoja të pashmangshme për caktimin e një date për dëshmorët e kombit me ligj të veçantë. Këtë e thashë për shkak se kur kemi nevojë për t'i informuar të pranishmit se çfarë është qëndrimi i një komisioni të caktuar, këtë e bëjmë atëherë kur nuk kemi nevojë ta bëjmë. Këtë e prita nga kryetari, sepse ishte vërejtja e qëndrueshme e një diskutuesi nga reformistët, se është dashur paraprakisht të vlerësohte a kishte mbështetje dhe si do të duhej të procedohej për ta nxjerrë një ligj të tillë. Sërish them, e mbështes këtë projektligj, si nevojë dhe se viza për procedim të mëtejme, përkatësisht është dhënë nga Komisioni për Legjislacion. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU:

Ju faleminderit. Është lajmëruar për fjalë edhe kryetari i Komisionit për Çështje Gjyqësore, Hydajet Hyseni, besoj në emër të kryetarit tani.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI:

Ju faleminderit, z. kryesues. Në vend të replikës, si të them, në fjalën time i dhashë më shumë sesa përkrahje parimore idesë dhe këtë, natyrisht, e bëja si deputet. Isha në dilemë, të them se komisioni vlerësoi se projektligji nuk ka ndonjë pengesë, se ka mbështetjen juridike kushtetuese siç e bëjmë për të gjitha ligjet. Pra, kjo në këtë fazë as nuk kërkohet, por në fazën e mëvonshme. Zakonisht kështu e kemi bërë, asnjëherë në shqyrtim nuk e kemi dhënë këtë konstatim. Kjo mund të kthehet në pyetje, them se nuk kemi pasur këtë praktikë. Ç'është e vërteta e kemi biseduar a mund të shkojmë përtej kësaj, do të thotë si komision të hyjmë, të lëshohemi edhe në vlerësimin funksional të ligjit. Nuk mund ta bënim këtë, për arsye se nuk jemi caktuar si komision funksional dhe nuk jemi ata që caktojmë vetveten që do të jemi përgjegjës për x apo ypsilon ligjin. Kryesia është ajo që e bën këtë, prandaj këtë do ta bëni më vonë nëse Kryesia do ta

shohë të arsyeshme që komisionin tonë ta konsiderojë të tillë. Këtë po e them jo për të kontestuar atë që e tha, se e konsideronte plotësim dhe mund ta falënderonte, natyrisht besoj që gjithmonë është qëllimshme, por për t'ua sqaruar deputetëve dhe opinionit. Ju faleminderit

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit. Një minutë përgjigje në replikë ,deputeti Sadudin Berisha.

**DEPUTETI SADUDIN BERISHA:**

Nuk kam koment në përgjegjen e z. Hydajet Hyseni,

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Për fjalë është paraqitur z. Sabri Hamiti

**DEPUTETI SABRI HAMITI:**

Z. kryesues, z. kryeministër z. kolegë të çmuar

Po shihet se është një materie e ndjeshme ,për të cilën ,ç' është e vërteta po diskutohet shumë . Nuk është mirë të bisedohet për gjëra të mëdha në këtë formë. Unë e përkrah nxjerrjen e një ligji të Kosovës,që i nxjerr në dritë dhe i kujton të gjithë dëshmorët e Kosovës. Mendoj se ajo që ka qenë bazë e orientimit për ta nxjerrë këtë ligj, ka qenë element që të njehet një ditë kur do të kujtohen të gjithë dëshmorët e Kosovës. Nëse unë e kuptoj pasi përcaktim tjetër nuk ka me titull të të gjitha kohërave, nuk ka saktësim kohe, periudhe, as hapësire. Ky ligj ,si e kemi në formulimin që në esencë i ka dy nene themelore ,të tjerat janë procedurë ,hesapi është 2 dhe 4, nuk e sqaron si duhet këtë destinim të ligjit. Ju merreni, lexoni mirë të dyja nuk janë sqaruar si duhet, prandaj duke pasur parasysh edhe këtë nivel të ligjit, kujtoj që edhe derivimet e mendimeve ,që duket që janë shumë të ndryshme, këtu në këtë diskutim rreth ligjit, por secili e ka arsyen e vet prapa, se është ai mendim si duket që është derivuar. Çka duhet të them këtu, duhet të them që të kemi kujdes në parimin çka duam.Nëse duam ligj për dëshmorët e Kosovës të të gjitha kohërave, atëherë nuk duhet të mbetemi peng i asnjë date, qoftë edhe 6 Marsi. E di se nuk ka , mendoj gjatësi të këtillë, sepse e lidhin vetëm me familjen e Jasharajve dhe me 6 marsin e familje së Jasharajve, por kjo nuk duhet as të implifikohet as të mitizohet në këtë formë.

Nën dy, duhet të saktësohet ç'është dëshmori, sepse ju e patë interpretimin në tekstin anglisht i qitëm në lajthitje ose në dyshim për një herë z. Hydajet Hyseni , sepse nuk janë njësoj, as të njëjtë termat martir dhe dëshmorë.Në shqip jo.Ndoshta në gjuhë të tjera mund të jenë, shqip mund të jetë, por nuk janë njësoj.Këtë duhet ta merrni parasysh edhe në zhargonin e të folurit politik edhe historik , pra nuk janë njësoj: hero dhe viktimë as te shqiptarët, vlera morale mund të jetë në një qëndresë të barasvlershme shpirtërore, por si definim nuk është njësoj dhe ne duhet të mësohemi t'i dallojmë këto çështje, duhet të mësohemi që historinë ta shohim nga perspektiva e largësisë. Është në natyrën e njerëzve që për kohën e vet të llomotitin më shumë se për kohërat e vjetra. Merrni edhe

tekstet e historisë, krejt historinë e lashtësisë e shkruajnë në një vëllim, kurse për këto bëhen më llogaritë edhe i bëjnë disa vëllime, që nuk do të thotë se njëra e mund tjetrën, por për nga natyra e njerëzve është për gjërat që i kanë përjetuar dhe i njohin të vetët më shumë, çka duhet të them, duhet të them se të bëheni racionalë, ta caktojme sa më parë dhe patjetër ditën e dëshmorëve, nëse na përshtatet të jetë 5 marsi, le të jetë, se pas 5 marsit po jo me shtesën dy, sepse ju e patë ajo shtesa dy thotë të bëhet për familjen e Jasharajve, po të njëjtën kohë brenda këtij Kuvendi interpretimet janë të ndryshme. Derisa dikush e sheh si mjerim, tjetri e sheh si kufizim, d.m.th. perceptimet janë diametralisht të kundërta, dikush thotë është mirë se po nderohet shumë familja, sepse mbetet datë e gjithë dëshmorëve të të gjitha kohërave e Jasharajve, tjetri për njëherë e sheh cenim, se thotë ngushtim. Këto janë diskutime parimore, por edhe janë diskutime që i përkasin një civilizimi në mënyrën e të menduarit, këtu ne, nëse duam datë për të gjithë dëshmorët, nuk është e thënë- po them haptas- të jetë vetëm 6 marsi, mund të jetë, por nuk është e thënë çfarë duhet të përfundoj tash. Duhet të përfundoj që ky tekst është, po them prapë me dy nene, mua më duket z. kryeministër që ju e keni sponsoruar, më duket se në këtë formë nuk është i specifikuar mirë. Ky është mendimi im. Ne e përkrahim nxjerrjen e ligjit me krejt fuqitë dhe dihet me energjitë që kam, një ligj për dëshmorët e Kosovës. Ju faleminderit.

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Të nderuar deputetë, jam i obliguar, për shkak se po bartet emri i një deputeti, këtu e kërkon fjalën, t'ia jap fjalën deputetit Veton Surroi, ose atij që përdor kartelën e tij, ose të lus të mos manipulohet kartela e deputetit. Atëherë deputeti Jakup Krasniqi e ka fjalën.

#### DEPUTETI JAKUP KRASNIQI:

I nderuari kryesues, i nderuari kryeministër, Vërtet duhet ta kemi një ditë të dëshmorëve, që sanksionohet me ligj dhe nderohen të gjithë dëshmorët, madje edhe ata të të gjitha kohërave, mendoj se këtu nuk ndahemi me mendime, por mendoj që ne në parim e përkrahim, se nuk ka mundësi të tjera, por megjithëkëtë nuk është punuar si duhet, nuk është diskutuar para se të vijë në Parlament sa duhet, se jam i bindur po të ishte diskutuar për këtë çështje më tepër para se të vinte në Parlament do të na vinte sot një ligj dhe nuk do të na linte shumë fjalë.

Në rend të parë po nisem nga fjala e parë pas hyrjes, ligji për ditën e dëshmorëve, megjithëkëtë duhet të përcaktohet që të jetë ky ligj për ditën e dëshmorëve të kombit, ligj për ditën e dëshmorëve të Kosovës. Mendoj që nuk ka nevojë të nxirret ligj për dëshmorët e UÇK-së, se në fund të fundit të gjithë dëshmorët janë dëshmorë.

Nëse mendon ta nxjerrim një ligj për ditën e dëshmorëve të kombit, ne si komb e kemi një ditë. Nëse duam ta nxjerrim një ligj për ditën e dëshmorëve të Kosovës, mendoj se po e zvogëlojmë sakrificën ose flijimin e dëshmorëve për idealet e tyre, se gati të gjithë dëshmorët, që ne synojmë t'i nderojmë, kanë prapa interesat e kombit dhe nuk mund të na kufizohet t'i quajmë dëshmorë të Kosovës. Dëshmorët kanë rënë për kombin në

tërësi dhe nuk e përfshijnë atë për të cilën kanë rënë, kurse ligji vetëm për ditën e dëshmorëve mendoj që është pak, por përsëri nuk e thatë atë që duhet ta thoshit, prandaj menjëherë po them ne në parim jemi, por të zhvillohet prej leximit të ligjit të parë deri në leximin e ligjit të dytë një debat më i gjerë, në Parlament, por edhe jashtë tij, mënyrë që ta bëjmë një ligj që do t'i përfshinte të gjithë dëshmorët e kombit.

6 Marsin, si ditë të caktuar mendoj se askush mund ta kontestojë, sepse ka flijim që i kalon edhe kufijtë e kombëtares, është flijimi që është bërë me 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998, madje, nga një herë e kam drojën që duke e lënë vetëm si ditë dëshmorë epopenë e UÇK-së, sikur ia zvogëlojmë peshën, prandaj mendojmë se për këtë arsye, para se të fillojë leximi i dytë i këtij projektligji, që na ka ardhur sot, duhet të bëhet një debat më i gjerë dhe të na vijë një ligj më i përkryer. Ky është edhe mendimi im edhe mendimi i Grupit Parlamentar të PDK-s, që kemi biseduar edhe më parë për këtë çështje. Ju faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit. Mendoj se është i fundit deputeti Fatmir Sejdiu.

**DEPUTETI FATMIR SEJDIU:**

Një minutë po flas. Z. Jakup Krasniqi e mori fjalën tash jashtë asaj pjesës së procesit ju ia dhatë fjalën me të drejtë, nuk kishte problem fare, por mua më kërcënuat me një minutë më parë. Kaq pa të keq.

**KRYETARI NAIM MALOKU:**

Dhe për fund sponsoruesi i Projektligjit kryeministri Bajram Kosumi

**KRYEMINISTRI BAJRAM KOSUMI:**

I falënderoj të gjithë deputetët, edhe ata që debatuan, të gjithë të tjerët dhe dëshiroj të them që kjo është një çështje për të cilën duhet të kemi pajtim të përgjithshëm. E dëshiroj atë që tha z. Krasniqi, në fund atë që ta shfrytëzojmë punën në Komision, që të bëhet një debat i gjerë për këtë çështje.

Dua t'i jap vetëm dy sqarime rreth atyre që u folën këtu gjatë tërë kohës. Projektligji, siç e thotë titulli, është për ditën e dëshmorëve, nuk është projektligj për dëshmorët, por për ditën që do të nderohen dëshmorët. Kjo është çështja e parë me të cilën do të thuhet se e kemi hequr nga projektligji definimin: cilët janë dëshmorë, sepse kjo prek tema të tjera, si u përmend edhe këtu, ndoshta ende nuk kemi pasur mundësi t'i definojmë saktësisht dhe i kemi lënë t'i definojmë me projektligje të tjera arrihet kjo. Ajo që ishte e nevojshme dhe që të na nderonin të gjithëve, edhe neve që jemi gjallë na nderon ta kemi një ditë në 366-ditshin e vitit, kur të gjithë ne nuk do të punonim, por do t'i nderonim dëshmorët dhe kalendarin e vitit të punës që në Kosovë të ketë një ditë që është e shënuar me të kuqe se është festë zyrtare e Kosovës ku nderohen gjithë dëshmorët e saj.

Çështja e dytë, që desha të sqaroja, është ligjshmëria me 6 marsin, neni 2 aty ku thuhet: Nuk është ditë për Epopenë e UÇK-së, por 6 marsi është dita në shenjë të nderimit ndaj familjes Jashari dhe të komandantit Adem Jashari, ka mund të merret cilado ditë që do të pajtohemi është e saktë, cilado ditë e vitit do të thuhet kjo është dita jonë. Mund të jetë një datë e rëndësishme ose e parëndësishme, por mendoj se vetëm rritim respektin për punën e madhe për luftën që e ka bërë dhe për flijimin e familjes Jashari, nëse bashkohen në një ditë krejt gjaku, puna dhe mundi i bërë për më se një shekull për Kosovën e kemi përmbledhur vetëm në një ditë. Pra, kjo vetëm e ngrit vlerën asaj dite dhe nuk e zvogëlon. Ju faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit. Ju foj deputetë të nderuar për votim. Votojmë tash.

Për janë.....73

Të pranishëm.....85

Konsideroj se Projektligji është miratuar në parim. Në bazë të Rregullores 23.6 dhe rregullës 35.2 Kuvendi ngarkon këto komisione.

1. Komisioni për Çështje Gjyqësore Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese si komision funksional dhe referues.
2. Komisioni për Buxhet
3. Komisioni për Komunitete.

Me këtë, të nderuar deputetë, përfundojmë punën për sot. Kuvendi vazhdon seancën të hënën, më 23 janar, në orën 10.

Vazhdimi i seancës plenare e ndërprerë më datës 19 dhe 20 janarit  
(Vazhdimi i kësaj seance bëhet me datën 14 dhe 15.02.2006)

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Në rend të ditës kemi:

### **13. Debat sipas kërkesës së Grupit parlamentar të Partisë reformiste ORA**

Për fjalë, në emër të Orës është, paraqitur shëfja e Grupit Parlamentar Teuta Sahatçija. Foltorja është juaja. Urdhëroni.

Deputetë të pranishëm në sallë janë 91.

**DEPUTETJA TEUTA SAHATÇIJA:**

Z. kryetar. Kemi vërejtje procedurale se kërkesa jonë ,që është pikë e parë e rendit të ditës sot, në fakt është kërkesë që i përmban dy pika dhe ne kishim dashur të respektohet kjo, por pasi është pranuar si pikë e rendit të ditës, të debatohet në mënyrë të veçantë pika e parë. Kur të përfundojë pika e parë , të debatohet për pikën e dytë. E keni kërkesën tonë të protokolluar më 7.11 dhe në të si pikë e parë është: **Debat lidhur me mënyrën e vendimmarrjes për ndërtimin e Qendrës administrative-protokollare,kurse pika e dytë është: Debat lidhur me shpenzimet buxhetore të Kuvendit të Kosovës për periudhën janar - qershor 2005.** Siç dihet, në rregullën 23 pika 5 shpjegohet kjo çështje dhe aty, mos ta lexoj krejt Rregulloren, por thuhet që: Kërkesa duhet të përmbajë çështjen ose çështjet, d.m.th në shumës që do të shqyrtohen si dhe arsyet që konsiderohen të ngutshme dhe të rëndësishme që edhe në mënyrë të tillë të shqyrtohen në Kuvend. Në raste të tilla shqyrtohen vetëm çështjet që përbëjnë bazën e kërkesës, prandaj kishim dashur që për këto dy çështje të debatohet në mënyrë të veçantë. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Z. deputet ju faleminderit. Rendi i ditës është propozuar nga Kryesia në kohë të duhur. Seanca e ka marrë atë rend të dite në kohë të duhur. Jemi në pikën e 13 të rendit të ditës, në seancë të veçantë.Si pikë të parë e filluam atë, prandaj do të vazhdojmë të punojmë sipas rendit të miratuar të ditës dhe ju në debat e shtroni çështjen. Është kjo çështje juaja e si kërkesë të saj, prandaj do t'ju lutja , se ju takon radha, që të parët të merrni fjalën si propozues, kuptohet nëse dëshironi, sepse është çështje juaja. Për fjalë është paraqitur z. Gazmend Muhaxheri.

#### DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI:

Deputetë të nderuar, para 6 muajsh kur në mbledhje të Kryesisë kërkuam nga kryetari i Kuvendit dhe nga Sekretaria e tij informatë të hollësishme për mënyrën si merret vendimi për ndërtimin e Qendrës Administrativo – Protokollare në Gërmi. Kryetari i Kuvendit tha ndiqni procedurat. po të kishim një kryetar që i respekton, të paimplifikuar në veprime të paligjshme, do të zgjatëshin 4 – 5 ditë maksimum. Për të arritur në këtë debat u desht të ndiqëshin procedurat 5 muaj. Çka fsheh kryetari i Kuvendit nga Kryesia, deputetë dhe qytetarë të Kosovës. Një pjesë e asaj që e fsheh kryetari ,doli në shesh nëpër media, një pjesë do të dalë sot në këtë seancë,kurse një pjesë do të zbulohet më vonë. Kërkesa e parë për kryetarin e Kuvendit isht: Kush dhe kur vendosi të ndërtohej Qendra administrativo – protokollare në Gërmi?. Nga materialet e mbledhura për këta 5 muaj doli se më 23 mars 2004 është vendosur të ndërtohet Qendra administrativo – protokollare në Gërmi dhe se do të kushtojë hiç më pak se 3 milion e 303 .665 euro. Më 17 mars ,vetëm një javë më parë, kryetari i Kuvendit kishte vendosur të rinovohej kabineti i tij që ka një sipërfaqe prej 450 metra katrorë . Renovimi i tij kushtoi hiç më pak se 800.000 €. 30.000 punëtorë të arsimit do të paguajnë tatim nga pagat e tyre 15 vjet ,që kryetari i Kuvendit të ketë një vend për të pirë kafe, pune me bashkëpunëtorët e tij, siç e tha një ditë. Edhe pse detyrë kryesore e Kuvendit në këta dy vjet ishin nxjerrja e ligjeve, kontrolli i punës së Qeverisë dhe përmbushja e standardeve,

kryetari i Kuvendit të Kosovës ka pasur disa prioritete të tjera. Vetëm brenda 9 muajsh ,d.m.th. prej gushtit 2003 deri në mars 2004, ka aranzhuar punë 6 milion e gjysmë euro, punë ndërtimore edhe atë renovimin e sallës, renovimin e zyrës së tij dhe ndërtimin e Qendrës administrativo – protokollare. Deputetët dhe opinioni publik duhet të njoftohen për shkeljen e ligjit dhe uzurpimet e kompetencave gjatë marrjes së vendimeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me funksionimin e Kuvendit. Jemi ndalur vetëm edhe në një rast eklatant-Ky është rasti i rindërtimit ose më mirë të themi i ndërtimit të Qendrës administrativo – protokollare në Gërmi.

Shkelja e parë që me vete bart edhe dhjetra shkelje të reja është se nuk ekziston vendimi i Kryesisë së Kuvendit për ndërtimin e Qendrës. Vendimi për ndërtimin e Qendrës është vendim privat i kryetarit të Kuvendit, është keqpërdorim i detyrës zyrtare, është keqpërdorim i buxhetit të këtij Kuvendi.

Vendimi i dytë, vendimi i sekretarit të Kuvendit i 24 marsit 200, është i paligjshëm dhe atë për shumë arsye:

1. Nuk i paraprin vendimi i Kryesisë së Kuvendit,
2. Sekretari i Kuvendit nuk ka autoritet të vendosë për menaxhimin e buxhetit dhe çka është më e rënda
3. Është dokument i falsifikuar.

Është i shkruar dhe i falsifikuar enkas për ta mbrojtur kryetarin e Kuvendit ,d.m.th. duhet të bëhet kurban sekretari i Kuvendit që përgjegjësia të mos mbërrijë te kryetari i Kuvendit. Nuk ekziston asnjë vendim i Qeverisë Rexhepi për ndarjen e mjeteve nga Qeveria, po të ekzistonte vendimi i tillë do të duhej të ishte pjesë e dokumentacionit të kërkuar edhe nëse Qeveria do të vendoste për ndërtimin e kësaj qendre, a thua duhet mjetet t'i ndahen kryetarit të Kuvendit dhe Kuvendi të bëjë ndërtime për Qeverinë.Ngastra ku ndërtohet Qendra, zotëri, është pronë e Këshillit Ekzekutiv, ose më mirë të themi e ish- Qeverisë së dikurshme. E tërë procedura, prej momentit të vendosjes për ndërtimin e Qendrës Administrativo – protokollare në Gërmi, shpalljes së tenderit, për projektin realizues, zgjedhjen e komisionit vlerësues, shpalljen e tenderit për ndërtim, komisionit vlerësues për kompanitë konkurruese e deri te caktimi i fituesit,sipas materialeve në dispozicion ,shihet se është i manipuluar.

Më 24 prill Sektori i Prokurimit i Kuvendit të Kosovës bën ftesë për ofertë publike për hartimin e dokumentacionit intensiv teknik të objektit ish -"Vila Gërmi". Dokumentacionin e kanë tërhequr 5 kompani, ofertat më 27 maj i kanë dorëzuar 3 ndërmarrje: **Rrëgava** dhe **Universiteti**, një firmë mikste ose më mirë të themi kentaur, nuk ka bërë tërheqjen e dokumentacionit edhe **Rrëgava** , fituese e këtij projekti ,është një firmë nga interneti sa kam marrë vesh, Radiolidhje dhe Taksi. Sipas ofertës së kompanisë, **Rrëgava** ofron kryerjen e shërbimit për 98 mijë e 500 euro. Nga dokumentet e marra nga njësia qendrore e prokurimit të datës 8 qershor figuron vlera për kryerjen e shërbimit 98 mijë e 500 euro. Kontrata përfundimtare me dorëshkrim, sipas dokumentacionit,për arsye për mua të dyshimta, është rritur në 144 mijë e 500 euro. Më 16 shtator 2004 sekretari jep pëlqimin për rindërtimin, e unë po them për ndërtimin e ri të objektit, Zyra e prokurimit fton hartuesit e kualifikuar për realizimin e projektit, kanë konkurruar 6 kompani. Me 25 nëntor fitues u shpall firma MEG-a me shumën e kontratës 3 milion e 303.655 euro. Sekretari në vendimin e 24 marsit 2004, 6 muaj më parë i kishte siguruar 3 milion 303.655, çfarë koincidence. Në Komisionin Vlerësues,



për vlerësimin e projektit ideor për rindërtim ose për ndërtimin të Qendrës administrative – turistike, kryetari i Komisionit është fitues i tenderit për ndërtim. Dy shërbyes janë të stafit të Kuvendit, ndërsa dy ekspertë janë të pavarur, në Komisionin Vlerësues për vlerësimin e kompanive ndërtimore, një anëtar i Komisionit është projektuesi kryesor i "Vilës Gjermia", d.m.th. puna ka shkuar sipas parimit: t'i mua, unë ty. Në raport me Ministrinë e Planifikimit Hapësinor në Kuvendin Komunal të Prishtinës dhe në Drejtorinë për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtimtari të kësaj komune, gjatë tërë kohës Kuvendi, ose më mirë të themi Sekretaria e Kuvendit, ndiqte politikën e aktit të kryer. Ne kemi vendosur e ju, zotëri, mund vetëm ta vulosni atë çka kemi vendosur ne dhe duhet t'i shkëlmi të gjitha ligjet se bajraktari kështu ka vendosur.

Kërkesa që i është dorëzuar Drejtorisë për Urbanizëm për të dhënë leje është e paligjshme, sepse kërkon të ndërtohet diçka në një pronë që ty nuk të takon. Drejtoria për Urbanizëm me mirësjellje i drejtohet Kuvendit dhe i thotë: Zotëri shumë mirë që po doni të ndërtoni, mirëpo e keni një gabim procedural, prona është e huaja dhe nuk mund të ndërtoni në pronë të huaj, d.m.th. ndërmerrni hapa dhe pronën që nuk është juaja bëjeni pronë tuajën. Kuvendi nuk ka marrë asnjë hap, se ka vendosur kryetari apo sekretari, ka hyrë në procedurë të tenderimit, është marrë tenderi për ndërtim, është ndërruar ngastra ku do të ndërtohet vila. Më 4 shkurt, pasi ishin kryer të gjitha procedurat, 6 muaj më vonë, Kuvendi Komunal u detyrua, në presion sigurisht, mori vendim për t'ia dhënë ngastrën Kuvendit të Kosovës.

Ministria e Planifikimit Hapësinor u gjend para aktit të kryer në momentin kur kanë nisur punët, i është kërkuar pëlqim për ndërtim, kurse pëlqimi për ndërtim është dashur të kërkohet një vit më parë.

Ne nuk jemi kundër që Kosova të mos ketë jo një qendër të tillë, por t'i ketë edhe disa qendra të tilla, mirëpo jemi kundër mënyrës së fshehtë, konspirative dhe me shkelje ligjore të marrjes së vendimeve, zotëri dhe caktimit të prioriteteve. Kjo mënyrë e punës së bajraktarit mbi ligjin, tregon se sa të brishta i kemi institucione, nuk respektohet ligji, por vullneti i bajraktarit. Funkcionimi i institucioneve demokratike dhe sundimi i ligjit janë shkelur pikërisht nga institucioni që duhet t' i mbrojtë dhe t' i respektojë. Si njeri dhe si qytetar i Kosovës, bashkëndjej me njerëzit që jetojnë në këtë vend, shtroj një pyetje të vetme: A ja vlente të bëheshin gjithë këto shkelje? Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Z. anëtar i Kryesisë, ju faleminderit për të gjitha vlerësimet personale, meqë janë përmendur emrat dhe njerëzit që kanë dokumentacionin e përshtatshëm, e ftoj sekretarin e përhershëm, z. Isuf Demaj, ta marrë fjalën.

#### SEKRETARI ISUF DEMAJ:

Të nderuar ministra, të nderuar deputetë.

Unë besoj se jam në Parlament dhe jo para prokurorit. Unë nuk e kam ndërmend të bëj debat, por me gjithë atë më takon ta lexoj informatën që ne e kemi si Sekretari, që

sigurisht do t'u ndihmojë të gjithëve dhe nuk është qëllimi im këtu ta akuzoj as ta ofendoj askënd.

Si u mor vendimi për ndërtimin e Qendrës Administrative-Protokollare të Kuvendit të Kosovës.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Nuk është e zakonshme që sekretari i Kuvendit me një fjalë si kjo t'i drejtohet seancës plenare, apo thënë më mirë, nuk është e zakonshme që sekretari i Kuvendit, si institucion dhe udhëheqës i gjithë administratës së Kuvendit t'i drejtohet Kuvendit në seancë publike. Zakonisht çështjet, për të cilat jam kompetent dhe përgjegjës t'i shpjegoj, do të ishin për seancë të mbyllur për publikun, me pyetje dhe përgjigje dhe me prezantim të gjithë dokumentacionit të nevojshëm që e kemi, pasi mund të thuhet gjëra që janë interne dhe që kanë të bëjnë me natyrën e punës, me ruajtjen e sekretit, edhe të atij profesional edhe të teknikës së vendimarrjes, por edhe të çështjeve të natyrës së ruajtjes së sekretit dhe të autoritetit të institucionit, dhe të bartësve të funksioneve më të larta shtetërore të Kosovës. Por, pasi tashmë kërkesa e një subjekti politik dhe njëkohësisht edhe e Grupit Parlamentar të Kuvendit, është futur në procedurë të rregullt dhe është kërkuar seancë publike, mandej pasi dokumentacioni u është shpërndarë të gjithë deputetëve, dhe pasi një pjesë e këtij dokumentacioni tashmë është publikuar në një gazetë të përditshme të Kosovës, me komentet që sipas mendimit tim nuk qëndrojnë dhe nuk janë profesionale, por janë vënë në kuadër të një qëllimi politik, madje edhe të akuzave publike kundër meje si sekretar i Kuvendit, e shoh shumë korrekte dhe të arsyeshme proceduralisht që të përgjigjem në këtë foltore të Kuvendit.

Për këtë është edhe një arsye domethënëse. Subjekti politik "ORA" e ka marrë dokumentacionin zyrtarisht nga Administrata e Kuvendit, me lejen dhe me dijeninë time, sepse është e drejtë e tyre dhe nuk kemi asnjë arsye të fshehim asgjë, sepse dokumentacioni gjithmonë është në disa kopje dhe ndodhet në disa instanca e jo vetëm në Kuvend. Gjithashtu në dokumentin që e keni ju përpara, konsideroj se janë bërë disa lëshime, sepse është dhënë një pozicion i përkohshëm dhe i pambyllur, siç janë akontacioni dhe mëditjet, pa u theksuar se për kë janë ato akontacione e mëditje, për cilin udhëtim dhe për cilën periudhë kohore. Pra, dokumentacioni që ju e keni nuk është pozicion përfundimtar dhe si i tillë është i pavlefshëm për çdo komentim që dëshironi ta bëni pa i pasur pozicionet e mbyllura sipas kritereve që i përmenda. Ky dokumentacion ekziston dhe është në dispozicion të secilit prej jush, sepse, e dini, se me ligj secili pozicion financiar duhet të përmbillet dhe të arsyetohet. Ju të gjithë e dini, sepse e keni provuar vetë, se mëditjet janë unike në gjithë Kosovën, se është një vendim që është marrë në Kryesi, në bazë të të cilit edhe veprohet, se është e përcaktuar sa është shuma e mëditjes për Kosovë, që është 25 euro për person, se po ashtu ka kriter se sa orë duhet të qëndrosh jashtë Prishtinës për të fituar të drejtën e mëditjes. Gjithashtu dihet sa është mëditja jashtë Kosovës, sa është shuma me hotel të paguar nga nikoqiri dhe sa është pa fjetjen e paguar. Po i shpjegoj këto çështje, sepse në media është ngritur një fushatë dhe është bërë një mistifikim i qëllimshëm, sikur dikush ka marrë madje 500 euro mëditje në ditë, që nuk është e vërtetë. Gjithashtu nuk është e vërtetë se ndonjëherë kryetari Daci, pa dashur që ta mbrojë atë, sepse secili e mbron vetveten, apo stafi i tij politik nuk ka marrë as edhe një mëditje të vetme për qëndrim brenda Kosovës, gjatë katër vjetëve prej se jam sekretar i Kuvendit. Kjo shihet nga dokumentacioni dhe me përgjegjësi të plotë

morale e ligjore e theksoj se askush nuk mund ta dëshmojë të kundërtën. Këtu në procedurë janë bërë disa lëshime sa i përket respektimit të Ligjit për menaxhimin e financave dhe të Ligjit për qasje në dokumente zyrtare, që u është shpërndarë ky dokumentacion dhe që është botuar edhe në gazeta. Lëshimi ndodhi, sepse ende nuk i kemi nxjerrë Udhëzimet administrative se cilat dokumente dhe në cilën formë janë në dispozicion për publikun, cilat dokumente janë për përdorim intern, cilat dokumente lejohen vetëm të shihen, por jo edhe të kopjohen dhe cilat dokumente dhe me ç'shikallë sekreti zyr tar janë .Në këto punë, për dallim nga shtetet e tjera, nuk e kemi ndonjë përvojë për ruajtjen e sekretit profesional, të sekretit të punës dhe të sekretit zyrtar e shtetëror.

Të nderuar deputetë

Më lejon që në vijim t'i shpjegoj procedurat e vendimmarrjes dhe të ndërtimit të Qendrës Administrative Protokollare të Kosovës në Gërmi të Prishtinës.

Sipas shënimeve , por edhe sipas dëshmimeve të tjera, janë deklaratat e anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit, por edhe të anëtarëve të tjerë të stafit të Kuvendit të Kosovës që ishin të pranishëm, vendimi parimor për rindërtimin, përkatësisht ndërtimin e Qendrës Protokollare Administrative të Kuvendit të Kosovës në Gërmi, është marrë në Mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës të datës 6 maj të vitit 2003. Në atë mbledhje u mor vendim për renovimin e sallës së mbledhjeve plenare të Kuvendit të Kosovës, është dhënë arsyetimi i sigurimit të mjeteve financiare nga burimet vetjake dhe nga donacionet ndërkombëtare. Në atë mbledhje u diskutua edhe për objektet e tjera të institucioneve të Kosovës që duhet të shfrytëzohen. U përmend edhe objekti në Blinajë të Lipjanit, që tash është në shfrytëzim të TMK-së. Kryetari Daci ka thënë se është në procedurë dhe po bëhen përgatitjet për vizitë në këtë objekt. U tha se duhet të nisim procedurat për rindërtimin e objektit në Gërmi ,duke u theksuar se duhet të shihet gjendja e përgjithshme dhe të zhvillohen të gjitha procedurat ligjore edhe me komunën e Prishtinës të fillojë rindërtimi. Përkatësisht ndërtimi i Qendrës Protokollare Administrative të Kuvendit të Kosovës ,pasi objekti i vjetër ishte shkatërruar plotësisht në bombardimet e NATO-s, sepse ishte shfrytëzuar si objekt nga ushtria dhe paramilitarët serbë.

Në këtë mbledhje u zhvillua debat për të gjitha këto çështje. Atëherë kishim koalicion të gjerë e gjithëpërfshirës dhe nuk u kërkua të votohej, por pati pajtim unanim. Gjithashtu u theksua të shihen mundësitë financiare, të gjenden burimet, pastaj të fillojë ndërtimi i Qendrës Protokollare Administrative, për të cilën ndihet nevojë e madhe dhe që do të shfrytëzohet nga të gjitha institucionet shtetërore të Kosovës.

Të nderuar deputetë

Në atë kohë sekretari i Kuvendit ishte ushtrues i detyrës së sekretarit të Kuvendit, ishte edhe një ndërkombëtar Frank Bullen dhe në at kohë ne nuk i bënim incizimet e mbledhjeve dhe as transkriptet. Incizimet dhe transkriptet nisëm t'i bënim prej datës 3 qershor të vitit 2003. Deri atëherë i bënim procesverbalet që i bënte personi i autorizuar sipas shënimeve që i mbante vetë në mbledhje. Këto procesverbale, në formë të shkruar, u shpërndaheshin anëtarëve të Kryesisë,që ose pajtoheshin me korrektësinë e prezantimit në formë të shkurtër të rrjedhave të mbledhjes, ose i bënin vërejtjet dhe përmirësimet që pastaj futeshin në procesverbalet që miratoheshin nga Kryesia. Kjo ishte atëherë përvoja dhe kapacitetet e punës sonë si administratë e Kuvendit, por edhe si Kryesi. Pohimin se

vendimi për rikonstruktimin e Qendrës Protokollare Administrative në "Gërmi" e kemi marrë pikërisht atë ditë e konfirmoj vetë me pjesëmarrjen time në atë mbledhje dhe me dëshmitë që i kam mbledhur prej anëtarëve të Kryesisë dhe prej stafit që atë ditë ishte prezent në mbledhje.

Është shumë logjike se unë si sekretar nuk kam mundur ta marr vetëm iniciativën dhe të bëj kërkesa buxhetore nga Qeveria e Kosovës për këtë destinim, e këtë nuk ka mundur ta bëjë as kryetari i Kuvendit të Kosovës e as unë me urdhër të tij, sepse kjo Qendër është një pasuri e Kosovës jo një ndërtim privat, se do të jetë në shfrytëzim për institucionet e Kosovës e jo për persona privatë, çfarë do të jem edhe unë në të ardhmen sepse si e dini është shpallur konkursi për sekretarin e ri të Kuvendit.

Si thotë populli, xhamia nuk mund të futet në xhep dhe për ndërtimin e një objekti të tillë në parkun "Gërmi" nuk ka pasur asnjë motiv tjetër, për çka akuzon pa të drejtë ORA, përveç interesit shoqëror e publik, për për këtë çështje ishte një marrëveshje edhe ndër institucionale ndërmjet organeve më të larta të Kosovës. Kjo edhe është arsyeja e vetme për të cilën shpenzimet për ngritjen e Qendrës Protokollare Administrative të Kosovës, pra jo të Kuvendit, kanë hyrë në Buxhetin e Kosovës, tash e tre vjet me radhë dhe që janë miratuar nga deputetët e këtij Kuvendi.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës

Kosova sot ende nuk e ka një objekt adekuat ku do t'i vendoste delegacionet e huaja që e vizitojnë Kosovën, nuk kemi ambient të qetë dhe të sigurt, nuk kemi restorant për ushqim, salla të takimeve dhe ambiente të tjera të punës, sikurse i kanë të gjitha shtetet e tjera edhe ato përreth nesh në fqinjësi, Të përmendim se Maqedonia i ka më se dhjetë objekte të tilla si në Shkup, Tetovë, Dibër, Strugë Ohër etj. Ne si institucione të Kosovës edhe tash jemi në hall të madh ku të sigurojmë fjetjen, ushqimin, akomodimin dhe takimet e nivelit të veçantë, sepse nuk e kemi objektin adekuat tonin që i plotëson të gjitha kushtet e një vizite zyrtare protokollare, ndërsa qëndrimi dhe organizimi në hotelet e ndryshme nuk është i përshtatshëm për shkak të kushteve ekzistuese për shkak të kushteve të sigurisë dhe për shkak se në këto hotele nuk mund të bllokojmë tërësisht punën dhe hyjnë klientë të ndryshëm e të gjitha profileve, me çka rrezikohen jeta dhe misioni i vizitorit dhe vihet në dyshim autoriteti shtetëror i Kosovës dhe i institucioneve të saj.

Të nderuar deputetë

Pas konsultimeve të bëra me Presidencën e Kosovës me Qeverinë e Kosovës me Komunën e Prishtinës, pas veprimeve të Komisionit të Kuvendit për Buxhet dhe Financa dhe të Ministrisë përkatëse të Kosovës, në buxhetin për vitin 2004 është futur dhe nga Seanca plenare është miratuar Buxheti i Kosovës, ku janë paraparë mjetet për Qendrën Protokollare Administrative në Gërmi dhe shuma përkatëse është miratuar edhe në buxhetin për këtë vit, pra për vitin 2006, sepse shuma totale e ndërtimit të objektit ishte shpërndarë në buxhetin e tre vjetve.

Pas kryerjes së këtyre procedurave unë si Sekretar i përhershëm i Kuvendit të Kosovës në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë të mia me një vendim të datës 24 mars 2004, (ju e dini se at vit buxheti është miratuar tek në mars) nisa të gjitha procedurat e nevojshme dhe obligative për nismën e objektit të Qendrës Protokollare Administrative në Gërmi.

Të gjithë dokumentacionin e keni, këtu është fjala se u keqpërdor vendimi i sekretarit . Vendimi i sekretarit është vendim për iniciimin e procedurës, jo vendim politik për ndërtimin e objektit dhe nga ai e shihni, se janë bërë edhe publikimet në mjetet e informimit, se është bërë me tender edhe projekti ideor, më vonë edhe projekti i ndërtimit, se me tender nga shumë konkurreues është zgjedhur nga një komision i pavarur ekspertësh jashtë Kuvendit , firma ndërtuese e objektit në Gërmia.

Pasi nuk jam ekspert i kësaj lëmie nuk do të hy në faktin se pse është zgjedhur pikërisht ky projekt ideor dhe pikërisht kjo kompani ndërtimi sepse edhe nuk është kjo në mandatin tim, por të atyre që janë profesionistë , por po theksoj se ne e kemi edhe Organin mbikëqyrës dhe ka një sërë mekanizmash edhe nga Inspektorati ndërtimor edhe nga Ministria e Ambientit që në cilëndo fazë të intervenohet dhe të korrigjohet projekti konform rregullativës dhe standardeve ligjore.

Po theksoj se pas disa muaj shqyrtimi me komunën e Prishtinës me propozim të organeve përkatëse të tyre jemi marrë vesh që objekti i ri të ndërtohet në një lokacion tjetër nga ai i vjetri, sepse e dini se në kohën e ndërtimit të objektit të vjetër ka pasur të tjera norma ndërtimi, ai objekt ka qenë fare pranë rrugës dhe në atë kohë me rastin e vizitave të rëndësishme së veçantë është bllokuar gjithë zona. Duke respektuar normat e reja të ndërtimit dhe të ruajtjes së ambientit u vendos që objekti i ri të ndërtohet disa dhjetëra metra larg të vjetrit në anën tjetër të rrugës, ku ka hapësirë pak më të gjerë dhe ku mundësohet respektimi i obligimit ligjor që objekti të jetë 25 metra larg rrugës dhe ku në rast të vizitave të rëndësishme ndërkombëtare nuk ka nevojë të bëhet asnjë bllokim e kontroll i veçantë e as të pengohet me asgjë lëvizja e lirë e qytetarëve, e shetitorëve, duke marrë parasysh faktin se përfundi QAP Gërmia 60 -70 metra më poshtë janë dy objekte të tjera hoteliere, njeri privat e tjetri shoqëror, pra objekti "Lira " dhe Villa "Gërmia".

Të nderuar deputetë

Unë si sekretar i Kuvendit të Kosovës me përgjegjësi të plotë morale e ligjore konsideroj se nuk është shkelur asnjë procedurë dhe asnjë normë ligjore në gjithë procesin prej marrjes së vendimit përmes tenderimit deri në ndërtimin e këtij objekti të një rëndësie të veçantë për institucionet e Kosovës, nuk është bërë prishje e ambientit, por inkorporim maksimal në rrethinën e parkut të Prishtinës "Gërmia", nuk është bërë asnjë precedent, sepse objekti ka qenë aty më herët dhe edhe tash ka së paku tri objekte hoteliere në këtë hapësirë dhe se nuk dëmtohen as ambienti as qetësia e siguria e qytetarëve.

Një sqarim. U përmend këtu se Kuvendi i Kosovës ka keqpërdorur, d.m.th pronën e dikujt tjetër - të Këshillit Ekzekutiv. Për ata që e dinë dhe për ata që s "e dinë unë do të sqaroj se Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Kosovës, faktikisht vetë emri Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Kosovës, tregon se ka qenë organ ekzekutiv i Kuvendit të Kosovës dhe të gjitha shërbimet apo më shkurt ka qenë organ ekzekutiv i Kuvendit të Kosovës, ku çdo gjë ka qenë e përbashkët dhe është shfrytëzuar në mënyrë të përbashkët nuk ka pasur ndarje të pronës të Këshillit Ekzekutiv apo të Kuvendit të Kosovës. Së këndejmi kështu që ai është një manipulim me qenë se unë pak a shumë kam punuar që kam pasur rast me ditë edhe këtë dhe besoj se një pjesë e madhe e juaja e din.

Jam i gatshëm për çdo përgjigje shtesë, për shpjegime dhe qartësime dhe për prezantim të cilitdo dokument në cilëndo fazë të punës.

Ju faleminderit.

## KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Sekretar ju faleminderit.  
Replikë, Gazmend Muhaxheri, urdhëroni

## DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI:

Po shihet se kryetari i Kuvendit ka pasur nevojë për mbrojtje 40 minutëshe për veprimet e tij nga sekretari i Kuvendit. A thua për keqpërdorimet buxhetore sa kohë do t'i duhet drejtorit të buxhetit që ta mbrojë kryetarin e Kuvendit, a thua që do të na i bie të flasin në seancë edhe vozitësit e tij edhe punëtorët e stafit tjetër. Kryetarit të Kuvendit dhe Kryesisë së Kuvendit më 14 gusht u është kërkuar vendimi për ndërtimin e Qendrës kush e ka marrë dhe kush ka vendosur? Vendimi i dorëzuar në Kryesi a është i sekretarit? Tash ka ndodhur- para këtij debati e shpikën një vendim që e paskan marrë diku në një farë darke e po duket që atje nuk kanë pasur letër për ta shtypur atë vendim dhe ta nënshkruanin, d.m.th në këso rrethanash të vështira paska qenë Kuvendi i Kosovës sa nuk ka pasur as letër për ta shtypur një vendim për ndërtimin e një qendre. Le të shikojnë në sirtarët e Kuvendit të Kosovës mos ka lënë Vukashin Jakanoviqi farë projekti për ta ndërtuar Kuvendin e Kosovës.

## KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Regjia kur të ketë replikë, koha e përcaktuar për replikë le të respektohet, ju faleminderit për çdo fjalor, sepse tregon nivelin që e keni, hapim debatin e deputetëve. Për debat është paraqitur Fadil Geci, Lidhja Demokratike e Kosovës, urdhëroni.

## DEPUTETI FADIL GECI:

I nderuari kryetar, të nderuar ministra, të nderuar deputetë.  
Unë sot, në këtë fjalën time, do ta shpjegoj një pjesë të motiveve dhe të prapaskenave të kësaj iniciative të mbështetur me një fushatë të paparë mediale që po ndërmer Ora dhe lideri i saj. Në këtë çështje kaq të thjeshtë që kudo në botë është punë e verifikimit të rregullt të komisioneve parlamentare dhe të shërbimeve të Kuvendit të Kosovës, sepse dokumentacioni është shumë konkret, gjithmonë i nënshkruar nga disa përgjegjës dhe me një kopje edhe në thesarin e Kosovës me një transparencë të plotë edhe në UNMIK edhe në ministrinë përkatëse të Kosovës edhe në institucionet e tjera të kontrollit financiar. Këtë që sot po e bën Partia reformiste Ora, se kështu tash e ka edhe emrin, Partia Reformatore e Kosovës Ora, si duhet ta kishte këtë emër të vërtetë po të kuptonte se çka do në politikë dhe po ta kishte të sinqertë angazhimin e saj, nuk do të kishte urrejtje patologjike ndaj kryetarit të Kuvendit të Kosovës Nexhat Dacit. Kjo urrejtje nuk mbeti pa u përmendur as në mbledhjen e parë të këtij kuvendi, kur lideri i saj Surroi doli në foltore dhe mbajti fjalimin kundër akademik Dacit edhe pse ai nuk ishte pjesë e koalicionit dhe votat e tij nuk ishin të rëndësishme për këtë zgjedhje. Por nuk votoi- që dihet- për presidentin e Kosovës, kur dukej se këto vota të tij do të kishin ndonjë peshë, ndërsa sot si një kameleon ka marrë poza të ndryshme karshi presidentit Rugova, ku në çdo dokumentacion mund të shihen qëndrimet e tij destruktive ndaj institucionit të presidentit

të Kosovës. Për t'u bindur për këtë mjafton ta kesh një kompjuter dhe të hulumtosh në internet nën sigojmën Surroi. Me akuzat dhe me shpifjet e tij mund të dalë një përmbledhje libri, pa numëruar këtu gazetën e tij të ngritur me donacione dhe me ndihmat e huaja, kinse në emër të zhvillimit të shoqërisë civile e të demokracisë në Kosovë, por edhe të parave të qytetarëve të Kosovës. Koha pas katapultimit të Vetonit në politikë për ta kryer misionin e tij të caktuar ,udhëhiqet nga motra ,si të ishte kjo një kompani familjare edhe pse e motra më parë mund të kishte kompani mediale nuk punonte në këtë kompani, por edhe ajo udhëhoqi shoqata të ndryshme që mbledhin paratë dhe ndihmat ndërkombëtare.

Kjo që po e them sot flet për motivet e vërteta të kësaj fushate, që ndërmorën Ora dhe partia e tij që ka për qëllim bllokimin e zgjidhjes së çështjes së Kosovës sipas vullnetit politik të popullit,duke synuar zgjidhjen sipas vullnetit të Vetonit e dihet.... Populli i Kosovës e di mirë se kur terrori dhe dhuna serbe ishte shtuar, Surroi organizoi protestën kundër dhunës me lojën e varrosjes së tabutit, që ishte një maskara e turpshme, ashtu si edhe kërcitja e çelësave, e tepsive dhe e kusive ,sepse ne shqiptarët nuk bënim shumë dhe nuk kishim si ta varrosnim të keqen që nuk vinte nga ne, por nga pushteti i Millosheviqit. Kjo ishte edhe arsyeja pse LDK-ja nuk mori pjesë në këtë manifestim. Duke dalë me komunikatë kundër dhe duke deklaruar se kjo kishte për qëllim legjitimimin e regjimit serb që kinse si demokratik, ja që po i lejuaka protestat paqësore. Gjithashtu e mbani mend deklarin dhe angazhimin e Veton Surroit që shqiptarët të dilnin dhe të mermin pjesë në zgjedhjet presidenciale të Serbisë, sepse shqiptarët u faktorizuan dhe ndihmojnë proceset demokratike në Kosovë. Kjo thirrje u bë pikërisht në kohën kur në Kosovë ishin krijuar partitë politike dhe kur po krijoheshin institucionet vetiake të Kosovës që vetëfinancoheshin nga populli dhe që e legjitimuan me sukses veprimtarinë në botë që të njihej si politikë aktive paqësore, krijues i së cilës ishte dr. Ibrahim Rugova,që së bashku me luftën e forcave të armatosura solli luftën e NATO-s dhe çlirimin e Kosovës.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Ju e dini edhe këtë se në kohën kur kishte filluar shkatërrimi i Jugosllavisë ,që ishte bërë një shtet antishqiptar dhe kur në Kosovë kishin ardhur policë dhe forca të shtuara ushtarake nga të gjitha republikat e atëhershme të Jugosllavisë, për ta shtypur revoltën e popullit në Kosovë, Veton Surroi krijoi Ujdin, një subjekt politik që kishte për qëllim ta ruante Jugosllavinë tash kinse në formë demokratike, kurse në fakt për të krijuar parti nacionale edhe në republikat e tjera, por sidomos në Kosovë. Ky ishte roli i Ujdit që kishte marrë nga sigurimet e ndryshme sekrete dhe shihni tani, shumicën e ujdistëve, ku kanë përfunduar. Kjo ishte arsyeja pse kur këta këtu, në Kosovë, deshën t'ia bënin lojën, dr. Ibrahim Rugova publikisht refuzoi të anëtarësohej në Ujd, por 2-3 javë më vonë e krijoi Lidhjen Demokratike të Kosovës, në të cilën u anëtarësuan atdhetarë dhe intelektualë të Kosovës dhe për 2-3 muaj arriti në shifrën 700.000 anëtarë, duke u bërë lëvizja më gjithë popullore që ndonjëherë është shënuar në historinë shqiptare.

Vetoni është i njohur edhe për Forumin Rinor, madje edhe për partinë parlamentare; që e nisi me qëllim manipulimi të vullnetit të rinisë dhe të studentëve kosovarë,që më vonë për t'ua kthyer shpinën dhe të kalonte në biznes. Kjo shumë fytyrësi e bën atë që sot, në cilësinë e kryesuesit të një ekipi negociator të Kosovës, në biseda me serbët, të deklarohet që synon ndërtimin e një shteti qytetar, ndërsa në biseda me shqiptarët e Luginës së Preshevës të deklarohet se ai personalisht do të jetë avokat i interesave të tyre, sigurisht

me qëllimin djallëzor se nuk janë vlerësuar kërkesat reale për pozitën e keqe të tyre në Serbi. Madje deklaroi se Kosova do të jetë shtet amë i shqiptarëve të Preshevës, tash duke bërë kapërcimin e duke dalë me konceptin se Kosova është shtet i dytë i shqiptarëve në Ballkan, a thua se tash pritet që shqiptarëve në Maqedoni, sipas kësaj logjike të mbrapshtë, t'u thuhet se Kosova është nëna, ndërsa Shqipëria babai i tyre. Kjo lojë e Vetonit, që e ka për qëllim që me një paternalizëm të sëmurë t'i defaktorizojë shqiptarët aty ku janë, duke zhvilluar me sukses subjektin e vet politik. Dhe në fund t'ju them se pikërisht Vetoni, që në numrin e para dy ditëve të "Danasit" të Beogradit boton intervistën me titull: **Shqiptarët nuk mund ta kenë monopolin mbi shtetin e Kosovës**, duke i shkuar për shtati tezës së presidentit Tadiq. Konceptin me dy etnitate të Kosovës ky Surroi që sot e ka përkrahjen e disa qarqeve ndërkombëtare kinse demokrat, dua t'ia kujtoj që ka qëllimin e një karrieristi. Në vitin 1991 e bëri marrëveshjen me autoritetet kroate për hapjen e të ashtuquajturit front të dytë të luftës në Kosovë. Presidenti Rugova, në atë kohë dërgoi profesorin Fehmi Agani, sigurisht u kujtohet kolegëve dhe atij vetë, ta prishte atë marrëveshje, duke ruajtur kështu substancën biologjike të popullit shqiptar të Kosovës, sepse në atë kohë bota nuk i njihte egërsinë dhe fashizmin serb që nisi ta njihte pas masakrës së Srebrenicës dhe Kosova në atë kohë ishte në fillimet e organizimit të saj politik dhe institucional, që ende nuk i kishte fituar simpatinë dhe përkrahjen ndërkombëtare për kërkesat e drejta, për shtet sovran dhe të pavarur. Lufta në atë kohë do ta masakronte popullin tonë dhe do ta dëbonte popullsinë shqiptare nga Kosova, si e pat parashikuar me të drejtë presidenti Rugova dhe deklaratat e dhëna publikisht. Ju falënderoj që më dëgjuat për t'i paraqitur prapaskenat dhe motivin e vërtetë të liderit të Orës. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Fjalën e ka z. Ylber Hysa, kurse le të përgatitet Sabit Rrahmani

#### DEPUTETI YLBER HYSA:

Unë do ta marr fjalën më vonë z. Daci.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem as më vonë as më herët, në qoftë se do shefja e Grupit, Teuta Sahatçija, në qoftë se jo, ua japim fjalën të tjerëve. Teuta, urdhëroni.

#### DEPUTETJA TEUTA SAHATÇIJA:

Pikërisht tash ishim dëshmitarë që përsëri këtu në Kuvendin tonë shkelet Rregullorja. Edhe në foltoren e Kuvendit mund të vijë kush ka dëshirë, mund të flasim për çfarëdo temash, edhe pse dikush nuk është deputet, mund të vijë 40 minuta të flasë. Kjo ndoshta pikërisht është arsyeja pse kemi ardhur në këtë gjendje, ka qenë nevoja të vijmë dhe t'i diskutojmë këto shkelje të rregullave dhe të procedurave.

Në dokumentacionin që jua kemi dorëzuar, si material për diskutim dhe që është mbledhur për një kohë të gjatë ka shumë vende në të cilat shihen parregullsitë dhe



mosrespektimi i ligjit. Unë do të përqendrohem vetëm në njërin nga dokumentet e shumta, në vendimin e ndërtimit të Qendrës Protokollare-Administrative Gërmia. Nga shkresa dhe vendimi për ndërtimin e saj, të datës 24 mars 2004 të Kuvendit të Kosovës, i nënshkruar nga sekretari i Kuvendit Isuf Demaj, mund të konkludohet se z. Demaj është parashikuesi më i zoti i trevave tona. Në paragrafin e tretë të këtij vendimi, që me siguri secili e keni para vetes, pasi ju është dorëzuar i nënshkruar më 24 mars 2004, z. Demaj parashikon se vlera e kësaj qendre protokollare – turistike – administrative hoteliere, do të jetë saktësisht aq sa do të jetë vlera që do të dalë pas shpalljes së tenderit, që le të kuptohet pas 8 muajsh, më 16 nëntor 2004. Gabimi me parashikimin është 75 cent, pra sekretari ynë e ka parashikuar vlerën 8 muaj para se ajo të jetë publike, aftësi e rrallë. Në të njëjtin vend thuhet se Qeveria e atëhershme i ka siguruar mjetet edhe pse nuk parashtrohet kurrfarë dokumenti, në bazë të cilit është kryer ky sigurim i mjeteve. Ishim dëshmitarë që aty paska pasur marrëveshje, që janë marrë vesh, po asgjë në letër nuk ka mbetur edhe pse ka pasur mjaft kohë, apo ndoshta bartja e më se 3 milion eurove nga Qeveria në Kuvend, është një gjë e zakonshme që nuk ka nevojë për dokumente me shkrim.

Vazhdon aftësia fenomenale e parashikimit. Në paragrafin e tretë, në rreshtin e tretë, ku ai shpjegon prejardhjen e mjeteve të mbetura, 1 milion 415.000 eurove që mbetën pa u shpenzuar nga viti 2003 të barten në 2004, dokumenti është i 2004-shit, si dhe pse vendimi u nënshkrua në mars 2004, parasheh dhe flet për kohën e kaluar e jo që të ishte pritur në të ardhmen, se ato mjete që nuk janë shpenzuar me 2004 do të barten në 2005. Thuhet që mjetet e 2003-shit barten në 2004 dhe në 2005. Dokumenti është i 2004-shit. Pra 10 apo 11 muaj para se të ndodhte ngjarja parashihet se mjetet nuk do të shpenzohen. Hallall ju qoftë. Në 6 rreshtat e këtij paragrafi janë tri gabime, që nuk përputhen kurrsesi njëri me tjetrin, nëse është fjala për aftësi parashikimi, do të duhej ta angazhonim z. Demaj, pasi edhe ashtu kontrata i ka kaluar në ndonjë vend të ri të punës si parashikues zyrtar i Kuvendit, ose ndoshta nuk bëhet fjalë për parashikime astrologjike të së ardhmes, por për gjëra shumë konkrete. Fitohet përshtypja se ky vendim famoz është një fallsifikat i bërë në vitin 2005 e jo në 2004, duke pasur parasysh se ai as nuk është protokolluar, prandaj përdoret koha e shkuar e jo koha e ardhme, pastaj vlerat që të habisin për saktësi. Fitohet përshtypja se ky dokument në fakt që as ka ekzistuar ndonjëherë, është krijuar ad-hoc, pikërisht atëherë kur u problematizua ndërtimi i qendrës nga shoqëria civile, më saktësisht nga koalicioni Gërmia, kinse një dokument në të cilin mungojnë logjika dhe intelekti i shëndoshë në akordimin e fakteve. Gjithashtu fitohet përshtypja se sekretari ynë është person me autorizime ekstra të fuqishme më të fuqishme se të gjithë deputetët e Kuvendit, por edhe nga Kryesia, pasi ai vendos për zhvendosjen e mjeteve nga Qeveria në Kuvend, vendos për shpenzimin e shumëve milionëshe për ndërtim pa e pyetur asken as kryetarin, as Kryesinë e Kuvendit e cila sipas Rregullores së vjetër dhe sipas të resë. Do të duhej të ishte ajo pikërisht Kryesia që vendos, për ndërtim, që ndërtesa të ngritet para se të merren lejet e nevojshme. Pra, vendos të merret ngastra nga një kompani shoqërore me këtë nën kompetencën e AKM-së dhe të bartet nga komuna në pronësi të Kuvendit të Kosovës, vendos që shuma e lexuar në tender prej 98.000 eurove, kur u hap tenderit të shndërrohet në 144.000 mijë, krijohet përshtypja e rreme se Kuvendi është i sekretarit, mirëpo nuk mund të paramendohet se sekretari i Kuvendit nuk ka qenë i njoftuar për çdo detal në çdo moment edhe pse nuk ka nënshkruar asnjë dokument me dorën e vet, përveç Rregullores së punës së Kuvendit, në fakt rregullorja, pikërisht

regulla 6.6 thotë: Kryesia e Kuvendit emëron sekretarin e Kuvendit dhe ai i përgjigjet drejtpërsëdrejti Kryesisë. Sekretari i Kuvendit kryen detyrat në bashkërendim të ngushtë me kryetarin e Kuvendit. Pra pozita e kryetarit të Kuvendit kërkon që ai të jetë i njoftuar dhe të jetë përgjegjës për punët që bëhen në emër të Kuvendit, prandaj nuk vlen arsyetimi eventual për mosinformim etj.

Fatkeqësisht kjo është vetëm maja e Ajzbergut, vetëm njëri prej rasteve të zbuluara, që të tregojnë një praktikë të sëmurë, një praktikë shumë të përdorur të keqpërdorimit të mjeteve publike, të konsiderimit të parave të mbledhura nga taksat e popullit mall shteti, i keqpërdorimit të pozitës së besuar nga populli, mosrespektimit të popullit dhe më në fund keqpërdorimi i emrit të këtij populli. Kjo praktikë që ka lëshuar rrënjë të thella ka shkaktuar krizë të moralit, përmbysjen e vlerave të mirëfillta dhe dëshpërim të thellë në popull ndaj njerëzve që e udhëheqin dhe që do të duhej një herë e përgjithmonë të ndërpritej.

Kosova kalon nëpër një kohë të vështirë, të krijimit të komizës ligjore dhe deputetët janë shumë të ngarkuar me punë nëpër komisione. Ata punojnë në kushte të vështira. Po në këtë parlament, ku shpenzohet paratë pa marifet e pa prioritet, ata nuk e kanë një kompjuter ku mund t'i shtypin fjalimet e veta, ku mund ta kontrollojnë postën elektronike, nuk kanë ekspertë ligjorë të mjaftueshëm që do të ndihmonin hartimin e ligjeve sa më të mira për qytetarë dhe janë të detyruar të bartin shumë kilogramë dokumentacion sa herë që të vijnë me autobus nga qytetet e tyre për në Prishtinë, sepse nuk kanë zyre. Në të njëjtën kohë, kur për deputet nuk sigurohen zyra edhe eksperë ligjorë, sigurohen kushtet e luksit ekstrem për mysafirë.

Unë njoh shumë deputetë të ndershëm, më ka ndodhur që në një udhëtim jashtë ta shoh deputetin që e kishte ndërprerë telefonin me roming për të mos krijuar shpenzime të buxhetit, që sillej ndaj parave të buxhetit me shumë përgjegjësi. Kjo më jep shpresë se ka njerëz të ndershëm nëpër institucione, se ka ende vlera të shëndosha morale të ne dhe për ata deputetë, pa marrë parasysh përkatësinë partiake është fyerje morale, njerëzore, intelektuale të identifikohen me këto punë të mbrapshta, që në emër të Kuvendit, në emër të atyre deputetëve, në emër timin kryhen në mënyrë të pandershme. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDJIT NEXHAT DACI:

Fjalën e ka Sabit Rrahmani, le të përgatitet Jakup Krasniqi në emër të PDK-së ose Xhaviti si anëtar i Kryesisë si anëtar i Kryesisë.

#### DEPUTETI SABIT RRAHMANI:

Ju faleminderit z. kryetar, fillimisht ju bëj me dije se nuk flas në emër të Grupit Parlamentar për integrim. Kam menduar se në fillim seanca do të ketë propozime nga deputet ose nga grupet parlamentare, nuk po e shoh kohën që do të flas lidhur me këtë me pikën e rendit të ditës, nuk kam të shtoj asgjë, por pasi është koha shumë e shkurtër për një manifestim që ne e kemi organizuar, nëse ju ma jepni fjalën ta bëj këtë propozim mëqë është mbështetur edhe nga grupet parlamentare dhe e kanë nënshkruar të gjitha

grupet parlamentare, atëherë do ta jap propozimin, e nëse jo do ta lë në fund të seancës nëse ka mundësi.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Nëse është për pikën e rendit të ditës,

#### DEPUTETI SABIT RRAHMANI:

Jo për pikën e rendit të ditës, por ju kisha lutur z. kryetar që në fund të seancës të ma jepni fjalën, sepse është shumë e nevojshme. Ju faleminderit.

#### KRYETRI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Në takord, fjalën e ka Jakup Krasniqi, Partia Demokratike e Kosovës

#### DEPUTETI JAKUP KRASNIQI:

Z. kryetar, të nderuar deputetj, Derisa fliste sekretari i Kuvendit, nuk e pamë të arsyeshme të jemi në Kuvend se rregulla do ta donte që ky Kuvend të vendoste t'i jepej ose të mos i jepej fjala sekretarit administrativ të Kuvendit të Kosovës. Grupi Parlamentar i PDK-së nga fillimi i kësaj legjislature, ka kërkuar sundimin e ligjit, jemi angazhuar që në Kuvendin e Kosovës të formohet komisioni hetimor për të ndërprerë keqeverisjen në të gjitha institucionet e Kosovës, jemi angazhuar që askush të mos jetë mbi ligjin. Që në institucionet e Kosovës të ndërpritet diferencimi politik, të ndërpritet nepotizmi e papërgjegjësia e drejtuesve të institucioneve ,që Kuvendi i Kosovës të qëndroë në ballë të proceseve politike që të jetë organ që njerëzve u jep përgjegjësi dhe ua merr atë kur e kërkon interesi i vendit. Që Kuvendi i Kosovës të ngritë zërin kundër të gjitha formave të krimit dhe të të gjitha shfaqjeve të tij të korrupsionit, të kontrabandës dhe kundër të gjitha trafikeve të tjera që dëmtojnë shtetin ligjor dhe perspektivën e Kosovës. Jemi angazhuar dhe jemi këmbëngulës që në institucionet e Kosovës të sundojë ligji e demokracia. Besojmë se tani është momenti më i mirë që liderët e institucioneve t'i drejtojnë dhe t'i menaxhojnë institucione e jo të sundojnë në klane e forma të tjera despotizmi. Shumë këso paligjshmëri i kemi argumentuar me fakte relevante, por ka munguar gatishmëria e shumicës për ta ndihmuar vendosjen e rregullit dhe të ligjshmërisë në institucionet tona. Shpresojmë se debati i sotëm që ka për qëllim menaxhimin e buxhetit të Kuvendit në përgjithësi, me përgjegjësi nuk i vë para përgjegjësisë të gjithë ata që kanë menaxhuar keq buxhetin, pa përfillur normat ligjore që kishte si qëllim luftën kundër dukurive negative të instaluara në institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës, të mos e degjenerojë me konflikte personale dhe më qerim individual hesapesh individuale ,siç po ndodh. Kjo formë jo vetëm që degjeneron debatin, por degjeneron edhe demokracinë dhe procesin politik. Nëse ndodh kështu debatin humb kuptimi debatin si instrument i zhvillimit të demokracisë dhe i luftimit të dukurive siç janë: krimi, korrupsioni, kontrabanda, keqeverisja, diferencimi, familjarizmi dhe praktika e shkeljes të ligjeve dhe të normave të tjera ligjore, prandaj kemi kërkuar shpesh që Parlamenti i Kosovës të fillojë me seanca javore .nëse vërtet dëshirojmë t'i kryejmë përgjegjësitë që i kemi marrë

nga qytetarët. Pa funksionuar Kuvendi i Kosovës, pa hartuar orar pune as për 3 muaj, pa kontrolluar Qeverinë dhe institucionet e Kosovës, institucionet tona kanë marrë shumë vërejtje nga institucionet relevante ndërkombëtare, si nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, nga Kai Aide, nga OSBE-ja dhe nga Grupi i Kontaktit. Këto raporte nuk do mend se do të kenë reflektime negative në procesin politik. Çështja e këtyre raporteve është dashur të shqyrtohej në këtë Kuvend, bashkë me çështjet e zhvillimit ekonomik dhe të privatizimit.

Probleme të shumta të procesit të arsimit dhe të edukimit, çështja e KEK-ut dhe e territ, është njëra ndër sfidat më të mëdha që i bëhet zhvillimit dhe gjithë progresit shoqëror në Kosovën e re. Çështja e diferencimeve në shërbimin civil, shkeljet e shumta të ligjeve në fuqi, keqmenaxhimi i financave publike dhe paligjësitë e tjera të shumta të sferës së prokurimit publik e të ligjit të shërbimit civil. Sistemi i drejtësisë është një çështje që kërkon reformim të plotë e të thellë, ashtu si edhe siguria, sisteme këto që sipas të gjitha gjasave do të fillojnë, mbase kanë filluar keq. Natyrisht këtu përgjegjësia është edhe e kryeadministratorit ndërkombëtar që toleron shkelje të ligjeve që ka obligim t'i mbrojë ato.

Në Kosovë ekziston një auditor i përgjithshëm që ka bërë shumë raporte për keqmenaxhimin e financave publike, nga organizatat e ndryshme buxhetore, duke përfshirë edhe pushtetin vendor. Pse nuk publikohen ato raporte, sa njerëz duhet të shkonin para drejtësisë po të publikoheshin ato raporte, kush duhet të përgjigjet për këto fshehje të krimit ekonomik, a e di Qeveria për ato raporte? A e di dhe pse heshtë administrata e UNMIK-ut? Kush duhet t'i bëjë publike ato raporte, sa i kushtojnë Kosovës vjedhjet që i bëhen buxhetit të konsoliduar të saj, cili është rroli i Parlamentit në këto raste. Ne nga rrethanat e reja të krijuara presim funksionimin demokratik të institucioneve të Kosovës, sundimin e ligjit. Për t'u bërë kjo Parlamenti, të bëhet shembull i sundimit të ligjit e i ligjshmërisë, shembull i veprimit demokratik, duhet të fillojë nga Kuvendi i cili gjithë veprimtarinë politike, financiare, ligjore duhet ta bëjë transparente, të fillojë me shembullin e mirë nga institucioni ynë, nga përgjegjësia jonë. Për çështjet që i kemi ngritur edhe deri më tash e që në këtë Kuvend nuk janë dëgjuar me kujdes, ose pse shumica është bërë e shurdhër, shumë nga ato çështje janë thënë nga ndërkombëtarët e tani po thuhet edhe nga zyrtarët e lartë të Qeverisë së Kosovës. Diçka u tha edhe mbrëmë në mjetet e informimit publik.

Një gjë dihet, tagrin për këto parregullsi do ta paguajë Kosova dhe qytetarët e saj, Kosova nuk e meriton këtë papërgjegjësi dhe këto institucione të papërgjegjshme. Ne, Grupi Parlamentar i PDK-së jemi që përgjegjësia për të gjitha shkeljet e ligjeve për keqqeverisje të të gjitha format të saj të fillohet me Kuvendin e Kosovës, në këtë rast me kryetarin e Kuvendit.

Keqpërdorimi sa i përket Gërmisë, ka filluar në Kuvendin Komunal të Prishtinës dhe atje janë ngritur probleme nga asamblistët tanë, që pastaj e kanë përfshirë Kuvendin dhe Qeverinë, pra të gjitha hallkat e pushtetit në Kosovë, prandaj ne e kemi nënshkruar kërkesën për seancë të jashtëzakonshme, se shumë herë më parë kemi kërkuar krijimin e një komisioni parlamentar hetimor për të konstatuar shkallën e përgjegjësisë për keqmenaxhimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe verifikimin e fakteve. Mirëpo as anëtarët e këtij Kuvendi nuk mund të jenë krejt të amnistuar nga mosfunksionimi i shtetit ligjor dhe nga keqmenaxhimi i mjeteve publike, nga sundimi autokratik i drejtuesve të institucioneve politike, publike dhe financiare. Angazhimi ynë do të jetë në

shërbim të mbylljes së kapitullit të praktikës jodemokratike të qeverisjes që ka ndodhur deri më tani në Kosovë. Do të jemi në shërbim të sundimit të ligjit e jo në shërbim të formave të paligjshme në jetën institucionale, siç ka ndodhur deri më tani. Këtë prerje të së keqes mund ta bëjë vetëm përgjegjësia e shumicës në këtë Kuvend, ne do të jemi në shërbim të sundimit të ligjit dhe të përgjegjësisë politike për vendin. Ju ftoj që ky debat të vihet në shërbim të sundimit të ligjit, në shërbimit të forcimit të shtetit ligjor, që të formohet komisioni hetimor për të vërtetuar dhe verifikuar atë që u tha dhe nëse një komision hetimor verifikon këto që u thanë këtu, në këtë rast përgjegjësia bie mbi Prokurorinë Publike të Kosovës. Ju faleminderit.

#### KRYETRI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, dy sqarime z. Shef i grupit parlamentar. Në asnjë dokument dhe as në kornizën kushtetuese, as në rregullore të Kuvendit nuk shkruan që sekretari gjeneral nuk mund të marrë fjalë. Konsultimet e bëra për çështjet për të cilat është përgjegjësi dhe kompetencë, kanë shtyrë që të lejohet që ta mbajë fjalën. E dyta, unë e kuptoj se ata nuk kanë pasur kurrë qasje në procese politike, nuk mundën me e kuptu që këtu shumë herë kanë pasur fjalë ata që nuk kanë qenë deputet, po ajo që është më me rëndësi, që unë plotësisht pajtohem që të mbahen seanca javore edhe ditore. Një muaj ditë e ju e dini shumë mirë z. Krasniqi pse ka pasur pauzë veprimtarie, ose pamundësi veprimtarie dhe nuk do të ndërpritet dhe kjo vetëm e përshpejton procesin dhe do të përgatiten dhe do të kenë seanca aq sa të ketë nevojë dhe në rend dite të gjitha çështjet, prandaj është mirë që propozimet Parlamenti t'i filloj prej vetvetes dhe duhet t'i filloj, por nuk mund ta përjashtoj askush vetveten sepse ka qenë dikush ministër dhe është prapë në institucione dhe t'i iket përgjegjësisë, as kryetari i Kuvendit dhe askush tjetër.

Për fjalë është paraqitur Gjylnaze Syla, kurse le të përgatitet Besa Gaxherri.

#### DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA:

I nderuari z. Kryetar, anëtar të kabinetit qeveritar, deputet të nderuar.

Grupi parlamentar i Aleancës është i përkushtuar me punën e vetë në Kuvend të veproj në pajtim me besimin e dhënë të qytetarëve, duke u kujdesur që vendimet e marra në Kuvend të jenë në dobi dhe interes të tyre dhe në veçanti angazhohemi për përparimet si transparenca, objektiviteti dhe përgjegjësia. Andaj grupi parlamentar i Aleancës në debatin e sotëm do të kontribuoj me rekomandimet e veta për evitimin e mangësive me qëllim të funksionimit sa më të mirë të Kuvendit. Grupi parlamentar i aleancës konsideron se origjina e problemit të parashtruar sot në Kuvend qëndron në moszbatimin adekuat të mekanizmave të mbikëqyrjes. Me që fjala është sot për ndërtimin e Qendrës Protokolare-administrative në Gërmë, konsiderojmë se kjo ka filluar pa aprovimin formal me shkrim nga Kryesia e Kuvendit, por askush asnjëherë nuk ka pyetur seriozisht për të hollat e dhëna nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave për këtë projekt. Kryesia nuk është konsultuar dhe askush nga Kryesia nuk ka bërë pyetje në këtë temë. Kuvendi nga ana e vetë nuk ka ndërhyrë gjatë debatit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës 2005. Këshilli ekonomik dhe fiskal i cili e përcjell për së afërmi draftimin e procedimit të buxhetit asnjëherë nuk ndërhyri. PSSP-ja aprovoi buxhetin 2005. Debati për ta ndalur

projektin e Qendrës Administrative – protokollare nuk ka ndonjë rëndësi meqë paratë për ta finalizuar janë në dispozicion në buxhetin 2006, andaj debati duhet të fokusohet sot në mekanizmat e mbikëqyrjes në nivele të ndryshme, në kontrollin e zhvillimit të buxhetit të konsoliduar të Kosovës, kontrollën e departamentit të financave dhe prokurorimit brenda Kuvendit, propozojmë që për funksionimin më të mirë të brendshëm të Kuvendit:

1. Kryesia duhet të involvohet më drejtpërdrejtë në menaxhimin financiar të Kuvendit, kjo mund të bëhet duke ju dhënë rolin specifik në kontrollin e shpenzimeve dhe draftimin e propozimeve për buxhetin e Kuvendit, si shtesë Kryesia duhet së paku 1 herë në muaj t'i raportoj Kuvendit për shpenzimet dhe të paraqet përmbledhjen e detajuar për të gjitha shpenzimet një mujore.
2. Departamenti i financave. Gjatë vitit të fundit janë vërejtur mangësi në këtë departament për shkak të mungesës së kontrollës, si përfundim Grupi parlamentar i Aleancës rekomandon ndërrimin e udhëheqësit të Departamentit duke u bazuar në indikacionet dhe provat për menaxhimin jo të mirë financiar. Udhëheqësi i Departamentit duhet të zëvendësohet me një menaxher financiar kompetent dhe një revizor të brendshëm ose me formimin e komisionit të brendshëm të auditimit, qëllimi i të cilit është përmirësimi i menaxhimit të buxhetit.

Sipas ligjit për menaxhimin e financave publike çdo njësi buxhetore duhet të ketë komision të revizionit të brendshëm, kjo normalisht përfshinë së paku një revizor të brendshëm dhe drejtorin ekzekutiv të Departamentit. Ky komision duhet t'ia prezantoj Kryesisë së paku një herë në vit revizionin e brendshëm të detajuar duke shpjeguar se sa është menaxhuar buxheti në mënyrë efektive, efikase dhe gjithashtu duke u përqendruar në keqmenaxhimin e mundshëm.

Departamenti i Prokurimit, duhet të ketë mbikëqyrje më efikase, grupi parlamentar i AAK-së propozon që ky departament të integrohet në departamentin e financave dhe pastaj këtij departamenti t'i jepet vend i posaçëm në organogram të njëjtin nivel si departamentet e tjera.

Sekretari ka autoritetin e kontrollit për buxhet dhe prokurim, ai duhet t'i raportoj Kryesisë njëherë në javë.

**Zhvillimet buxhetore** - Draft-propozimin për buxhetin e Kuvendit duhet ta bëjnë Kryesia e Kuvendit, grupet parlamentare dhe administrata. Komisioni për buxhet dhe financa duhet t'i radhitë prioritetet dhe të bëjë propozimin final, i cili duhet përfshirë në buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Për funksionimin e mirë të Kuvendit është me rëndësi që të parashihet se cilët mekanizma të Kuvendit i përshtaten më së shumti çështjes. Konsiderojmë se çështjes së sotshme i përshtaten më së shumti krijimi i një komisioni ad-hoc për të mbikëqyrë funksionimin e Kuvendit. Më së miri do të ishte që anëtarët e komisionit të jenë shefat e grupeve parlamentare. Ata duhet të kenë mandat të gjerë, të kenë qasje në të gjitha dokumentet, të drejtën e marrjes në pyetje të të gjithë anëtarëve të stafit. Objektiva kryesore e këtij komisioni është që të këshilloj Kuvendin për masat, për funksionimin më të mirë të Kuvendit dhe të monitoroj funksionimin e përgjithshëm të Kuvendit. Në këtë mënyrë të gjithë ushtrojmë përgjegjësitë që i kemi dhe sigurojmë funksionimin demokratik të Kuvendit. Faleminderit për vëmendjen tuaj.

## KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, Besa Gaxherri, kurse le të përgatitet Lulzim Zeneli.

## DEPUTETJA BESA GAXHERRI:

Faleminderit z. Kryetar, deputetë të nderuar.

Në bazë të fushatës mediave që e ka bërë ky subjekt që përmes tyre ka treguar edhe qëllimin të cilin e ka dhe në bazë të diskutimeve të cilat i bëjnë kolegët nga ky subjekt vërtetë u pa që nuk ka asnjë gjë thelbësore për të cilën e vlen për të diskutuar në këtë Kuvend, me gjithë atë tash ka filluar t'i ngjajë këtij debati, s'po di si t'i them, pallavra, gjykatë e më së paku po i përngjan Kuvendit të Kosovës. Në qoftë se subjekti Ora kushtimisht ka pasur fakte të këtu ka mund t'i drejtohet organeve kompetente siç janë drejtësia, auditorë të ndryshëm, por më së paku në këtë formë që e ka shtruar, me gjithë atë më vjen shumë keq pasi që në këtë formë e ka shtruar dhe në këtë formë ka filluar debati, na duhet edhe në këtë formë ta zhvillojmë debatin, më vjen shumë keq që ky subjekt mundohet të bëhet më Papë se Papa, më vjen shumë keq prej kolegëve të mijë kur debatin e orientojnë në person e jo në çështje. Në bazë të diskutimeve të tyre ku të gjitha institucionet që janë të implikuara në aplikimin e këtij Projekti në fjalë ju dalin në mbrojtje dhe i vetmi fajtor është Nexhat Daci, shihet qartë se problemi ku është, problemi është i personalizuar komplet dhe më vjen shumë keq që janë gabuar se Nexhat Daci është prej një shtëpie shumë të madhe e nuk ka nevojë ta mbrojë as vozitësit e tij, as sekretarët e as administrata dhe sikur të kishte ndonjë gjë të tillë të sigurtë apo të vërtetë grupi parlamentar i LDK-së nuk e ka votën e besimin kot prej popullit të Kosovës, por populli i Kosovës i beson këtij grupi apo këtij subjekti, e kishim ngritë ne vetë dhe nuk ka pasur nevojë me u marrë Ora që më së paku është marrë dhe merret me popullin dhe i kisha lut që të mos fletë në emër të popullit, një koincidencë pasi hymë në këto debate po e them dhe po ju drejtohem kolegëve të mijë nga Peja që janë dy. Z kryetar ne jemi 3 deputet që vijmë nga Peja që udhëtojmë dhe e kemi mandatin e dytë, për çudi grupi apo kolegët e tij nga Peja e kanë mandatin e parë vetëm një vit dhe nuk ju vjen keq me manipulu me mjetet publike, ju vjen vetura prej Kuvendit, vetura luksoze, vozitësi dhe vijnë çdo ditë në seancë dhe në grupe parlamentare, ndërsa ne që 16 vjet punojmë dhe vetëm japim për këtë popull dhe nuk kemi as veturë që dy mandate as vozitës, por vetë jemi vozitësa dhe i kemi veturat private që kemi pasur problem edhe me parking se lëre ma shpenzimet, prandaj nuk kanë faj sepse kjo demokracia e ka këtë dhe tash dalin këtu me gjëra të tilla dhe më vjen shumë mirë që të gjithë deputetët i kanë faktet dhe nuk po dua të hyjë ta elaboroj akuzën dhe kundërfaktet të cilat janë ofruar, por po e përsëris se ka vend ku mund të shkojnë dhe të drejtohen për këto gjëra dhe jo të malltretohemi në këtë formë kur krejt diçka tjetër është si qëllim, është një qëllim krejt tjetër politik i cili vërtet po ju tregoj se nuk do të vjen në shprehje.

Unë po e them edhe një gjë kushtimisht 7 deputet të Orës kanë hapësirë në Kuvendin e Kosovës sa 47 deputetë të LDK-së dhe këtë asnjëherë nuk e vërejnë në diskutim, i vëjnë në diskutim gjërat që janë të manipuluar dhe thjesht këtu nuk e kanë vendin dhe në qoftë se vërtet duhet apo mendojnë vërtet të merren kështu me persona që nuk është edukatë në Kuvendin e Kosovës, por nuk kanë faj sepse këta e kanë mandatin e parë, ende ndoshta nuk janë mësuar, në Kuvend të Kosovës duhet të flitet për çështje e jo për persona d.m.th

ta lëmë këtë anash e mos t'i personalizojmë gjërat edhe në qoftë se e duamë apo nuk e duamë njëri tjetrin e këto janë gjëra tjera. Tash është shumë e qartë se kërkesa për këtë ndërtesë është aprovuar në vitin 2003 më vjen shumë keq që këta nuk kanë qenë atëherë në Kuvend dhe nuk e kemi menduar që e bëjnë tërë këtë problem se ishim shkuar atje edhe i kishim pyetur sepse ne jemi shumë demokrat i kishim pyetur, i kishim thirrur dhe nuk na kishte dalur tash tan ky problem që vërtetë është e pa tolerueshme, afër 100 deputet të merremi me këto gjëra të paargumentuara, të pakuptimta nuk është e drejtë, krejt në fund unë e kisha lutur subjektin e Orës që herëve tjera të jetë më konkret dhe t'i matë gjërat më mirë se kryetarin e Kuvendit të Kosovës e ka dërguar LDK-ja dhe vetëm LDK-ja mundet me e largu, larg asaj sepse nuk jemi dhe unë i ftoj kolegët e mijë që ta mbyllim këtë çështje mos të humbim kohë sepse kemi punë shumë më të mençur dhe shumë më të rëndësishme e sidomos në këto momente dhe mos të harroj ta them edhe këtë. Nuk ju vjen keq të përmendim se ne e patëm këto ditë vdekjen e presidentit të nderuar, se i kanë shti në material edhe shpenzimet kapitale e ku ta di unë 6 milion e sa po thonë, sepse ma mirë po i dinë këta se ne që po merremi me këto çështje, i vetmi hollë i Kuvendit të Kosovës ai objekt në të cilin ne mundëm t'i bëjmë një nderim, por vërtetë LDK-ja ishin ato që mundën me e bë sepse ne e dimë fortë mirë se çfarë objektësh kemi në Kosovë, s'kemi dhe e dimë fortë mirë që u desh ta improvizojmë sallën, por Orës nuk i intereson sepse Ora nuk e ka problem, Orës nuk i nevojiten institucionet e Kosovës, por i nevojiten objektet private të cilat i dimë ku i ka, sa i ka dhe si i ka dhe ju lutem në qoftë se doni me u marrë me personalizëm, atëherë ne i kemi 7 biografi sa jeni ju aty dhe merremi deri në fund, më vjen keq sepse ndoshta duhet por mos shkoni mëtutje sepse humbni. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Fjalën e ka Lulzim Zeneli, kurse le të përgatitet Xhavit Haliti

#### DEPUTETI LULZIM ZENELI:

I nderuar z. Kryetar, të nderuar kolegë deputet.

Në fillim më lejoni ta riafirmoj nevojën për një angazhim permanent në të gjitha institucionet vendore për një transparencë në të gjitha procedurat e marrjes së vendimeve e sidomos ato që konsiderohen me rëndësi kapitale në këtë fazë që po kalon Kosova. Në këtë prizëm parimisht nuk jam as nuk ka asgjë kundër debateve të tilla si kjo pikë e rendit të ditës, mirëpo brenga kryesore e krejt kësaj problematike qëndron se ekziston një spektër i caktuar politik, e këtu e kamë fjalën konkretisht për opozitën e cila trumbeton aq shumë me akuza dhe kritika që konsideroj se janë shumë të pabaza që vjen në pyetje edhe një dilemë se deri ku mund të shkojnë kufijtë e demokracisë parlamentare.

Për me qen më i qartë unë në fjalën time po lidhem drejtpërdrejtë me informatën që e kemi marrë me shkrim nga Sekretaria e Kuvendit. Informimi është dhënë në mënyrë eksplicite dhe të gjitha argumentet e nevojshme juridike dhe formale që kanë shërbyer si bazë për iniciimin dhe fillimin e realizimit të projektit, Qendra Protokolare – administrative në Gërmi. Me këtë shkresë përmenden edhe faktorët tjerë relevant, institucional që në këtë mënyrë apo tjetrën kanë qenë të involvuar drejtpërdrejtë në këtë



projekt siç është Kuvendi Komunal i Prishtinës dhe Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapsinor.

Gjithsesi se ne jemi për të qenë të hapur dhe transparent në mënyrën e marrjes së vendimeve, por jemi dhe jam kundër fushatave të cilat orkestrohen dhe dirigjohen ekskluzivisht për kalkulime politike dhe për ta deskredituar kreun e Kuvendit, të mos harrojmë se kalkulimet politike kanë filluar shumë më herët dhe kemi pasur në vazhdimësi kundër të gjitha institucioneve që i udhëheqë LDK-ja, deri dje pengesa kryesore dhe caku kryesor ka qenë ish presidenti i Kosovës dhe sot kryetari i Kuvendit dhe normalisht se ne duhet të mësohemi, unë kujtoj që edhe spektri politik e ka shumë të qartë se në këtë mënyrë vazhdojnë në vazhdimësi aktrimet në politikën ditore, fatkeqësisht se po ekziston politika ditore ajo që është shumë primare për ne.

Një koleg i yni deputet në një nga seancat e kaluara e patë shtruar edhe si çështje se ekziston kriza morale dhe fatkeqësisht sot këto po konfirmohet një gjë e tillë. Shumë çka çka u tha prej kolegëve të mi, në shumëçka pajtohem dhe më lejoni të theksoj në këtë rast se distancohem prej të gjitha atyre akuzave të cilat janë bërë dhe shtruar në këtë seancë, mirëpo më lejoni të theksoj se edhe atë që e ndijë për obligim unë e ndien edhe opozita, për të monitoruar punën dhe për të evidentuar të metat e pozitës, por kjo asesi nuk i jep të drejtë që t'i kalojë kufijtë dhe të degjenerojë në fushatë dhe propagandë për keqpërdorim të opinionit politik.

Për fund unë mund të theksoj se ndërtimi i Qendrës Protokolare-administrative Kosovës vetëm i bënë nderë dhe sadopak plotëson një infrastrukturë aq të nevojshme për institucionet e Kosovës. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Fjalën e ka Xhavit Halit, kurse le të përgatitet Ramadan Kelmendi.

#### DEPUTETI XHAVIT HALITI:

Z. kryetar faleminderit, të nderuar kolegë.

Unë nuk e kisha ndërmend që të diskutoj për faktin se jemi në situatë të tillë që nuk kemi nevojë për polarizime të mëdha, por me qenë se është pikë e rendit të ditës do të inkuadrohem në diskutim për faktin se edhe fjala e sekretarit e paparalajmëruar as në Kryesinë e Kuvendit e as në Kuvend nuk ishte sipas meje konform procedurës edhe pse kryetari e ruan të drejtën si udhëheqës i seancës, si drejtues i Kuvendit që t'ia jep fjalën dhe ndoshta ka bërë mirë, është problem për të cilin ne mund të diskutojmë dhe mund të sqarohet. Si anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës edhe në mandatin e kaluar jam i obliguar për shkak se dëgjova vendimin e 6 majit të sqaroj që unë si anëtar i Kryesisë të Kuvendit të Kosovës asnjëherë nuk kamë marrë të shkruar rendin e ditës në të cilin është thënë që sot do të merret vendim për Qendrën Protokolare – administrative në Gërmë. Asnjëherë dhe në asnjë mbledhje nuk kamë marrë pjesë ku është marrë vendim për ndërtimin e kësaj Qendre Protokolare dhe nuk e besoj që ka të shkruar në rendin e ditës të Kryesisë që pikë e rendit të ditës ka qenë kjo dhe të diskutohet rreth kësaj dhe të merret vendim.

Unë nuk e konsideroj si çështje urgjente marrjen e një vendimi të shpejtë ku do qoftë për ndërtimin e një shtëpie protokollare, por mendoj se çështje për të cilën duhet marrë

vendim të shpejtë është sot që të marrim vendim të ndajmë një buxhet shtesë nga Qeveria e Kosovës për ta hapur rrugën e cila e ka bllokuar Kosovës me Maqedoninë, ndoshta kjo do ta arsyetonte marrjen e një vendimi të shpejtë. U arsyetua që nuk kemi pasur incizime gjë që unë mendoj se jo që kemi pasur incizime nëpër mbledhjet tona, por kemi pasur incizime të shumëfishta, jo vetëm nga aparaturat që kanë qenë ndoshta jo moderne si janë sot por edhe aparatura të sofistikuar nga afërsia, nga largësia, nga qielli, nga toka, kështu që mos t'ju rrok kasavet kush donë të hyjë mëtutje në këtë çështje, prandaj për të mos u futur në akuza dhe kundër akuza sepse nuk është qëllimi im sot do të kërkoj shoqërisht nga diskutuesit që të mos na i përmendin dosjet këtu, për faktin se sipas Kornizës kushtetuese të Kosovës askujt në Kosovë nuk ju ka ndaluar e drejta për të qenë deputet, as atyre që kanë qenë anëtarë të Lidhjes së Komunistve, as atyre që kanë punuar në UDB, as atyre që kanë punuar për Serbinë, as Rusinë, kjo është antiligjore që ta përmendim ne sot këtu, të gjithë janë deputet, e kaluara e tyre është pjesë e votës që e zgjedh vetë populli se kujt ja jep për të mirat, për të këqijat që ia ka bërë këtij vendi dhe uroj që në këtë sallë të mos ketë njerëz që i kanë bërë dëme popullit të vetë.

Unë sa për ta sqaruar pozicionin e Kryesisë mendoj se rendi është me folë edhe Haxhi Merxha që është këtu dhe ka qenë anëtarë Kryesie atëherë, a ka marrë vendim për villën, është Hydajet Hyseni këtu, është Fatmir Sejdiu, Saviqi, Oliveri mund të ftohen në qoftë se formohet ndonjë komision për të dëshmuar s'ka ndonjë problem, por unë personalisht nuk kam marrë pjesë në asnjë mbledhje në të cilën është marrë vendim as për shpalljen e tenderit, as për ndërtimin e asaj ville dhe as nuk kam marrë pjesë në ndjekjen e procedurave lidhur me këtë, nuk e di ajo është çështje e Kuvendit, çështje e komisionit a do ta konsideronin oportunitizëm apo pa përgjegjësi timen personale që nuk jam hyrë më thellë për t'i kontrolluar dokumentet, por si anëtar i Kryesisë jam shumë i vetëdijshëm që kompetencat e mija shkojnë për aq sa vjen procesi me rendin e ditës i bërë nga kryetari i cili është i autorizuar për atë punë. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, Ramadan Kelmendi, kurse le të përparitet Fatmire Mulhaxha – Kollçaku.

#### DEPUTETI RAMADAN KELMENDI:

Ju faleminderit z. Kryetar. I nderuari kryetar, të nderuar kolegë deputet, ministra të pranishëm.

Ne sot po diskutojmë për një çështje vërtetë të personalizuar dhe jo për një çështje përmbajtësore që dihet qëllimi dhe orientimi i saj, ndon se në shoqërinë demokratike dhe në institucionet dhe në organet më të larta të saj siç është ky Kuvend ligjdhënës parimisht mund të propozohet për t'u shqyrtuar shumë çështje dhe së fundit kjo e drejtë nuk i mohohet askujt për të paraqitur iniciativa të ndryshme, por vërtetë ato paraprakisht duhet të jenë të argumentuara si të tilla dhe është me interes të përgjithshëm se para se të vihen në shqyrtim në këtë Kuvend të bëhet një analizë e prioriteteve dhe jo të shqyrtohen tema të njëanshme, të paargumentuara me plotë insinuata, me papërgjegjësi dhe duke kërkuar përgjegjësi të njëanshme.

Bazuar në fakte të shumta kjo çështje e hapur në Kosovë për të cilat vite të tëra nuk bisedohet dhënia e prioritetit për debat Qendrës Protokolare në Gërmi dhe disa lisave atje është i paarsyeshëm, i nxituar dhe jo i drejtë në raport me peshën që ka shumë probleme të hapura nga se qëllimi i kësaj teme tani më është i qartë për të gjithë ata që vërtetë kuptojnë drejtë. Institucionet e Kosovës kanë marrë shumë iniciativa, institucionet e Kosovës kanë nevojë shumë të madhe për një Qendër Protokolare ku do të bëheshin takime, seminare, tubime e forma tjera të organizuara me shpenzime shumë më të vogla se sa p.sh ato të organizoheshin në Ohër, Shkupë e vende tjera. Së fundi një shtëpi më e vogël e bën një dhomë për t'i pritur miqtë, mysafirët apo për të organizuar gëzimin dhe hidhërimin familjar, po ashtu edhe institucionet e Kosovës duhet patjetër ta kenë Qendrën protokollare për të cilën procedura paraprake argumenton ligjshmërinë. Zërat e ngritur kundër kësaj Qendre në emër të mbrojtjes së ambientit e disa lisave në Gërmi nuk dinë apo nuk donë të din, nuk donë të mendojnë apo edhe nuk donë të mendojnë kundër se çka kanë bërë për ndalimin e qindra deponive në meset tona që kundërmojnë erë të rëndë. Mbulimin e sipërfaqeve të piritit në Mitrovicë që helmon një regjion të tërë apo ndotjen e lumenjve dhe degradimin e tyre me nxjerrjen e rërës, prerjen masive të pyjeve dhe përhapjen e erozionit, derdhjen e ujërave të zeza në liqejt akumulues nga të cilët pijmë ujë gjëja se të pastër etj.

Vlerësoj se prioriteti duhet shikuar në përputhshmëri me interesat e përgjithshme dhe shtoj pyetjen: Pse nuk është ngritur fakti se 23.320 refugjatë shqiptarë në Mitrovicë të cilët nuk kanë kurrfarë mbrojtje juridike nga pronat dhe shtëpitë e tyre dhe atyre u mohohet e drejta edhe nga Habitati dhe nuk ngrisin zërin për mbrojtjen e të drejtave të tyre të ligjshme ose ndarja e 300.000 eurove nga buxheti i Kosovës qendrës rajonale në Mitrovicë ku shqiptarët nuk kanë qasje se a janë tatimpagues, pensionet dhe zgjedhja e problemeve të shumta të tyre, problemet në shëndetësi, në Universitet etj dhe na hapet ky problem më i vogli në mesin e më të voglave, problem të cilin vërtetë e dimë se për çfarë arsye shtrohet. Problemi i papunësisë dhe zbutja e tij. Shikuar në përgjithësi për këtë Kuvend më prioritet se kjo çështje e hapur do të ishte nxjerrja e këtyre ligjeve se sa të debatohej për një Qendër në Gërmi siç është ligji mbi pronën, Ligji mbi librezat e punës, Ligji mbi themelimin e marrëdhënies së punës, Ligji mbi shërbimin civil, Ligji mbi zgjedhjet, Ligji mbi të drejtat dhe institucionet e deputetit dhe shumë ligje tjera. Në tërësi vlerësoj se prioriteti dhe arsyeshmëria duhet të jenë kritere dhe jo inatet dhe interesat pushatore, politike e forma tjera të cilat vërtetë janë të karta dhe të kuptueshme, për mua duke lexuar dhe përpunuar materialin e parashtruar, vlerësoj se procedura juridike për ndërtimin e Qendrës në Gërmi nuk është në kundërshtim me procedurat për ndërtim, sipas materialit të deponuar dhe të dërguar të gjithë deputetëve dhe vlerësoj përfundimisht se është shumë, po e them me përgjegjësinë më të madhe, e paarsyeshme që të shkojmë dhe të formojmë grupe për të vlerësuar sepse vetëm krijohet mjegull për etiketime dhe për degradime të vlerave demokratike në proceset që po shkojmë më tutje. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Ramadan ju faleminderit, Fatmire Mulhaxha – Kollçaku, kurse le të përgatitet akademik Mark Krasniqi.

## DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA – KOLLÇAKU:

Kërkesa e grupit parlamentar Ora për debatimin e asaj se si është marrë vendimi për ndërtimin e villës protokollare dhe në anën tjetër se si është menaxhuar buxheti i Kuvendit buron nga nevoja për respektimin e ligjit dhe ligjshmërisë, nga nevoja për transparencë në këtë Kuvend, nga mundësia e shfrytëzimit të ligjit për çasje në dokumente zyrtare e cila e drejtë edhe nuk shfrytëzohet sot nga shumë qytetarë të Kosovës.

Zonja dhe zotërinjë, habitë fakti si tentohet që kjo çështje të personalizohet, të vëhet në pah plotësisht të kundërt prej qëllimit të një kërkesë të tillë e cila është legjitime, ta kuptojmë më në fund se si mirren vendimet në institucionet në Kosovë sot. E dimë se në institucionet tona në Kosovë ekzistojnë borde, këtu ekziston Kryesia, pyetja është shumë e thjeshtë për juve deputet në këtë sallë, dokumentacionin e keni të ofruar, është dashur ta analizoni, i keni dëshmitë e ish anëtarëve të Kryesisë, besoj që ju besoni në fjalë dhe ju pyes juve se a është në rregull për juve që vendimet si janë marrë dhe a janë legjitime, po që se janë ta legjitimojmë mënyrën e vendimmarrjes në këtë institucion dhe të shkojmë më tutje.

Zonja dhe zotërinjë nuk jemi futur me dëshirë të gjithë në politikë, ndoshta kemi pasur afinitete, por i jemi qasur profesioneve tona për të cilat edhe jemi shumë të thirrur, por bash kjo mungesa e transparencës, keqmenaxhimi i buxhetit, parasë publike prej bazës të cilën e keni vërejt, na ka shty që të tentojmë të provojmë diçka të përmirësojmë, nuk është bash krejt mirë dhe në rregull siç tentoj dikush të thotë dhe se futja e Orës e rastësishme në politikë me siguri do të pëson debakël, ndoshta pash nevoja e disa qytetarëve dhe pakënaqësia e dikujt dhe së paku atyre votuesve që neve na kanë votuar na ka shtyrë që ne sot të ngrisim zërin e tyre sot këtu. Si do të shkon të ardhmen nuk e di, mirëpo shumë mirë na treguan disa deputet që në vitin 2003 nuk është debatuar këtu sepse nuk ka qenë me rëndësi të debatohet se si shpenzohet buxheti i Kuvendit sepse ishte vërejtur qysh atëherë dhe ndoshta sot ne kishim debatuar për tema tjera.

Kjo pyetje duhet të shtrohet në dy rrafshë, në aspektin e harxhimit të buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe në aspektin e harxhimit të buxhetit të Kuvendit, se nuk mund të shikohen të ndara njëra prej tjetrës.

Zonja dhe zotërinj shtrohet pyetja se a është prioritet sot për Kosovën që të shpenzohet kjo vlerë marramendëse për ndërtimin e villës protokollare, ne jemi të pajtimit se Kosova ka nevojë, por mbas prioriteteve edhe në kohën e duhur, vetëm shtrojeni pyetjen, unë nuk mund t'i iki shëndetësisë sepse ndonjëherë edhe kur përmendet këtu nuk është e pëlqyeshme tema e shëndetësisë, sepse po ta kishim përmend më shpesh nuk kishim me ardhë në situata që ta vëmë në pyetje jetën e njerëzve sot në Kosovë, ku kemi shkurtime çdo vit drastike të buxhetit në shëndetësi dhe ne sot me buxhetin që është ndarë për pajisje, produkte, medikamente dhe duhet të vendosim a ta shpenzojmë në 3 muajt e parë dhe më tutje të shikojmë kah zoti se si t'ju ndihmojmë pacientëve apo ta shpenzojmë gjatë tërë vitit dhe të vendosim këtij ti ndihmojmë e atij jo, sepse nuk kemi buxhet të mjaftueshëm dhe a duhet të shkurtohet buxheti në shëndetësi për të ndërtuar villa protokollare dhe për me ble vetura ekstra luksoze. Dikush i përmendi kushtet e famshme për deputetë, nuk është hera e parë që e kamë shtuar pyetjen dhe pyetja ka të bëjë me funksionalizimin e këtij Kuvendi. Në qoftë se nuk sigurojmë kushte për deputetë, unë jam që një vit dhe kamë vërejtur shumë mangësi, mungesë totale të kushteve të punës.

Shtrohet pyetja e këtyre deputetëve më të vjetër a nuk kanë kërkuar asnjëherë kushte më të mira, apo janë të kënaqur, a jemi këtu duke e bërë pjesën luksoze reprezentative, ndërsa deputetët tanë, ndoshta edhe sipas kushteve është dashur me ec edhe në këmb. Autobusi është zgjidhja më e mirë. Unë edhe njëherë e kam cekur se mungesa e zyrave në këtë Kuvend, mungesa e telefonit zyrtar, takimet zyrtare i mbajmë në hollë të Kuvendit, më vjen keq prej ndërkombëtarëve se prej tanëve kur kemi takime po ju kërkoj falje, e kam shfrytëzuar zyrën e z. Xhezair Muratit, znj. Teuta Sahatqija të z. Gazmend. Nëse unë vijë me veturë të z. Gazmend Sahatqija sot në seancë unë duhet t'i falënderohem, por unë jam e rregullt në stacion të autobusëve, këtë mund ta dëshmojnë shoferat e autobusëve të cilët i njoh të gjithë personalisht, sepse këtu pat insinuata, personalizime, po më vjen keq se nuk do të replikoj dhe shpeshherë bjenë në nivel nëse hyn në replikë me vikend. Ju lutem nëse për juve deputet këtu në Kuvend është në rregull që të bihen vendimet prej një njeriut apo prej bashkëpunëtorëve të tijë ju lutem Kryesia ku e ka rolin, të gjithë jeni dëshmitarë këtu se shpeshherë drejtorët, koordinitorët me ndonjë bashkëpunëtor të ngushtë menaxhojnë me buxhet, vendosin dhe bordin e thërrasin vetëm për akte solemne, kjo është e vërteta sot dhe nëse dikush ka dëshmi të kundërta ju kisha lutur, sepse më kishte ardhë shumë mirë për të kuptuar që ka institucione ku me të vërtetë funksionalizojnë shumë mirë kryesitë dhe bordet. Unë e përmbylli me këtë dhe ju kisha lutur me qenë se ne deputetët e orës nuk e kemi personalizuar, nuk e kemi përmend, ne jemi detyruar me e përmend nëse është fjala për kryeparlamentarin sepse ka të bëjë me temën, ndërsa deputetët tjerë kur kanë hyrë edhe në kërkimin e dosjeve dhe nëse kanë le t'i ofrojnë, por mos të manipulojnë këtu me shifra dhe të dhëna të cilat nuk ju shërbejnë me nder. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, profesor Mark Krasniqi, kurse le të përgatitet Sanije Alijaj.

#### DEPUTETI MARK KRASNIQI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputet, këto diskutime që po zhvillohen në parlament japin përshtypje të njerëzive të paktën që nuk e njohin Kosovën se ne jemi një shtet i konsoliduar me një histori shumë vjeçare të pavarësisë dhe sovranitetit. Ne po diskutojmë për gjëra që duhet të diskutohen sigurisht dikund, por po e lëmë atë që është kryesorja për ne e që është shumë aktuale, po e lëmë fatin e Kosovës anash. Më duket, jo por jam i bindur se çdo diskutim dhe çdo veprim i yni dhe çdo mendim i yni duhet të orientohet sot kah e mira e Kosovës, kah shpëtimi i saj nga kthetrat e robërisë. Ju dhe ne të gjithë, por edhe i gjithë populli është i brengosur për fatin e Kosovës sepse po japim sugjerime, propozime, madje edhe kërcënime të ndryshme për fatin e saj, ne këtu duhet ta kemi parasysh se duhet ta kemi një shtet sigurisht të konsoliduar si duhet, ku respektohen ligjet, ku respektohet e drejta e njeriut, ku respektohen të gjitha ato që duhet të respektohen, por duhet që para së gjithash të përpiqemi që ne ta krijojmë atë shtet. Unë këtu me habi po konstatoj se ne si

Parlament jemi të anashkaluar fare nga procesi i negociatave që po zhvillohen sot për fatin e Kosovës.

Kemi dhënë vetëm një rezolutë e cila nuk di se sa do të respektohet dhe sa e obligon ndokënd atje i cili vendos për fatin e Kosovës. Ne këtu po diskutojmë për keqpërdorimin e mjeteve, për padrejtësi të ndryshme, të njerëzve që janë në krye të këtyre institucioneve, por në realitet këtu është lufta për pushtet, deshët apo nuk deshët ne duhet patjetër t'i kemi parasysh të metat që duhet t'i luftojmë, por në këtë kohë, në këtë moment kur vendoset fati i Kosovës ne duhet të tregohemi se jemi një popull shtetformues, një popull i civilizuar i cili e respekton atë që e ka zgjedh populli, atë që e kemi ne këtu, institucionet e ndryshme që i kemi dhe njerëzit që janë në krye të tyre. Ka sigurisht gabime, por këto gabime, këto të meta dhe këto padrejtësi, ose këto abuzime në qoftë se ka në ndonjë vend, ose ndonjë rast tjetër mund të diskutohen dhe të përmirësohen pasi ta kemi fuqinë në dorë, pasi ta kemi ministrinë e drejtësisë, pasi ta kemi policinë dhe mundësitë tjera për t'i luftuar këto të meta. Tash duhet ta kemi parasysh sigurisht edhe detyrat tjera, Parlamenti ka kohë dhe ka mundësi të merret edhe me Ligje, por duhet nganjëherë duhet edhe këtu të diskutohet edhe për fatin e Kosovës, sepse neve populli na ka zgjedhur jo vetëm të diskutojmë për buxhet ose për ndonjë problem tjetër, por para së gjithash të përpiqemi që Kosova të jetë shtet i pavarur, shtet demokratik, shtet pa këso kombinimesh që po i propozojnë disa, shtet me kushte, sovranitet me kushte dhe disa gjëra që nuk dihen se çka janë ato kushte ose disa gjëra tjera që po propozohen, madje propozohet edhe në parlamentin e Serbisë që të merret vendimi ose shqyrtimi që Kosova është e okupuar nga shqiptarët si pjesë e pandashme e territorit të Serbisë, kurse e vërteta është krejtësisht kundër, Kosova është okupuar nga Serbia më 1918 dhe si okupator duhet ta kemi edhe në biseda Serbinë në anën tjetër të tavolinës. Ju faleminderit.

#### KRYETRI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor ju faleminderit, fjalën e ka Sanije Alijaj, kurse le të përgatitet Ferid Agani.

#### DEPUTETJA SANIJE ALIJAJ:

Ju faleminderit z. Kryetar, të nderuar ministra dhe kolegë deputet dhe ju të pranishëm që e përcillni mbarëvajtjen e kësaj seance.

Do të bëj përpjekje për t'i dhënë disa vlerësime për iniciativën e ndërtimit të qendrës Protokollare -administrative në hapësirën e Gërmisë. Mendoj se interesimi për sqarim lidhur me mënyrën e vendimmarrjes për ndërtimin e Qendrës Protokollare Administrative të Kuvendit të Kosovës si dhe procedurat e përcjellur nga ana e Kryesisë së Kuvendit nuk e arsyeton insistimin nga ana e disa deputetëve me nënshkrime për një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës sepse kjo iniciativë është e kahershme, do të ishte në rregull si interesim për një sqarim që të futet në rend dite në një seancë të rregullt të Kuvendit të Kosovës duke i paraprirë në radhë të parë verifikimi i procedurave dhe dokumenteve në komisionet parlamentare. Lidhur me debatin që zhvillohet rreth kësaj pike të rendit të ditës mendoj se koncentrimi ynë duhet të jetë i përqendruar në rëndësinë

e këtij objekti se a e vlen munda dhe mjetet e shpenzuara për të. Duke u nisur nga fakti se Kosova ndodhet në fazën e tranzicionit dhe formimit të shtetit dhe të Legjislacionit, duke u ndier nevojë e madhe për hapësirat që do të krijonin kushte për punë të qetë dhe të frytshme, duke e ditur se një shumë e konsiderueshme e buxhetit shpenzohet për krijimin e kushteve për punë të parlamentarëve jashtë Kosovës si dhe duke e ditur se një objekt i tillë ka ekzistuar dhe ka shërbyer edhe më parë për nevojat e Kuvendit në këtë hapësirë, nevoja për një infrastrukturë të tillë është më se e domosdoshme sepse jemi në rrugë për formimin e shtetit. Ndoshta jemi vendi më i vizituar nga ndërkombëtarët, prandaj është më se e domosdoshme për të krijuar hapësirë për takime me delegacionet e vendit dhe ato ndërkombëtare, krijimit të hapësirave për punë të grupeve dhe komisioneve parlamentare, krijimit të hapësirave për konferenca, seminare të ndryshme me shërbimet tjera përcjellëse që të mos vrapojmë nga një hotel në tjetrin për të shkëmbyer një përvojë për funksionim, ku ndodhë një nismë e mirë siç është kjo e ndërtimit të Qendrës Protokollare Administrative që unë mendoj që ky objekt është i një rëndësie të veçantë dhe se ashtu si thotë shpesh herë ish presidenti ynë i nderuar dr. Ibrahim Rugova duhet ndërtuar e lënë diçka me të cilën krenohemi ne dhe pasardhësit tanë.

Do të shfrytëzoja rastin të theksojë me rastin e vizitës që pat nderin të bëjë grupin parlamentar i grave deputete në legjislaturën e parë institucioneve në Gjermani pamë dhe vizituam shumë objekte që ishin në funksion të Bundestagut Gjerman ajo ishte krenari për ta prandaj interesimi edhe i institucioneve tona që të bëjmë të përafërt diçka të tillë është shumë i domosdoshëm.

Ky objekt përveç se i ndihmon kushte për punë më të mirë të institucioneve krijon kushte të favorshme edhe për zhvillimin e proceseve në Kosovë prandaj diskutimet tona nuk duhet shkaktuar huti tek qytetarët që i marrin informacionet që ne po i plasojmë në këtë seancë ende të pa konstatuara mirë sepse ne deputetët i kemi materialin dëshmuës për respektimin e procedurave nga dy nivele të institucioneve, atij qendror dhe të pushtetit lokal në Prishtinë.

Duke filluar nga leja urbanistike pëlqimi ekologjik si dhe vendimi për ndarjen e mjeteve buxhetore nga ish Qeveria e Kosovës dhe që ka pasuar nga Qeveria aktuale dhe një varg dëshmisë tjera përcjellëse. Ky objekt ka qenë aty edhe ma herët në Gërmis, natyrisht që të gjithë e dimë që është dëmtuar si pasojë e luftës. Tash ka së paku edhe 3 objekte hoteliere në këtë hapësirë që askush nuk është ankuar deri më tani, me këtë rast do të propozojë që mundësisht të ndërtohet një rrugë e veçantë apo të zgjerohet me trotuare të nevojshme që vajtja dhe ardhja e delegacioneve të huaja dhe puna e institucioneve vendore në këtë hapësirë mos t'ju pengojë qytetarëve të rëndomtë në realizimin e të drejtës së tyre në shfrytëzimin e hapësirë së Gërmisë për pushim dhe argëtim.

Ky debat është pak sa i tepruar sepse ndërtimi i këtij objekti nuk është për çështje personale apo private, objektin në fjalë do të ndërtohet për funksionimin më të frytshëm të institucioneve të Kosovës.

Disa demokracinë po e kuptojnë si shprehje e lirë e mendimit lehtë është për të thënë diçka të vërtetë apo të pa vërtetë por për të vepruar në një mënyrë demokratike është pak

sa më vështirë, sot shihet hapur përpjekja për ta sulmuar krye parlamentarën që me shumë suksese ka udhëhequr legjislativën e parë po me aq sukses edhe të dytën, mu kjo po ju pengon atyre që nuk mundin të gjejnë hapësirën e dëshiruar për të dhënë mend se mund të hulumtojnë dhe të dinë çdo gjë e gjithë çka në këtë botë, si përfundim do të them se ata që sot sulmojnë me një frymë të tillë e tregojnë përmasën e vogëlsisë së tyre që për kundër të gjitha vështirësive fushatave formaliteteve dhe procedurave punët në këtë objekt vazhdojnë me cilësi dhe dinamik të paraparë dhe të parashtruar nga institucionet dhe punë kryesi, kurse lidhur me transparencën dhe menaxhimin e buxhetit të Kuvendit është tepër të flitet sot, sepse buxheti paraprakisht ka kaluar nëpër të gjitha procedurat e nevojshme dhe në fund është miratuar në çdo periudhë të vitit ku secili ka pasur rastin dhe mundësin për të dhënë vlerësime dhe sugjerime për një shpërndarje sa më të mirë dhe të nevojshme. Ju faleminderit

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Saniqe ju faleminderit, Ferid Agani e ka fjalën

**DEPUTETI FERID AGANI:**

Ju faleminderit z. kryetar, në periudhën shumë të suksesshme të ndërtimit të unitetit politik të përfaqësuesve politik të Kosovës veçanërisht në kohën e fundit mendoj se ky lloj debati po na qon në një drejtim të kundërt dhe në opinion po krijohet një bindje tjetër.

Në periudhën e zhvillimeve tejet të rëndësishme politike dhe shoqërore si në rrafshin mendor edhe ashtu ndërkombëtar mendoj se na nevojitet një efikasitet dhe fiktivitet shumë më i lartë i Kuvendit të Kosovës në këto ditë. Me këtë në asnjë mënyrë nuk dëshiroj që të minimizojë rëndësin e këtij debati sepse rëndësia respektimit të ligjit dhe ligjshmërisë është e pa diskutueshme dhe paraqet gurë themel të çdo shteti demokratik. Për arsyeshmërinë e ndërtimit të objektit në fjalë me siguri mund të them fjalë miradije por edhe argumentet e kundërta veçanërisht në dritën e krijimit të kushteve elementare për punë të deputetëve të Kosovës të cilët disa deputetë të ndërruar i përmendën, mirëpo, megjithatë duke pas parasysh se para nesh u sollën fakte të kundërta lidhur me temën e njëjtë lidhur me objektin e njëjtë të bisedës unë propozoj që për hir të vazhdimin të ndërtimit të unitetit politik dhe njëkohësisht të respektimit të ligjshmërisë shëfat e grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës të takohen në pauzën e këtij Kuvendi dhe të mirën vesh për konkludimin lidhur me mënyrën e përfundimit të këtij debati.

Unë mendoj se në këtë mënyrë do të kishin dërguar mesazh adekuat dhe në këtë drejtim ka solucione të ndryshme të cilat dhe në mënyrë efektive mund të sigurojnë këto dy elemente që përmenda do të thotë unitetin e faktorit politik dhe njëkohësisht synimin e qartë të këtij Kuvendi për të respektuar ligjshmërinë në çdo instancë. Ju faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni le të përgatitet Nazim Jashari.



## DEPUTETI HYDAJET HYSENI:

Ju faleminderit z. kryesues, po të kisha qenë i paralajmëruar do të isha përgatitur pak më mirë.

Zonja dhe zotëri deputetë, unë nuk e kisha ndërmend të diskutoj për këto çështje, megjithatë e përshëndes debatin. Konsideroj se ne na duhen praktika të tilla, na duhet mbi gjitha kontrolli demokratik mbi institucionet dhe unë nuk shoh absolutisht asgjë të keqe nga debati i hapur dhe parimisht për të gjitha çështjet, ama bash për gjitha çështjet.

Unë nuk druaj me këtë që do të them as do të bëjë avokatllëk se nuk do ta bëjë këtë as nuk do të bëjë prokurorin as nuk do të dëshiroja që të jap material për ata që duan pika të zeza për realitetin e ri kosovarë por as nuk do dëshiroja që të bëhem pre e demagogjisë, shumë përhapur në Kosovë sipas të cilës dikush bën të keqpërdorë bën të vjedhë po të tjerët duhet të heshtin sepse po e dëmtojnë imazhin e Kosovës, palë a ta shikoj ju lutem ata të tjerët së pari a po e dëmtojnë imazhin e Kosovës apo jo, prandaj mendoj se ne duhet flasim hapur, megjithatë të flasim hapur është mirë të mos personalizohen gjërat, prandaj unë do të përpiqem të flasë parimisht dhe as mos të merrem me emrin e kryetarit të Kuvendit por as me përfaqësuesit e një grupi opozitar dhe pastaj të bëhen tirazh akuzash që s'kanë bash asnjë lidhje me debatin që po diskutojnë këtu sot.

Për mendimin tim ka rëndësi këtu çka po ndodh me institucionet tona, si po funksionojnë ato. Është një nga standardet kryesore të cilën ne duhet ta japim provimin. As nuk e japim provimin duke pëshpëritur gjithçka por as nuk e japim provimin duke mbuluar shkeljet evidente.

Për mendimin tim rruga më e mirë është parandalimi i fenomeneve të tilla sundimi ligjit, transparenca dhe zonja e zotërinj vetë edhe ky debat është dëshmi se ka shumë çka do të duhej të ishte parandaluar dhe korrigjuar edhe në institucionin pjesë të cilat jemi ne. Nuk mund ti kuptojë, prandaj as ndoshta akuzat aprioristike dhe përfundimet para se të përfundojnë hetimet por as nuk mund t'i kuptojë prirjet për të amnistuar apriori gjithçka dhe pa e hetuar fare sepse kjo lë dyshimin a është edhe një përpjekje për ta gjeneralizuar përgjegjësinë për ta bllokuar kritikën dhe duhet ata që bëjnë këtë ku po na çojnë në këtë mënyrë, unë mendoj prandaj ne na duhet një qasje parimore.

Së pari për mendimin tim nuk është mirë që është kjo e paqartë ka pas vendim s'ka pas vendim duhet të sqarohet a ka pas vendim për projektin për të cilin po bëhet fjalë. Unë mund të them me përgjegjësi të plotë se Kryesia për këtë nuk ka vendos, thuhet atje se vendimi është marrë me njëzet e sa mars, zonja dhe zotërinj njëzet e sa marsi ka qenë pas ngjarjeve të marsit ju e dini kush ka vendosur atëherë, a ka pas mundësi të vendoset dhe çka do të thotë nëse vendimet të tilla të merren pikërisht në atë kohë, por çështja kryesore është edhe po të ishte marrë nga dikush vendimi a ka pas bazë ligjore për atë që është marrë ku është mbështetja a është shkelë me këtë rast ligji. Këtu po flitet sikur debati është a duhet të kemi ne qendër protokollare apo jo, zonja e zotërinj nuk është fare kjo në shqyrtim sepse po të ishte ne do të duhej të kishim biseduar shumë vjet më parë a po e

bëjmë a nuk po e bëjmë dhe s'do të kishte nevojë fare për debat tash, çështja është si është kryer krejt kjo punë dhe ju e dini a është kryer po thotë dikush, asht kryer por është kryer keq jemi vënë në situatë shumë problematike ose të amnistojnë shkelje do ti bëjmë presedan dhe pastaj ato të vazhdojnë gjithkund ose ne të themi se ka pa rregullsi dhe mos të bëhen më. Për mendimin tim duhet shtrohet çështja a është e arsyeshme se në këto kushte kur si u tha këtu, edhe në këtë seancë është shtruar edhe në forma tjera deputetët nuk kanë asnjë zyre nuk kanë asnjë llap top, nuk kanë as kushtet elementare për punë, harxhohen miliona për çështje që janë megjithatë luks për ne, kurse spitalet barna nuk kanë për pacientë, invalidë e luftës nuk kanë proteza ju lutem, kurse ne tash me fare me një elegancë bën të shkojnë miliona për cilat ne nuk kemi ditur si është vendosur nuk kemi ditur kush ka vendosur etj. Unë prandaj nuk them se a është shkelje a s'është shkelje po ne duhet ta verifikojmë as nuk duhet ta prejjudikojmë shkeljet por as nuk duhet të amnistojmë apriori të tjerët le të hetohen.

Për mendimin tim duhet të shikohet edhe një aspekt shumë i rëndësishëm ky institucion bën ligjet duhet të jep shembullin e sundimit të ligjeve dhe të respektimit të ligjeve a është shkelur ligjshmëria në këtë rast a është shkelur korniza Kushtetuese së pari, a është shkelur ligji mbi ambientin, a është shkelur ligji për parkun nacional, a është shkelur ligji për financat dhe menaxhimin e tyre a është shkelur ligji për prokurimin, a është shkelur ligji për qasjen e dokumenteve zyrtare, unë psh. kam dyshime serioze se edhe kërkesat që janë bërë për të pasur dokumentet janë bllokuar me javë dhe me muaj dhe nuk janë proceduar. Unë kam arritur në dyshim se ka shkelje deri sa të bllokohen procedurat të cilat ne jemi të obliguar ti ndjekim dhe t'i respektojmë. Pse bëhen, a është shkelur ligji kundër korrupsionit, a është shkelur fondi dhe rregullorja e Kuvendit të Kosovës a janë tejkaluat kompetencat, a është respektuar kompetenca e Kryesisë së Kuvendit, kush ka vendosur për buxhetin e Kuvendit, zonja dhe zotërinj këtu po thuhet pse nuk është diskutuar, mua më vjen keq, procesverbalet janë, këto çështje janë shtruar në vijim si edhe në Kryesinë e Kuvendit dhe janë procesverbalet edhe atje, janë shtruar edhe në këtë sallë në seancë plenare jo njëherë, janë shtruar edhe në media publike por thonë tupani rreh për ata që ka vesh, për ata që duan ta dinë të vërtetën, unë megjithatë nuk dua të bëjë prejjudikime por mendoj se nuk është nën nderin e Kuvendit as politizimi negativ por as amnistimi apriori. Ne jemi institucion demokratik prandaj edhe mënyra e vetme është procedura demokratike edhe procedura demokratike për situata të tilla është shumë e qartë. Kuvendi nuk është ai që mund t'i bëjë verifikime gjithë asaj dosje, duhet të bëhet një grup hetimor parlamentar i cili sipas procedurave të njohura edhe praktikave parlamentare do ta hetojnë çështjen dhe do t'i raportojë Kuvendit të vërtetën për këtë, ata që janë të pa fajshëm nuk kanë nevojë që të frikësohen as nuk kanë nevojë që dikush t'i mbrojtë apriori sepse duke i mbrojtur apriori krijohet përshtypja se ata e dinë që ka keqpërdorime por duan t'i arsyetojnë t'i mbulojnë t'i justifikojnë ndoshta edhe sepse kanë ndonjë thelë prej sajë.

Zonja dhe zotërinj prandaj unë mendoj që të vërtetën për çështje dua ta jap grupi hetimor parlamentar që duhet formohet natyrisht në procedurë të rregullt parlamentar. Ju faleminderit

KRESUESI, NAIM MALOKU:

Ju faleminderit z. deputetë Nazim Jashari e ka fjalën le të përgatitet Nimon Alimusaj

**NAZIM JASHARI:**

I nderuari z. kryesues, të nderuar kolegë deputetë.

Më lejoni fillimisht që t'ju kërkojë ndjesë dy deputetëve të LDK të cilët reagues me rastin e protestës sime për shkak të marrjen së fjalës nga ana z. sekretar i Kuvendit, z. Zeqiraj dhe z. Kameri. Në asnjë rast dhe në asnjë moment protesta ime nuk është drejtuar ndaj atyre, bile për më tepër, nuk ka qenë e drejtuar ndaj z. Demaj, po ka qenë e drejtuar ndaj z. Kryetar të Kuvendit, i cili vazhdimisht në mënyrë të përsëritur po e imponon vullnetin e tij në këtë Kuvend. Të nderuar kolegë deputetë, ne jemi këtu 120 deputetë, të cilët sipas Komizës Kushtetuese i kemi të drejtat e njëjta, kështu thotë së paku aty, dhe në qoftë se është ashtu, atëherë z. Demaj ka mundur ta marrë fjalën vetëm me vendimin tonë, e jo me vendimin e kryetarit të Kuvendit, pavarësisht që atij i lihet e drejta të interpretojë Rregulloren e punës së Kuvendit në seancë. Por kjo nuk ka pasur të bëjë me interpretim të Rregullores, por ka pasur të bëjë me shkelje të drejtpërdrejtë të Rregullores nga ana e kryetarit të Kuvendit. Prandaj, edhe një herë po e shprehim keqardhjen po që se deputetët e grupit parlamentar të LDK-së e kanë ndier veten të fyer, nuk ka qenë ky qëllimi im, bile për më tepër edhe z. Demaj nuk kam dashur ta pengojë si person që ta marrë fjalë, por kam dashur ta pengoj një paligjshmëri. Fatkeqësisht ka qenë e pa mundur ta pengojë një paligjshmëri, një praktikë, e cila nuk i bënë nder as një Kuvendi. Bile bile as në vendet jodemokratike, në ndonjë diktaturë si në Siri, apo ku e di unë ku, nuk i bënë nder Kuvendit që të vijë dikush nga jashtë dhe të marrë fjalë me vullnetin e vetëm të një njeriut, pavarësisht që ai të jetë edhe kryetarë i Kuvendit.

Në këtë kuptim, më duhet të them se është e pashmangshme që gjërat të personalizohen, por jo të personalizohen në mes grupit parlamentar ORA, ose të deputetëve të grupit parlamentar të LDK-së, por të deputetëve të ORË-s dhe njeriut që përfaqëson Kuvendin, e njeriu që përfaqëson Kuvendin është kryetari i Kuvendit, ai është Nexhat Daci sot dhe nesër mund të jetë dikush tjetër. Këso personalizimesh do të kemi sigurisht gjithmonë që ky Kuvend has në shkelje të ligjshmërisë dhe të procedurave të funksionimit të vet.

Të nderuar kolegë deputetë, në praktikën parlamentare të vendeve të ndryshme të botës ekzistojnë forma të ndryshme të organizimit të qeverisjes. Ekzistojnë vende që bëjnë qeveri me 19, 15 apo 16 ministra, ku e di unë sa. Ekzistojnë mënyra të ndryshme të dhënies së kompetencave, të delegimit të kompetencave nga ana e kuvendit apo të ministrave për ta ushtruar një veprimtari. Ka pasur praktika parlamentare, ose praktika qeveritare më mirë të them, kur kanë ekzistuar ministra për ndërtim nëpër qeveri të ndryshme të vendeve të ndryshme, madje ka praktika edhe në rrethinën tonë, ku ekzistojnë ministra për investime kapitale. Në Serbi e kemi në nivel një A. Iliq, që është një gjeni prej politikani, i cili merret me menaxhimin e investimeve publike në Serbi.

Në Qeverinë e Kosovës nuk është paraparë ministër për investime, sepse nuk është pa e arsyeshme. Të gjithë ministrat i kanë menaxhuar në një mënyrë apo në një mënyrë tjetër investimet nëpër ministrat e tyre, ose është një ministër i pashpallur për investime, e ky

është z. Daci. Gjashtë milion e gjysmë euro, të nderuar kolegë, për katër vjet të ekzistencës së këtij Kuvendi janë menaxhuar nga z. Daci në investime publike dhe kështu sinqerisht është e pamundur që të mos i bëjë njeriu vetes pyetje për nga interesimi në ndërtime. Z. Daci për kah afiniteti i tij profesional është kimist dhe nuk ka shumë të bëjë me ndërtime, nuk ka shumë të bëjë me konsultime, mbetet vetëm një përfundim, fatkeqësisht të nderuar kolegë deputetë, z. Daci si akademik dhe si kimist e ka gjetur formulën alkimike si mund të shndërrohet çimentoja në ari, si mund shndërrohen dërrasat në ari dhe prandaj z. Daci insiston që të gjitha këto investime, të cilat janë kapitale dhe të cilat sigurisht që i duhen Kosovës dhe institucioneve të Kosovës, të kryhen sa më shpejt, sa më parë, deri sa është në krye të Kuvendit, sepse nuk kemi nevojë të bëhemi anglez. Ne këtu të gjithë e dimë se si udhëhiqen investimet, se si organizohen tenderimet. Ne e dimë se në rastet më të këqija 20% i tërë asaj shume futet në gjepat e dikujt. S'ka nevojë që të bëhemi ne këtu anglez. Ne duhet ta themi fjalën hapur edhe në këtë foltore. Ky është interesi i z. Daci, është pikërisht ajo përqindje të cilën ai e fut në gjep. Mund të thoni që po e sulmoj, po bëj akuza pa mbulesë. Fatkeqësisht është vërtetë se vështirë mund të dokumentohet korrupsioni. Mirëpo, në shoqëri të cilat pretendojnë që ta organizojnë jetën e tyre në një mënyrë shembullore, si i kemi shembujt, që shpesh i zëmë në gojë, nga perëndimi, nga shtetet e Bashkuara të Amerikës, prandaj duhet të insistohet që kjo të arrihet, edhe pse donë kohë, donë punë, donë mund, donë përkushtim, nuk donë avokati banale të shkeljes së ligjit. Nuk mund t'i bësh avokati shkeljes së ligjit dhe është e pa kuptimtë vetëm të mundohen njerëzit njerëzit në përpjekje për t'i bërë avokati shkeljes së ligjit.

Shkelja e ligjit duhet të konstatohet edhe duhet të merren masat që të sanksionohet në mënyrën më të qëlluar. Kjo mund të bëhet po qe se ne të gjithë, deputetë të nderuar, të gjitha grupet parlamentare jemi në nivelin e autoritetit të deputetit. Nuk mund ta bëjë Grupi parlamentar ORA me 7 deputetë, se thjeshtë nuk e ka fuqinë votuese për ta bërë, mirëpo po qe se të gjithë ju të tjerët jeni në dispozicion të këtij Kuvendi dhe jeni të prirë që këtë Kuvend ta ngritni në cilësi të ushtrimit të përgjegjësive të veta, ne mund ta bëjmë fare letë. Mund të formohet komisioni i cili do të analizojë rrjedhën e tërë këtij procesi, do të shihet aty se a është përdorur apo është keqpërdorur z. Demaj apo a është instrumentalizuar z. Demaj apo jo mund ta konstatojmë bashkërisht të gjithë se a janë marrë vendimet a s'janë marrë vendimet. Si ka shkuar puna, mendoj se ky Kuvend duhet përfundimisht ta kryej punën e vetë ose të fillojë ta përmirësojë cilësinë e ushtrimit të detyrës së vet. Kjo ka do të ndodhë, nëse jo tash do të ndodhë pak më vonë, por gjithsesi do të ndodhë. Prandaj, edhe një herë duke kërkuar falje atyre të cilët e kanë ndier veten të fyer me rastin e ndërhyrjes sime dhe të protestës sime të shpallur këtu, unë e përmbyllë fjalën time.

Ju faleminderit

**KRYESUESI, NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit z. deputetë, fjalën e ka deputeti Nimon Alimusaj le të përgatitet Veton Suroi.

#### DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ:

Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë, jam plotësisht i vetëdijshëm për rolin që duhet ta ketë opozita të gjurmojë lëshimet e pozitës t'i theksojë ato dhe t'i akuzojë dhe një opozitë të tillë e cila akuzon në mënyrë të bazuar e admirojë dhe do ta admirojë për herë, por mu nuk më brengosin as akuzat e pa bazuara siç ishin disa nga ato që i dëgjova sot, unë po sjellë vetëm një shembull që nga oratori i parë që e ngriti akuzën u tha se nuk është miratuar buxheti për objektin për të cilin bëhet fjalë kurse unë e di mirë dhe jam i informuar mirë se buxheti për një objekt të tillë është miratua në këtë Kuvend edhe për vitin 2004, 2005 dhe 2006 dhe asnjë zhurmë në këtë Kuvend nuk është bërë për atë buxhet, pra nuk më brengosin madje as ato fjalime me zhargone që nuk i shkojnë nuk i bëjnë hije një deputeti madje as britmat aq të vrazhda që dëgjohej nga karika e shenjtë e deputetit, nuk më brengosin këto edhe kur i drejtohen kryetarit të Kuvendit i cili del nga partia ime, pra nuk më brengosin atentatet e karaktereve sepse jemi familjarizua me atentatet e tilla edhe më herët por për çudi më të madhe në mënyrë ma naive pastaj janë kërkuar në mënyra tërthorta falje për atentate të tilla karakteresh, mu më brengos pa masë përpjekja me ngulm e disa subjekteve ose një subjekti që të përhapet në Kuvend filozofia e sherrit filozofia e përçarjes në këtë moment historik për Kosovën dhe kjo filozofi e dëmshme po përdorë për çdo temë kemi pas akuza më të rëndat edhe kur është diskutuar edhe për ndonjë Projektligj, nuk është fol fare për projektligjin por është fol për ministrin ose ministrin që e ka sponzoru ligji, një filozofi e tillë e sherrit, unë jam shumë i sigurt që do të na sjell shere dhe probleme, prandaj kërkesa e ime e parë do të ishte në këto momente të rënda të mos e përdorim një filozofi të tillë se edhe atij që e përdorë një diçka të tillë nuk do ti sjellë dobi, dhe jam shumë i sigurt se disa mendojnë se një filozofi e tillë para qytetarëve të Kosovës do 'ju sjellë dobi si një subjekt që e akuzon për keqpërdorime në këto momente kur papunësia varfëria këto janë shumë të mëdha, populli tash më këto e dinë këtë. Ju faleminderit.

#### KRYESUESI, NAIM MALOKU:

Ju faleminderit z. deputetë fjalën e ka deputeti Veton Suroi, le të përgatitet Gani Koci

#### DEPUTETI VETON SUROI:

Zonja dhe zotërinj, ndoshta për ta relaksuar atmosferën do të ishte rendi që prej këtij Kuvendi t'ju urojmë gjithë të dashuruarve ditën e Shen Valentinit dhe që të mos mërzhiten, të gjitha këto kalojnë, vinë ditë të tjera edhe manifestohen në formë tjetër.

Para dy javësh ka ndodhur një ngjarje e madhe perceptimin e së cilës ende nuk e kemi tërhequr si shoqëri. Fuqitë e mëdha, Grupi i Kontaktit ka vendosur në Londër që ta kalojë rubikonin dhe që si akt final të procesit negociator të shpall predileksionin, afinitetin nga pavarësia. Kjo do të thotë se grupi i kontaktit në masë të madhe po heq dilemën se a do të jetë Kosova e pavarur apo jo, dhe ky është një zhvillim i madh i shteteve të fuqishme të cilat e shohin nëpërmjet edhe të statusit të Kosovës stabilitetin rajonal.

Por njëkohësisht është edhe kontratë sepse nuk do të thotë se ekziston dilema në mes pavarësisë apo jo por ekziston dilema përmes Kosovës së pavarur demokratike dhe funksionale, apo Kosovës jo funksionale jo demokratike.

Kjo dilemë në shoqërinë tonë ekziston ende dhe kjo dilemë në shoqërinë tonë të vështruar nga Bashkësia Ndërkombëtare ka arritur në pikën e vetë kulminante. Bashkësia ndërkombëtare nëpërmjet të dërguarve të vet në mënyrë eksplicite na është adresuar me kërkesën që ky partneritet, kjo kontratë të përfundoj jo vetëm me pavarësinë e Kosovës por me Kosovën e pa varur demokratike dhe funksionale. Një pjesë të kësaj kontrate e kishim më herët dhe për z. Geci i cili e përshkroi biografinë time ka qenë ndoshta rendi të përshkruaj se një pjesë të kontratës e kam nënshkruar unë për bombardimet e NATO-s fillimisht vetëm më vonë natyrisht me Kryetarin Rugovë me z. Thaqi dhe me Z. Qosje.

Kjo kontratë e perëndimit del ndonjëherë në histori, ka dalë një herë në histori në Rambuje dhe një herë në histori sot. Dhe duhet të sillemi me përgjegjësinë historike dhe të përbashkuar. Ajo çka ndodhi sot është fillimisht mesazh krejt i kundërt prej atij se çfarë duhet t'i japim Bashkësisë Ndërkombëtare. Ndodhi dhunimi i demokracisë me praninë e një njeriu i cili nuk është anëtarë i Kuvendit dhe të cilit ne nuk i dhamë leje, ne lejuam zonja dhe zotërinj të shkelet dinjiteti ynë, dhe njëkohësisht shkelet dinjiteti i Kosovës, të asaj Kosove demokratike për të cilën aspirojmë. Në një moment dhe me kaq do të përfundojë personalizimi. Shpresoj unë në një moment kur ju shtrua pyetja kryetarit të Kuvendit për blerjen e veturës, ai tha: gjenetiki kishte patur vetura gjatë tërë jetës, ky është një interpretim bukur lateral besoj i gjenetikës nuk ka lidhje me shkencë shumë, por dëshmon edhe një dallim esencial se çka është gjenetika.

Gjenetika zonja dhe zotërinj, kodit gjenom ka vërtetuar se nuk ekziston dallim substancial mes njerëzve, se gjithë njerëzit janë të njëjtë edhe të bardhët edhe të zitë edhe të kuqët, gjithë janë të njëjtë. Ekziston shumë pak diferencë mes tyre dhe kjo gjenetikë na nevojitet sot për të demonstru se të gjithë këtu jemi të barabartë në këtë Kuvende dhe kjo është porosia jonë, porosia të cilën deshëm ne 40 deputetë të Kuvendit të Kosovës që ta japim: Është se ne jemi të barabartë në këtë Kuvend, çdo njeri prej nesh dhe se këtë barazi, këtë dinjitet njerëzor, këtë dinjitet parlamentar duhet ta mbrojmë, nuk mendoj se duhet të replikojë ndaj sulmeve që mua më bëhen personalisht. Qenë të rënda z. Geci, por t'i i din edhe dy shënime, i pari kur e përmendini motrën time duhet të kishit respekt edhe ndaj saj edhe ndaj territorit prej nga vini sepse gjatë luftës ju ka ndihmuar me barna aq sa ka mundur duke e rrezikuar jetën e saj. Mos e personalizoni këtë konflikt, ju dalë bollë unë mos e futni edhe motrën time, nuk është as burnore as e drejtë e as parlamentare.

Çështja e dytë është se në tërë këtë proces ne mund t'i kemi pasur dallimet edhe mes veti, por në fund kemi mbërritur që në momentet kur kemi ardhur ta krijojmë unitetin, nuk mendoj se ndaj sulmeve personale që mi adresuat dua të përgjigjem me sulme me ofendim, mendoj se ofendimi ndaj jush do të ishte ofendim edhe ndaj meje si anëtarë i Kuvendit duke ju ofenduar juve z Geci edhe të tjerët do të ofendoja anëtarin e Kuvendit njeriu i cili e ka marrë votën e popullit, ne gjithë kemi përgjegjësi ndaj qytetarëve tanë, ato çka deshëm ta japim si mesazh shpresoj se do ta kuptoni, nuk është që të shtrojmë

pyetje a është një udhëheqës i lartë i LDK-së i implikuar në vendimet e paligjshme, çështja është se një kryetar i Kuvendit i pari ndër të barabartë, primus interparis, sipas mendimit tonë ka shkelur rregulloret i vazhdon t'i shkelë ato dhe e shpërfillë dinjitetin tonë edhe njerëzor edhe krye parlamentar, ne nuk kemi ndër mend ta ndërrojmë z. Dacin as nuk kemi forcë për atë, është çështja e vendimit të përbashkët jo për të nderuar dikend apo jo, por për të konstatuar të vërtetën, ta konstatojmë bashkërisht të vërtetën pastaj do të marrim vendime, ato vendime natyrisht do të shkojnë edhe me peshën që çdo njeri prej nesh e ka nga ana e votës së popullit.

Para një jave ose para disa ditësh hiq ma larg arritëm që këtë unitet ta manifestojmë me zgjedhjen e kryetarit, apeloj të ju që ta ruani dinjitetin e Kuvendit të Kosovës, ruani dinjitetin tuaj si anëtarë të Kuvendit të Kosovës. Në një iniciativë të përbashkët për formimin e komisionit hetimor i cili duhet të bëjë vetëm një gjë të konstatojë të vërtetën dhe ta sqarojë këtë gjendje dhe këtë situatë të na hiqet nga rendi i ditës kjo. Zonja dhe zotërojtë, do të ishte mesazhi i demokracisë i cili nevojitet për partneritetin të cilin duhet ta mbërrim në Bashkësinë Ndërkombëtare. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit, fjalën e ka për replikë deputeti Fadil Geci ju lutem

**DEPUTETI FADIL GECI:**

Do të ndalem në dy çështje që mi adresoi. Ju faleminderit për ato fjalë të mira që i tha se edhe unë kam fjalë të mira por dua të them vetëm një, motrën nuk e sulmova por tregova që ajo punon në kompaninë e tij koha dhe asnjë fjalë tjetër fyese për te nuk thash të jetë e qartë, e dyta, shumë mirë po më vjen që po thotë se kam nënshkruar për bombardimin e NATOS, mos ju ka përzier Vetonit mos ka nënshkruar për sigurimi ne Serbisë ndonjë gjë e ju ka përzier e ka dalë andej, këtu mos ju ka përzier, ju faleminderit.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU:**

Më falni, Veton Surroi e ka fjalën

**DEPUTETI VETON SURROI:**

Më falni porosia ime ishte dhe mbetet të ruhet dinjiteti. Nuk kam ndërmend të përgjigjem në të njëjtën formë, dinjiteti i Kuvendit të Kosovës është më i lartë se që mund të jetë kënaqësia e të replikuarit me ndonjë ashpërsi. Ju faleminderit

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit z. deputetë, Gani Koci e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Behxhet Brajshori.

## DEPUTETI GANI KOCI:

Ju faleminderit për fjalën, nuk e kam pas ndërmend të diskutoj por sikur ky debat ka marrë një kahje të tillë që në një farë mënyre jemi barikadu dikush të sulmojë dhe dikush të mbrohet, gjë që nuk konsideroj se esenca e këtij debati duhet të jetë kjo, e keqja është sepse ne nuk jemi mësuar me debatet e tilla dhe në diçka që nuk jemi mësuar se natyrisht se mund edhe të iritohemi e keqja tjetër është sepse edhe kur është kërkuar debate të tilla më herët gjithmonë janë injoruar dhe nuk është debatuar deri në fund që në një mënyrë për çështje të njëjta mos të vijmë në situatë të njejtë unë duhet të përmendi vetëm një fakt që diku me 15.01.2004 kemi pas bërë një kërkesë për krijimin e një komisioni hetimor kur ishte në pyetje renovimi i sallës të Kuvendit këtu që jemi tash sot dhe mënyra se si është proceduar mënyra se i janë marrë vendimet dhe mënyra arbitrare është refuzuar një kërkesë e tillë dhe jam i bindur që po të realizojë kjo atëherë nuk do të vinim të njëjtën çështje thuaja për të njëjtën gjë që të diskutojmë sot se qysh atëherë disa probleme dhe disa çështje do t'i kishim sqaruar. Se është vepruar atëherë keq dhe po veprohet sot keq ne jemi ka e shohim këtë dhe nuk do diskutim të madh, nga diskutuesit u tha këtu se nuk duhet t'i frikohemi hetimeve se vërtetë nuk duhet ti frikohemi hetimeve për të qitur në shesh të bërat ose të pa bërat tona të institucioneve tona dhe kujdo qoftëshin ato dhe kjo për hirë që vërtetë kemi institucione dhe çfarë duhet t'i kemi dhe natyrisht kemi edhe njerëz në ato institucione çfarë duhet të jenë. Lidhur me renovimin e kësaj sale do të kthehemi pak mrapa ka pas atëherë edhe një vendim një dokument të organit rregullatorit të prokurimit publik të cilin do tua lexojë disa pjesë këtu edhe që nuk është vepruar edhe mbi bazë të atij dokumenti sikur të ishte vepru sot do të ishim ndryshe nuk do të na shtrojë çështja kjo temë as ajo qendra protokollare atje. Duke marrë parasysh këto fakte gjithnjë po flas për një çështje të njejtë të ma hershme dhe rëndësinë e renovimit të ndërtesës së asamblesë së Kosovës organi rregullatorit publik të prokurimit publik kërkon që të formohet një komision i përbërë nga zyrtarë kosovarë të institucioneve publike dhe të UNMIK-ut për të verifikuar të ashtuquajturat "gabimet e cekura në dokumentet e ofertimit e posaçërisht faktin mbi përpilimin e specifikacinit teknik gjegjës të atij tenderimi, organi i rregullatorit prokurimit publik kërkon që pas konstatimit të komisionin mbi verifikimin e shkeljeve të supozuara të ndërmerr masa ligjore ndaj personave të cilët me veditje ose pa të kanë bërë konfuzitet në dokumentacionin e ofertimit, dhe vërtetë edhe Kryesia e Kuvendit sikur edhe organi i prokurimit publik sikur edhe vetë Kuvendi të ishte përgjigjur shkresave të tilla për shkelje të tilla jam i bindur se nuk do të ndodhnin shkelje të tjera të supozuara gjithnjë siç kanë ndodhur tash edhe me qendrën protokollare që është në fazën e vetë përfundimtare, e ajo që thuhet këtu se për hirë çështjeve madhore mos të meremi me çështje të vogla unë jam i bindur se edhe ata që na përcjellin edhe faktori i brendshëm edhe faktori i jashtëm nuk është i interesuar që të bëjë një Kosovë të pa varur me institucione këso fare i kemi dhe me njerëz të tillë se çfarë janë në institucione. Nuk besoj që Kosovës së pavarur i vyejnë institucione të korruptuara me njerëz të korruptuar. Aq më tepër kjo do të bëhet pengesë për atë që gjithë e dëshirojmë dhe gjithë e synojmë por që ti iket kësaj problematike dhe vërtetë si u tha mos të personalizohen gjërat të bëhet një komision hetimor dhe të konstatojë atë që do ta konstatojë vetë komisioni dhe pastaj ky Kuvend të merë vendim mbi bazë të atyre konstatimeve. Në qoftëse thuhet se ka pasur shkelje të verifikojë



komisioni në qoftëse vihet deri te ato shkelje dikush duhet të japë llogari, dikush duhet të japë përgjegjësi.

Ne i kemi nëpër duar shumë raporte të auditeve të jashtme dhe të brendshme nëpër institucione tona dhe kemi parë se çfarë shkeljesh kanë bërë në të kaluarën në vitin 2003 e 2004 edhe në vitin 2005 dhe deri më sot nuk e di asnjë institucion asnjë përgjegjës nga një institut që së paku moralisht është përgjigj për shkelje të till, dhe në këtë drejtim vërtetë neve kemi gjithçka por nuk e kemi institucionin e përgjithësisë as përgjegjësisë morale as përgjegjësisë politike që besa as asaj që është mbi të gjitha përgjegjësi njerëzore. Prandaj ky debat do të duhej të sillte përfundimin që të bëhet ai Komision hetues të hetoj çështjen dhe të biejë te përfundimi dhe në fund të fundit komisionet e tilla të ngritën për të hetuar edhe secilin deputet veç e veç, edhe secilin institucion veç e veç vetëm në atë mënyrë mund të themi se jemi transparent vetëm në atë mënyrë mund të themi se jemi përgjegjës ndaj votës dhe ndaj besimit që na kanë dhënë qytetarët tonë. Përndrysh ne do të debatojmë ditë e natë me akuza që na uan sjellura këtu dhe problemi dhe çështjet nuk do të zgjidhen asnjë herë. Ju faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit z. deputetë, për fjalë tani janë lajmëruar edhe 6 deputetë, unë propozoj që ta dëgjojmë deputetin Behxhet Brajshori dhe të shkojmë në pauzë deri në ora 3 dhe pas pauzës pastaj ta dëgjojmë debatin.

**DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI:**

Faleminderit z. kryesues, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë.

Po më duket se të gjithë së bashku që në fillim e kemi bërë një lëshim të vogël për të mos them një gabim por një lëshim gjithësesi dhe sigurisht pa qëllim asnjëri prej nesh.

Cili është ai lëshim, pikërisht duke pasur parasysh zhvillimin e ngjarjeve në muajin e fundit në Kosovë me dhimbjen e madhe që patëm për presidentin Rugova dhe vazhdojmë ta kemi më tutje por edhe me ecje pozitive në këtë drejtim ditëve të fundit në Kosovë dhe ato që na presin në të ardhmen dhe shumë shpejtë kjo çështje e debatuar tash po më duket se me një farë forme thjeshtë na vënë para dilemave ose na vënë para asaj që e kemi ndie ose përgatitemi ta bëjmë karshi problemit madhor të Kosovës, jo për të minimizuar problemet jo për të mos i marrë me i diskutuar ato por thjeshtë për të pa se çka në një moment të caktuar është e lëvërdishme për tu thanë dhe çka jo. E dyta e një fjalori të përdorur aty këtu prej disave nuk dua absolutisht ta adresoj me emër por mua për veti nuk po më pëlqen, ka mënyra tjera të cilat mund të argumentohen gjërat mund të thuheshin gjërat çartë dhe mirë dhe matematik një e një bëjnë dy dhe nuk bëjnë tri kur një herë. Nuk e di asnjë grup parlamentar këtu në Kuvendin e Kosovës që mund të jetë më i thirrur se sa grupi parlamentar i LDK dhe i interesuar po ashtu po ashtu për transparencë në të gjitha fushat dhe për zhvillim pozitiv të ngjarjeve, ne jemi të interesuar që këto ta bëjmë ta ngrisin nivelin gjithë herë ma të madh dhe natyrisht në bashkëpunim edhe me grupet tjera parlamentare duke respektuar interesimin e tyre për çështjet sikur që janë

edhe këto natyrisht për të kaluar bashkërisht edhe çështjet që mund të jenë diskutabile edhe që mund të shtrohen sikur që është kjo sot. Komisioni parlamentar për buxhet po mundohet që të hyjë në thellësinë e problemeve në monitorimin e buxhetit në përgjithësi të gjitha axhencionet shpenzuese sepse kjo e obligon edhe me rregulloren e punës së Kuvendit, jemi në një fazë të mirë jemi në hapa të mirë por natyrisht se edhe neve na mungon kapaciteti i nevojshëm njerëzor do të thosha dhe ka nevojë si u tha prej diskutuesve këtu që nganjëherë kemi edhe angazhime, do të thosha të resurseve njerëzore për tu ardhur deri te përfundimet e duhura.

Unë kolegë të nderuar deputetë e kam një propozim, nëse pajtoheni të gjithë një propozim konkret, dhe ai propozim është se kjo çështje debatohet paraprakisht në Kryesinë e Kuvendit, Kryesia e Kuvendit të bëjë raport për Kuvendin e Kosovës ne do të diskutojmë pas edhe për këtë çështje edhe për çështje tjera të cilat mund të na interesojnë. Ju faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit z. deputetë po lajmërohen vazhdimisht edhe 6 deputetë, kërkesë e një numri të madh e deputetëve është që deri në ora tre për shkak të fillimit të transmetimit të ..... që të kenë mundësi të përcjelljes së paku një orë, pra propozimi është që të vazhdojmë në orën 3. ju faleminderit.

(Vazhdimi - seanca plenare e datës 14.2.2006, pas pauze 3.00)

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju lutem deputetë, vazhdojmë me seancën me debatin në lidhje me pikën 13 të rendit të ditës, prezentë janë 79 deputetë, mund të vazhdojmë, për fjalë është paraqit deputetja Nekibe Kelmendi, e keni fjalën.

**DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:**

I nderuari z. kryesues, të nderuar kolegë deputetë.

Unë nuk desha të paraqitem me fjalën time në këtë seancë, mirëpo më nxiti një konstatim për pendimin tim nuk qëndron.

Fjala është për atë se këtu u tha se u dhunua demokracia për faktin sepse në foltore doli sekretari i përgjithshëm i Kuvendit të Kosovës z. Isuf Dema. Unë daljen e tij në foltore dhe drejtimin e tij nuk e konsideroj si drejtim deputetëve të Parlamentit të Kosovës, por e konsideroj si përgjigje të tij, dhënë lidhur me pjesën e diskutimit i cili i referohet vendimit për nismën e procedurës për ndërtimin e qendrës administrative. Ky vendim në fakt nënkupton përgatitjet teknike për ndërtimin e asaj qendre administrative. Këtë e eksplikoj edhe në fjalën e vet edhe sekretari i përgjithshëm z. Isuf Dema. Duke u bazuar

në atë se është njeriu i parë i administratës së Kuvendit. Kaq desha të them sepse këtu të thuhet se po dhunohet demokracia nuk ka vend sepse kemi pas raste kur na janë drejtuar edhe njerëzit që s'kanë qenë deputetë, kemi pranuar t'i dëgjojmë .  
Faleminderit!

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Faleminderit z. Deputet, për fjalë është paraqit shefi i Grupit Parlamentar i LDK-së prof. Alush Gashi, e keni fjalën.

**DEPUTETI ALUSH GASHI:**

I nderuari z. kryesues, sot është shtruar një çështje shumë e rëndësishme, u shtrua për debat çështja e transparencës së punës së Kuvendit të Kosovës. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, që nga seanca e parë garanton angazhim për një transparencë të plotë, në kuadër të rregullave ekzistuese të punës së Kuvendit të Kosovës.

Lidhur me pikën e rendit të ditës deri më tani, janë dëgjuar shumë pro dhe kundër dhe natyrisht, për ne si grup parlamentar dhe besoj edhe për deputetë të tjerë. Pyetja është se si të vijmë deri te një e vërtetë parlamentare? Mendoj se e vërteta parlamentare ka mundësi që të arrihet në kuadër të rregullave ekzistuese, në bazë të së cilave punon, ose së paku duhet të punon Kryesia dhe Kuvendi i Kosovës në tërësi.

Në këtë rast z. kryesues, ju përkujtoj se në seancën e 19. dhjetorit të vitit 2005, kur u ngrit kjo çështje nga partitë opozitare. Grupi Parlamentar i LDK, për qëllim të dhënies së kontributit me një debat konstruktiv ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës, që lidhur me këtë çështje të seancës plenare t'ia përgatit një raport. Kërkesën e atëhershme e bënë më të fuqishme debati i sotëm dhe kërkojmë që Kryesia e Kuvendit të Kosovës, në kuadër të Rregullores së punës të organizimit të brendshëm ta analizojë debatin e sotëm, ta analizojë tërë dokumentacionin të cilin e posedon, dhe në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës të debatohet, dhe Kryesia para seancës plenare del me rekomandimet e veta. Ne mendojmë se nuk jemi në fazë të organizimit të një hetimi të posaçëm sepse konsiderojmë se nuk janë shterë mundësitë të cilat i afron Rregullorja e punës e Kuvendit të Kosovës. Me këtë rast, përgëzoj kryetarin e Kuvendit se në këtë pikë aq të ndjeshme e hapi seancën e vet dhe premtoi një debat konstruktiv me kohëzgjatje aq sa e shohin të arsyeshëm deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Lidhur me propozimin tonë i ftojme grupet parlamentare në koalicion si edhe opozitën që të na bashkëngjiten dhe ne ta vazhdojmë punën si Kuvend, për ne kjo nuk është një mbledhje e jashtëzakonshme, është një mbledhje për të cilin ne në fillim kemi garantuar që do të jemi transparent dhe i qëndrojmë premtimit tonë sepse është substanca po themeli i programit të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ju faleminderit z. kryesues.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit prof. Për fjalë janë paraqitë edhe katër deputetë. Fjalën e ka deputeti Genc Gorani, le të përgatitet deputeti Fetah Berisha.

#### DEPUTETI GENC GORANI:

Ju faleminderit z. kryesues, zonja dhe zotërinj deputetë, gjer më tani kemi qenë dëshmitarë të shumë argumenteve pro dhe kundër kësaj, që është përmend në lidhje me këtë çështje. Ne faktikisht e kemi në dorë një përmbledhje të dokumenteve e cila përmbledhje e ka autenticitetin e vet dhe nuk mund të jemi të pa shqetësuar ndaj asaj se çka dëshmojnë këto dokumente. Këto punë janë tonat dhe ne duhet t'i zgjidhim këtu mes nesh. Ka shumë çështje parimore që ngriten lidhur me këtë, e njëra prej tyre është llogaridhënia. Ne nuk mund të mos jemi të shqetësuar, kur e shohim që llogaridhënia ligjore e paraparë me ligjin anashkalohet dhe anashkalohet në ato raste kur me të drejtë shihet se diçka fshihet. Llogaridhënia është bazë, një prej bazave të funksionimit tonë demokratik dhe kur thuhet ose mendohet se kërkesa për llogaridhënie është një lloj shqetësimi artificial, mollë sherri, u kisha thënë që është anasjelltas. Kur nuk jepet llogaridhënia, kur nuk zbatohet llogaridhënia, atëherë është burimi i këtyre shkeljeve të ligjit edhe të sherrit. Pse dhe është simptomatike në fakt që duhet me muaj të tanë një anëtar i Kryesisë së Kuvendit t'i kalojë për t'i marrë dokumentet të cilat janë apriori publike që nuk janë në asnjë mbrojtje ligjore ose ndonjë regulative tjetër. Kur një anëtar i Kryesisë së Kuvendit, organi më i lartë i Kosovës i duhen muaj të tanë, pesë muaj, për t'i marrë dokumentet elementare të kësaj shtëpie tonë. Çka me thanë për situatën e një qytetari të thjeshtë të cilët jemi ne të gjithë, para se gjithash. Ky është një aspekt i parimit të demokracisë për të cilën desha të bisedoj.

Ne duhet ta qesim këtë në dritë, ne duhet ta propozojmë një mekanizëm një procedim të mëtutjeshëm që është përmend nga parafolësit e mijë që ta qesim këtë qartë, ta dokumentojmë si duhet deri në fund. Nëse ka përgjegjësi ato duhet t'i evidentojmë e të shkojmë përpara. Ne nuk mund të jemi peng të disa personave ose të disa çështjeve që dikush i konsideron tash jo të rëndësishme e ashtu me radhë.

Ku thuhet se s'është momenti t'i diskutojmë këto, nuk është kurrë momenti ti diskutojmë, dakord, thuhet se s'është momenti sepse në këtë rast jemi në një situatë ndërkombëtare e delikate dhe është me rëndësi mos të bëjmë shumë shere në mes veti. Dakord, kërkohet uniteti po mirë, a të kërkohet uniteti, a ta manifestojmë për rreth vlerave dhe mekanizmave demokratike, apo bëjmë unitet duke e sakrifikuar të vërtetën, ta quajmë atë parlamentare, dokumentare që nuk është me rëndësi. Prandaj jam i mendimit se duhet patjetër p.sh në një komision hetimor në fund të fundit, i cili pikë së pari e vlerëson validitetin e këtij dokumentacioni dhe mandatohet të shkojë deri në fund, kjo është ajo esenciale që mendoj se nuk duhet të na frikësojë t'i tërhiqemi kësaj përgjegjësie. Në një moment, ne po ashtu kemi lejuar që z. sekretar ta marrë foltoren. Në rregull, të përkujtojmë një fakt. Ka pas shumë raste gjatë këtij legjislacioni kur ne kemi mundur dhe është dashur që t'i ftojme njerëzit tjerë të cilët nuk janë deputetë ta marrin fjalën këtu në foltore, për mos asgjë tjetër e kisha përmend rastin kur arsimtarët tanë u detyruan të jenë në rrugë, në greva për ta kërkuar të drejtën e tyre. Ne nuk kemi reaguar në atë mënyrë që e kemi ftuar dike këtu në foltore. Ndërkaq tash pa vendim të Kryesisë,

pa shqetësim, i kemi dhanë foltoren dikujt, pra këtë desha ta theksojë dhe mos ta zgjasë më tepër sepse pjesa më e madhe e argumenteve është thënë. Ju faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Faleminderit z. deputet.

Fjalën e ka deputeti Fëtah Berisha, le të përgatitet deputeti Gjegj Dedaj.

**DEPUTETI FETAH BERISHA:**

Faleminderit z. kryesues, të nderuar kolegë deputetë.

Për materialin që ne të gjithë e kemi para veti, paraqitur nga Grupi Parlamentar ORA, për Qendrën Protokolare - Administrative Gërmia, për shpenzimet buxhetore të Kuvendit. Si po e shihni i gjithë është dhënë sekretaria dhe administrata e Kosovës. Nëse i shikoni datat në secilin dokument, atëherë do të shihni se këto dokumente janë dhënë në vazhdimësi dhe janë prezantuar në Kryesi të Kuvendit. Me këtë, me fakte, hedhen poshtë akuzat e subjektit politik ORA, se gjëja atyre nuk iu janë dhënë dokumentet e nevojshme dhe në kohë të duhur. Unë këtu kam vërejtje në shërbimet që i kanë dhënë këto dokumente, që së paku me këto nuk kanë dhënë edhe udhëzime për mënyrën e shfrytëzimit të këtyre dokumenteve, sepse një medium ditor i Kosovës, duke shfrytëzuar afërsinë me liderin e partisë ORA, e ka publikuar një pjesë të këtyre dokumenteve dhe i ka komentuar jo saktë dhe jo në mënyrë profesionale. Me këtë konsideroj se i është bërë dëm Kuvendit të Kosovës dhe autoritetit të tij në popull. Secili institucion, e në rend të parë Kuvendi i Kosovës, duhet ta ketë një rregullore të veçantë apo një urdhëresë administrative me të cilën rregullon marrjen apo posedimin apo përdorimin e dokumentacionit dhe për mënyrën e shfrytëzimit të tij. Duhet të dihet se cilat dokumente dhe në cilën fazë janë të mundshme të botohen dhe të dalin në publik dhe cilat dokumente janë në përdorim të brendshëm. Si ja kemi nisur ne kështu një ditë do të akuzohemi për kafet që i pimë këtu, ose do të akuzohemi edhe për blerjen e materialit shpenzues e të ngjashme. Unë nuk po shoh ende se ORA në gazetën e vet, apo në cilin do medium tjetër, po e publikon edhe transparencën financiare të vetën edhe të partisë së vet, apo të kryesisë së saj, apo të mëditjeve, apo të udhëtimeve, apo shpenzimeve tjera, apo të qirasë, të mobileve, apo të telefonave, sikur që po e kërkon dhe po e boton dokumentacionin nga Kuvendi i Kosovës. Kjo në fund të fundit le të mbetet në principaletin e saj.

Për secilin njeri që ia do të mirën Kosovës dhe institucionit ku punon do të ishte shumë normale që këto dokumente të Kuvendit, pasi edhe ashtu janë futur për debat në një seancë publike siç është kjo, të dërgohen në gazetë pasi të jetë përmbyllur debati dhe pasi të jenë dëgjuar të gjitha palët me argumentet e veta. Por kjo nuk ndodhi me ORËN, kjo i botoi dokumentet dhe mbi to ndërtoi shpifje dhe akuza. P.sh. gazeta "Koha ditore", më datën 18. 2006, në faqen e parë me germa të mëdha në mënyrë sensacionale e botoi shkrimin e titull: Zyra e Dacit 500 euro një mëditje për Brezovicë. Duke ngritur kështu tensionin në popull, se Zyra e kryetarit të Kuvendit të Kosovës po e merr një mëditje prej 500 eurosh për të shkuar në Brezovicë. Atëherë kur populli është i varfër, kur kategoritë e

ndryshme kanë nevoja të mëdha e tjerë e tjerë. Kjo është një gënjeshtër sipas meje e mbështjellë me një propagandë për të denigruar, që e dinë edhe të gjithë deputetët e ORËS, sepse ata e dinë si merren mëditjet dhe sa është shuma e një mëditje brenda Kosovës apo jashtë Kosovës, se të gjithë këta vetë kanë marrë mëditje nga Kuvendi i Kosovës. Për ta sqaruar këtë çështje, ia bëra një pyetje drejtorit të Departamentit të Buxhetit dhe të Financave të Kuvendit të Kosovës Jusuf Nikçit. Pyetja ishte se a kanë marrë mëditje për qëndrim kudo në Kosovë kryetari i Kuvendit Nexhat Daci, këshilltari i lartë Ahmet Alishani, këshilltari politik Ramush Tahiri dhe asistentja ligjore dhe këshilltarja Zoja Osmani? Në cilin rast kanë marrë dhe sa ka qenë shuma? Përgjigjja me shkrim e drejtorit Jusuf Nikçit ishte se këta që u përmendën, asnjëri nuk ka marrë asnjë mëditje për qëndrim në Kosovë, as në Brezovicë e as gjetiu. Pra, kryetari i stafit të tij, asnjëherë për katër vite pune ,nuk kanë marrë asnjë cent për mëditje e lëre më 500 euro, gjë që ORA nuk mund të thotë të vërtetën. Pozicioni sipas kodit 1130 për të cilën gazeta "Koha ditore" shpifte të nesërmen, po në faqen e parë ,kinse po e thërret Uka zyren Daci. Gjysmë mëditje në shumë prej 25 erosh kanë marrë shoferi i kryetarit Daci, sipas përgjigjes që pata bërë Rexhep Plakolli, polici Naim Gashi dhe polici tjetër Driton Makolli për datën 23 dhe 24 prill të vitit 2005 dhe për datën 29 prill deri në 2 maj të vitit 2005 në shumë, secili për të gjitha këto ditë nga 150 euro, që të tre bashkë në shumën totale bëjnë 450 euro. Gjithashtu shoferi tjetër i automobilit mbështetës për ditët 23 e 24 prill 2005, ka marrë mëditje prej 50 eurosh. Të gjitha pagesat janë bërë përmes llogarisë bankare.

Të nderuar deputetë

Unë kërkoj që këtu t'i lejohej drejtorit të Departamentit të Buxhetit dhe të Financave, z. Jusuf Nikçit, që t'i paraqes llogaritë të përmbyllura për çdo pozicion, e të mos lejojmë që dikush nga ORA, apo kushdo çoftë ai, për qëllime politike t'i shtrembërojë faktet, duke prezantuar dokumentacionin nismëtar që dokumentacioni është përfundimtar. Pastaj gjithashtu, të sqarohet këtu se paratë e harxhuara për veshmbathje çka nënkupton a janë ato veshmbathje për policët e Kuvendit, apo ashtu si edhe bëjnë institucionet tjera botërore, apo janë këtu veshje për stafin civil të administratës dhe kur është marrë ky vendim dhe në cilin shumë vjetore për secilin shfrytëzues.

Të nderuar deputetë

Ky trok i shpifjeve dhe akuzave, ky mosdurim i përfaqësuesit të ORËS, për kryetarin e Kuvendit Nexhat Daci, të bënë dhe të imponon një pyetje, a thua ku mund të ketë burimin dhe cakun, ndoshta qëllimi është për ta denigruar nëpërmes fushatës personalitetin e Nexhat Dacit edhe si funksionar edhe si intelektual edhe si njeri. Ky trok mosdurimi, deri dje ishte aplikuar nga ca persona të papërgjegjshëm edhe kundër presidentit shpirtëror të Kosovës Dr. Ibrahim Rugovës, të cilët tani ashtu si dihej, çdo herë kanë mbetur me gishta në gojë.

Të nderuar deputetë

Sinqerisht t'ju them se respektoj pozicionin e opozitës, jo aq shumë për opozitën se sa për Kosovën. Kosova duhet të jetë e lumtur se tani në këto zgjedhje ka pozitë dhe opozitë. Prandaj një opozitë konstruktive, për problemet e ndryshme alternative, po assesi për të bërë fushata, denigrime për persona të caktuar. Dhe krejt në fund kjo nuk i ndihmon proceset e pavarësisë së Kosovës, për cilin jemi përcaktuar të gjithë, por i denigron edhe ato. Kështu pra e denigrojmë dinjitetin e Kosovës. Ju faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit z. deputet.

Fjalën e ka deputeti Gjergj Dedaj, le të përgatitet Ylber Hysaj.

**DEPUTETI GJERGJ DEDAJ:**

Z. kryesues, të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj.

Kam qenë deri tash në dilemë a mu paraqitë apo jo edhe pse as mos keni shqetësim mos të them diçka që nuk u tha këtu, as diçka shumë të mençur, është vështirë që ta dimë në këtë rast të vërtetën. Flas vetëm në emër të Partisë Liberale të Kosovës, që unë si deputet i kësaj partie në këtë Kuvend të Kosovës, ai duhet me qenë i Kosovës, e jo i partive politike. Muj me thanë se ndihem krejtësisht si me qenë mysafir, e shfrytëzoj vetëm derën për me hy, korridorin edhe këtë sallë, kthehem prapa po të njëjtën rrugë, dhe nuk di sinqerisht është e pandershme nga ana ime që të them me këtë rast se Grupi Parlamentar, respektivisht Partia ORA, ka të drejtë ose nuk ka të drejtë. Sikur që është shumë e pandershme që të them se nga ana e Kryesisë, respektivisht e kryetarit të Kuvendit akademik Dacit, ka shkelje, apo nuk ka shkelje, ka manipulime, apo nuk ka manipulime. Po dua me thanë, kjo është shumë e pandershme, që të thuhet kur skam informacione as elementare. Megjithatë, unë mendoj se duhet të mësohemi, nëse jo tash, në të ardhmen, që të dëgjojmë edhe zërat që janë indiferent, edhe zërat opozitës edhe t'i dëgjojmë mirë kritikën edhe t'i dëgjojmë nëse janë akuzat e bazuara edhe të pabazuara. Në bazë të argumenteve dhe fakteve, t'i dëshmojmë ose t'i shfuqizojmë edhe t'i zhvlerësojmë, por nëse kurgjo tjetër Kosova në këtë moment, ka dy momente shumë për mendimin tim historik, që jemi në periudhën post rugoviane, të vdekjes së presidentit moral dhe historik të Kosovës, të cilin në një farë mënyre individë të caktuar e patën uzurpua, okupua. Nuk na lanë as me respektua as me iu afrua. Vdekja e tij ishte një rast, që tregon jo vetëm deputetët, jo vetëm liderët, por i gjithë populli i Kosovës, se jemi në raste të tilla të bashkuar, jemi unik, treguam dinjitet. Muj me thanë pa përjashtim pozitë, opozitë pa përjashtim, deputetë e pa përjashtim ministra, sikur që tregoi dinjitet i gjithë populli i Kosovës. Nga fakti se ishim dhe jemi të vetëdijshëm se Kosova tash është në një moment para statusor, kur nuk na ka shumë hije, domethënë shtyhemi me bërryla edhe ndoshta etiketojmë edhe të merremi me çështje që janë ndoshta në këtë moment sekondar, kur para nesh është problemi madhor për të cilin kanë sakrifikuar gjenerata të tëra, e ky është problemi i statusit final politik të Kosovës.

Respekt ndaj partisë reformiste ORA, sepse edhe shumë akuza u dëgjuan në adresë të tyre e që unë mendoj nuk i shërbejnë për nder askujt. Të gjithë ishim 15 vjet lojtarë në një fushë mejdani që kontribuam aq sa mujtëm, aq sa ditëm, as sa patëm mundësi, dhe nuk i bën nder kurrkujt që ta rrah gjoksin çka ka bërë për Kosovën, se unë mendoj se kemi bërë të gjithë pa marrë parasysh ku si dhe me çfarë mjetesish dhe si kemi mujtë ta bëjmë.

Mendoj se në këtë Kuvend, në këtë fazë duhet të reflektojmë etape mesazhe të unitetit, edhe sot më mirë ka qenë dashtë ta kishim p.sh. si e dimë javën e ardhshme, pikërisht sot një javë, pritët të jetë takimi i parë në Vjenë e deputetët edhe qytetarët e Kosovës, kishin pas me qenë shumë më të lumtur dhe ma komod, që sot të dëgjonin çka po flasin të zgjedhurit e tyre për këtë çështje mjaftë të rëndësishme, edhe për problemet që na presin mas kësaj se kemi të bëjmë me çështje kruciale dhe vendimtare për fatin e Kosovës. Unë në emër të Partisë Liberale të Kosovës, pa dashtë me më keqëkuptu, ose më keqkuptoni të gjithë, ajo nuk më shqetëson aspak e shpalli dhe kërkoj nga ju të gjithë deputetët edhe nga pozita edhe nga opozita ta shpallim një moratorium brylave tonë deri në zgjidhjen e statusit final politik të Kosovës, që të funksionon grupi negociator me një unitet që sinqerisht mua personalisht më ka gëzuar shumë, kur kam pa që edhe kur janë dalë duke buzëqeshur të gjithë nga mbledhja e fundit e grupit negociator, se u pa edhe u reflektua se po ekziston një unitet. Por, nëse secili akuzon secilin për tradhti atëherë po i bie kjo se krejt çka jemi këtu jemi tradhtarë, ose nuk jemi tradhtarë edhe mendoj se këto tashmë janë konsumue. T'i etikojmë njerëzit siç po dëgjoj në këtë Kuvend, që nuk na bënë nderë asnjërit prej nesh të dëgjojmë akuza të tilla. Kështu që pa dashtë, thashë nuk bëhet nami nëse kryeparlamentari Daci edhe unë mendoj dhe jam i bindur tue e njoftë personalitetin e tij që është çdo gjë okej, çdo gjë pastër, pranoj formimin e një grupi do me thanë, çoftë ai hetimor nga të gjitha grupimet parlamentare dhe pas atij hulumtimi na tregohet, kërkohet falje, tregohet mos të maltretohet se nuk po maltretohemi vetëm deputetët këtu, por besoj që na përcjellin edhe qytetarët e Kosovës dhe mendoj se kjo vetëm mund t'i shërbejë transparencës e sundimit të ligjit, rregullsisve. Ndoshta edhe Grupi Parlamentar ORA ka qenë dashtë të afrojë argumente më të prekshme, argumente do me thanë më faktike edhe nëse ato ekzistojnë. Atë farë grupi për hulumtim, pra grupin hetimor do me thanë t'i afrojë si grup parlamentar në mënyrë që të mos ta maltretojmë vetveten dhe mos t'i maltretojmë qytetarët e Kosovës me këto ndasi dhe me këto shtyrje, me këto fyerje me këto gjëra që nuk i shërbejnë as Kuvendit të Kosovës, as deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Edhe një herë e di se nuk keni as obligim të dëgjoni, e di se nuk kërkoj të më dëgjoni do me thanë unë vetëm po shfaq një mendim timin për hirë të situatës çfarë është në Kosovë, dhe për hirë të gjendjes çfarë na presin, besoni se na presin ditë me të cilat do me thanë duhet me na shqetësua të gjithëve. Ta shpallim një farë moratoriumi të partive, do me thanë të mosmarrëveshjeve pozitë opozitë dhe të merremi me çështje kruciale. Tua lamë këto zgjedhjeve të ardhshme kur vijnë sepse pas statusit pritët shpallja e zgjedhjeve të reja, e atëherë mos harroni edhe unë si deputet edhe si një lider i një partie të vogël kam shumë çka me thanë edhe për Kuvendin edhe për secilin prej këtu që jemi e që s'jemi. Por ato do t'i themi masë zgjedhjes së statusit final politik të Kosovës. Ky është mesazhi im, kjo është porosia ime që sinqerisht tash mos ta prishim atë imazh që e treguam gjatë ceremonisë dhe homazheve që ishin një referendum. Mos ta prishim edhe



imazhin që e treguam me rastin e zgjedhjes së presidentit të ri Sejdiut, që ishte një provim dhe një test shumë dinjitoz i Kuvendit të Kosovës dhe të shkojmë tutje, unik. Unë apeloj, edhe pse s'jam në grupin negociator, edhe dëshirojë që gjithë liderët që janë në atë grup të jenë unik dhe të dalin faqebardhë ndaj sfidave dhe problemeve që kanë para vetes. Faleminderit shumë.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit.

Fjalën e ka deputeti Ylber Hysa, ndërkaq le të përgatitet Xhevat Bislimi.

**DEPUTETI YLBER HYSA:**

Ju faleminderit.

Pasi që nuk e kemi transmetimin e RTK-së besoj që mund të jemi më pak teatral dhe sa për t'ju çuditur kolegë unë do t'ju them se unë pajtohem me z. Demaj. Pajtohem së paku me një pjesë të fjalës së tij ku tha që duhet të kemi parasysh që disa çështje delikate si sekrete profesionale duhet trajtohen në mbledhje të mbyllura për ta pasur parasysh këtë tërë specifiket që shtrohet. Prandaj unë besoj që duhet t'i ndihmojmë zotit Demaj ta krijojme një panel, një Komision të pavarur ku ai dhe të tjerët do të ishin në gjendje pa frikë dhe pa dro nga publiku në mënyrë shumë të qartë t'i thonë të gjitha ato që kishin dashur t'i thonë e që janë shumë me interes për ne, por edhe për qytetarët e Kosovës, pa marrë parasysh që bëjnë fjalë për paratë e tyre, andaj në këtë aspekt dua që ta përkrah edhe z. Hydajet Hysenin i cili ishte shumë eksplicit në diskutimin e tij për të krijuar një komision hetimor, në mënyrë që të gjithë ne të jemi në gjendje pastaj të shohim se çka të bëjmë. Në këtë aspekt unë kisha dashur që ta shtrojë këtë çështje sepse kjo është një borxh. Keni parasysh që 40 njerëz e kanë shtruar një çështje të tillë. Dikush këtu ka të drejtë, ose këta 40 njerëz kanë drejtë ose dikush, zoti Demaj ose dikush tjetër ka drejtë. Dhe nëse në fund do të zbardhet që këta deputetë, 40 sish. një e treta e parlamentit ndoshta e kanë pasur gabim, unë jam i pari që do t'i thërras të kërkojnë publikisht falje këtij auditoriumi dhe publikut. Unë jam i pari që do ta bëjë atë punë. I kisha ftuar edhe këta 39 të tjerë që ta bëjnë një gjest të tillë mirëbesimi po që se ky komision do të dalë me atë që tentojnë të tjerët se kanë të drejtë do me thanë siç u tha këtu ata që mendojnë se e vërteta është në anën e tyre në asnjë moment nuk duhet të frikohen nga ajo. Ju thërras që në emër të kësaj të vërtete dhe të një transparence që, së paku publikisht thamë, të gjithë dëshirojmë ta ndërtojmë, menjëherë pas kësaj do me thanë të merremi vesh përmes shefave të grupeve parlamentare ne jemi të gatshëm menjëherë që ta deponojmë një listë propozimesh, thashë jemi të gatshëm ta kemi vetëm një person në atë komision, nëse doni asnjë anëtarë në këtë komision që do të duhej të bëjnë në mënyrë që në fund të gjejmë atë që këtu u përmend aq shumë e vërteta. Në këtë aspekt, nëse dëshironi edhe që sot nuk është temë e ditës, mund ta bëjmë një komision për dosje, ju propozoj që ta fillojmë nga e mbrama, nga germa Y dhe pastaj do të mbërijmë te germa B edhe te germa A pa ndonjë problem. Faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit z. deputet. Xhevat Bislimi deputeti e ka fjalën le të përgatitet për fjalë deputeti Ymer Halimi.

#### DEPUTETI XHEVAT BISLIMI:

Z. kryesues, z. deputetë. Sot unë në gazetë pashë se është shpallur një konkurs për sekretar të Kuvendit. Prandaj nuk e di nëse ishte ko incidencë pikërisht paraqitja e sekretarit këtu para Kuvendit apo ishte kënga e Mjellmës apo promovim për rizgjedhjen e tij në vendin që ka qenë deri sot.

Jam plotësisht dakord ose pajtohem me ata kolegë deputetë që kërkuan që çështja të mos personalizohet të mos personifikohet sepse mendoj që këtu nuk është problem personi ose tash personat, problem është sistemi që është ndërtuar nga këto politika dhe nga ky koalicion qeverisës, sistem i cili është i bazuar dhe funksionon mbi bazën e parregullsive, paligjësive, korrupsionit e mashtrimeve dhe të jeni të bindur që momentin që do të vendoset ligji do të respektohet ligji, momentin që do të respektohen procedurat, momentin që do të luftohet korrupsioni do të bie edhe ky sistem, prandaj deri atëherë keni durim se nuk do të bie ky sistem dhe do të funksionojë mbi këtë bazë mbi të cilën është ndërtuar.

Këtu dëgjuam disa kolegë deputetë që thonë se Kosova ka çështje shumë të më të mëdha se vila Gërmia. Pajtohem plotësisht, por këta kolegë të nderuar nga pozita nuk i kuptojnë pse nuk i ngrisin ato çështje, nuk kuptoj pse Qeveria e tyre nuk i zgjedh ato probleme a mos vallë po i pengon opozita. Nëse ne duhet t'i mbledhim 40 nënshkrime për të fut në rend dite një çështje ose për të thirrur një mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit. Të paktën koalicioni qeverisës dhe grupet e tyre parlamentare e kanë mundësinë që pa nënshkrime t'i fusin në rend dite këto çështje dhe t'i trajtojnë. Ne nuk mundemi as t'i pengojmë që dikush ta ngre edhe çështjen e bisedimeve. Të jeni të sigurt se pengesa nuk është te opozita, nuk është opozita ajo që ka orientuar bisedimet dhe ministrat e koalicionit qeverisës që të shkojnë të bisedojnë në Beograd dhe me Serbinë për çështjet e decentralizimit dhe të trashëgimisë kulturore pa e shtruar çështjen në këtë Kuvend. Prandaj shikoni në mesin tuaj, aty i keni ato probleme dhe jo në mesin e opozitës.

Z. deputetë, qeveritarët tanë të barikaduar në luksin e tyre, të barikaduar në veturat e tyre të blinduara dhe prapa xhamave të errët si duket Kosovën asnjë herë nuk po e shohin në dritë, prandaj edhe nuk po e nxjerrin nga terri e kanë kthyer në mesjetë në kohën e kandilave dhe ministrat e kësaj Qeverie vazhdojnë të kreken majë karrikave të Kuvendit dhe të Qeverisë dhe as nuk ju shkon ndërmend të pakën për arsye morale njerëzore dhe politike të japin dorëheqje, nëse koalicioni dhe kolegët tanë të nderuar deputetë nuk e kanë guximin moral dhe politik t'ua bëjnë kërkesën për dorëheqje. Nuk e kuptoj edhe atë pjesë të bashkësisë ndërkombëtare, ata segmente të UNMIK-ut që janë në mbështetje të kësaj Qeverie që e ka zhytë në terr Kosovën dhe e ka kthyer në mesjetë. Nuk e kuptoj Rykerin që i akuzon qytetarët për borxhli dhe për fajtorë gjoja bashkë me ministrin Et'hem Çekun, borxhli janë KEK-u është Qeveria është UNMIK-u te qytetarët e Kosovës, te Ekonomia e Kosovës, te biznesi i Kosovës, te shëndetësia e Kosovës te

arsimi i Kosovës, prandaj aty kërkoheni, ata janë fajtorë, por zotërinj mos i kërkoni te opozita. Korrupsionin nuk e mbolli dhe nuk po e vjelë opozita por pozita. Miliona të shpenzuara për vetura, edhe qeveritarë edhe nëpunës të thjeshtë të zakonshëm na bredhin para hundëve tona me vetura luksoze, me telefona shumë të kushtueshëm që nuk i kanë ndoshta as deputetët e Francës apo të vendeve perëndimore. Prandaj zotërinj thirrni mendjes dhe mos akuzoni opozitën po shikojeni një herë veten dhe sistemin që keni ndërtuar në politikën tuaj të dështuara para lufte, gjatë lufte të dështuara edhe sot dhe të dështuara në të ardhmen në qoftë se nuk bien nga pushteti. Ju faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit z. deputet.

Fjalën e ka deputeti Ymer Halimi dhe janë edhe dy deputetë tjerë që janë lajmëruar për fjalë në emër të propozuesit besoj të kësaj pike të rendit të ditës, besoj Gazmend Muhaxheri dhe për fund deputeti prof. Sabri Hamiti, Ymer Halimi e ka fjalën.

**DEPUTETI YMER HALIMI:**

Ju faleminderit kryesues.

Unë fjalën time e kam të shkruar dhe kam vendosë ta deponoj e të mos ju bezdis, për shkak se keni dëgjuar shumë çka nga kjo, atëherë unë do ta deponoj.

Është e pajustificueshme që kërkesa e një Grupi parlamentar të shtyhet për muaj të tërë për tu vënë në rend dite në seancën e Kuvendit. Aq më parë kur dihet se Kuvendi është vendi më meritor për shqyrtim të temave dhe të transparencës së veprimeve të kujdoqoftë, e kudoqoftë në veprimtaritë publike, kur atë e kërkojnë deputetët.

Por kjo shtyrje flet se nuk e përfillim demokracinë në Kuvend, dhe nuk jemi të gatshëm të përballemi me përgjegjësinë tonë përderisa dikush dhunshëm, si në këtë rast, nuk na urdhëron.

Ky urdhër na zhvlerësoi moralisht para votës së popullit. Por, pesha e përgjegjësisë bie mbi Kryesinë tepër inerte të Kuvendit, që nuk ka vizion të qartë për çështjet fundamentale, e në këtë rast, për kërkesa reale të grupeve parlamentare.

*Deputetë të nderuar*, kur ka qëndrime të ndryshme për një çështje, forma më e mirë për të përcaktuar të vërtetën, po edhe më demokratike, është të lejohet debati. Nuk ka tema të ndaluara për të debatuar në Kuvend. Meqenëse është kështu, atëherë shtrohet pyetja: pse hezitohet për debat të këtillë, aq më parë kur dihet se institucionet publike, dokumentet financiare i kanë të shkruara dhe duhet tu nënshtrohen inspektimeve dhe transparencës publike(?)

Kur ne nuk jemi të gatshëm për transparencë për punët brenda Kuvendit, e kujt tjetër kemi të drejtë t'i kërkojmë përgjegjësi?!

Ky zotëri është edhe një nga synimet e Kuvendit

Vendimet e marra për ndërtimin e Qendrës Administrativo-Protokollare në Gërmë, po edhe i investimeve të bëra në Kuvend janë, siç thonë politikologët, "me diskrecion". Po

të jenë njëqindpërçind të arsyeshme, në kohë, vend dhe qëllim, (çka edhe nuk janë) vetë vendimet si të tilla ngrenë polemika, jo vetëm te ne, por kudo në shtetet me demokraci.

Psh. për blerjen e një veture të zakonshme kuvendi suedez ka debatuar seanca të tëra. Ndërsa, Kuvendi i Kosovës për miliona euro në investime kapitale e milion euro shpenzime nuk debaton fare! Kjo s'do koment!

Si arsyetohet shuma enorme e eurove të shpenzuara për rinovimin e hapsirës për një kabinet në Kuvend. Apo avanse të udhëtimit e meditime, mirmbajtje të objektit si edhe disa pozicione të tjera diskutabile!?

Vërtetë punët në Kuvend i kryen një administratë tepër e varur, e të mos them edhe e papërgaditur, nga një anë, e në anën tjetër këtë e bëjnë, mbase, me bindjen se këto janë "euro shteti" dhe i shpenzon për të imituar lluksin e të pasurëve, e pjesa dërmuese e popullit, djersë e të cilit janë ato euro, me vështirsinë maksimale e mbijetojnë.

Veprimet e tilla në politikë quhen sulltanizëm, të denja për sistemet në tranzicion.

Po t'i referohemi mendimit se "efektet anësore të sëmundjes" të çojnë në diagnozë të saktë, atëherë disa vendime dhe shpenzimet në Kuvend janë shqetësim, në shumë rrafsh, dhe prekun në ndergjegjien e deputetëve në Kuvend. /Shiqoni dokumu./

*Deputetë të nderuar*, miqtë tanë nuk u shqetësuan se në Kosovë nuk gjetën hotele luksoze, qendra protokollare, sauna e pishina, por u brengosën kur takuan klasën politike pa vizion të çartë për strukturimin e shtetit, rimëkëmbjen e ekonomisë, zvoglimin e varfërisë, ngritjen e arsimit dhe shëndetësisë në shkallën që e meritojnë qytetarët e Kosovës. Pa vizion për zgjedhjen e problemeve të brendëshme politike, dhe për disa vite na mungoi *identiteti politik veprues* e ne, vendnumëruam.

Këto nuk e shqetësuan Kuvendin në masën e duhur, po as kjo që për katër vite miratuan vetëm 146 ligje, ndërsa Kuvende në vende Ballkanike miratuan numër treshifrorë të ligjeve brenda një viti. Nuk u angazhuam që të kemi ekspertë ligjor që të miratojmë ligje më të mira! Fare nuk u brengosëm për të përcjellë zbatueshmërinë e ligjeve, që në çdo hap po shkelen, apo për të përcjellë punën e Qeverisë.

Këto koncepte bazë për Kuvende demokratike, ne si përfillëm.

Udhëheqja e Kuvendit të Kosovës është shqetësuar që sa më parë të ketë një 'ultra-infrastrukturë' në hapësira të caktuara. Me gjasë, e interesuar më tepër që të kap 'kohën e tenderëve' në përparësi. Kjo konkludohet nga këto dokumente ku ka vendime tepër të çoroditura, dhe vepruar pa frigë se deri sot në Kosovë, janë individ të paktë, për të mos thënë askush, që kanë dhënë përgjegjësi morale, a penale, për lëshime në punë publike(!).

'Siguria' më vetura të blinduara me standarde të NATO-së për udhëheqës të institucioneve të caktuara është bërë modë, por edhe sinjal se mosbesimi i këtyre udhëheqësve ndaj popullit të vetë mjerisht po rritet. E kjo asesi nuk duhet t'i takojë deputetit të Kuvendit pa marrë parasysh çfarë funksioni kryen në Kuvend.

Ekstra-lluksi dhe shpenzimet enorme përballë varfërisë ekstreme të popullit janë të paqëndrueshme. Kjo provokon durimin e popullit të cilin po e mbanë ende durimi i pritjes së pavarësisë. Këtë më së paku ka drejtë ta bëjë Kuvendi - vota e popullit.

Të jemi të kujdesshëm, se në histori ka ndodhë që klasa e dobët politike, një institucioni të shenjtë ose një ideje të shenjtë e madhështore në shumë raste u ka ulë vlerën.

*Deputetë të nderuar, "drejtësia është ide supreme e njerzimit", të bëjmë përpjekje që kjo të jetë realitet i Kuvendit në formimin e shtetit ligjor në kurrizin e të cilit ndërtohet liria dhe demokracia e mirfilltë, shumë të nevojshme për Kosovën.*

Prandaj, kërkoj që të formojmë një grup punues që të hartojë një raport më shkrim lidhur me vlerësimin e fakteve, ecurive; gjendjes në tërësi, për kërkesat e shtruara nga deputetët, për të gjitha pozicionet financiare, jo vetëm për një vit.

Të kthejmë përgjegjësinë e ikur që është tepër e nevojshëm për punë të suksesshme në Kuvend. Ky është obligim i jonë.

*Ju flm. për vëmendje.*

#### KRYESUESI NAIM MALOKU:

Ju faleminderit z. deputet, fjalën e ka Gazmend Muhaxheri, urdhëroni.

#### DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI:

Faleminderit z. kryesues.

Jo nuk është, është pika e dytë e rendit të ditës është dashtë me debat, mirëpo do të kthejë një përgjigje unë për avokatin e zyrës së kryetarit të Kuvendit që u mundua me i arsyetua shpenzimet e kryetarit të Kuvendit të Kosovës edhe me thanë se të dhënat që i kam dhanë nuk janë të sakta.

Të dhënat që i kam dhënë janë marr prej sekretarisë së Kuvendit nga këto të dhëna figuron se për 4 ditë Zyra e kryetarit të Kuvendit ka marrë mbi 6 mijë euro shpenzime, ashtu si i shpërndaj ai njeri nuk del që as 1 mijë euro para të shpërndara.

Unë nga 14 shkurti i vitit të kaluar kërkoj transparencë konform ligjit si anëtar i Kryesisë nuk e kam kërkuar këtë për me mujt me ja shpjeguar nënës teme të shtëpia si harxhiten paratë këtu por me ditë deputetët e Kuvendit të Kosovës si menaxhohet buxheti i Kuvendit të Kosovës. Me ligj jeni të obliguar çdo 3 muaj me jep raport të hollësishëm, detal, e detal, sa unë muj me kuptu është kusht, kur, sa ka harxhuar edhe cilën kohë për çfarë qëllimi.

Në raportin që na ka dorëzuar sekretaria figuron se për 4 ditë do me thanë se me 27.5, 7.6, 29.4 edhe 30.6 do me thanë janë marrë 6 mijë euro, qysh i arsyetojnë këta është problem se nuk e kanë shkruar kujt ia kanë dhënë këto para a me ligj janë të obliguar me i treguar se kush i ka marrë këto para. Prej fillimit po kërkoj transparencë. Në vitin 2004 janë harxhuar 596 mijë euro për avans udhëtime zyrtare nuk dihet kush i ka marrë për

vitin 2005 janë 100 mijë euro avans për udhëtime zyrtare për të cilat kurrkush nuk e dinë kush i ka marrë ato pare. Ligji i obligon mirëpo çmos ka bërë kryetari i Kuvendit për me i mshfë këto sekretaria e tina mos me u debatu.

Pika e dytë sot nuk po debatohet, falë këtyre sendeve që këto po mundohen me i mshfë, para gjithëve këtu po them kryetari i Kuvendit është tu mshfë diçka edhe është duke mshfë manipulime të rënda. Nëse keni guxim e keni përgjegjësinë edhe ju deputetë duhet me bë komision hetimor duhet me zbardhë këtë akuzë që po e bëjmë ndaj kryetarit të Kuvendit ndaj sekretarisë së tij. Nëse s'donim me e marrë përgjegjësinë edhe me kanë në një thes me ta. Faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Faleminderit z. deputetë prof. Sabri Hamiti ju lutem e keni fjalën.

**DEPUTETI SABRI HAMITI:**

Z. kryesues, kolegë të nderuar.

Më tha dikush se s'ka transmetim edhe boll mirë qenka kështu që mund të bisedojmë, se e tha dikush atë, nëse është edhe ma mirë por nëse s'është njësojë krejt.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Vetëm një ndërhyrje z. profesor do të transmetohet në një emision special komplet kjo.

**DEPUTETI SABRI HAMITI:**

S'ka lidhje, unë po them për njerëzit këtu që të jenë këtu më të relaksim. Në këtë truallin tonë të quajtur të politikës, unë kam dëgjuar edhe kohëve të fundit edhe shpeshherë thuhet që politika i ka dy fytyra do të thotë i ka shumë fytyra do të thotë s'ka fytyrë hiq. Për mua personalisht ende mendoj që politika do besim politika do veprim dhe përgjegjësi dhe unë ndryshe nuk e kuptoj, ndryshe nuk e kuptoj as ardhjen në këtë parlament as diskutimin e sotëm po të njëjtën kohë duhet të nisem nga para gjykimet që po fluturojnë në ajër në këto tipe të definimeve të politikës dhe unë për vete po ju them që po e shohim në diskutimet këtu.

Përfundimisht duhet të zbritet nga dyfytyrësia ose me thanë më but, duket me fjalë tjetër hipokrizi, e cila, duhet ta pranojmë haptazi, po funksionon te ata që janë eksponentë politikë në Kosovë, po funksionon edhe te ne këtu në këtë sallë të parlamentit dhe po funksionon, besomëni, të gjithë, hiq s'është e pjestume veç te një grup politik. Ju mund ta analizoni këtë çka u tha vetëm gjatë kësaj paradite dhe pasdite kur njerëzit e dinë shumë mirë që ekziston një pikë e rendit të ditës, që ekziston një objekt i përcaktuem, se duhet bisedohet për një shtëpi për nevojat e institucioneve të Kosovës që do të ndërtohet ose ka provuar të ndërtohet në Germi. Kjo është pika e rendit të ditës, ndërsa rrëshqitja në diskutime është e tmerrshme kah ka shkue dhe me një parashenjë të një popullzimi

shumë qesharak. Nëse doni që të mos shpjegohet kurrë fenomeni ju ndërroni tezat, nëse ju doni që mos të bisedohet problemi sot të kalojmë në fushën tjetër dhe tue kalua në mënyrën më të egër prej një fushe në fushën tjetër. Për mua problemet janë themelore thjeshta a duhet të ndërtohet ajo shtëpi, unë mendoj po, se ka nevojë për te nën një.

Nën 2. A e ka dhënë lejen në mënyrë të pastër juridikisht organi që është i detyruar ta jap, kjo është pyetje në cilën nuk kam përgjigje, biseda është bërë që të gjindet përgjigja. A ka të drejtë sekretari ta jap atë leje, nëse ka e ka dhënë bravo e ka kryer punën mirë.

Nëse Kryesia e Kuvendit thotë se nuk është në rregull Kryesia e Kuvendit është më së pakti hipokrite sepse nuk është e zonja të mblidhet dhe ta jep qëndrimin e vet si organ që kryeson këtë Kuvend, dhe mos ta qesë problemin bankës te parlamenti pa marrë kurrfarë qëndrimi. Ne nuk kemi qëndrim të Kryesisë që na udhëheqë, në anën tjetër ne kemi një problem që ka pjellë nga Kryesia ose ka dal nëse ju duket më i mirë, janë anëtarë të Kryesisë që s'kanë mund ta gjejnë dialogë të zgjedhin problemin brenda 5 vetëve dhe e kanë qitë në opinion, kur të them në opinion unë kam shumë përcaktim të saktë. Ky problem është bërë problem medial para se të bëhet problem parlamentar, prandaj zotni kemi derivim të folurit kaq qesharak sot në Kuvend, sepse është shterë janë shterë gati të gjitha mundësitë dhe pa mundësitë nëpër gazeta dhe finale kemi ardhë këtu me reminishencat e interpretimeve të gazetave të flitet parlament që është shumë keq edhe për parlamentin edhe për fenomene. Unë jam habitë sa janë grupi parlamentar ku sa është i zbehtë në argumente sot karshi krejt bujës opinionale që ka ndodhë dhe drejtë po ju thanë jam befasuar me këtë. Si është e mundur që të bëhet një tollovi opinionale dhe në fund del krejt çdo gjë e mbushur me pikëpyetje. As një përgjigje unë se kam ndi as prej grupit që ka parashtruar problemin as prej të gjithë diskutantëve tjerë do me thanë, a duhet të ndërtohet shtëpia, duhet të thomi ne si parlament, a duhet apo jo, unë mendoj duhet se kemi, s'kemi, s'kemi, ka nevojë, pse jo. Problem tjetër është kush duhet ta japë lejen që të harxhohen ato pare, kjo është problem krejt tjetër, nuk mund të shtrohet problemi i tipit popullist ne po e marojmë një shtëpi për të gjitha institucionet e dikush nuk ka para a, ky diskutim është qesharak, kur ta shtrojmë problemin social në Kosovë ne bisedojmë për problemin social, kur ta shtrojmë problemin politik të statusit të Kosovës të cilin se kemi shtruar kurrë këtu, atëherë bisedojmë për atë problem, kur flitet dihet kush për fshisa e kush për lisa, të saktë çka po themi.

Pra me që problemi është bërë medial para se institucional para se fajin e ka Kryesia dhe ne si doni gjithë atëherë ne kemi një diskutim partizan, qesharak që ka ndodhur këtu sot, ku me vullnet apo pa vullnet deputetët janë bërë disa gardian të Nexhat Dacit e disa të Veton Surroit dhe këtu Parlamenti e ka hëngër keq, nëse doni, ka gabuar shumë, sepse s'ka nevojë që këta dy njerëz që janë të mbrojtur, shumë mirë nalt nga gardianët, partizan në kuptimin e të folurit, që është gabim, prandaj ka derivuar problemi themelor dhe unë mendoj se është gabim që të bisedohet në Parlament kështu, jo pse mendoj se parlamenti është jopartiak, si u tha këtu, që e tha dikush se ne jemi krejt njësoj, nuk jemi, ne përfaqësojmë programe partiake, më në fund secili në fund po thotë se në emër të partisë fola, e si nuk je partiak e po flet në emër të partisë. Nuk jam njeri që mendoj se rrafshohen interesat dhe mënyra e të folurit, por jo diskutime partizançe për një problem ku deshëm a nuk deshëm problemi është personalizuar dhe është personalizuar për hatër

jo tonin ose fajin tonë, por për hatër të këtyre dy akterëve. Grupi Ora gati e ka program njëvjeçar për t'u shtyrë me Nexhat Dacin edhe në Parlament edhe jashtë, ai është problem i tyre, nëse ata kanë hesap le ta thjeshtëzojnë programin e vet në parlament me Nexhat Dacin, është çështje e tyre, por edhe në anën tjetër Nexhat Daci që e kryen rolin e kryetarit të Kuvendit nuk ka nevojë, unë mendoj, për tipe të mbrojtjeve partizançe, sepse vetëm i bëjnë keq, po ju them unë juve këtu edhe atij dhe unë zonja dhe zotërinj deputetë të mij të nderuar dhe kolegë shumë të çmueshëm edhe njëherë mund ta citoj kryetarin e grupit parlamentar të LDK-së Alush Gashin. Ne kemi biseduar dhe jemi përpjekë në grup që të gjejmë zgjidhje racionale, e zgjidhja racionale as në këto banka assesi nuk mund të gjendet përpara se Kryesia e Kuvendit të deklarohet për pyetjet të cilat unë i shtrova këtu, që janë shumë të qarta, se a duhet dhe a ka shkuar në rregull gjithçka deri më tash. Nëse ata përgjigjen edhe ne do të përgjigjemi deri në fund në të gjitha mënyrat institucionale dhe parlamentare. Ju faleminderit shumë.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit z. deputet.

Unë nuk besoj se ka nevojë për replikë, janë dy deputetë që kërkojnë replikë, Hydajet Hyseni dhe Veton Surroi. Hydajet Hyseni replikë dy minuta

**DEPUTETI HYDAJET HYSENI:**

S'di a ka bazë tash ma ke përmendë si kryesues emrin, shyqyr kam arsye, shaka po bëj më falni.

Po së pari mendoj se ka arsye për replikë nëse eventualisht diskutimi është i natyrës polemizuese dhe që i referohet edhe nëse nuk i referohet emri të përmbajtjes së diskutimit. Po unë nuk e kam ndërmend të replikoj as polemizoj, po deshta më shumë duke shfrytëzuar të drejtën për ndërhyrje ose kërkesë procedurale që tërheqë vërejtjen se vërtetë edhe në diskutimet e fundit edhe krejt të fundit kam përshtypje sikur po devijohet pikërisht rendi i ditës. Nuk është në rend dite a ka nevojë a s'ka nevojë të ndërtojë të një qendër protokollare dhe do ta vejmë lajthitje opinionin dhe Kuvendin nëse e shtrojmë çështjen kështu. Çështja është shtruar ndryshe, a është proceduar drejtë, a është shkelur ligji a është shkelur procedura, a është shkelur rregullorja, si janë menaxhuar financat, kush i ka ndarë paratë, kush ka vendosur për to dhe eventualisht në këtë kuadër mund të vendoset a ka vendosur drejtë.

Kolegë të nderuar disa prej jush e dini në iniciativë të Komisionit Legjislativ, javë më parë, është thirr një mbledhje me Kryesinë e Kuvendit në të cilën është kërkuar një përmirësim elementar i kushteve të deputetëve, përgjigjja e kryetarit ka qenë vërtetë shokuese shumë të drejta propozimet kërkonim nëse jo tjetër ndonjë lehtësim ndonjë zyre së paku për 3, 4 deputetë ndonjë llaptop nëse s'ka zyre që të ketë një zyrë lëvizëse, kërkonim gjëra elementare. Përgjigjja ishte - thjeshtë s'ka para, duhet të presim shekullin tjetër për gjëra tilla, e kush vendos tash për miliona të Kuvendit.



KRYESUESI NAIM MALOKU:

Ju faleminderit z. deputetit, për replikë deputeti Veton Surroi.

DEPUTETI VETON SURROI:

Faleminderit,

Do të jetë replikë pak sa e çuditshme. Përkrahi në shumicë atë çka tha prof. Sabri Hamiti me një distinkcion që atë që e kemi ngritë nuk ka qenë e personalizuar nuk ekziston programin tonë, duket shumë imagjinative që të jetë në programin tonë të merremi ne Nexhat Dacin për një vit rresht.

Ne merremi me sundimin e ligjit, dhe të njëjtat pyetje të cilat i keni shtruar ju, të njëjtat pyetje të cilat i ka shtruar Hydajet Hyseni, të njëjtat pyetjet, të cilat i kanë shtruar shumë deputetë i kemi shtruar ne në mbledhjen e Kryesisë dhe keni drejtë absolutisht, kjo është një çështje e cila na ka rrjedh nga Kryesia në Kuvend për shkak të bllokimit të punës brenda Kryesisë. Tash interesi ynë nuk besoj se është që kjo çështje të zvarritet çoftë në media çoftë në debat të pafund. Duhet t'i kthehet rrjedha për të mund ta kthejmë rrjedhën ne mund ta bëjmë pyetësor ashtu siç e parashtruat ju ashtu e parashtrroi Hydajeti, ashtu siç e parashtruan disa deputetë tonë në mënyrë që të bëhet pyetësor do të duhej një konsultim i shefave të grupeve parlamentare. Le të del ky propozim unik i shefave të grupeve parlamentare. Kisha lutë për një pauzë gjysmë ore. Unë besoj se shefat do të mund të pajtohen.

KRYESUESI NAIM MALOKU:

Faleminderit. deputeti Sabri Hamiti,

DEPUTETI SABRI HAMITI:

Me u mbledhë gjithë i kam pas problem se më kanë thanë njerëzit se po fletë tepërt qartë. Këtu po mundohen me më thanë se nuk flas qartë përkundrazi, unë flas shumë qartë dhe e kam kërkuar që të bisedohet për objektin jo për tregti, do me thanë, ato që i kam shpjegua kanë qenë që po iket prej objektit dhe unë po i shoh që njerëzit, cili do çoftë, masë fjalisë së dytë po ik prapë prej objektit. Thirrja ime është që të ipet përgjigja për tri pyetje themelore të cilat i shtrova dhe mos të çuditen aktorët themelorë të kësaj, se është e vërtetë që aktorët themelorë të kësaj janë personifikuar vetvetiu, e jo prej meje por vetvetiu, e ata janë Surroi e Daci. Faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU:

Faleminderit,

Debati për këtë pikë të rendit të ditës ka marrë fund, nuk e keni kërkuar fjalën z. Sabit Rrahmani me kohë. Ta kryejmë këtë pikë të rendit të ditës, ju e keni kërkuar fjalën jashtë pikës së rendit të ditës. Do ta keni fjalën, por ta kryejmë njëherë, do ta keni fjalën në fund, po për diçka krejt tjetër, po është këtu. Ishte propozim i Grupit Parlamentar të LDK-së që Kryesia e Kuvendit, më lejoni të përfundojë, pra ishte propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së që Kryesi e Kuvendit t'i drejtohet Kuvendit me analizën e këtij debati dhe me pyetjet të cilat janë identifikuar që janë parashtruar gjatë këtij debati në lidhje me objektin temë e të cilit që ka qenë edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Propozim tjetër ka pas që të formohet komision parlamentar hetimor. Unë jam i detyruar në bazë të procedurës të qesë në votim, pra ta qesë në votim, propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së, i lutem regjisë që të përgatitet për votimin, kush është për propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së, votojmë tani.

Ju faleminderit, mund të ndodhë që kartelat nuk i keni vu. 46 deputetë janë për propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së të shprehur përmes shefit të Grupit Parlamentar prof. Alush Gashit, 23 deputetë janë kundër, besojë që e kemi shumicën, andaj propozimi ka kaluar. Mee këtë debati përfundohet me këtë temë të rendit të ditës.

Shumica e deputetëve. Nuk muj me pas dy propozime pozitive ju lutem, mirë ne merremi për procedurat. Seanca vazhdon nesër në ora 10,00. Faleminderit.

DEPUTETI SABIT RRAHMANI:

Faleminderit z. kryesues

Ndonjëherë duhet me marrë fjalën me zor, sot këtu na keni ardhë me Germia e këto sene. Pika e parë unë e kam një problem me komunitetet, falë Zotit që nuk është seancë drejtpërdrejtë në televizion e kam votën e tyre dhe dua me prezantua mendimin e tyre, i rashë pishman që se morra fjalën atëherë por respektin që e pata ndaj prof. Sabri Hamitit, ma bëri me gisht, leje në fund dhe e lash, krejt në rregull unë të respektoj shumë.

Dua me ju tregua një send që ka qenë e vërtetë këtyre ditëve. Vetëm dje diku rreth 18 herë jam enë në zyrën e kryeministrit dhe në zyrën e zëvendëskryeministrit edhe zyrën e sekretarit permanent Fitim Krasniqit, nuk kemi pas fytyrë dhe s'na ka lanë marrja me ju drejtua Qeverisë më herët me një kërkesë për shkak të vdekjes së kryetarit Rugova duke marrë parasysh që institucionet kanë pas një barrë tjetër, përgatitjen e homazheve, varrimit dhe ne jemi vonuar në këtë procedurë. Nesër e kemi ditën kombëtare të komunitetit e Hashkalinjve që festohet në Ferizaj.

Kemi kërkuar një mbështetje prej Qeverisë, s'kemi kërkuar me 6 milion e gjysmë, por kemi kërkuar një mbështetje me 3.200 euro. Kurrë nuk kemi kërkuar kesi kërkesa, tri vite kemi festuar me vetëorganizim kurse tash kemi mbet për 3.200 euro. Nuk kemi kërkuar pare po kemi kërkuar nga Qeveria që mundësisht t'i sjellim disa fatura që neve na nevojiten për shërbime edhe ato kompani që i kryen shërbimet Qeveria me i pakua me një afat një mujor apo dy mujor. Na kanë arsyetuar se nuk kanë mundësi me bë atë, plus asaj ju kemi drejtuar edhe kryetarit të Kuvendit që moralisht me na mbështetë edhe kryetarit

të Kosovës z. Sejdiu që me insistua te Qeveria me na mbështetë, edhe ajo nuk ka. E kuptoj kryetarin e Kosovës dhe kryetarin e Kuvendit që ndoshta nuk kanë pas kohë për shkak të angazhimeve që e kanë me grupin negociator.

Dje e kemi bërë një kërkesë dhe jemi mbështetur prej të gjitha grupeve parlamentare: Partia Demokratike e Kosovës; ORA, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Grupi 6+ dhe Grupi Parlamentar për Integrim. Me deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës kam biseduar në mënyrë individuale, të cilët kanë qenë për, por nuk kemi pasë mundësinë me takua shefin e Grupit Parlamentarë Alush Gashi që mundësisht kjo Qeveri apo ky Kuvend me na i lejuar ato mjete që na nevojiten. Thash nuk kemi kërkuar mjete po kemi kërkuar kontrata me kompani që na i kemi dhe Qeveria me na i pagua. Tash janë tri opsione z. kryesues, na festën e kemi nesër kemi thirr shumë mysafirë nuk dojna me dal labilë para asaj, tek e fundit dasmat bëhen me mish e pa mish ne do ta bëjmë dasmën bukë e kripë nëse ka nevojë, po vetëm mos thoni se nuk ju kemi thanë, se mos të ishin këto standarde Plimetini kishte më të edhe 60 vjet, se për 6 vjet mos të flasim hiq. Kishe për të mirën e standardeve do të na përkrahin po, po, janë tri opsione nëse Kuvendi nuk merr vendim, që ato mjete me lëshu urgjentisht atëherë nëse ka mundësi ju lutem që ky propozimi im me dalë në votim, ose prej mjeteve të fondit mbështetës për demokraci, Partisë Demokratike të Hashkalinjve të Kosovës me na i nda mjetet qysh nesër ose mundësisht me na mbështetë Qeveria pa kthim, ose nëse ka mundësi unë do ta sakrifikojë edhe xhepin tëmë, mundësisht prej buxhetit të Kosovës me institut që ky Kuvend katër paga mujore me mi lëshu edhe mos me marrë asnjë rrogë e mos të koritemi para njerëzve atje. Ju faleminderit.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Faleminderit, deputetë lidhur me këtë ka kërkuar fjalën deputeti Alush Gashi.

**DEPUTETI ALUSH GASHI:**

Ju faleminderit z. kryesues, ju faleminderit që ja dhatë fjalën deputetit.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkon që në kuadër të kompetencave të rregullores që të gjendet mundësia të mbështetet ky komunitet. Ne si Grup Parlamentar jemi të gatshëm që pjesën tonë nga buxheti që e marrim si parti politike aq sa na takon neve që ta përmbushim. Me këtë rast ju urojmë festën dhe ju afrojmë një bashkëpunim konstruktiv me këtë grup. Faleminderit shumë.

**KRYESUESI NAIM MALOKU:**

Ju faleminderit, seanca vazhdon nesër në orën 10,00.

(Vazhdimi i seancës plenare më datën 15.02.2006 me fillim në orën 10,00)

## PJESA E I

### KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Do të fillojmë punën . Ju lutem, 76 deputetë janë të pranishëm. Para se të kalojmë në pikën e 14, profesor Alush Gashi e ka një ide për sot, urdhëro profesor.

### DEPUTETI ALUSH GASHI:

I nderuari z. kryetar të nderuar z. deputetë,

Jo larg nga kjo ndërtesë, para sa vitesh ,ka qënë një sinagogë e bukur , një xhami dhe një kishë. Në atë kohë kur qytetarët nuk ishin fuqizues , pushteti i atëhershëm e fshiu atë pjesë të historisë sonë. Këto ditë , fatmirësisht kemi një angazhim të qytetarëve të Kosovës që të provojnë ta ruajnë një pjesë të arkitekturës së vjetër të këtij qyteti e cila lidhet dhe simbolizohet në emrin e hotelit „Union”.

LDK e Kosovës , përmes Ministrisë të Kulturës, e ka ngritë këtë çështje në Qeverinë e Kosovës që Agjencia Kosovare e Mirëbesimit ta rishqyrtojë vendimin e vetë që mos ta qes në shitje këtë objekt të qytetarëve të Kosovës. Për mua dhe LDK-në është shumë inkurajuese se qytetarët e Kosovës angazhohen jo vetëm për pronën private , por edhe për pronën shtetërore të Kosovës. Ne e mbështesim angazhimin e kuptimplotë të artistëve dhe të dashamirëve të artit që ky objekt të ruhet dhe aty të eksponohen siç janë veprat e Musli Muliqit , Ibrahim Kodrës, Shijakut, Xhafës, Berishëve e të tjerëve, andaj zoti kryetar ju lus që me rrugë zyrtare të komunikoni me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit dhe të ruani këtë pasuri shoqërore. Ju faleminderit shumë.

### KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit z. Alush. Unë me kënaqësi do të provoj ta realizoj këtë propozim shumë të qëlluar dhe të shpresojmë se do të dalim me rezultat në këtë çështje, prandaj vazhdojmë.

Pika e 14.

**14. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e pa varur për ankesa.**

Vërejtjet hyrëse:

Në pajtim me dispozitat ligjore, Qeveria e Kosovës i propozon Kuvendit të marr vendim për emërimin e 13 anëtarëve në Bordin e pavarur të ankesave. Propozim- vendimi i anëtarëve të Bordit, kohëzgjatja e mandatit dhe biografitë e kandidatëve të propozuar u janë shpërndarë të gjithë deputetëve. Në qoftë se përfaqësuesi i Qeverisë e sheh të arsyeshme, unë nuk po i lexoj emrat por nëse deputetët nuk e kanë materialin, mund t'ua rikujtojmë propozimin. Besoj që e keni materialin me veti. Qeveria në qoftë se e sheh të arsyeshme, urdhëro ministër Haki Shatri.

#### MINISTRI HAKI SHATRI:

Ju faleminderit z. Kryetar , deputetë të nderuar

Unë shkurtimisht do t'iu kujtoj që, në bazë të nenit 57.2 të Ligjit për administratën tatimore , anëtarët e Bordit propozohen nga Qeveria në bazë të aftësisë për kryerjen e funksioneve të tyre. Anëtarët emërohen nga Kuvendi, përpos dy anëtarëve të Bordit të cilët i emëron PSSP-ja, pas konsultimeve me Qeverinë. Në emërimin e parë , në bazë të dispozitave të këtij ligji, 7 anëtarë emërohen me mandat 2 vjeçar kurse 8 anëtarë emërohen me mandat 1 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje , por me qëllim që të sigurohet vazhdimësia e funksionimit të këtij Bordi. Qeveria më datën 13 dhjetor i ka identifikuar kandidatët e mundshëm të cilët i plotësojnë këto kushte dhe këtë propozim ia ka dërguar Kuvendit për miratim.

Kandidatët , emrat e të cilëve ia kemi dërguar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim për anëtarë të Bordit të pavarur të ankesave janë:

Lutfi Zharku , i propozuar për kryetar me mandat 2 vjeçar,  
Muharrem Ibraj - anëtar,  
Mentor Prekazi - anëtar,  
Azem Shefkiu - anëtar,  
Shaban Muharremi - anëtar,  
Nevruz Berisha - anëtar,  
Minire Begaj -anëtare . Këta janë propozuar me mandat 2 vjeçar.

Bahri Hyseni - anëtar,  
Hajdin Ramadani - anëtar,  
Islam Qeku - anëtar,  
Zijadin Maliqi -anëtar  
Qemajl Smajli - anëtar dhe  
Ljubisha Shupiç - anëtar me mandat njëvjeçar , kurse dy të tjerë mbetet që, në konsultim me Qeverinë , t'i emërojë Përfaqësuesi Special. Meqë biografitë e këtyre personave të propozuar për Bordin e ankesave i janë dërguar Kuvendit dhe sipas të dhënave që disponojnë i plotësojnë kushtet e parapara me ligj .Ju sugjeroj që t'i votoni dhe në këtë formë ta plotësojmë një Bord i cili ka një vit që po prolongohet dhe po na shkakton probleme jashtëzakonisht të mëdha në shqyrtimin e ankesave që bëjnë subjektet ekonomike në rastet e ankesave që kanë të bëjnë me ngarkesat tatimore. Ju faleminderit për mirëkuptim.

## KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ministër ju faleminderit. Për fjalë është paraqitur z. Jakup Krasniqi

## DEPUTETI JAKUP KRASNIQI:

Z. kryetar për fjalë jam paraqitur më herët dhe mendoj se është dashur që fjalën të ma jepni kur e kam kërkuar. Unë fjalën nuk e kam kërkuar për këtë pikë të rendit të ditës, por e kam kërkuar që t'iu njoftojë juve dhe të kërkojë nga ju dhe Qeveria që ndërtesa e ish Unionit, me një vendim të Qeverisë së përkohshme, i është dhuruar Galerisë së arteve. Të mos privatizohet por të mbetet për shkak se edhe vetë forma e sajë klasike do të ishte në interes edhe të artit por edhe të institucioneve të Kosovës që ai objekt të jetë objekt i kulturës dhe të mos privatizohet. Për këtë e kam kërkuar fjalën të cilën nuk e mora me kohë, kurse për këtë pikën e rendit të ditës është një anëtarë tjetër i Grupit parlamentar të PDK-së.

## KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Unë në qoftë se ka nevojë do t'iu kërkojë falje, se kam shikuar monitorin. Ia dhashë fjalën Alush Gashit, por me kënaqësi do ta përkrahi edhe atë vendim tuajin. Urdhëro z. Gani Koci

## DEPUTETI, GANI KOCI:

Ju faleminderit z. Kryetar. Të nderuar deputetë: Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, gjegjësisht propozimin e Bordit të ankesave nga ana e Qeverisë ne pak sa jemi në konfuzion për arsye se kemi pasur një propozim të tillë nga Qeveria e Kosovës në muajin qershor të vitit 2005 dhe atëherë Kuvendit i është proceduar vendimi Qeverisë i mbajtur me një datë në muajin e 6 të vitit 2005 dhe se lista e anëtarëve të Bordit ka qenë një listë tjetër, ndërsa lista ose propozimi i dytë që na vjen edhe në dhjetor ka hequr katër emra nga lista ose nga propozimi i parë dhe do të kërkoja nga Qeveria të deklarohet se kur është tërhequr dhe me cilin vendim është tërhequr propozimi i parë, do të thotë i muajit qershor 2005, dhe mbi çfarë baze është ndryshuar lista që nuk e kemi sot të njëjtën që nuk e kemi pasur në qershor të vitit 2005 dhe në anën tjetër cila është baza juridike dhe ligjore e formimit të një agjencioni të tillë të një bordi të tillë të ankesave, kur dihet se me Rregulloren e punës së Qeverisë, në nenin 4.3 ku edhe janë mbështetur, përveç tjerash thotë: „Qeveria merr vendime, bën politika e tjera” dhe nuk thuhet askund se edhe formon të gjithë rregulloren e punës së Qeverisë. Nuk del se Qeveria e bën një bord të tillë të ankesave. E dyta cilat kanë qenë kriteret për anëtarët e këtij bordi për zgjedhjen dhe propozimin e anëtarëve të këtij bordi, a është ky një agjencion kushtimisht të them i pavarur dhe nëse është i tillë, pse duhet në këtë përbërje të ketë edhe deputetë të parlamentit të Kosovës dhe në qoftë se duhet të ketë deputetë të parlamentit të Kosovës pse nuk është respektuar përbërja e Kuvendit të Kosovës, natyrisht sipas grupit politik që e përfaqësojnë këtu dhe në anën tjetër, mbi çfarë baze rregullative dhe ligjore do të

funksionojë ky bord dhe cila është puna , kompetenca dhe përgjegjësia e këtij bordi dhe kujt i përgjigjet ky bord. Në qoftë se themi kushtimisht ky bord do të shqyrtojë, analizoj gjithë ankesat që vijnë për Qeverinë dhe institucionet qeveritare , atëherë si do të mund të jetë bord i pa varur dhe bord i ankesave kur vetë Qeveria e bën këtë dhe punon për qeveri. Këto janë disa arsye që ne si Grup parlamentar , formën, mënyrën dhe bazën mbi të cilën ngritet ky bord nuk i kemi të qarta dhe nuk mund të pajtohemi e të vendosim lidhur me këtë Bord të ankesave deri sa nuk na jepen sqarime se katër anëtarë të këtij bordi, nga propozimi i parë, janë hequr në propozimin e dytë, një dhe e dyta a duhet të ketë deputetë dhe nëse duhet të ketë deputetë pse nuk është respektuar përbërja e Kuvendit të Kosovës?

**KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:**

Unë do ta lusja ministrin, por para ministrit një sqarim një përgjigje. Z. Gani Koci dhe grupi i PDK-së rendi i ditës është miratuar. Në mënyrë procedurale nuk e keni të drejtën për të kërkuar heqje, për krejt këto sqarimet tjera unë mendoj që ministri është këtu dhe unë e kuptova si dëshirë të mirë që të ngritet cilësia e të ketë informacion në parlament , por nuk kemi të drejtë tash pos në qoftë se grupet parlamentar e arrijnë,

Urdhëro Gani, replikë

**DEPUTETI GANI KOCI:**

Ne nuk kërkuam që të hiqet nga rendi i ditës ky propozim. Kjo pikë e rendit të ditës ka qenë në muajt korrik dhe gusht në rend të ditës. Nuk dihen arsyet pse është hequr nga rendi i ditës .Ne vetëm kërkojmë sqarim pse është bërë ndryshimi i propozimit. Mbi çfarë baze është bërë ndryshimi i propozimit dhe në qoftë se në atë komision ose në atë agjencion ta quaj bord duhet të ketë deputetë të Kuvendit, por në qoftë se duhet të ketë deputetë pse nuk është respektuar përbërja e Kuvendit të Kosovës.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Ministri Shatri, urdhëroni

**MINISTRI HAKI SHATRI:**

Ju faleminderit. Unë vetëm do të jap përgjigje. Bordi i pa varur për shqyrtimin e ankesave themelohet në bazë të ligjit për administratën dhe procedurat tatimore të miratuar në këtë Kuvend dhe të shpallur nga Përfaqësuesi Special më datën 9 prill e që ka hyrë në fuqi prej datës 1 maj 2005. Në bazë të këtij ligji , neni 57 dhe nenet që pasojnë përcaktojnë saktësisht rregullat e funksionimit të mënyrës së raportimit dhe përgjegjësisë së Bordit të pa varur të ankesave. Bordi i pavarur i ankesave , në bazë të këtij ligji , themelohet nga Kuvendi i Kosovës, por propozimin e anëtarëve të Bordit e bënë Qeveria , në bazë të

dispozitive të këtij ligji dhe kriteri kryesor për të qenë anëtarë i Bordit është aftësia profesionale. Me aftësi profesionale nënkuptohet që anëtari i Bordit të ketë certifikatën si auditor i pa varur dhe të jetë i certifikuar si kontabilist. Pra, strikt në profesionin me të cilin do të merret si anëtarë i bordit. Meqenëse në propozimin e parë ka pas disa propozime të cilat pikërisht këto kriteret nuk i kanë plotësuar, Grupi parlamentar i LDK-së ka kërkuar që kjo të tërhiqet dhe anëtarët e propozuar të cilët nuk i plotësojnë këto kriteret të rishqyrtohen. Këtë propozim të Grupit parlamentar të LDK-së, Qeveria e ka shqyrtuar edhe në mbledhjen e datës 13 dhjetor. E ka kompletuar një regjistër me propozime, biografitë e të cilëve ju i keni marrë dhe me këto biografi mund të shihni se në mënyrë strikte i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara me ligj. Prandaj, ky është propozimi i Qeverisë dhe ju ftojë që ta votoni në mënyrë që ta kemi këtë bord, sepse vërtetë është shumë i nevojshëm për arsye praktike. Ju faleminderit shumë.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Xhavit Haliti, anëtarë i Kryesisë, po ju jap përparësi, urdhëroni

**DEPUTETI, XHAVIT HALITI:**

Unë nuk e konsideroj veten si specialist për këtë fushë, por mendoj që çështja u ngrit lidhur me formulën e përzgjedhjes dhe ministri Shatri e tha që është marrë parasysh kriteri profesional dhe aftësia profesionale, por për mua nuk është e qartë sa duhet dhe mendoj që nuk është në pajtim me Ligjin për shkeljen e interesave ose interesave të dyfishta nga buxheti i Kosovës, që edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës të jetë edhe anëtarë i atij bordi dhe në këtë rast do të kërkojë edhe një sqarim shtesë se anëtarët e këtij bordi a paguhen dhe kush i paguan. Në qoftë se paguhen nga buxheti i Kosovës unë mendoj që një deputetë i Kuvendit të Kosovës nuk mund të jetë në atë bord, sepse atëherë është konflikt interesash.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Gani Koci urdhëro,

**DEPUTETI GANI KOCI:**

Unë do të them vetëm një emër nëse i ka plotësuar ose nuk i ka plotësuar kriteret për të cilat tha z. Ministër. Nuk besoj prej gjithë këtyre, me përjashtim të ndoshta disave që, mund t'i plotësonte kriteret më shumë se sa Bedri Hamza i cili ka qenë i propozuar në propozimin e parë, por arsyeja e heqjes së tij ka qenë thjeshtë arsye politike, për shkak se Bedri Hamza i takon Kabinetit të qeverisjes së mirë të PDK-së së Kosovës. Nuk besoj nga të gjithë këta që të ketë profesionalist dhe t'i ketë gjithë ato, si të them, licenca të auditimeve si Gani Geci që punon në administratën tatimore tash dhe që profesionalisht është shumë i ngritur. Nuk besoj që mos t'i ketë plotësuar edhe kërkesat edhe kriteret edhe Besa Morina që është hequr e gjithashtu edhe Tomor Zhavci.



Heqja e këtyre emrave nga kjo listë ka qenë thjeshtë politike dhe është politike e jo për shkak të kriterëve profesionale , sepse edhe në propozimin e parë ne i kemi pasur biografitetë e secilit anëtarë dhe të gjitha të dhënat që kanë qenë dashur të kërkohen ato kanë qenë të plotësuar. Kush e ka propozimin e parë le t'i marrë dhe t'i shoh se a i kanë plotësuar kriteret njerëzit e tillë që janë hequr në propozimin e dytë.

**KRYETARI I KUVENDIT , NEXHAT DACI:**

Ju faleminderit, Gjylnaze Syla urdhëroni

**DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA:**

Ju faleminderit z. Kryetar. Në emër të grupit konsideroj se ne duhet t'ia fillojmë punës për arsye se në rend të ditës e kemi shqyrtimin e propozimit për emërimin e anëtarëve dhe ashtu në qershor nuk e kemi kryer këtë punë dhe mendoj që duhet të përqendrohemi në punën që e kemi dhe të fillojmë.

Ju faleminderit

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Ju faleminderit .Për këtë debat nuk ka më të paraqitur. Lus regjinë për vendimmarrje.

Të pranishëm janë 89 deputetë. Regjia bëhuni gati për vendimmarrje dhe votojmë tani:

Për .....51 deputetë

Kundër..... 30 deputetë

Konsideroj se propozimi i Qeverisë për çështjen e shqyrtuar u miratua.

Kalojmë në pikën e radhës.

#### **15. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Agjencisë për Prokurim Publik**

Qeveria e Kosovës i propozon Kuvendit që të miratojë vendimin për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Prokurim Publik dhe atë:

Vlora Kuqi - kryesuese e agjencisë,

Behxhet Rrukiqi , anëtar

Sami Uka , anëtar

Sadik Veliu , anëtar dhe

Sabri Ramadani , anëtar.

Propozimi i vendimit të Qeverisë bashkë me CV-të e kandidatëve me kohë u janë shpërndarë të gjithë deputetëve, sipas nevojës . Në qoftë se dikush nuk e ka të qartë , përfaqësuesi i Qeverisë mund të bëjmë ndonjë. Z. Naser Osmani - kryetar i Komisionit për Buxhet, pastaj le të përgatitet Gani Koci .

**DEPUTETI NASER OSMANI:**

Faleminderit z. kryetar , z. ministër dhe kolegë

Vazhdimisht kam insistuar që të formohen sa më parë komisionet , agjencionet dhe bordet e tjera, mirëpo kjo nuk do të thotë që nuk do të kemi nga pak edhe vërejtje në cilësinë e atyre që janë propozuar. Për këtë agjencion kam një vërejtje konkrete për kandidatin e dytë, Behxhet Rrukiqi, për të cilin kemi vërtetuar se personi në fjalë nuk ka diplomuar ende dhe është i pa diplomuar dhe konsideroj se nuk e ka vendin në këtë agjencion dhe propozojmë që të tjerët t'i votojmë , ndërsa kandidatin e pestë Qeveria t'ia propozojë Kuvendit në një seancë tjetër. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Naser ju faleminderit. Unë mendoj që vërejtja është e akceptueshme .Edhe ministri po prandaj, ky emër që nuk i plotëson ato kriteret hiqet prej vendimmarrjes.

Urdhëro , Gani Koci.

**DEPUTETI GANI KOCI:**

Për të mos i përsëritur ato që i thash më parë rreth këtyre farë bordesh që na u kanë bërë aq shumë që nuk e dimë as vetë sa janë , dua të them të njëjtën gjë se edhe për këtë çështje i kemi pasur dy propozime: njërin e kemi pasur më 17 maj 2005 dhe këtë më 13 dhjetor 2005. Brenda gjashtë muajsh kemi dy propozime.

Edhe të propozuarit e fundit, lista e të propozuarve të fundit ndryshon nga lista e të propozuarve të 17 majit 2005 . Edhe këta që e kanë propozuar unë nuk do të lëshohem në atë që e tha z. Naser rreth cilësisë së tyre , sepse Qeveria është dashur ta ketë parasysh , kur e ka ndryshuar listën , verifikimin e këtyre çështjeve por mua më duket se edhe këtu i vie era pak politikë dhe njerëzit, se përfshirja e njerëzve jo që vërtetë profesionalisht janë ngritur me këtë çështje po sa janë të afërt me këtë grupim ose me atë grupim politik ose të partive politike. Ne e dimë rëndësinë e bordit të prokurimit publik dhe e dimë se çfarë lufte bëhet që secili njerëzit e vet t'i vendos në këtë bord. Quhet bord i pa varur , por është më se i varur dhe do të dëshiroja që vërtetë në këtë listë të jenë emra që e meritojnë dhe jo emra që me propozim të kësaj ose të asaj partie të futen në këtë listë.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Ju faleminderit . Urdhëroni z. Xhavit Haliti

#### DEPUTETI XHAVIT HALITI:

Ju faleminderit. Unë duke u mbështetur në praktikën e kaluar që kemi votuar borde në Kuvendin e Kosovës dhe këto borde realisht nuk i kanë dhënë llogari deri më tash asnjë herë Kuvendit të Kosovës, asnjëri nga këto borde nuk është ardhur një herë të vetme një herë që thotë e kemi kryer këtë punë ose se kemi kryer, kemi këto pengesa ose ato pengesa, përveç që na u kanë drejtuar me kërkesa për mjete buxhetore. Mendoj që edhe mënyra se si i kemi zgjedhur dhe si janë propozuar ka qenë krejtësisht e gabueshme qoftë e mbështetur në ligj apo jo. Unë mendoj që këto borde dhe këta anëtarë të këtyre bordeve, meqenëse duhet të kalojë në procedurat në Kuvendin e Kosovës, do të duhej të kishin secili kundër kandidat të vetin dhe të votoheshin me kundër kandidatë ose të jepeshin votat për secilin në këtë Kuvend, por jo të votojmë në paket për njerëzit që vërtetë shumica prej nesh nuk dimë as kush janë as pse janë aty.

Nën dy, çështja tjetër se a ka diplomuar dikush apo jo, mendoj nuk është çështje e cila mund ta kufizojë dikë me qenë diku. Në qoftë se votohet në këtë parlament sepse këtu votohet më shumë politikisht se sa profesionalisht. Profesionalisht le t'i zgjedhin ministrat ose ministratë njerëzit, këshilltarët e tyre punonjësit e tyre. Në anën tjetër në qoftë se dëshirojmë ashtu ta bëjmë edhe Kuvendin me konkurs kush çfarë shkolle duhet me pas dhe të konkurrojmë këtu, mendoj që votimi në Kuvend nuk duhet me qenë i kushtëzuar ka diplomuar dikush apo nuk ka diplomuar, a është i përshtatshëm në qoftë se na binin këtu a është i përshtatshëm apo nuk është dhe votim pa kundër kandidat nuk e shoh të drejtë dhe se shoh votim demokratik, por edhe mënyra e sjelljes e pa përgjegjshme pa dhënë llogari asnjë herë këtu për mua është shumë e gabueshme. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Z. Jakup Krasniqi,

#### DEPUTETI JAKUP KRASNIQI:

Të nderuar deputetë. E ndjej veten të obliguar t'i them pak fjalë për mënyrën se si janë duke u bërë përzgjedhjet në Bordin mbikëqyrës që shpesh quhen të pavarura. Nëse ideja e këtyre bordeve është pëlqim kontrollues të punëve të ministrisë e të ministrive dhe të Qeverisë me qëllimin më të mirë për t'i penguar keqpërdorimet, keq menaxhimin, për të mbrojtur buxhetin e konsoliduar të Kosovës, mënyra se si po përzgjidhen thjeshtë nuk ofron diçka të tillë përkundrazi.

Të nderuar deputetë. Duke parë këto përzgjedhje si po bëhen e kam të drejtën për të reaguar se kam reaguar për mënyrën si janë zgjedhur këto borde edhe kur kam qenë ministër në Qeverinë e kaluar dhe kam thënë. Unë kam kundërshtuar edhe atëherë po kundërshtoj edhe sot.

Këto borde nuk po krijohen për të mbikëqyrë dhe për të bërë punë më të mira, por po bëhen borde për të legjitimuar krimin dhe korrupsionin sidomos korrupsionin në institucionet e Kosovës. E ndjej përgjegjësinë si deputetë. E kam ngritur zërin me kohë po e ngriti edhe sot dhe vërtetë po më vjen keq që jam pjesë e një mekanizmi i cili në vend që të formojë borde për të bërë një qeverisje më të mirë po krijon borde për të legjitimuar korrupsionin në institucionet e Kosovës. A duhet ta ketë këtë rol parlamenti i Kosovës është mirë që secili deputetë t'ia parashtrojë këtë pyetje vetes. Z. kryetar nëse vazhdohet në këtë mënyrë të jeni të bindur se buxheti i Kosovës, përveç që po legjitimohet korrupsioni dhe krimi, po ngarkohet me nëpunës që janë në shërbim të stafit politik të ministrave dhe të qeverisë dhe nuk e shoh të arsyeshme që ministri të krijojë administratë që kontrollon përsëri ministri apo edhe kryeministri dhe po bëhet një ngarkesë shtesë në buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Unë jam që, së paku me këto borde që janë bukur të mëdha që marrin rroga të majme, mos të ngarkohet buxheti i konsoliduar i Kosovës se këta janë duke u vënë në shërbim të ministrave e jo në shërbim të qeverisjes së mirë në Kosovë. E ndjeva si obligim t'i them këto fjalë se vërtetë këto borde edhe një herë po e them janë borde për të legjitimuar krimin ekonomik në Qeveri dhe në institucionet tjera të Kosovës. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Jakup faleminderit. Fjalën e ka ministri pastaj profesor Gashi dhe Behxhet Brajshori

#### MINISTRI HAKI SHATRI:

Ju faleminderit z. Kryetar. Të nderuar deputetë unë nuk do të sillem në pjesën e polemikave me anëtarët e Kuvendit sepse unë nuk jam deputetë dhe nuk dua t'i lejoj vetes që të vihem në raporte ose në relacione të polemikave, por vetëm ndiej për obligim të sqaroj që Qeveria nuk ka propozuar borde për të ngarkuar buxhetin por Qeveria e ka propozuar bordin i cili është i paraparë me Ligjin për prokurimin publik.

Bordi për agjencionin e prokurimit publik është dashur të formohet nga 1 qershori i vitit 2005 dhe siç e dini tri herë në këtë Kuvend ka dështuar, pikërisht për shkak të fërkimeve që kanë ndodhur në Kuvend rreth pozitës së anëtarëve të propozuar të bordit dhe përkatësisë partiake të tyre. Ne kemi propozuar një bord i cili e ka një funksion dhe një rol të limituar. Bordi i agjencionit të prokurimit publik të funksionojë në bazë të ligjit dhe ka mandat dy vjeçar. Me ligj është paraparë që ky bord të funksionojë deri në aftësimin e plotë të njësisë të prokurimit nëpër organizatat buxhetore dhe kjo është paraparë që të bëhet brenda dy viteve dhe pastaj ky bord do të pushojë së funksionuari. Nuk do të funksionojë më sepse konsiderohet i pa nevojshëm. Deri më tash bordi ka funksionuar në

fakt udhëheqja e agjencionit të prokurimit ka funksionuar jashtë ligjit. Është një bord që ka funksionuar në periudhën para tri katër vitesh dhe ka kryer punën e vetë. Nuk do ta vlerësojë se besoj që e ka kryer mirë, por është koha që ne ta respektojmë ligjin dhe ta formojmë bordin.

Nëse më lejohet do t'i isha përgjigjur deputetit Xhavit Haliti vetëm në pyetjen e parë që i mbeta borxh. Anëtarët e bordit të ankesave nuk paguhen , nuk marrin paga. Anëtarët e bordit paguhen për seanca që i mbajnë në bazë të praktikave të deritashme. Një seancë një shqyrtim i një ankese mbahet maksimum një herë në javë dhe paguhet 25 € .Kjo është ajo që mbahet d.m.th. kompensimi material. Ju faleminderit

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Ministër ju faleminderit. Fjalën e ka profesor Gashi pastaj Behxhet Brajshori

**DEPUTETI ALUSH GASHI:**

I nderuari z. kryetar,

Grupi parlamentar i LDK-së , lidhur me këtë çështje që debatohet , është në dijeni të plotë dhe i pa luhatshëm se zbaton një obligim të paraparë me ligj. Ne jemi shumë të hapur që në nismë të opozitës apo të një grupi tjetër d.m.th. një grupi të konsiderueshëm të deputetëve ta marrim në konsideratë, sa herë që është e nevojshme, që ta ftojme bordin të informohemi për punën e tyre dhe ta kontrollojmë punën e tyre. Po ashtu nëse në këtë Kuvend mendohet se ka mënyra më të mira ligjore se kjo e cila sot për sot është e rregulluar me ligj ne jemi të gatshëm që t'i marrim në shqyrtim amendamentet e tyre dhe së bashku me opozitën ta gjejmë një zgjedhje më të mirë.

Me këtë nivel të ndërtimit të demokracisë sonë ne na është sugjeruar nga ekspertë vendor dhe ndërkombëtar se kjo është mënyra e veprimit të vendeve në tranzicion dhe jemi të përkushtuar ta miratojmë këtë listë. Fatmirësisht në shoqërinë kosovare ka mjaft kuadro të aftë të cilat kishin për t'u kualifikuar me qenë në këtë bord , por siç e shihni numri i anëtarëve të këtij bordi nuk është i tillë që të mund të përfshiheshin të gjithë. Ne e falënderojmë opozitën për kontributin e dhënë në këtë debat dhe ju ftojme z. kryetar që propozimin e Qeverisë ta qitni në votim. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Ju faleminderit profesor Gashi. Urdhëroni z. Brajshori

**DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI:**

Z kryetar, të nderuar deputetë e ministra,

Atë që desha ta them unë e tha ministri Shatri. Ne vetëm po e plotësojmë një obligim ligjor dhe ky bord është i nevojshëm. Ftoj deputetët dhe kolegët që ta votojmë si u tha më herët. Ju faleminderit

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

E ftoj regjinë të bëhet gati për të votuar dhe votojmë tani:

Për ..... 53 deputetë

Kundër .....28 deputetë

Propozimi i Qeverisë ka kaluar, me vërejtjen që është hequr kandidati i cili nuk i plotëson kriteret ligjore. Ju faleminderit dhe vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**16. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Rregullatorit të energjisë.**

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit për rregullatorin e energjisë, Qeveria e Kosovës i propozon Kuvendit që të merr vendim për emërimin e dy anëtarëve të Bordit për rregullatorin e energjisë dhe atë:

Peranda Beqiri, Fakulteti Ekonomik Prishtinë dhe  
Nusret Avdiu, profesor i Fakultetit elektroteknik në Prishtinë

Propozim - vendimi së bashku me arsyetimin dhe biografite e kandidatëve të propozuar u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Sipas nevojës arsyetimin për ta mbështetur këtë propozim mund ta paraqes përfaqësuesi i Qeverisë do të thotë nëse ka nevojë dikush për sqarime ose ministri. Nuk ka debat lus regjinë të përgatitet për votim dhe votojmë tani: Në sallë janë 87 deputetë.

Për ... ..... 59 deputetë

Kundër ..... 19 deputetë

Konsideroj se është miratuar propozimi i Qeverisë

Pika e radhës është:

**17. Shqyrtimi i propozimi të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Këshillin e Agjencisë kundër- korrupsion**

Kryesia e Kuvendit, në disa mbledhje radhazi, ka shqyrtuar kërkesën e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të këshillit të Agjencisë kundër- korrupsion bashkë me listën e të nominuarve nga institucionet e përcaktuara me ligj e cila duhet të plotësohet me tre përfaqësues të emëruar nga Kuvendi. Kjo çështje ishte temë debati edhe në seancën e kaluar e cila vendosi që miratimi të shtyhet për seancën e radhës me qëllim që të sigurohen të dhënat biografike për çdo kandidat të propozuar dhe të sigurohet marrëveshja e grupeve parlamentare për propozimin e tre anëtarëve nga radhët e Kuvendit.

Propozimi i Qeverisë bashkë me të dhënat biografike të kandidatëve të nominuar, u është shpërndarë me kohë të gjithë deputetëve. Deri më tani nuk kemi njohuri për marrëveshjen eventuale të grupeve parlamentare, përkundër kësaj Kuvendit i kanë arritur propozimet e veçanta nga disa prej grupeve parlamentare edhe atë nga Grupi parlamentar i LDK-së

Sadudin Berisha dhe Fadil Gashi, Grupi parlamentar i PDK-së nuk ka emër, Grupi parlamentar i AAK-së Ymer Halimi, nga Partija Demokratike Serbe si pjesë e grupit parlamentar të komunitetit serb Sasha Gjokiq dhe nga Gupi parlamentar për integrim dr. Ferid Agani.

Urdhëroni, Jakup Krasniqi

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI:

Z. kryetar, ne grupet parlamentare nuk jemi marrë vesh për anëtarët e parlamentit në këtë bord të Agjencionit anti - korrupsion dhe mendoj që edhe këtu jemi, dhe është përshpejtuar. Ne si grup parlamentar mendojmë që pasi Qeveria dhe gjithë institucionet tjera dhe koalicioni që është në bashkëqeverisje ka propozuar dhe ka anëtarë të tjerë në këtë bord ka kuptim që nga parlamenti të jenë kryesisht anëtarët nga grupimet e opozitës dhe jo nga pozita, nëse vërtetë dëshirojmë të kemi një agjencion pak a shumë të balancuar për të qenë bar anti- korrupsion.

Nëse nuk ndodhë kjo dhe vendoset me makinerinë e votës mund të vendoset por unë ndoshta kisha bërë edhe një pyetje shtesë për juristët. Për të votuar për ministra duhet të ketë së paku 50+1 për ligje e dimë që duhet të jenë shumica e anëtarëve prezent në Kuvend po a duhet të kërkohet që edhe për anëtarët e bordeve t'i kenë 50+ 1 të votave të deputetëve të parlamentit apo me shumicën e votave dhe konsideroj që këto borde nuk janë zgjedhur për faktin se janë zgjedhur vetëm me shumicën e votave por jo me 50 + 1 dhe kjo është një defekt tjetër mendoj për këto borde.

Nëse vazhdojmë t'i zgjedhim këto borde si po i zgjedhim edhe mund të zgjidhet edhe kjo e Agjencionit anti- korrupsion mendoj që është mirë t'ia ndërrojmë emrin, ta bëjmë: Agjencioni për legjitimimin e korrupsionit në institucionet e Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Z. Kryetar i Grupit parlamentar të PDK-së, kryetari i Komisionit ad-hoc për rregullore të Kuvendit ka qenë nga grupi parlamentar i juaji dhe shumica e rregullave janë dominuar në përkrahje të unitetit të plotë në opozitë por meqë çështja është e ndjeshme, unë do t'ju propozoj 15 ose 30 minuta pauzë. Shefat e grupeve parlamentare në këtë kohë mundohuni edhe një herë duhet, në qoftë se keni nevojë për ndihmën time unë jam i gatshëm por nuk dua të ndikoj. Mund të jem edhe unë i pranishëm por unë po ju lë të lirë dhe ju lutem në qoftë se edhe atëherë nuk merreni vesh në asnjë mënyrë proceduralisht e kemi në rend të ditës dhe do të procedojmë ashtu si jemi të obliguar. Prandaj po ju lë jo 15 minuta por 35 minuta kohë, vazhdojmë me të njëjtën temë mundohuni të gjeni një marrëveshje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë mendoj që mund të vazhdojmë. Më tepër se 70 deputetë ndodhen në sallë. Besoj që ishte një pauzë e mirë pune dhe e frytshme. Unë besoj që shefat e grupeve parlamentare

janë këtu pos Jakup Krasniqit. Prof. Alush Gashi mund të na raportojë për atë për çka janë marrë vesh. Profesor urdhëroni.

**DEPUTETI ALUSH GASHI:**

Faleminderit z. Kryetar. Së pari ju falënderojmë për mundësinë e dhënë që gjatë seancës të konsultohen shefat e grupeve parlamentare , d.m.th. pozita dhe opozita. Më lejoni që shkurtazi t'ua përcjell marrëveshjen tonë. Ne u pajtuam që themelimi i Agjencisë kundër- korrupsion është i domosdoshëm dhe e konsiderojmë si vendim dhe punë të kryer.

Ne , po ashtu biseduam për modalitet e ndryshme të themelimit të kësaj agjencie si dhe e pamë të arsyeshme që të kërkojmë nga ju të na jepni kohë deri në seancën e ardhshme që t'i studiojmë modelet e vendeve të ndryshme në veçanti të atyre në tranzicion për mënyrën e funksionimit të këtij komisioni apo të kësaj agjencie. Siç jeni në dijeni për çështje si kjo si dhe për komisionet parlamentare të zbulimit dhe kundër zbulimit ka modele të ndryshme ku është modeli i bashkëkryetarëve apo modeli i opozitës, por natyrisht i vendeve demokratike këto çështje i udhëheqin ata të cilët e kanë shumicën në parlament. Për të mos e zgjatur ne u morëm vesh që z. kryetar të kërkojmë nga seanca plenare që kjo çështje të vazhdojë në seancën e parë të Kuvendit të Kosovës e cila do të mbahet sipas gjasave në javën e ardhshme, në mënyrë që idetë tona t'i diskutojmë në kuadër të grupeve parlamentare. Z. kryetar ne do të vijmë me emra të gatshëm, me propozime , në seancën e ardhshme. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Profesor ju faleminderit. Ne e besojmë që të gjithë e mirëpresim këtë , sepse më 23 do të jetë seanca e rregullt dhe nuk kemi asnjë arsye që të mos i japim shanse suksesit, prandaj besoj që nuk kemi nevojë as ta votojmë ku të gjitha grupet parlamentare pajtohen . Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës:

#### **18. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me buxhetin e ART-së për vitin 2006**

Konstatime hyrëse:

Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Kryesisë së Kuvendit që, konformë përfundimit të dalë nga seanca e datës 19 dhjetor 2005, të radhitë për shqyrtim propozim- buxhetin e Agjencionit rregullator për telekomunikacionin për vitin 2006.

Arsyetimin do ta paraqes kryetari i Komisionit z. Naser Osmani.  
Urdhëroni foltorja është për ju.

**DEPUTETI NASER OSMANI:**



Komisioni e ka shqyrtuar buxhetin për ART-në ashtu siç e parasheh Ligji për telekomunikacion dhe respektivisht ligji 2002/7 i cili është miratuar në këtë seancë më 8 maj 2003.

Neni 5 i këtij ligji kapitulli 1 ku flitet për fondet për buxhetin , revizionin dhe raportimin e ART-së parasheh që ART-ja të financohet nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës vetëm vitin e parë të veprimit të këtij agjencioni. Më tutje , parashihet që ky institucion të vetë financohet. Burimet për këtë institucion janë autorizimet, licencimet , dhënia e numrave dhe akordimi i të drejtës për përdorimin e spektrit frekuentor. Të gjitha fondet e mbledhura nga ART-ja depozitohen në një llogari të BPK-së dhe teprica e këtyre mjeteve derdhet në Buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Thjeshtë ne kemi vepruar në bazë të ligjit dhe kjo do të miratohet sot. ART-ja është dashur t'i paraqes një raport Kuvendit e që këtë nuk e ka bërë , por shpresojmë që deri më 28 shkurt do ta kemi edhe raportin ashtu siç parashihet me Ligji për menaxhimin e financave publike. ART-ja komisionit ia ka dorëzuar një version të vetin mbi kërkesat dhe nevojat për këtë vit. Ne e kemi shqyrtuar dhe me shumicë të votave mund të them se e kemi para jush dhe një sasi të mjeteve të domosdoshme që ART-ja të mund të funksionojë për këtë vit fiskal. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Naser ju faleminderit. Fjalën e ka Xhevat Bislimi. është paraqitur edhe Nazim Jashari

#### DEPUTETI XHEVAT BISLIMI:

Unë nuk e di z. kryetar a po funksionon kjo teknika e Kuvendit. Fjalën e kam kërkuar para pushimit dhe e kërkoja pas pushimit për pikën e 5. Në qoftë se më lejohet mund të vazhdojë për pikën që e kërkoja. Ende pa u marrë vesh grupet e kam kërkuar fjalën, por nuk e di a ishte gabim i teknikës.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Fjalën e ka Nazim Jashari. Le të përgatitet Safete Hadergjonaj

#### DEPUTETI NAZIM JASHARI:

Të nderuar kolegë deputetë , i nderuar z. kryetar

Kemi në rend dite shqyrtimin e menaxhimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me buxhetin e ART-së për vitin 2006. Pa dashur të kontestojë asgjë nga ajo që tha z. Kryetar , Naser Osmani, e që është evidente që ne po procedojmë sipas Ligjit për telekomunikacion dhe po e bëjmë një detyrë që na e ka ngarkuar ai ligj, ta miratojmë buxhetin e këtij agjencioni.

Më duhet të them një gjë që ne jemi vonuar bukur shumë me këtë procedim. Kjo punë është dashur të kryhet bashkë me Ligjin për buxhetin 2006. Unë tash realisht e kam të pa qartë se çka po bëjmë. Këtu përpara e kam Kornizën kushtetuese të Kosovës ku pjesa që flet për përgjegjësitë e Kuvendit thotë: „ Kuvendi ka përgjegjësitë e mëposhtme nën a : miraton ligje dhe rezoluta në fushat e përgjegjësisë të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes siç është parashtruar në Kreun 5 kurse 9.1.27 thotë ligjet pasi të shpallen në aktet legislative të detyrueshme të një natyre të përgjithshme kurse rezolutat janë deklaratat jo detyruese”. Unë tash nuk e di çka po bëjmë ne a po miratojmë ligj apo rezolutë apo çka po miratojmë. Siç e dimë Projektligji për buxhetin është një projektligj që diskutohet në Kuvend , miratohet në Kuvend dhe me miratimin tij ai bëhet i obligueshëm për të gjitha institucionet e Kosovës dhe mënyra e shpenzimit është e paraparë me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Tash e kemi një punë, po e bëjmë një punë dhe nuk e di a po e bëjmë ndryshimin e ligjit të buxhetit a është kjo pra një projektligj për ndryshimin e ligjit apo çka është. Ne po e autorizojmë një agjencion , pa u ditur me çfarë dokumenti po e autorizojmë. Për mua kjo është krejtësisht e pa kuptueshme dhe njëkohësisht e pa pranueshme. Ju faleminderit

#### KRYETARI KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Fjalën e ka Safete Hadergjonaj . Le të përgatitet Xhavit Haliti

#### DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ:

Ju faleminderit. Z. kryetar, të nderuar deputetë,

Në seancën e datës 19.12.2005 pati konfuzion rreth këtij projektbuxheti ashtu siç ka pasur konfuzion edhe në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Zbrazëtitë juridike të Ligjit për telekomunikacionin e thellojnë edhe më tepër këtë konfuzion dhe e vejnë Kuvendin në pozitë e pa lakmueshme tani kur duhet të votojmë për buxhetin e ART-së. Gjatë vitit të kaluar, ART-së buxheti i konsoliduar i Kosovës sipas nenit 5.1 të ligjit për telekomunikacion i janë ndarë 300 mijë euro. Po që se e shikojmë raportin 3 mujor, 6 mujor dhe 9 mujor të buxhetit është i vetmi institucion që ka marrë mjete nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe nuk ka raportuar për shpenzimet as për të hyrat. Ne sot kur duhet të miratojmë buxhetin e vitit 2006 të këtij autoriteti nuk dimë se cila ishte dinamika e shfrytëzimit të buxhetit në vitin e kaluar dhe cila është dinamika e realizimit të të hyrave. E vetmja gjë që e dimë është se me buxhetin e vitit 2005 janë paraparë 6.5 milion euro nga licenca të cilat nuk janë realizuar. Kjo është papërgjegjshmëri sepse të hyrat nuk janë pronë private e ART-së dhe për shfrytëzimin mjeteve të buxhetit të konsoliduar të Kosovës duhet të mbizotërojë mbi të gjitha transparencën.

Në ART-në nuk ka pasur transparencë, prandaj ka dyshime se ka pasur keqpërdorim por edhe korrupsion. Sipas ligjit për telekomunikacion neni 5.6 ART duhet t'i dorëzojë buxhetin për shqyrtim dhe miratim Kuvendit jo më pak se 2 muaj para fillimit të vitit fiskal. ART e sjell projekt-buxhetin në shqyrtim me datën 12.02. 2006 vetëm dy ditë para mbajtjes së seancës plenare ku sipas rregullit duhet të shqyrtohej buxheti. Me këtë bënë shkelje të Ligjit për telekomunikacion, neni 5.5, por edhe të Ligjit për financa publike

dhe përgjegjësi. Komisionit për Buxhet dhe Financa i është ofruar një kërkesë buxhetore në vlerë prej 1 milion e 91 mijë e 210 €, kurse në këtë projekt-buxhet janë paraparë të hyrat prej 18 milion eurosh. Komisioni për Buxhet ka bërë reduktimin e këtyre shpenzimeve në 794 mijë e 235 euro, por duke mos disponuar me të dhënat e mjaftueshme. Nuk konsideroj se është bërë një punë edhe aq serioze. Në buxhetin që sot është ofruar për miratim janë paraparë 164 mijë e 354 euro për paga dhe mëditje të 30 punëtorëve , ku paga mesatare e një punëtori është 456 euro për një muaj, kurse paga mesatare e punëtorëve në shërbimin civil është 219 euro. Në nenin 8.7 thuhet: „ ART do të dorëzojë një raport vjetor në Kuvend mbi punën e ART-së gjatë vitit paraprakë”. Kuvendi nuk disponon as me këtë raport për të ndarë mjete duhet bërë analiza paraprake, e për të bërë analiza duhet disponuar me të dhëna. Kuvendi nuk disponon me të dhëna, prandaj është jo logjike pa një kontroll nga ana e Kuvendit pa pasur kurrfarë informatash zyrtare nga ART-ja të bëhet ndarja e mjeteve. Unë nuk jam në dijeni nëse është respektuar neni 16.1 .A i ka dorëzuar ART-ja Kuvendit ndonjë raport sipas këtij neni. Gjatë këtij mandati ne nuk kemi pasur në dispozicion absolut asnjë raport. ART nuk ka respektuar as nenet 16. 3, 17.1 dhe 17.2 , ku sipas këtyre neneve ART është e obliguar të raportojë mbi baza vjetore në Kuvend. Për të miratuar këtë buxhet më parë është dashur të dimë pse ka munguar raporti për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore gjatë vitit 2005. ART ka shfrytëzuar mjetet që janë ndarë nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe është dashur të respektojë Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi ( 2003/17 ). A janë paraparë të hyrat e ART-së në buxhetin e konsoliduar të Kosovës të cilat ne sot duhet t'i miratojmë dhe nëse të gjitha të hyrat e ART-së janë të parapara në buxhetin e konsoliduar të Kosovës , atëherë duhet shikuar si të mbulohet disbalanca buxhetore. Dikush duhet të japi shpjegim si i ka shpenzuar ART-ja mjetet gjatë muajit janar dhe këtij muaji. Deri më tani a është respektuar Ligji për menaxhimin e financave dhe përgjegjësi. Kryetari i bordit të ART-së nuk mërzhitet shumë nëse Kuvendi miraton apo jo buxhetin siç ka theksuar edhe vet në mjetet e informimit pas seancës së datës 19.12.2005 , nga se është i prirë për keqpërdorime, por na mbetet neve si Kuvend të dimë të monitorojmë shpenzimet e parave publike , sepse askush nuk ka të drejtë të përvetësojë pasurinë publike apo të gërryëj bazën e burimeve financiare për interesa personale.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Urdhëroni z. Xhavit Haliti dhe Naser Osmani, urdhëroni Xhavit.

#### DEPUTETI XHAVIT HALITI:

Z kryetar unë sa i përket kërkesës për ndarjen e buxhetit nuk do të ndalem por mendoj për neve si deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe qytetarët e Kosovës është një interes i veçantë që të kemi informatat lidhur me frekuencat dhe lojën që po bëhet me këtë çështje në nivele të caktuara dhe në këtë rast nga ART-ja.

Frekuencat për telefonin mobile në Kosovë dhe për atë statike tokësore janë interes nacional i Kosovës dhe një nga interesat më të mëdha të Kosovës.

E dimë që nga mediat më së shumti dhe jo nga sqarimet që janë bërë në Kuvendin e Kosovës, nga njerëzit të cilët kanë qenë përgjegjës të bëjnë sqarime këtu, që i janë ndarë frekuencat një herë dikujt dhe është konstatuar shkelje e tenderit. Janë marrë frekuencat ngase me një vendim të veçantë të UNMIK-ut dhe prapë insistohet në këtë frekuencë.

Është thënë që është një kompani nga Sllovenia dhe ka dalë se ajo është nga Serbia. Tani prapë shtyhem bërërylas a ta japim a mos ta japim. Dihet nga mediumet që konflikti mes kompanisë „Mobtel” në mes vëllezërve Kariç dhe Qeverisë së Serbisë është aktual dhe unë nuk e kuptoj sinqerisht pse janë ndërprerë tash ato frekuencat e mobtelit (063-shit), në rrethanat kur konflikti është në mes Qeverisë serbe dhe Kariçëve. Unë nuk e kam të qartë sepse nga informatat e mia del që „Mobteli” si kompani është legale në Kosovë dhe është e licencuar pranë UNMIK-ut dhe është mirë për këtë çështje të na informoni a është e vërtetë a s’është e vërtetë kjo dhe ideja e licencimit të kompanisë së tretë është si kompani e tretë dhe jo kompani e dytë siç është interpretuar. Prandaj, duke pas parasysh që ART është e votuar në Kuvendin e Kosovës dhe ky Kuvend i Kosovës fatkeqësisht i ka dhënë mandat më të gjatë se mandatin e vetë që e ka, konsideroj që vetëm në raport me situatën e krijuar muajve të fundit, ART-ja është dashur të vijë këtu për të dhënë llogari ose me u shkarkuar nga ky Kuvend që e ka votuar dhe me zgjedh një bord të ri në këtë agjencion.

Prandaj, unë nuk jam dakord që ART-së t’i ndahet buxhet pa i sqaruar këto çështje në Kuvendin e Kosovës bashkë me kryeministrin dhe ministrat që kanë kompetencë për këtë çështje. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Khavit ju faleminderit. Z. Naser Osmani dhe po ju kërkojë falje z. Zef Morina, ministër në mandatin e kaluar, sigurisht donë një informatë, urdhëro Naser

#### DEPUTETI NASER OSMANI:

E mora përsëri fjalën për hir të një transparence të punës të Komisionit për Buxhet dhe Financa të cilën unë e udhëheq. Dua të bëjë publike që komisioni ka mbajtur disa mbledhje, disa takime, ku e ka shqyrtuar këtë buxhet për këtë institucion. E vërteta është që përveç përfaqësuesit të ORA-s, z. Nazim Jashari, të gjithë anëtarët e komisionit kanë votuar pro këtij buxheti dhe nuk është korrekte para mediave të dilet me qëndrime të tilla. Çështja e raportimit është çështje që ne do ta kemi në fund të muajit shkurt dhe të cilën sigurisht do ta bëjmë gati për seancë të muajit mars, eventualisht të muajit prill. Kjo qëndron kështu dhe ju lutem që ta miratojmë këtë buxhet. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Z. Zef Morina urdhëro.

## DEPUTETI ZEF MORINA:

Ju faleminderit z. kryetar të nderuar ministra e deputetë. Është e vërtetë që sipas Ligjit mbi telekomunikacionin Bordi i ART-së dhe kryesuesi i bordit duhet së paku një herë në vit të raportojë për punën e tij gjatë vitit, do të thotë që e ka kaluar d.m.th. unë sa e di deri më sot nuk është raportuar, por sido që të jetë funksionimi i bordit të ART-së është shumë i domosdoshëm dhe buxheti duhet të miratohet, sepse veç jemi vonuar shumë. Dëshiroj ta bëjë me dije opinionin në lidhje me dy çështje: Sa i përket licencës së telefonisë mobile „Mobtel” të Kariçve dhe sa i përket tenderit të telefonisë mobile që është shpallur para dy vitesh. Në atë kohë unë edhe si bashkëdrejtues që nga viti 2000 dhe si ministër këtë çështje e kam hulumtuar shumë dhe mund të them që kompania „Mobtel” në Kosovë nuk ka pasur licencë prej vitit 1999 e këtej.

Licencën të cilën e ka pasur e ka vlejtur për territorin e Serbisë dhe atë e ka marrë në vitin 1995 nga Ministria e telekomunikacionit të Serbisë, e cila licencë vlen deri në vitin 2015. Në atë kohë kur ishte kryeadministrator z. Kushner është marrë qëndrim që „Mobteli” të operojë vetëm në ato vende ku ka pasur të drejtë d.m.th. në Prishtinë dhe në Mitrovicë dhe të mos i lejohet zgjerimi në pjesë të tjera të Kosovës. Arsyeja ka qenë sepse Serbët nuk kishin mundësi të zgjerohen ose të inkuadrohen në valën 900. Ajo që dua të them është shumë e vërtetë që prej atij momenti kur ne kemi kërkuar ndërprerjen ose së paku paraqitjen e raporteve për pagesën e taksave ndaj Kosovës ose UNMIK-ut, Kariçët asnjëherë nuk kanë sjell asnjë raport ose „Mobteli”. Në atë kohë është kërkuar që të ndërpritet funksionimi i tij dhe si e tillë të bëjë kërkesë pranë UNMIK-ut ose më vonë pranë Qeverisë, këtë gjë nuk e ka bërë.

Gjithashtu, kur është shpallur tenderi i telefonisë mobile ka qenë neni i veçantë përmes të cilit ju ndalohet pjesëmarrja ose paraqitja e kërkesës operatorëve ilegal në Kosovë. Në këtë rast ka qenë edhe për „Mobtelin”. Sa i përket frekuencave, unë sa jam në dijeni frekuencat të cilat i përdorë „Mobteli” janë frekuenca të interferuara, për shkak të veprimeve që në atë kohë përmes KFOR-it rus ka qenë i instaluar edhe veprimi i telefonisë mobile „Mobtel”, kështu që mund të them veprimet e ART-së, tash për tash për ndërprerjen e frekuencave, janë konformë ligjit dhe natyrisht si e tillë nuk duhet të lejohet të operojë.

Sa i përket Mobtelit ose Mobitelit ose Mobikosit kjo është një procedurë dhe shpresoj që ART-ja është e obliguar të na raportojë për punën që është bërë, sepse ka shumë vonesa dhe kemi humbje shumë të mëdha.

## KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Z. Zef ju faleminderit.

Një vërejtje. Unë, për shkak të respektit që kam ndaj Xhavit Halitit, si anëtarë i Kryesisë, e lash me u larguar nga tema. Debat për diçka që nuk është në rendin e ditës nuk ka.

Anëtarja e komisionit Safete Hadergjonaj.

**DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ:**

Z. kryetar, desha të them atë që nuk është çështje këtu e mediave . Është çështje e parimeve , rregullave dhe ligjeve të cilat duhet t'i respektojmë ne të gjithë. Unë e kisha lutur kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa le t'i shikojë të gjitha procesverbalet për buxhet dhe financa dhe nga aty do ta shoh që kurrë nuk kam votuar pro këtij projektbuxheti të ART-së.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Z-nja Nekibe në qoftë se e keni për buxhet urdhëro.

**DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI:**

Dua ta them edhe atë që e thatë edhe ju. Nuk dua të largohem nga tema. Në rend dite kemi buxhetin për ART-në. Sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës , ART-ja është emëruar nga ky Kuvend si organ i pa varur i cili i përgjigjet këtij Kuvendi. Nderkaq buxhetin e ka të vetin gjithashtu të pavarur. Sa i përket atyre 6 milion eurove. Ato 6 milion euro nuk janë në buxhet të tij, por janë në bankë për deri sa nuk përfundon procesi i operatorit të dytë. Prandaj , meqë komisioni ka propozuar të miratohet buxheti unë nuk e shoh të arsyeshme që të mos votohet për buxhetin dhe të mos miratohet buxheti. Sa i përket raportit mund të jetë ajo një temë tjetër e rendit të ditës dhe ajo mund të bisedohet edhe për raport. Ju faleminderit

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Z-nja Nekibe ju faleminderit. E lus regjinë të përgatitet për votim dhe të votojmë tani.

Për..... 53 deputetë

Kundër..... 31 deputetë

Konstatoj se buxheti për ART-në u miratua.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

**19. Përgjigja e ministres, Melihate Tërmkolli, lidhur me interpelancën e Grupit Parlamentar të PDK-së.**

Vërejtjet hyrëse:

Në pajtim me Rregulloren e punës së Kuvendit, Grupi parlamentar i PDK-së i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit me ftesë për interpelancë të ministres së Shërbimeve Publike , Melihate Tërmkolli. Interpelancën e parashtruar Kryesia ia ka dërguar ministres Tërmkolli për shqyrtim dhe përgjigje. Në afatin e paraparë me Rregullore të punës ,

ministrja Melihate Tërkkolli është përgjigjur në përfundimin e Kryesisë. Përgjigja e ministres u është shpërndarë me kohë të gjithë deputetëve. Prandaj, mendoj që e keni përgjigjen. Nuk e shoh të arsyeshme por në qoftë se dikush mendon që duhet pa tjetër.

Ramë Buja , urdhëroni Ramë.

DEPUTETI RAMË BUJA:

Të nderuar deputetë , z. kryetar

Ne prej zonjës apo zonjushës ministre nuk kemi kërkuar të përgjigjet me shkrim as nuk kemi kërkuar leksion për Kryesinë e Kuvendit se si do të procedojë me këtë çështje. Ne kemi proceduar në mënyrë krejt të rregullt, edhe administrata edhe Kryesia , dhe ne kemi kërkuar që ministrja të paraqitet në interpelancë dhe t'iu përgjigjet atyre pyetjeve që ne jemi të gatshëm dhe është e domosdoshme që t'iu përgjigjet ajo. Prandaj d.m.th. është e nevojshme që ajo t'iu përgjigjet atyre pyetjeve që tash deputetët e Partisë Demokratike , ata që kanë bërë kërkesën për interpelancë, të përgjigjet në ato pyetje që i parashtrojnë ata, sepse forma si e kemi bërë pyetjen e përgjysmuar ka qenë jo e pa qëllim të me qëllim të kuptimit më pozitiv të mundshëm që ajo me kaosin që ka krijuar në ministrinë e sajë të përgjigjet për ato gjëra, edhe mund të thotë sepse nuk janë të tilla se çfarë ne po i themi dhe t'i arsyetojë edhe nëse është e kundërta e atyre, kështu që unë mund t'iu them që z-sha ministre do të duhej ta dinte se administrata është shtylla e shtetit , sepse është juriste dhe nuk do të duhej të luante dhe të manovronte me administratën as ajo as askush tjetër që mund të vie pas saj , sepse ajo është një shtyllë vertebrale dhe duhet të jetë qëndrestare dhe jo të luhet sipas tekeve të personave politik , ministrave që mund të vijnë në çfarëdo ministrie e edhe në atë të shërbimeve publike, prandaj besoj se ajo duhet ta dijë këtë. Nuk e di se sa e din.

Kështu që z-sha ministre është përgjegjëse të përgjigjet në këto pyetje. Jo të na japi as leksion e as përgjigje me shkrim, prandaj unë kërkoj që të hapet debati dhe unë përsëri kam mundësi të them atë që do të duhej ta them.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DADI:

Z. Xhevat Bislimi është paraqitur për fjalë, urdhëro

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI:

Po konsideroj se me këtë u hap edhe debati. Unë përveç shumë shkeljeve që i ka konstatuar grupi ynë dhe deputetët, përveç shkeljeve të shumta unë kam ndarë çështjen e kontratës që e ka pasur organizata „Çlirimi” për renovimin e pallatit të shtypit “Rilindja”.

Ne mendojmë që ministresha ka bërë ndërprerjen e kësaj kontrate pa të drejtë në kundërshtim me ligjin dhe për anulimin e kësaj kontrate e ka involvuar edhe Qeverinë.

Vendimi i kësaj kontrate është nënshkruar nga kryeministri i atëhershëm z. Ramush Haradinaj.

Shkelje tjetër të ligjit ne e konsiderojmë formimin e komisionit nga ministresha për vlerësimin e punëve të kryera deri në atë shkallë nga firma „Çlirimi“. Mendojmë se kjo ministri dhe personalisht ministresha nuk kanë pasur të drejtë të formojnë komision dhe unë kërkoj shpjegime nga ministresha, por deklaratën e sajë në shtypin e ditës më 15 korrik 2005, ku ajo publikisht deklaroi se ministria ose buxheti i Kosovës nuk i paguan asnjë cent kompanisë „Çlirimi“, kurse dokumentet ekzistojnë. Ne i kemi ato dokumente që i ka edhe ministria se me 28.06.2005 e njëjta ka paguar 750 e disa mijë euro për këtë kompani, prandaj në këtë kontekst ne mund ta kualifikojmë këtë deklaratë si dezinformim të opinionit nga personi zyrtar, konkretisht nga ministresha Melihate Tërmmkolli. Ju faleminderit.

Do të kërkoj shpjegime a qëndrojnë këto apo nuk qëndrojnë.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë dua t'iu jap shpjegime pastaj të shohim. Unë mendoj që nuk thash se debati është hapur. E lash një anëtarë të PDK-së të parashtrorë mendimin e vet. Unë po e lexoj atë që duhet parlamenti të nxjerrë dhe pastaj shkojmë më tutje.

Në interpelancë për ministreshën Melihate Tërmmkolli thuhet se nga e njëjta ka ardhur përgjigjja me shkrim dhe duhet të ndiqen procedurat e mëtejshme, nëse PDK-ja nuk është e kënaqur me përgjigjen dhe se Kryesia nuk ka marrë vendim as nuk ka sugjeruar që sot këtu në këtë mbledhje të hapet debat për këtë çështje.

Kështu kemi vendosur edhe në rastet e mëparshme dhe nëse deputetët konsiderojnë se Rregullorja e punës nuk është në rregull për këtë çështje, atëherë le të kërkojnë ndryshimin e saj, por edhe ashtu një propozim që ne u vonuam si Kryesi t'ia japim seancës plenare për punën. Në atë koncept parashihet që minimum të mbahet një seancë në muaj. Ora e parë do të thotë, prej orës 10 deri në 11, do t'ia kushtohet pyetjeve dhe përgjigjeve për ministrat dhe kryeministrin. Për Qeverinë, në fund të seancës, do të rezervohet një orë pune për pyetje dhe përgjigje dhe mund të shtjerrim këto, prandaj do t'iu lus që ta ndjekim këtë mënyrë të punës, sepse prapë do të hyjmë në atë veç kemi një numër të të paraqiturish dhe përfundimi dihet. Ju lutem të vazhdohet në seancën kur ka pyetje dhe përgjigje ose të ndiqet procedura e mëtejshme, në qoftë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur për debat. Ju e thatë një prej PDK, Ramë e arsyetoj atë, çka ju lutem po hap debat, vetëm anëtarë i kryesisë Xhavit Haliti, jo debat nuk kam hapur ju lutem, urdhëro Xhavit

#### DEPUTETI XHAVIT HALITI:

Unë e di që si institucione, duke përfshirë edhe Qeverinë edhe Kuvendin e Kosovës, kemi marrë si obligim për t'ia përmbushur edhe standardet dhe njëri nga ato është edhe instalimi i demokracisë pranë institucioneve dhe funksioni demokratik i tyre. Unë e di dhe të gjithë e dinë këtu se sa funksionale dhe se çfarë demokracie të brendshme dhe



çfarë transparence. I kemi të gjitha çështjet, të paktën për hir të kësaj do të duhej nga një herë të lozim në këtë kartën e demokracisë dhe jo të vazhdojmë praktika të dërgimit të letrave nga Qeveria dhe mos me a në interpelanca ku flohen ministrat dhe ministri. Ju kisha lutur që të mos vazhdohet me këtë praktikë.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Xhavit unë mendoj se propozimi qëndron. Unë thashë që Kryesia ta përgatis një propozim të plotë në seancë që do të jetë. Unë po e shoh që nuk duhet të ndiqet vetëm rruga që ju propozova. Ju lutem rrugë tjetër nuk ka, prandaj po ju lus nuk është hapur debat, procedurat i ndiqni në Komisionin për Legjislacion. Unë thash procedura e mëtejshme duhet të ndiqet, nuk po e mbrojë askënd, unë po ju lus, asnjë fjalë Gani Koci boll ke pasur kohë, kalojmë në pikën tjetër,

(polemikë)

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës,

#### **20. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare më 23 shkurt**

Në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 7 shkurt është propozuar miratimi i rendit të ditës për Seancën plenare më 23.02.2006. Propozimi i rendit të ditës u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Ju lutem në ndërkohë sot ka ardhur një kërkesë me shkrim nga deputeti Emrush Xhemajli, kryetar i LPK-së ku thuhet:

Në seancën e ardhshme plenare të Kuvendit të Kosovës të datës 23 shkurt 2006, në rend dite të jetë edhe një pikë e veçantë e rendit të punës (ditës), Informata apo Raporti i punës së grupit për statusin e Kosovës, me theks të veçantë për takimin e Vjenës. Ky grup është emëruar nga Kuvendi i Kosovës dhe është radha që më në fund të paraqitet para tij.

Unë mendoj që në parim kërkesa e deputetit është shumë në rregull, ta vlerësojmë vetëm kohën që më 20 shkurt është takimi Vjenës, a mund të përgatitet informacion për datën 23 shkurt. Prandaj unë them që ta pranojmë si seancë plenare por jo për datën 23 shkurt, por në seancën e parë menjëherë pas 23 shkurtit, prandaj ju faleminderit dhe me këtë e konsideroj seancën të përfunduar.

Shihemi në seancën tjetër.